



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E PODUJEVËS



PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL
2016 - 2025



KOMUNA E PODUJËVES

SHTATOR 2015

PËRMBAJTJA:

HYRJE

SISTEMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOSOVË
PËRFITUESIT E PROJEKTIT
BURIMI I TË DHËNAVE PËR HARTIMIN E PROFILIT KOMUNAL
ROLI DHE NATYRA E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL
ROLI I PJESËMARRËSVE
ROLET-VENDIMMARRËSE/JO VENDIMMARRËSE
QEVERISJA KOMUNALE
NDARJA ADMINISTRATIVE DHE QEVERISJA E KOMUNËS SË PODUJEVËS

FAZA E PARË

1. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

1.1 HISTORIKU I KOMUNES

1.2 POZITA GJEOGRAFIKE, KUFINJËT, MADHËSIA DHE MIKROPOZITA E PODUJEVËS

1.3 ZHVILLIMI DEMOGRAFIK

- 1.3.1 NUMRI I POPULLSISË
- 1.3.2 DENDËSIA E POPULLSISË
- 1.3.3 SHTIMI NATYROR I POPULLSISË
- 1.3.4 STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS MOSHËS DHE GJINISË
- 1.3.5 FAMILJA DHE KARAKTERISTIKAT E SAJË

1.4. ÇËSHTJET SOCIALE

- 1.4.1 ARSIMI
- 1.4.2 SHËNDETËSIA
- 1.4.3 PAPUNËSIA
- 1.4.4 VARFËRIA
- 1.4.5 KULTURA, RINIA DHE SPORTI
- 1.4.6 BARAZIA GJINORE

1.5. VENDBANIMET

- 1.5.1 STRUKTURA E VENDBANIMEVE SIPAS MADHËSISË
- 1.5.2 SHTRIRJA TERITORIALE E VENDBANIMEVE SIPAS MADHËSISË
- 1.5.3 KARAKTERISTIKAT MORFOLOGJIKE - URBANISTIKE TË VENDBANIMEVE
- 1.5.4 KARAKTERISTIKAT FUNKSIONALE TË VENDBANIMEVE
- 1.5.5 BANIMI
- 1.5.6 VENDBANIMET JO FORMALE
- 1.5.7 SHFRYTËZIMI I TOKËS

1.6 KARAKTERISTIKAT FIZIKO - GJEOGRAFIKE DHE MJEDISI

- 1.6.1 NDËRTIMI GJEOLOGJIK DHE MBËRTHIMI TEKTONIK
- 1.6.2 KARAKTERISTIKAT LITOSTRATIGRAFIKE
- 1.6.3 TEKTONIKA
- 1.6.4 SEIZMIKA
- 1.6.5 RELIEVI
- 1.6.6 TOKAT
- 1.6.7 BOTA BIMORE , LLOJET DHE PËRHAPJA
- 1.6.8 KUSHTET DHE KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE
- 1.6.9 HIDROGRAFIA NË KOMUNËN E PODUJEVËS

- 1.6.10 EROZIONI DHE VERSHIMET
- 1.6.11 NDOTJA E UJËRAVE
- 1.6.12 DEGRADIMI I LUMENJËVE
- 1.6.13 NDOTJA E AJRIT
- 1.6.14 DEGRADIMI I TOKËS
- 1.6.15 TRASHËGIMIA KULTURORE
- 1.6.16 TRASHËGIMIA NATYRORE

1.7 ZHVILLIMI EKONOMIK

- 1.7.1 BIZNESET
- 1.7.2 BUJQËSIA
- 1.7.3 TREGTIA
- 1.7.4 TURIZMI
- 1.7.5 INDUSTRIA
- 1.7.6 MINJERAT DHE XEHETARIA

1.8 INFRASTRUKTURA

- 1.8.1 INFRASTRUKTURA RRUGORE
- 1.8.2 RRJETI HEKURUDHOR
- 1.8.3 URAT
- 1.8.4 TRANSPORTI PUBLIK
- 1.8.5 ENERGJIA ELEKTRIKE
- 1.8.6 INFRASTRUKTURA E FURNIZIMIT ME UJË
- 1.8.7 SISTEMI I KANALIZIMIT
- 1.8.8 TELEKOMUNIKACIONI
- 1.8.9 MENAXHIMI I MBETURINAVE

1.9 KAPACITETET INVESTIVE

1.10. SWOT ANALIZA

1.11. SFIDAT E IDENTIFIKUARA

1.12. POTENCIALET LOKALE TË IDENTIFIKUARA

FAZA E DYTË

- 2. VIZIONI PËR KOMUNËN E PODUJEVËS**
 - 2.1 PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT**
 - 2.2 PARIMET E QEVERISJES SË MIRË**
 - 2.3 QËLLIMET AFATGJATE TË ZHVILLIMIT**
 - 2.4 PRORITETET STRATEGJIKE**

FAZA E TRETË

- 3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË KOMUNËS**
 - 3.1 KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR**
 - 3.2 SKENARËT E ZHVILLIMIT HAPËSINOR**
 - 3.2.1 ZHVILLIMI LINEAR
 - 3.2.2 ZHVILLIMI MONOCENTRIK
 - 3.2.3 ZHVILLIMI I KOMBINUAR
 - 3.3 STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR**
 - 3.3.1 ZONAT KRYESORE HAPËSINORE
 - 3.3.2 ZHVILLIMI EKONOMIK
 - 3.3.3 PARASHIKIMET DEMOGRAFIKE
 - 3.3.4 VENDBANIMET

3.3.5 ADMINISTRIMI TERRITORIAL

3.3.6 ZHVILLIMI I VENDBANIMEVE

3.3.7 VENDBANIMET JO FORMALE

3.4 INFRASTRUKTURA SOCIALE DHE TRASHËGIMIA

3.4.1 ARSIMI

3.4.2 INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

3.4.3 ZBUTJA E PAPUNËSISË DHE VARFËRISË

3.4.4 TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE

3.5 MOBILITETI DHE RRJETI I TRAFIKUT

3.5.1 INFRASTRUKTURA RRUGORE

3.5.2 URAT

3.5.3 RRJETI HEKURUDHOR

3.5.4 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

3.6 MJEDISI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

3.6.1 ZONA QENDRORE AKTIVE

3.6.2 ZONA MALET DHE PEJSAZHET

3.6.3 ZONA NATYRA DHE TURIZMI

3.7 FATKEQËSITË ELEMENTARE DHE MASAT MBROJTËSE

3.7.1 PARANDALIMI I VERSHIMEVE

3.7.2 MBROJTJA NGA EROZIONI

3.6.3 MBROJTJA NGA TERMETET

FAZA E KATËRT

4. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT KOMUNAL

4.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SOCIAL DHE ADMINISTRATES

4.1.1 ADMINISTRATE FUNKSIONALE DHE EFIKASE

4.1.2 SISTEM I AVANCUAR NE ARSIM DHE SHENDETESI

4.1.3 ZBUTJA E SHKALLES SE PAPUNESISE DHE VARFERISE

4.1.4 STRATEGJIA PER KRIJIMIN E KUSHTEVE ME TE MIRA NE VISET RURALE

4.1.5 ZHVILLIMI KOMPAKT DHE FUNKSIONALIZIMI I VENDBANIMEVE

4.1.6 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TE QENDRUESHEM MJEDISOR

4.1.7 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TE QENDRUESHEM EKONOMIK

4.1.8 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TE INFRASTRUKTURES

FAZA E PESTË

5. DISPOZITAT PËR ZBATIM

5.1 DISPOZITATE PERGJITHSHME

5.2 DETYRAT DHE MASAT PER ZBATIMIN E PLANIT

5.3 KUSHTET PER PERCAKTIMIN E DESTINIMIT TE SIPERFAQEVE

5.4 KUSHTET PER RREGULLIMIN E HAPESIRES

5.5 NDERTESAT ME RENDESI PER KOSOVEN NE KOMUNEN E PODUJEVES

5.6 ZONAT NDERTIMORE PER VENDBANIME

5.7 STRUKTURAT E NDERTUARA JASHTE VENDBANIMEVE

5.8 KUSHTET PER VENDOSJEN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE

5.9 MASAT PER MBROJTJEN E PEISAZHEVE, VLERAVE NATYRORE DHE TERSIVE KULTURORE-HISTORIKE

5.10 MENYRA E TRAJTIMIT TE HEDHURINAVE

5.11 MASAT PER PENGIMIN E NDIKIMEVE TE DEMSHME NE MJEDIS

5.12 MASAT PER PARANDALIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE SOCIALE

5.13 MJEDIS I PASTER DHE ATRAKTIV

5.14 KUSHTET PER VENDOSJEN E VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

5.15 KUSHTET PER VENDOSJEN E KORRIDOREVE APO TRASEVE, SIPERFAQEVE KOMUNIKUESE DHE SISTEMEVE TE TJERA TE INFRASTRUKTURES

5.16 DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

5.17 VLERESIM

ANEKSET – PROJEKTET E PLANIFIKUARA 2016 - 2025

ANEKSI 1 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SOCIAL DHE ADMINISTRATES

ANEKSI 2 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË SHENDETESISE DHE ARSIMIT

ANEKSI 3 - STRATEGJIA E ZBUTJES SË PAPUNËSISË DHE VARFËRISË

ANEKSI 4 - ZHVILLIMI KOMPAKT DHE I QËNDRUESHËM I VENDBANIMEVE

ANEKSI 5 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TE MJEDISIT

ANEKSI 6 - ZHVILLIM I HARMONIZUAR DHE I QËNDRUESHËM EKONOMIK

ANEKSI 7 - STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS

TABELA E SHKURTESAVE:

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BPV (GDP)	Bruto Produkti i Vendit (Gross Domestic Product)
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
FMN (IMF)	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GND	Të ardhurat nacionale në dispozicion
KK	Kuvendi Komunal
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
ZHEL	Zhvillimi Ekonomik Lokal
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post -Telekomunikacionit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	Plani Zhvillimor Urban
ZKK	Zyra Komunale për Komunitete
UNHCER	United Nations High Commissioner for refugees Komisioni i lartë i kombeve të bashkime për refugjat
UNDP	United nation Development program Programi i kombeve të Bashkuara për zhvillim

HYRJE

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal është një projekt strategjik për komunën dhe të ardhmen e saj. Projekti përcakton kahet e zhvillimit të ardhshëm të komunës, duke adresuar të gjitha problemet hapësinore dhe gjithashtu jep zgjidhjet e dëshiruara të këtyre problemeve përmes strategjisë së këtij plani, e cila duhet të realizohet në hapësirë dhe kohë të caktuar. Gjithashtu, hartimi i Planit Zhvillimor Komunal është edhe obligim ligjor për të gjitha komunat e Kosovës në bazë të Ligjit mbi ndryshimin e ligjit për planifikim hapësinor.

Bazuar në rolin dhe rëndësinë e këtij projekti dhe obligimeve ligjore, Kuvendi Komunal i Podujevës ka marrë vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Podujevës. Me datën 14.09.2009 u nënshkrua kontrata me kohëzgjatje prej 6 muajve në mes K. K. Podujevë dhe N. Sh. P. Data-GIS-consulting. Mirëpo, për shkak të mos miratimit të Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të PZHK-së, si kusht krejsor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk e ka dhënë pëlqimin e PZHK Podujevë.

Duke u bazuar në procedurën e rregullt të prokurimit komuna e Podujevës me datë 20.07.2015 ka angazhuar kompaninë Data GISconsulting sh.p.k. që të bëjë përmirësimin e këtij dokumenti me të dhëna të reja (Bazuar në Regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, dhe të dhëna të reja), duke i harmonizuar ato me dokumentin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Projekti ka për qëllim që komuna e Podujevës të ketë plan zhvillimor komunal modern, efikas dhe të bazuar në norma e standarde evropiane. Ky projekt do të jetë në harmoni të plotë me objektivat e „Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 dhe Ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003-14“ si dhe harmonizim të plotë me Planin Hapësinor të Kosovës.

Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Podujevës është i përfunduar në përputhje të plotë me Ligjin dhe me dokumentin e Vlerësimit të ndikimit në Mjedis të përpiluar me vendim të Kuvendit Komunal të Podujevës, Nr. 01/157-501 të datës 28 Shtator 2011. Ky dokument gjithashtu është kërkesë Ligjore që të gjitha planet zhvillimore komunale duhet ta kenë edhe Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM).

Qëllimi kryesor i VNM-së është që të identifikohet se ka apo nuk ka ndikime mjedisore të rëndësishme të përfshira në zbatimin e PZHK-së së komunës së Podujevës. Dokumenti i VNM-së është hartuar nga Qendra Regjionale Mjedisore (REC), zyra në Prishtinë dhe mbështetur dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkepunim Nderkombëtarë dhe MMPH. Me këtë rast është bërë një analizë e mirë dhe detaje për të gjitha aktivitetet dhe objektivat e parapara në këtë plan si dhe efektet e tyre në mjedis. Pasi që gjatë hartimit të dokumentit të PZHK-së janë marrë parasysh edhe prioritet mjedisore dhe gjithashtu ka qenë një fushë e veçantë për mjedisin, atëherë edhe në dokumentin e VNM-së nuk janë evidentuar konflikte serioze me ndikim në mjedis.

Plani Zhvillimor Komunal siguron një bazë të mirë për zhvillim të qëndrueshëm për komunën e Podujevës. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk nënkupton vetëm ruajtjen e mjedisit kryesor, por edhe shfrytëzimin e kontrolluar të resurseve për zhvillim ekonomik, me qëllim që edhe gjeneratat e ardhshme të kenë mundësi të shfrytëzojnë këto resurse. Gjithashtu plani parasheh edhe balancimin e

zhvillimeve hapësinore, ku dallimet në zhvillim dhe shërbime mes hapësirave të ndryshme do të zvoglohen. Kjo do të thotë që të ri koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike, kështu që të kontribuojnë në balancimin e zhvillimeve hapësinore.

Plani zhvillimor Komunal është dokument, që hartohet për territorin e komunës së Podujevës për periudhën e ardhme kohore deri në vitin 2020+ dhe jep udhëzime konkrete për veprimet që duhet të ndërmerren: Pse duhet ndërmarr ato veprime, po ashtu, sqaron se si duhet të realizohen veprimet e tilla. Veprime këto që do të ndikonin në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës së Podujevës, duke ndikuar në ngritjen e kualitetit social, ekonomik dhe fizik të hapësirës përkatëse.

Plani Zhvillimor komunal jep mundësi të vazhdimësisë së planifikimit edhe për të ardhmen (pas periudhës së caktuar). Në dokumentin e planit merren vendime afatgjate, por gjithmonë duke pasur parasysh fleksibilitetin e planit, kur dihet se: në të ardhmen mund të paraqiten rrethana të reja që kërkojnë modifikime të vazhdueshme (kërkesat e ndryshme të popullsisë, ndryshimet në politikën qeveritare, parimet ndërkombëtare etj.).

PZHK sot orientohet kah procesi dhe veprimi, fillon me konsensus mbi çështjet, dhe i fokuson ato duke adresuar përparësitë dhe mangësitë. Është proces në të cilin përfshihet edhe ajo që është e paplanifikuar. Këtij procesi i paraprinë, një vizion realist dhe i qëndrueshëm. Me aprovimin e dokumentit, i cili do të jetë i hartuar përmes procesit të konsultimeve publike dhe, i bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, resurseve potenciale, duke identifikuar çështje apo fusha ku duhet ndërmarrë veprime urgjente, me qëllim të mbrojtjes, kultivimit dhe zhvillimit të vlerave socio-ekonomike dhe mjedisore të komunës së Podujevës. Rezultat përfundimtar i këtij plani do të jenë informatat përmbajtjesore për gjendjen demografike e sociale, ekonomike, të infrastrukturës dhe mjedisit. Në shtrirjen hapësinore të dukurive, do të duken qartë, caqet e zhvillimit të Komunës dhe, zonat me prioritet për intervenim nga do të rrjedhin propozimet për zhvillimin e ardhshëm hapësinor dhe, mënyrën se si do të realizohet ky zhvillim.

SISTEMI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË KOSOVË

Në Kosovë, sistemi i Planifikimit Hapësinor është i rregulluar përmes Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, Ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-106 si dhe në Ligjin Nr. 04/L-174, Neni 10, 11 dhe 26. Sistemi i planifikimit në Kosovë ndahet në dy nivele:

1. Planifikimi për territorin e Kosovës
2. Planifikimi për territorin e Komunave

Në bazë të ligjit, parashihen tri lloje të planeve në nivel të Komunës:

1. Plani zhvillimor i komunës
2. Plani zhvillimor urban
3. Plani rregullues urban


Në bazë nenit 13.1 Secila komunë është përgjegjëse për përgatitjen e Planit zhvillimor të Komunës, i cili mbulon territorin e saj. Ky plan është strategjik dhe muti-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjate të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Plani zhvillimor i komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale të komunës.

PZHK bazohet në gjendjen ekzistuese sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe është proces gjithëpërfshirës, transparent me pjesëmarrje publike në vendimmarrje. Pjesëmarrja publike nënkupton involvimin e të gjithë faktorëve relevant në interes të komunës: Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, Drejtoritë komunale, Institucionet shkencore dhe hulumtuese, Organizatat e shoqërisë civile, komunale etj.

Bazuar në kornizën logjike të aktiviteteve, ky proces planifikohet të zgjasë 6 muaj.

Më poshtë është dhënë skema e mobilizimit institucional të pjesëmarrjes në procesin e hartimit të PZHK.

Skema 1. Skema e mobilizimit institucional



PZHK bazohet në:

- Parimet e përcaktuara me Ligj
- Vizionin dhe caqet strategjike
- Raportet e sektorëve të rëndësishëm
- Strategjitë zhvillimore të sektorëve të ndryshëm
- Elemente tjera të përcaktuara me akte të veçanta

Si i tillë, Plani përcakton, parimet dhe qëllimet afatgjate të planifikimit hapësinor për periudhën deri në vitin 2020+. Gjithashtu përcakton afatet kohore reale dhe, implikimet buxhetore.

Korniza për hartimin e PZHK përbëhet nga pesë faza:

- Faza I - Përgatitja e profilit dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese
- Faza II - Vizioni, Parimet dhe Caqet
- Faza III - Korniza e Zhvillimit Hapësinor
- Faza IV - Strategjitë dhe veprimet për zbatim

- Faza V- Dispozitat për zbatim
 1. **Faza e parë e Planit është hartimi i profilit**–Ky është dokumenti bazë për njohjen dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese të zhvillimeve në hapësirë, si dhe, përcakton orientimet themelore për hartimin e PZHK-së
 2. **Fazës së dytë të Planit - Vizioni**, parimet dhe caqet strategjike të zhvillimit hapësinor të Komunës.
 3. **Fazat e tretë e Planit** – Korniza e zhvillimit Hapësinor shpreh parashikimet e dëshiruara hapësinore për territorin e komunës.
 4. **Faza e katërt** - është Strategjia dhe veprimet për zbatim – Kjo fazë formulon pakon e strategjive dhe veprimet për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet kohore, implikimet financiare dhe, kornizën institucionale.
 5. **Faza e pestë** - Përfshin elementet e Zbatimit obligativ, që ndërlidhen me nivelin komunal.

Gjatë hartimit të PZHK-së, struktura e projektit do të ndahet në katër fusha kryesore:

- Popullsisë, çështjeve sociale, banimit dhe vendbanimet.
- Mjedisit dhe shfrytëzimi i tokës, përfshirë trashëgiminë kulturore, natyrore, peizazhet , etj.
- Zhvillimin ekonomik, industrinë, turizmin, rekreacionin, tregtinë, bujqësinë etj;
- Infrastrukturës - transportit komunal, komunikimet etj.

Përveç katër fushave kryesore të projektit janë edhe komponentët tjera që fuqizojnë planin për zbatim gjithëpërfshirës dhe implementus:

1. Plani Zhvillimor Komunal (përgatitja e dokumentit final dhe pranimi i planit nga asambleja komunale)
2. Rregullimi afatgjatë i zhvillimit hapësinorë dhe ekonomik i komunës së Podujevës duke u bazuar në koncepte të ndryshme të zhvillimit hapësinor.
3. Bashkëpunimi i ngushtë dhe trajnimi i stafit të qeverisë lokale gjatë hartimit të Planit zhvillimor komunal, si dhe, do të mundësohet atyre për të vazhduar detyrimet dhe përgjegjësit të cilat dalin nga plani zhvillimor komunal.
4. Trajnimi i stafit të selektuar nga komuna në GIS, i cili do të ofroj njohuri të mira në GIS, si dhe, do të jetë ndihmë e madhe në implementimin e projektit.
 - ✓ Paketën e GIS sofverit (me të cilën kompania e realizon projektin) komuna mund ta propozoj, ndërsa kompania Data GISconsulting do ta siguroj brenda ofertës së vet solucionin e MapInfos v. 8.0.
5. Ofrimin e konceptit për GIS infrastrukturë dhe menaxhimin e të dhënave me GIS.

PËRFITUESIT E PROJEKTIT

Ky projekt është gjithëpërfshirës dhe shumë dimenzional. Andaj, përfitimet janë shumë të rëndësishme nga fakti se do të planifikohet një zhvillim i përgjithshëm në përputhje të plotë me interesat e qytetareve të komunës së Podujevës. Projekti, gjithashtu do të jetë në harmoni të plotë me politikën e zhvillimit dhe mbrojtës që ka Qeveria e Republikës së Kosovës dhe vet Qeveria lokale, e që do të jenë në harmoni të plotë edhe me qëllimin e politikave të Unionit Evropian.

Perspektiva evropiane e zhvillimit hapësinor është e orientuar drejt një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm të territorit të vet Unionit Evropian.

Ministrat përgjegjës për Planifikimin Hapësinor në Shtetet Anëtare të Unionit Evropian dhe anëtari i Komisionit Evropian, përgjegjës për Politikën Regjionale, theksuan në Potsdam (Përspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor – ESDP) se: qëllimi i politikave të zhvillimit hapësinor është që të punohet drejt një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm të territorit të Unionit Evropian. Sipas pikëpamjes së Ministrave, është e rëndësishme që të arrihen në mënyrë të barabarët tri qëllimet fundamentale të politikës evropiane në të gjitha regjionet e UE-së:

- ✓ Kohezioni ekonomik dhe social;
- ✓ Ruajtja dhe menaxhimi i resurseve natyrore dhe i trashëgimisë kulturore;
- ✓ Konkurrencë më e balancuar e territorit evropian.

Në përputhje me këto politika, është edhe Plani hapësinor i Kosovës, që ka për synim arritjen e një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm. Harmonizimi i politikave të tilla zhvillimore ka një rol të rëndësishëm edhe për komunën e Podujevës, e cila gjatë këtij procesi, do të arrij të krijoj një bazë të mirë të planifikimit hapësinor në përputhje me këto politika.

Plani Zhvillimor Komunal që do të hartohet në përputhje të plotë me interesat e qytetarëve të komunës së Podujevës dhe që do të bëhet në harmoni me politikat e zhvillimit hapësinor të Kosovës dhe, të Unionit Evropian, paraqet një përfitim real dhe afatgjatë për të ardhmen e komunës. Në këtë kontekst, përfituesit kryesor të këtij projekti do të jen: KK Podujevë, Institucionet e Kosovës, komuniteti, sektori shoqëror, sektori privat, OJQ-ët, grupet e interesit etj.

BURIMI I TË DHËNAVE PËR HARTIMIN E PROFILIT KOMUNAL

Mbledhja e të dhënave si bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal është element i domosdoshëm. Gjatë hartimit të profilit komunal si dhe për vlerësimin i gjendjes ekzistuese janë shfrytëzuar burime dhe metoda të ndryshme për grumbullimin, sistemimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme. Grumbullimi i të dhënave është bërë nga strukturat komunale të Podujevës dhe stafi i kompanisë përmes një bashkëpunimi të ngushtë mes grupeve punuese.

Sektorët e Qeverisë komunale kanë bërë grumbullimin e të dhënave bazë në fusha të caktuara duke qenë në përputhje me kërkesat e kompanisë.

Të dhënat bazë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal janë shfrytëzuar nga burime të ndryshme:

- Të dhënat zyrtare nga sektorët e Qeverisë Komunale – plotësimi i veglave të punës.
- Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011
- Të dhënat nga zyrat komunale dhe regjionale të Qeverisë së Kosovës (Zyra e Punës dhe punësimit, Zyra për mirëqenie sociale, ESK etj.
- Të dhënat nga sektorë të ndryshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Të dhënat nga kompanitë publike komunale.
- Parcelat kadastrave – zyra komunale për Kadastër.
- Hartat topografike: 1:50 000, 1:25 000
- Orto-fotot (prodhim: viti 2009 dhe 2012) - zyra komunale për Kadastër.

- Puna në terren (ekipet e kompanisë kanë vizituar të gjitha vendbanimet e komunës).
- Aplikimi i GIS dhe GPS
- Literatura shkencore.

Në vazhdimësi të procesit të hartimit të planit, do të grumbullohen të dhëna të reja dhe të rëndësishme, që do të inkorporohen në dokumentin e profilit. Kjo nënkupton plotësimin e profilit me të dhëna të reja në të ardhmen deri në përfundimin e projektit.

ROLI DHE NATYRA E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL


a) Plani Zhvillimor Komunal duhet të:

- Mundësojë që, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, të përcaktojë kahet e zhvillimit social, shfrytëzimin mjedisor, mbrojtjes mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe infrastrukturë për qasje dhe lidhje më të mirë e mbi të gjitha rritjen e kualitetit të jetesës.
- Ndikojë në vendimet politike, lidhur me investimet publike në infrastrukturë, për t'i përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve;
- Përkrahë zhvillimin e balancuar në mes të zonave urbane dhe zonave rurale me zhvillim ekonomik më të ulët;
- Të jetë udhëzues në hartimin e Planit Zhvillimor Urban
- Identifikojë lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të komunës;
- Apropojë vendimet lidhur me zonat e industrisë dhe biznesit, banimit, shërbimeve, turizmit dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Identifikojë rolin e zonave kryesore brenda qytetit dhe atyre rurale, në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik dhe kulturor të qytetit dhe komunës.

b) Roli i qeverisë lokale - Qeverisja, si vendimmarrëse dhe implementuese e vendimeve të marruara, duhet të mbështetet në parimet kryesore

- Pjesëmarrja publike;
- Sundimi i ligjit;
- Transparenca;
- Përgjegjësia;
- Konsensusi;
- Barazia dhe gjithë përfshirja;
- Efikasiteti dhe
- Llogaridhënia

Skema 2. Struktura organizative e komunës së Podujevës



ROLI I PJESËMARRËSVE

Në respektim të parimeve ndërkombëtare të rekomanduara me ligj, e posaçërisht të Agjendës 21 dhe Agjendës së UN-HABITAT, procesi tenton të përfshijë një numër sa më të madh të pjesëmarrësve në

fazën përgatitore për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, në mënyrë që parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, efikasitetit, barazisë dhe qëndrueshmërisë, të promovohen dhe zbatohen në praktikë nga Komuna.

Në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 dhe Ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003-14, Plani Zhvillimor Komunal është plan multi-sektorial, i cili merr parasysh zhvillimet e sektorëve që menaxhohen nga komuna, involvimi, i të gjithë pjesëmarrësve të cilët mund të kenë ndikim ose të jenë të ndikuar nga plani esencial për të zbatuar parimet e pjesëmarrjes publike dhe transparencës së procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

ROLET-VENDIMMARRËSE/JO VENDIMMARRËSE

Roli ne vendim - marrje përveç qeverisë lokale duhet të jetë transparent edhe për pjesëmarrësit të tjerë në proces siç janë shoqëria civile, sektori privat, OJQ, shoqatat e ndryshme te fermerëve, bletarëve, ekspertëve të pa varur, e institucioneve te ndryshme që involvohen në proces të planifikimit.

Pjesëmarrësit nga niveli qendror, përfaqësues të ministrive të Qeverisë së Kosovës – me të dhënat, raportet dhe strategjitë e sektorëve përkatës e plotësojnë përmbajtjen e dokumentit

Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave rrjedhin nga sektori jo-qeveritar, analizat dhe raportet e të cilëve në të shumtën e rasteve kanë shërbyer për krahasim, e në disa raste edhe si të vetmet burime të dhënave.

QEVERISJA KOMUNALE

Komuna udhëhiqet nga Kuvendi që është organi më i lartë dhe Kryetari që udhëheq ekzekutivin e komunës

NDARJA ADMINISTRATIVE DHE QEVERISJA E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Komuna e Podujevës zë sipërfaqen prej 628.7 km². Gjatësia e vijës kufitare e komunës është 175.21km dhe kufizohet me disa komuna (komunën e Leposaviqit, Mitrovicës, komunën e Vushtrisë, Obiliqit, dhe komunën e Prishtinës, ndërsa në veri-lindje kufiri komunal tangon me kufirin shtetëror të Kosovës që kufizohet me Serbinë.

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave, territori i komunës së Podujevës përbëhet nga 78 zona kadastrale me 78 vendbanime

Nr	Vendbanimi	Nr	Vendbanimi	Nr	Vendbanimi
1	Bajçinë	27	Kunushec	53	Podujevë
2	Ballofcë	28	Kushevicë	54	Pollatë
3	Barainë	29	Letanc	55	Popovë
4	Batllavë	30	Livadicë	56	Potok
5	Bellopojë	31	Lupq i Epërm	57	Radujevc
6	Bërvenik	32	Lupq i Poshtëm	58	Rakinicë
7	Bllatë	33	Lladoc	59	Reçicë
8	Bradash	34	Llapashticë e Epërme	60	Repë

9	Brainë	35	Llapashticë e Poshtme	61	Revuq
10	Brecë	36	Llaushë	62	Sallabajë
11	Buricë	37	Llugë	63	Sfeçël
12	Dobërdol	38	Lluzhan	64	Siboc i Epërm
13	Dobratin	39	Majac	65	Siboc i Poshtëm
14	Dumnicë e Epërme	40	Merdar	66	Sllatinë
15	Dumnicë e Poshtme	41	Metehi	67	Surdull
16	Dumosh	42	Metergoc	68	Surkish
17	Dvorishtë	43	Miroc	69	Sylevicë
18	Dyz	44	Muhazob	70	Shajkoc
19	Gërdoc	45	Murgull	71	Shakovicë
20	Gllamnik	46	Obrançë	72	Shtedim
21	Godishnjak	47	Orllan	73	Tërnavë
22	Halabak	48	Pakashticë e Epërme	74	Tërnavicë
23	Hërticë	49	Pakashticë e Poshtme	75	Turuçicë
24	Kaçybeg	50	Penuhë	76	Velikarekë
25	Kalaticë	51	Peran	77	Zakut
26	Kërpimeh	52	Përpellac	78	Zhiti


ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

Komuna e Podujevës në aspektin e organizimit administrativ dhe territorial ndahet në 19 qendra lokale, ndërsa vet qyteti i Podujevës ndahet në tri bashkësi lokale

Ndarja administrative e Komunës së Podujevës

Podujevë	Podujevë, (Lagjja e -I-parë), Letanci
Podujevë	Podujevë (Lagjja II), Perani, Obrança
Podujevë	Podujevë (Lagjja III)
Dumnicë e Poshtme	Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e Epërme, Llaushë, Perpellac
Shtedim	Shtedim, Mirofc, Merdar, Livadhi
Sveqël	Sfeqël, Shajkofc, Dumosh, Surkish, Lladofc, Ballofc
Herticë	Herticë, Surdull
Bervenik	Bervenik, Kalaticë, Billatë, Metergoc
Orllan	Orllan, Barainë, Kushevicë, Muhazob, Rakinicë, Turuçicë, Brainë
Batllavë	Batllavë, Dyz, Gërdoc, Kaqybeg
Tërnavë	Tërnavë, Bellopojë, Halabak
Lupç i Poshtëm	Lupç i Poshtëm, Majac, Lupç i Epërm, Popovë
Lluzhan	Lluzhan, Godishnjak, Llugë, Sallabajë, Shakovicë
Gllamnik	Gllamnik, Burincë, Konushfc, Penuhë, Siboc i Epërm, Siboc i P
Llapashticë e Epërme	Llapashticë e Epërme, Katunishtë, Llapashticë e Poshtme
Bajçinë	Bajçinë, Dobratin, Dobërdol, Bradash
Kerpimeh	Kerpimeh, Repë, Metehi, Pakashticë e E dhe P, Zakut, Revuq
Pollatë	Pollatë, Potok, Dvorishtë, Sllatinë, Reçicë
Zhiti	Zhiti, Sylevicë, Brecë, Tërnavicë, Murgull

Harta 1. Komunat kadastrale



Pjesëmarrës kyç në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Nga Komunën e Podujevës - Udhëheqës i të gjitha grupeve punuese dhe tërë procesit janë:

1. Kryetar i Komunës
2. Drejtori DPUMM

Institucionet kyçe të komunës të involvuara në procesin e hartimit të planit janë:

1. Drejtoria për Planifikim Urban, Mbrojtje të Mjedis
2. Drejtoria për Administratë Komunale
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
4. Drejtoria për Arsim
5. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
6. Drejtoria e Inspektoratit komunal
7. Drejtoria për Kultur, Rini dhe sport
8. Drejtoria Pronës, kadastrit dhe Gjeodezi
9. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltari dhe Zhvillim Rural
10. Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
11. Drejtoria per Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

Mbikëqyrësi i projektit nga Komuna Podujevë:

Fatmir Uka – 044-166-818- uka_f@hotmail.com

Grupet punuese:

1. Demografia dhe çështjet social

1. Zenel Zenel	udhëheqës i grupit
2. Nafie Gerguri	anëtar
3. Makfire Zeka	anëtar
4. Abdulla Muqolli	anëtar

2. Zhvillimi ekonomik

1. Ejup Babatinca	udhëheqës i grupit
2. Ali Podvorica	anëtar
3. Shaban Ejupi	anëtar
4. Xhafer Sekiraqa	anëtar

3. Mjedişi dhe shfrytëzimi i tokës

1. Rasim fejza	udhëheqës i grupit
2. Rizah Muqolli	anëtar
3. Fitim Restelica	anëtar
4. Eset Restelica	anëtar

4. Infrastruktura

1. Shemsedin Latifi	udhëheqës i grupit
2. Fatmir Latifi	anëtar
3. Florie Moni	anëtar
4. Veton Aliu	anëtar

Këshilli i ekspertëve

Emri Mbiemri	Profesioni
Fitim Mexhuani	Ekonomist
Fatmir Gashi	Prof.Mbrojtje dhe siguri
Fatmir Uka	Ingj.Ndertimtari
Shpejtim Bulliqi	Dr. i Gjeografisë
Islam Revuqi	Jurist
Osman Jashari	Jurist
Ismet Mahmuti	Prof. i Historisë
Qazim Aliu	Prof. i Gjeografisë
Hava Bllaca	Prof. i Biologjisë

Grupet punuese nga kompania:

1. Udhëheqës të projektit:
 - a. Florend Krasniqi – Menaxher i Projektit për përmirësimin e të dhënave
 - b. Tomor Qela – Udhëheqës administrativ
2. Udhëheqësit e grupeve punuese:
 - a. Prof. Dr. Sc. Ibrahim Ramadani – Udhëheqës profesional, Urbanist
 - b. Popullsia dhe zhvillimi social – Mr. Hazer Dana, demograf -planer
 - c. Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës – Prof. Dr. Sc. Gani Gashi
 - d. Zhvillimi ekonomik -Riza Murseli, gjeograf-planer
 - e. Infrastruktura –Mr. Idriz Shala, planer
3. Staf i profesional:
 - a. Dr. Burbuqe Nushi-Latifi , specialist i shëndetit publik
 - b. Bajram Kafexholli, GIS ekspert
 - c. Hasim Kryeziu, GIS ekspert
 - d. Ecc. Luljeta Krasniqi, ekonomiste
 - e. Mr. Sc. Ecc. Mic Avdullahu
 - f. Ramush Aliu, Ing. Ndertimtarisë

“PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSIROR”

FAZA I

1. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Profili i gjendjes ekzistuese ne Komunën e Pdujevës do të realizohet përmes sigurimit dhe dokumentimit të informacioneve konkrete në lidhje me territorin komunal të Podujevës. Gjendja ekzistuese është hulumtuar në sfera të ndryshme duke e bërë inkorporimin e të gjitha elementeve hapësinore me qellim që duke e analizuar gjendjen ekzistuese në hapësirë, të jetë më i lehtë planifikimi i zhvillimeve të ardhshme.

1.1 Historiku i Komunës

Treva Llapit është herët e banuar për shkak të kushteve të volitshme natyrore. Edhe pse shumë monumente që e dokumentojnë vjetërsinë janë zhdukur, megjithatë kanë mbetë disa. Dokumente të tilla janë burimet arkeologjike si: themelet e kalave, varrezat, tjegullat, armët si dhe emërtimet e ndryshme. Banorët më të vjetër të Llapit ishin dardanët si fis ilir. Vendbanimet e para ishin ngritur pranë lumenjve. Degë ekonomike ishin: gjuetia, blegtoria etj. Gjatë pushtimit të romakëve kjo hapësirë ka pësuar mjaft dëme sidomos pjesët e fortifikuara. Qendër e rëndësishme e kësaj kohe ishte Vendenisi (Gllamniku).

Në vitin 395 kjo trevë bie nën sundimin e perandorisë Bizantine e herë pas herë nën sundimin bullgar. Kah fundi i shek. IX rajoni i Llapit bie nën sundimin bullgar mbret i së cilës ishte Mihail Borisi. Në fund të shek XII dhe fillim të shek. XIII pushteti Bizantin u dobësua. Këtë rast e shfrytëzoi shteti i Rashkës i cili u zgjerua duke pushtuar edhe Llapin.

Në shek XIV turqit osmanë depërtuan në Ballkan ngase mbretëritë e Ballkanit ishin dobësuar mjaft. Pas betejës së Kosovës me 1389 sundimtarët serb kishin pranuar vasalitetin osman. Gjatë sundimit osman popullata e kësaj treve ishte e pakënaqur dhe kishte bërë rezistenca të ndryshme deri te shpërngulja masive. Tokat shqiptare ishin ndarë në sanxhaqe e nahije. Nahija e Llapit i takonte sanxhakut të Prishtinës që e udhëhiqte Maliq Pashë Gjinolli. Në vitin 1811 me 28 qershor ekspedita ushtarake serbe kishte ndërmarr një sulm në fshatin Reçicë të Mavriqit. Në ditën e Bajramit masakroi familjen e Demë Ahmetit duke lënë të vdekur 28 anëtarë të familjes dhe dy mysafirë.

Gjatë dyndjes së popujve në këtë trevë janë vendosur shumë familje nga Çerkistani, të cilët u vendosën në Kaçibeg, Velika Rekë, Shtedim, Dumosh etj. Gjatë luftës ruso-turke që njihet si „Kriza Lindore” ishin bërë plane për pushtimin dhe spastrimin e tokave shqiptare. Ushtria osmane pësoi humbje në Sanxhakun e Nishit i cili ishte në kudër të Vilajetit të Kosovës. Ushtria serbe në fund të vitit 1877 arriti deri te ura e Lluzhanit. Gjatë kësaj lufte nga territori i sanxhakut të Nishit dhe treva tjera të banuara me shqiptarë, pasi i vrau dhe u dogji pasurinë i ndoqi nga vatrat e tyre. Muhaxhirët e shpërngulur u vendosën në troje tjera, ndërsa në Llap pothuajse nuk ka vendbanim ku nuk ka muhaxhirë.

Me 1910 në Llap kishte filluar lufta kundër pushtetit osman, në vendin e quajtur Kulinë, në krye të së cilës ishte Haxhi Sadri Blaku¹. Thuhet që kryengritësit e kishin rrëmbyer një top dhe e atë e kishte vendosur Islam Bulliqi në Kulina. Pas shuarjes së kryengritjes ishte dënua me vdekje (varje), së bashku me dy atdhetarë tjerë. Në tetor të vitit 1912 ushtria serbe fillon operacionet për okupim të Kosovës dhe me 21 tetor vazhduan operacionet për okupimin e Prishtinës. Nën okupimin serb gjendja ishte edhe më e rëndë se sa nën atë osman. Vrasjet, shpërnguljet, keqtrajtimet ishin gjëra të zakonshme. Për ta ndërruar strukturën etnike u sollën kolon serb e malazez. Shumë familje vendase dhe muhaxhir nga sanxhaku i Nishit u shpërngulën për Turqi dhe Shqipëri, që jetojnë atje sot e kësaj dite.

Në vitin 1915 fillon Lufta e Parë Botërore, ndërsa Kosova u pushtua nga Austro-Hungaria dhe Bullgaria. Treva e Llapit gjatë kësaj kohe ishte nën sundimin bullgar, që ishin të njohur për plaçkitje të popullatës. Në vitin 1918 kthehet prapë pushtuesi serbo-malazez. Kolonizimi sipas disa dokumenteve² në periudhën 1919-1938 ishte kryer në 42 vendbanime, 583 familje me 3421 anëtarë. Në këtë situatë jo vetëm që ju merrej toka shqiptarëve por kolonistët ishin të armatosur që paraqiste kërcënim dhe rrezik për popullatën vendase. Në këtë gjendje ishte intensifikuar rezistenca që njihet si lëvizja kaçake. Është numër i madh i kaçakëve të asaj kohe por më të njohur ishin: Hys Popova, Maliq Pushkolli, Sejdi Tashevc, Sherif Ahmeti i ardhur nga Medvegja, Raif Shabani, Kamer Sali Breca, Bejtullah Idrizi³, etj. Për informatë që qonte në arrestimin e tyre okupatori premonte shuma relativisht të mëdha parash. Sot e kësaj dite ka shumë këngë folklorike që përshkruajnë situatën e asaj kohe. E tillë është edhe kënga e Bec Sinanit e cila fillon ‘Kur na u çojka Serbia e parë na u bojka bashkë me bugar, na u ba bashkë me Bugari në grykë të Llapit kur janë hy ju kanë mar tokat fije për fije’, në vazhdim përshkruhet vuajtjet dhe mjerimet e deri te shpërngulja.

Në vitin 1941 fillon Lufta e Dytë Botërore, ndërsa treva e Llapit i takonte zonës okupuese gjermane. Gjatë kësaj kohe janë të njohura rezistencat kundër bandave çetnike të Kosta Peçanacit me 1941 dhe 1944. Pas përfundimit të luftës fillon rindërtimi i vendit, hapen shkolla, kurse të ndryshme për arsimim dhe rindërtimi i vendit. Në një hapësirë të prapambetur dhe shkatërruar me popullatë shqiptare rindërtimi i ka pas ngecjet dhe dobësitë e veta. Përndjekjet dhe burgosjet bëheshin me stil tjetër nga UDB e atëhershme. U ndërtuan rrugë, fabrika, popullata ishte më e arsimuar, por nuk kanë munguar edhe internimet në Goli Otok.

Është me rëndësi të vlerësohet edhe veprimtaria e NDSH-së në këtë anë pas Luftës së Dytë Botërore, e udhëhequr nga patrioti Gjon Sereqi. NDSH-ja në Llap filloi veprimtarin e vet me themelimin e saj me 27 gusht 1945 në malin e quajtur Kallqak të fshatit Koliq. Ndërsa detyrën për themelimin e NDSH-së në Llap e mori Murat Ademi. Aktivistet, në bazë të rrethanave, formuan komitetet e komunave në disa fshatra. Qëllimi i kësaj organizate ishte, që të mbanin kongrese dhe tubime, me qëllim që të merreshin vendime dhe të luftonin edhe më tutje kundër regjimit komunist për çlirimin e tokave shqiptare, të okupuara nga serbet⁴.

¹ Jusuf Osmani Vendbanimet e Kosovës, Besiana (Podujeva), Prishtine 2004

² Jusuf Osmani, po aty

³ Dr. Liman Rushiti, Kujtime për lëvizjen kaçake, Prishtinë 2003

⁴ Adem Ajvazi, Partia Nacional Demokratike Shqiptare në Llap (1949-1953), Podujev 2008, Fq. 29 - 35.

Rrënimimi i Autonomisë së Kosovës këtë komunë e ka goditur në të gjitha aspektet. Rezistenca e organizuar solli deri te formimi i njësie ushtarake në një zonë operative që përfshinte edhe komuna tjera e njohur si ZOLL. Brigada e parë në kuadër të ZOLL ishte brigada 151 e pagëzuar me emrin e Zahir Pjazitit si themelues i UÇK dhe dëshmor i kombit. Vrasjet dhe djegiet kishin filluar edhe para bombardimeve të NATO-s. Përgjatë rrugës Prishtinë-Podujevë ishin vendosur makineri ushtarake. Gjatë periudhës së bombardimeve në fshatin Shajkofc ishte krijuar një kamp ku qëndronte popullata jo vetëm e Llapit por edhe pjesëve tjera. Vlerësohej se këtë popullatë okupatori do ta përdorte si mburojë të gjallë në rast se ndërhyjnë forcat tokësore të NATO-s.

Me 15 qershor 1999 përfundon okupimi serb, popullata për një periudhe shumë të shkurtër i kthehet vatrave të veta, fillon rindërtimi i shtëpive dhe objekteve publike më vitale si shkollat ambulancat etj.

1.2 Pozita Gjeografike, Kufijtë, Madhësia dhe Mikropozita e Podujevës


Komuna e Podujevës shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës. Kufizohet me komunën e Prishtinës në jug, me Obiliqin, Vushtrinë, Mitrovicën dhe Leposaviqin në perëndim. E tërë pjesa veriore dhe lindore kufizohet me Republikën e Serbisë. Gjatësia totale e vijës kufitare është 175,2 km. Kufiri i komunës kalon nëpër terrene malore, afër vijave ujëndarëse apo nëpër to, dhe në pjesë të ulëta nëpër disa qafa malore, ose në lugina duke i prerë tërthorazi. Me Prishtinën gjatësia e kufirit është 37.39 km i cili kalon nëpër terrene kodrinore-malore dhe kah perëndimi lëshohet në luginën e lumit Llap te Lupçi i Poshtëm. Nga kjo pikë kufiri merr drejtim verior dhe kufizohet në distancë 2.8 km me komunën e Obiliqit. Kah veriu vazhdon kufizimi me komunën e Vushtrisë duke u ngritur maleve të Kopaonikut me gjatësi 18.9 km. Me Mitrovicën gjatësia e kufirit është 17.52 km, derisa me Leposaviqin është 7.7 km duke u rritur lartësia mbidetare. Me Republikën e Serbisë gjatësia e kufirit është 90.9 km. Lartësia mbidetare e kufirit në pjesën perëndimore është mjaft e lartë ngase shtrihen në pjesën jugore të maleve të Kopaonikut. Në kufizim me komunën e Leposaviqit në majën Shatorica lartësia mbidetare është 1770 m. Pika më e ulët e kufirit është në pjesën jugore në fshatin Lupç i Poshtëm në luginën e lumit Llap me rreth 550 m.

Tabela 1. Gjatësia e vijës kufitare në komunën e Podujevës

Komuna ose shteti me të cilën kufizohet	Gjatësia km	%	Kuota më e lartë metra	Kuota më e ulët metra
Prishtinë	37.39	21.3	1110	550
Obiliq	2.8	1.6	838	710
Vushtri	18.9	10.8	1220	710
Mitrovicë	17.52	10.0	1540	1080
Leposaviq	7.7	4.4	1770	1400
R. e Serbisë	90.9	51.9	1720	650
Gjithsej	175.21	100	1770	550

Territori i komunës ka shtrirje gjatësore në drejtim VVP-JJL. Ky drejtim përfitohet nëse paramendohet një drejtëz e cila kalon përmes sipërfaqes së komunës. Në jug sipërfaqja është më e gjerë në drejtim L-P. Gjatësia maksimale e pikave më ekstreme të sipërfaqes është 53.71 km, prej komunës kadastrale Murgull deri te Braina. Për shkak të formës së parregullt gjatësia e vijës kufitare është pothuajse 2 herë më e gjatë se sipërfaqja e rrethit me të njëjtën sipërfaqe të komunës. Vlera e koeficientit është 2.97. Komuna e Podujevës për nga sipërfaqja hyn në grupin e komunave më të mëdha në R. e Kosovës. Komuna ka mikropozitë relativisht të mirë gjeografike. Qendra komunale e Podujevës ndodhet pothuajse në qendër të territorit të komunës. Kjo është përparësi ngase vendbanimet përreth kanë qasje më të mirë për shërbime komunale dhe nevoja tjera që i ofron qendra urbane. Vendbanimet periferike janë në pozitë të pafavorshme dhe kjo ka ndikuar që numri i banorëve të jetë simbolik. Pjesa jugperëndimore e komunës ka mikropozitë shumë të mirë ngase lidhet me kryeqendrën e Kosovës-Prishtinën.

Harta 2. Pozita gjeografike e Komunës



Komuna e Podujevës ka makropozitë të mirë gjeografike. Nëpë territorin e saj ka kaluar rruga nga Lezha për në Nish. Kjo lidhje i mundësonte lidhjet si me lindjen, veriun, njashtu edhe me perëndimin

dhe jugun. Kah jugu lidhet me Prishtinën përmes luginës së lumit Llap. Në veri përmes qafës së Prepellacit në Merdar lidhet me Serbinë. Kjo lidhje ka shërbyer kohë të gjatë që varej nga situata politike. Aktualisht nuk shfrytëzohet sa duhet edhe sa është e nevojshme. Këtu kalojnë shtetas të Kosovës me numër të kufizuar për shkak të problemeve që i shkakton Republika e Serbisë. Në anën tjetër në Serbi ka kohë që fshati ka filluar të braktiset. Në këtë pjesë Serbia nuk ka investuar në rrugë që ka ndikuar në zvogëlimin e qarkullit të mallrave dhe njerëzve. Në juglindje të komunës ndodhet qafa e Bervenikut që e ka lidhë këtë pjesë me Leskocin por ka karakter sekondar. Podujeva me hekurudhë është lidhë në vitin 1948. Treni i udhëtarëve ka qarkullua nga Nishi, në Podujevë, Prishtinë, Fushë Kosovë etj. Aktualisht nuk përdoret për shkak rentabilitetit joekonomik dhe gjendjes jo të mirë të hekurudhave.

1.2.1. Zonat kryesore hapësinore

Komuna e Podujevës dallohet me tri zonat (tërësi) hapësinore, të cilat kanë dallime të theksuara në aspektin ekonomik, social, mjedisor, të infrastrukturës dhe shërbimeve.

1. **Zona Qendrore – Aktive**
2. **Zona Veri-Perëndimore – Malet dhe Pejsazhet**
3. **Zona Lindore –Turizmi**


Këto tri tërësi karakterizohen me veçoritë e tyre hapësinore specifike dhe potencialeve për zhvillimin e ardhshëm. Duke marr parasysh veçoritë e tyre natyrore, resurset dhe mundësitë zhvillimore, këto zona karakterizohen me funksione të veçanta.

Zona Qendrore e komunës është hapësira më e populluar, me veprimtari ekonomike të bazuara në agrikulturë biznese dhe shërbimet themelore të cilat i ofron.

Zona Veri-Perëndimore paraqet një kompleks kryesisht malor, në të cilën zhvillimi do të mbështetet në veprimtari të ekonomike të resurseve të natyrës dhe peizazheve, blegtorisë e turizmit

Zona Lindore, e cila është kryesisht kodrinore malore dhe me potenciale ujore, paraqet bazë për zhvillimin e turizmit, blegtorisë dhe prodhimeve ekologjike bujqësore.

Harta 3. Zonat hapësinore



1.3 Zhvillimi Demografik

Shqyrtimi i situatës demografike ka rëndësi të veçantë gjatë procesit të planifikimit. Popullsia me tërë kompleksitetin e saj është një faktor kyç për planifikimin e zhvillimeve të ardhme. Plani realizohet për njerëzit dhe si i tillë duhet të parasheh propozime reale për kushte më të mira për shtresa të ndryshme të shoqërisë. Bazuar në rrjedhën e zhvillimit të komponentëve demografike, më realisht mund të planifikohen kërkesat dhe nevojat e shoqërisë për të tashmen dhe të ardhmen.


Të dhënat demografike kryesisht merren nga regjistrimet e popullsisë. Regjistrimi i fundit i popullsisë në Podujevë, si në tërë Kosovën, është mbajtur në vitin 2011.

1.3.1. Numri i popullsisë

Komuna e Podujevës ka shënuar rritje të konsiderueshme të popullsisë që nga viti 1948 kur kishte 43783 banor. Sipas regjistrimit të vitit 2011 kjo komunë ka 88499⁵ banorë. Kjo tregon se për periudhën 1948 – 2011 popullsia është rritur për 44716 banorë që do të thotë se për 55 vjet popullsia e Podujevës është dyfishuar. Gjatë kësaj periudhe kohore, popullsia e komunës së Podujevës ka shënuar rritje vjetore rreth 709 banor.

Tabela 2. Numri i popullsisë sipas regjistrimeve

Vitet	Nr. i popullsisë
Regjistrimi 1948	43783
Regjistrimi 1953	48272
Regjistrimi 1961	53480
Regjistrimi 1971	62324
Regjistrimi 1981	77423
Vlerësimi 1991	94943
Regjistrimi 2011	88499




Grafiku 1. Numri i popullsisë sipas regjistrimeve

⁵ Enti Statistikor i Kosoves - Regjistrimi i popullsisë në vitin 2011 - Komuna e Podujevës

Bazuar në indeksin bazik dhe vargor të rritjes së popullsisë në komunën e Podujevës, mund të vërehet periudhat kohore kur ka pasur rritje më të theksuar.

Tabela 3. Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor

Vitet	Nr. i popullsisë	Indeksi bazik	Indeksi Vargor
Regjistrimi 1948	43783	100	100
Regjistrimi 1953	48272	110	110
Regjistrimi 1961	53480	122	111
Regjistrimi 1971	62324	142	116
Regjistrimi 1981	77423	177	124
Vlerësimi 1991	94943	217	123
Regjistrimi 2011	88499	202	93



Grafiku 2. Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor

Sipas të dhënave nga tabela dhe grafiku vërehet se deri në vitet e 60-ta komuna e Podujevës ka shënuar rritje të vogël demografike. Kjo ndërlidhet me shtimin e ulët natyror, ku shkallët e natalitetit dhe mortalitetit ishin të larta. Pas viteve të 60-ta dhe sidomos gjate viteve të 70-ta shenohet një rritje më e theksuar të popullsisë si pasojë e zvogëlimit të shkallës së mortalitetit dhe qëndrueshmërisë së shkallës së lartë të natalitetit. Rritje e theksuar demografike e popullsisë vërehet edhe në periudhën kohore 1971 – 1981 kur popullsia është rrit për më tepër se 15000 banor, trend që vazhdon deri në vitin 1991. Pas vitit 1991 shenohet stagnim i shtimit të popullsisë. Në baze të shënimeve të

regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, numri i popullsisë në komunën e Podujevës është zvogluar për afërsisht 7%, apo 6444 banorë, krahasuar me vlerësimin e vitit 1991. Ky stagnim i shtimit të popullsisë i atribuohet emigrimeve të jashtme dhe të mbrendshme të popullsisë së komunës ë Podujevës pas vitit 1991. Në bazë të shënimeve të Entit Statistikor të Kosovës (të publikuara në vitin 2014), Podujeva ka shënuar bilanc negativ të migrimit ndërkombëtar prej 12.7% dhe migrimit kombëtar prej 13.2%. Nga gjithsej 14982 banorë që kanë emigruar nga komuna e Podujevës në botën e jashtme, 12251 (82%) kanë emigruar pas vitit 1990. Poashtu, gjithsej 15704 banorë kanë emigruar në drejtim të komunave të tjera të Kosovës. Ngjashëm me emigrimin ndërkombëtar, pjesa më e madhe e tyre kanë emigruar pas vitit 1999.

Popullsia e komunës së Podujevës jeton në gjithsej 78 vendbanime, prej tyre 77 janë fshatra dhe vetë qyteti i Podujevës. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Numri më i madh i popullsisë (23453 banorë) jeton në qytetin e Podujevës që përbën 27% të popullsisë së komunës.

1.3.2. Dendësia e popullsisë

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, dendësia e popullsisë në komunën e Podujevës është rreth 141 banorë në 1 km², që është pak nën mesatarën në nivel vendi prej 160 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Tabela 4. Numri i popullsisë sipas vendbanimeve

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve	Sipërfaqja (km ²)	Dendësia e Popullsisë
1	Bajçinë	2358	9.10	259
2	Ballofcë	2131	10.32	206
3	Barainë	98	5.91	17
4	Batllavë	2334	17.26	135
5	Bellopojë	1412	5.80	243
6	Bërvenik	72	4.00	18
7	Bllatë	9	2.19	4
8	Bradash	2567	15.30	168
9	Brainë	268	16.65	16
10	Brecë	119	9.55	12
11	Buricë	246	2.74	90
12	Dobërdol	1106	6.50	170
13	Dobratin	1576	15.68	101
14	Dumnicë e Epërme	497	7.44	67
15	Dumnicë e Poshtme	2975	19.78	150
16	Dumosh	1207	3.43	352
17	Dvorishtë	143	5.90	24
18	Dyz	573	9.12	63

19	Gërdoc	1263	5.90	214
20	Gllamnik	3794	9.37	405
21	Godishnjak	353	2.60	136
22	Halabak	623	6.56	95
23	Hërticë	741	22.59	33
24	Kaçybeg	494	1.36	363
25	Kalaticë	89	3.27	27
26	Kërpimeh	755	6.03	125
27	Kunushec	204	5.26	39
28	Kushevicë	873	4.13	211
29	Letanc	2080	3.15	660
30	Livadicë	296	2.35	126
31	Lupq i Epërm	275	7.45	37
32	Lupq i Poshtëm	2113	8.23	257
33	Lladoc	821	4.70	175
34	Llapashticë e Epërme	2363	21.71	109
35	Llapashticë e Poshtme	2701	8.03	336
36	Llaushë	980	9.99	98
37	Llugë	1404	3.16	444
38	Lluzhan	757	4.44	170
39	Majac	1622	14.35	113
40	Merdar	188	3.00	63
41	Metehi	1251	6.87	182
42	Metergoc	79	16.37	5
43	Miroc	132	3.65	36
44	Muhazob	0	4.35	0
45	Murgull	135	37.53	4
46	Obrançë	3092	5.84	529
47	Orllan	844	17.47	48
48	Pakashticë e Epërme	732	15.30	48
49	Pakashticë e Poshtme	292	0.90	324
50	Penuhë	539	4.34	124
51	Peran	1241	3.35	370
52	Përpellac	0	5.57	0
53	Podujevë	23453	8.90	2635
54	Pollatë	239	6.90	35
55	Popovë	181	17.59	10
56	Potok	61	3.05	20
57	Radujevc	0	1.92	0
58	Rakinicë	14	4.16	3
59	Reçicë	0	10.38	0
60	Repë	484	11.79	41
61	Revuq	924	7.92	117
62	Sallabajë	506	2.50	202
63	Sfeçël	1739	5.54	314
64	Siboc i Epërm	961	5.80	166


65	Siboc i Poshtëm	454	1.42	320
66	Sllatinë	130	13.47	10
67	Surdull	27	2.60	10
68	Surkish	1091	2.18	500
69	Sylevicë	63	10.43	6
70	Shajkoc	1504	9.45	159
71	Shakovicë	619	1.64	377
72	Shtedim	1148	3.40	338
73	Tërnavë	853	9.03	94
74	Tërnavicë	27	6.31	4
75	Turuçicë	109	15.33	7
76	Velikarekë	544	6.58	83
77	Zakut	453	2.23	203
78	Zhiti	98	12.34	8
TOTALI		88,499	628.7	141

Dendësia më e lartë e popullsisë e është në qytetin e Podujevës ku mesatarisht jetojnë rreth 2635 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Letanc (660 b/km²), Obrancë (529 b/km²), Surkish (500 b/km²), Lluge (444 b/km²), Gllamnik (405 b/km²) etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Rakinice (3 b/km²), Murgulle, Bllatë dhe Tërnavicë (4 b/km²), Metergoc (5 b/km²) etj, derisa Muhazobi, Përpellaci, Radujevci dhe Reçica nuk janë të populluara.

1.3.3. Shtimi natyror i popullsisë

Të dhënat e shtimit natyror për vitin 2011 janë vlerësuar duke i shfrytëzuar të dhënat për lindjet dhe vdekjet nga Enti i Statistikës së Kosovës për vitin 2011 për komunën e Podujevës.

Gjatë vitit 2011 në komunën e Podujevës janë shënuar 1653 lindje dhe 326 vdekje. Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje për komunën e Podujevës.



Grafiku 3. Shtimi natyror në vitin 2011 në komunën e Podujevës

Siç shihet edhe nga grafiku, shkalla e natalitetit në komunën e Podujevës është 18.68 promilë, kurse shkalla e mortalitetit është 3.68 promilë. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 15 promilë.

Megjithatë, si rezultat i migrimit të lartë të popullsisë që komuna e Podujevës aktualisht ka, shtimi i përgjithshëm i popullsisë ka vlerë negative, që do të thotë se numri i popullsisë është në zvogëlim e sipër. Ne bazë të vlerësimeve të popullsisë për vitin 2014 të publikuara nga Enti Statistikor i Kosovës, komuna e Podujevës ka gjithsej 86,836 banorë, që është për 1663 banorë më pak krahasuar me regjistrimin e vitit 2011. Ne këtë gjendje ka ndikuar sidomos emigrimi ndërkombëtarë që preku gjithë Kosovën në fundvitin 2014. Ne bazë të vlerësimeve të popullsisë për vitin 2014 të publikuara nga Enti Statistikor i Kosovës, komuna e Podujevës ka shënuar bilans negativ të migrimit prej gjithsej 3318 banorë (2596 prej të cilëve të përfshirë në migrim ndërkombëtarë).


1.3.4. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, si për të tanishmen ashtu edhe për të ardhmen. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyç të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate. Në aspektin demografik kjo strukturë ka rëndësi për riprodhimin biologjik sepse krijohet kontingjenti fertil, ndërsa në aspektin socio-ekonomik ndikon në krijimin e kontingjentit të punës. Struktura e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës ka rëndësi edhe për strukturat tjera demografike, për faktin se strukturat e popullsisë sipas veçorive të ndryshme socio-ekonomike (sipas aktivitetit, veprimtarisë, profesionit, arsimit etj.) hulumtohen njëkohësisht edhe sipas gjinisë dhe moshës.

Komuna e Podujevës në aspektin e zhvillimit demografik ka veçoritë e saj edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktor demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Podujevës ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë të zgjeruar të


piramidës sipas moshës, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Struktura gjinore e popullsisë po ashtu është karakteristike, me dominim të popullsisë mashkullore dhe me ndryshime të theksuara të koeficientit të maskulinitetit sipas grup-moshave.

Komuna e Podujevës ka një popullatë që i takon tipit progresiv të cilin e kanë mundësuar shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëherit edhe në ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, piramida e popullsisë së komunës së Podujevës kishte bazë të zgjeruar me dominimin e grup-moshave 0 deri 4 vjeç. Kjo strukturë e moshës dhe gjinisë paraqitet gjatë analizave të të dhënave nga viti 1991, por ndryshimet në shkallën e shtimit natyror të popullsisë pas vitit 2000 kanë ndikuar edhe në formën e piramidës, ku baza e saj ka mundur të ngushtohet.




Grafiku 4. Piramida e popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011

Ne bazë të shënimeve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 vërehet se kontigjentin më të madh të popullsisë e perben grupmosha 5 deri 9 vjeçare (10%). Grupmosha e re, deri 19 vjeçare përbën rreth 40% të popullsisë, derisa grupmosha mbi 65 vjeçare përbën 6% të popullsisë së Podujevës.



Grafiku 5. Grup-moshat e popullsisë

Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Podujevës ka karakteristikat e veta me dominim të lehtë të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 1032, që do të thotë se mesatarisht ekzistojë 1032 meshkuj në çdo 1000 femra.



Grafiku 6. Përqindja e popullsisë sipas gjinisë

Siç shihet edhe nga grafiku, ekziston një debalans i vogël gjinor në popullsinë e komunës së Podujevës, ku popullsia mashkullore dominon me 51 përqind në krahasim me popullsinë femërore që ka 49 përqind të popullsisë së gjithmbarshme.

Struktura e krijuar e moshës dhe gjinisë dhe ndryshimet e tyre gjatë kohës krijojnë efekte të reja socio-ekonomike dhe demografike. Këto dy struktura vazhdimisht ndikojnë në krijimin e kontingjenteve të rëndësishëm siç janë: Kontingjenti i punës, fertil, shkollor, i moshuar etj.

1.3.5. Familja dhe karakteristikat e saj

Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomikë, social, demografik etj.⁶

Siç dihet, ekzistojnë dallime sipas komunave në Kosovë sa i përket madhësisë së familjes. Komuna e Podujevës kryesisht karakterizohet me numër të madh të anëtareve të familjes, që është karakteristikë për vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale. Në bazë të të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 del se mesatarja e madhësisë së familjes në komunën e Podujevës është 6.6 anëtarë. Madhësia mesatare e familjes në qytetin e Podujevës është më e vogël se në viset rurale. Në qytetin e Podujevës mesatarisht familjet i kanë nga 6.2 anëtar, ndërsa mesatarja e anëtareve të familjes në fshatrat e Podujevës është 6.7 anëtar.

1.4 Ceshtjet Sociale

1.4.1 Sistemi Arsimor

Arsimi në Kosovë zhvillohet në institucione shoqërore dhe private. Duke filluar nga viti 1999, arsimi në Kosovë iu nënshtrua reformave të thella në të gjitha nivelet. Këto reforma kishin për synim përshtatjen e arsimit në Kosovë sipas standardeve bashkëkohore evropiane e botërore.

Arsimi është themeli i një shoqërie të shëndoshë i cili garanton perspektivë për të ardhmen shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike të një vendi. Pas vitit 2000 institucionet kosovare bënë përpjekje në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore. Në vitin 2002, krijuan një model të ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e re ofron pesë vite të arsimit fillor, pasuar nga katër vite të shkollimit të ulët të mesëm dhe tri apo katër vite të shkollimit të lartë të mesëm. Modeli 5+4+3 apo 4 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re arsimit i obligueshëm është zgjatuar për një vit, nga tetë vite sa ishte para reformave në 9 vite pas saj.

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Podujevës sikurse edhe në tërë Kosovën është e organizuar në katër nivele:

- a) Niveli 0: arsimi parashkollor mosha (3 deri në 6 vjet).
- b) Niveli 1: arsimi fillor për 5 vjet (mosha 6 deri në 12 vjet).
- c) Niveli 2: arsimi i mesëm i ulët për 4 vjet (mosha 12 deri 15 vjet)
- d) Niveli 3: arsimi i mesëm i lartë për 3 ose 4 vjet (moshat 15 deri 19 vjet).

Në bazë të shënimeve të Departamentit për Arsim (DA) të komunës së Podujevës për Vitin Shkollor 2013 – 2014, sistemi arsimor në komunën e Podujevës është i organizuar dhe i shpërndarë në gjithsej 63 objekte shkollore, nga të cilat 41 janë shkolla amë, dhe 22 janë paralele të ndara. Nga gjithsej 41 institucione shkollore që gjenden në komunën e Podujevës, 1 i përket shkollimit parashkollor, 37 i përkasin shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe 3 institucione i përkasin shkollimit të mesëm të

⁶ Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë, 2008.

lartë. Nga 78 vendbanime sa ka komuna e Podujevës 27 prej tyre nuk kanë objekte shkollore, çka do të thotë se 34% e vendbanimeve nuk kanë objekte shkollore. Në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar 1528 persona si personel arsimor. Prej tyre 1271 mësimdhënës, 84 punëtor administrativ dhe 173 punëtor ndihmës. Numri i përgjithshëm i nxënësve në komunën e Podujevës është 20905 çka do të thotë se mesatarisht për cdo mësimdhënë janë 16.32 nxënës.


1.4.1.1 Arsimi parashkollor dhe parafillor

Komuna e Podujevës edukimin parashkollor e ka të organizuar në një çerdhe të vetme, Çerdhen “DRITA“ që përfshin fëmijët e moshës deri në 5 vjeç. Sipas MASHT për Vitin Shkollor 2013 – 2014, në edukimin parashkollor kanë qenë të regjistruar gjithsej 67 fëmijë. Personeli edukativo arsimor në çerdhen DRITA është 16, prej tyre 9 janë edukatorë (të gjitha femra), 4 personel administrativ dhe 3 punëtorë ndihmës. Raporti nxënës/mësimdhënës është 7.4 (për cdo mësimdhënë janë 7.4 nxënës). Hapësira e çerdeses “Drita” është 660 m² (9.85 m²/1 fëmijë). Personeli edukativ i kësaj çerdhe është i tëri i kualifikuar.

Arsimi para fillor është i organizuar në 41 objekte shkollore, nga te cilat 33 janë shkolla amë dhe 8 janë paralele të ndara. Numri i nxënësve (fëmijëve) për këtë nivel në komunën e Podujevës është 1292.

1.4.1.2 Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët përfshin nivelet 1 (klasat 1-5 dhe nxënësit e moshës 6 deri 10 vjecare) dhe 2 (klasat 6-9 dhe nxënësit e moshës 11 deri 14 vjecare). Ky arsim është i obliguar dhe zgjat 9 vite. Në tërë territorin e komunës së Podujevës mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në gjithsej 59 objekte shkollore, 37 shkolla amë dhe 22 paralele të ndara fizike. Bazuar në shënimet e DA të komunës së Podujevës, numri i nxënësve që kanë ndjekur mësimet në këtë nivel në Vitin Shkollor 2013 – 2014 ishte 16877, kurse numri i mësimdhënësve 1036.



Grafiku 7. Raporti nxënës/mësimdhënës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta

Raporti nxënës/mësimdhënës për këtë nivel arsimor në nivel komunal sillet rreth 16.4 nxënës për 1 mësimdhënës, që është mbrenda standardit të përcaktuar nga MASHT e Republikës së Kosovës prej 21.3. Megjithatë, në një numër të shkollave të këtij niveli arsimor ky raport është i disfavorshëm. Me gjendje jo të mirë të raportit nxënës/mësimdhënës, që tejkalojnë standardin e përcaktuar nga ana e MASHT-it dhe standardet ndërkombëtare, janë 7 shkolla:

Tabela 5. Raporti i lartë nxënës/mësimdhënës (mbi standardin e përcaktuar nga MASHT) në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta

Emri i shkollës	Vendi	Gjithsej Nxenes	Gjithsej Mesimdhenes	Raporti
"Shefki Kuleta"	Tërnavë	476	22	21.64
"Ditura"	Llap.e Po	267	12	22.25
"Eqrem Çabej"	Buricë	223	10	22.30
"Xheladin Rekalju"	Podujevë	608	26	23.38
"Enver Maloku"	Podujevë	970	38	25.53
"Shaban Shala"	Podujevë	1310	47	27.87
"Jetullah Gashi"	Dobërdol	234	8	29.25
"Dr .Ibrahim Rugova"	Podujevë	1118	38	29.42

Me numër shumë të ulët të raportit nxënës/ mësimdhënës paraqiten objekte shkollore në këto vendbanime:

Tabela 6 Raporti i ulët nxënës/mësimdhënës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta

Emri i shkollës	Vendi	Gjithsej Nxenes	Gjithsej Mesimdhenes	Raporti
"Sami Frashëri"	Zhiti	81	28	2.89
"Jahë Hasani"	Bërvenik	59	16	3.69
"Zahir Pajaziti"	Orllan	200	38	5.26
"Shefki Latifi"	Pollatë	160	26	6.15
"Jetullah Islami"	Dyz	123	14	8.79
"Rilindja"	Hërticë	116	12	9.67

Gjendja fizike e objekteve shkollore në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në përgjithësi është e kënaqshme. Nga gjithsej 59 objekte shkollore sa ka ky nivel i arsimit, janë në gjendje të mirë fizike, 2 janë në gjendje jo të mirë (shkollat "Ditura" në fshatin Llapashticë e Poshtme dhe shkolla "Emin Duraku" në Bajcinë) dhe vetëm 1 objekt shkollor është në gjendje të mjerë fizike (paralelja e ndarë e shkollës "Shefki Kuleta" në fshatin Halabak).

Nga 59 objekte shkollore të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, 57 prej tyre e zhvillojnë mësimin në 2 ndrrime (turne). Vetëm shkolla "Naim Frashëri" në Podujevë dhe "Kadri Kadriu" në Llaushë zhvillojnë mësimin në 3 ndrrime (turne).

Kualifikimi i mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta - Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta kualifikimi i mësimdhënësve është në nivel të mirë. 97% e personelit mësimor është e kualifikuar.

Tabela 7 Kualifikimi i personelit mësimor në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta

Emri i shkollës	Vendi	Gjithsej Mësimdhënës	Të Kualifikuar		Të Pakualifikuar	
			Numri	%	Numri	%
"Nuhi Gashi"	Bradash	28	26	93%	2	7%
"Sami Frashëri"	Zhiti	28	28	100%	0	0%
"Ali Ajeti"	Sfeçël	60	54	90%	6	10%
"Kongresi I Manastirit"	Gllamnik	50	50	100%	0	0%
"Naim Frashëri"	Podujevë	67	67	100%	0	0%
"Shaban Shala	Podujevë	47	47	100%	0	0%
"Xheladin Rekalju"	Podujevë	26	26	100%	0	0%
"Dr .Ibrahim Rugova"	Podujevë	38	38	100%	0	0%
"Musli Dumoshi"	Dumosh	18	18	100%	0	0%
"Ilir Kunushefci"	Llugë	20	20	100%	0	0%
"Drita"	Majac	30	28	93%	2	7%
"Elfir Behrami"	Metehi	18	16	89%	2	11%
"Emin Duraku"	Bajçinë	24	22	92%	2	8%
"Sheqë Mirofci"	Shtedim	22	22	100%	0	0%
"Jetullah Gashi"	Dobërdol	8	8	100%	0	0%
"Rilindja"	Hërticë	12	12	100%	0	0%
"Esat Mekuli"	Dobratin	20	18	90%	2	10%
"Luigj Gurakuqi"	Batllavë	46	44	96%	2	4%
"Lasgush Poradeci"	Dumnicë	18	16	89%	2	11%
"Elena Gjika"	Shajkofc	14	14	100%	0	0%
"Afrimi e Fahriu"	Lluzhan	40	40	100%	0	0%
"Hyzriu e Samiu"	Letanc	20	16	80%	4	20%
"Dëshmorët eKombit"	Podujevë	32	32	100%	0	0%
"Naum Veqilharxhi!"	Llap.e Ep	18	16	89%	2	11%
"Zenel Hajdini"	Lupç I Po	28	28	100%	0	0%
"Dituria"	Llap.e Po	12	12	100%	0	0%
"Shefki Kuleta"	Tërnavë	22	22	100%	0	0%
"Kadri Kadriu"	Llaushë	34	30	88%	4	12%
"Jahë Hasani"	Bërvenik	16	12	75%	4	25%
"Ali Hadri"	Obrançë	48	48	100%	0	0%
"Eqrem Çabej"	Buricë	10	10	100%	0	0%
"Zahir Pajaziti"	Orllan	38	38	100%	0	0%
"Enver Maloku"	Podujevë	38	38	100%	0	0%
"Azem Bejta"	Kërpimëh	28	28	100%	0	0%
"Pavaresia"	Sibofc	18	16	89%	2	11%
"Jetullah Islami"	Dyz	14	14	100%	0	0%
"Shefki Latifi"	Pollatë	26	26	100%	0	0%
TOTALI		1036	1000	97%	36	3%

Në bazë të analizave të sipërfaqes së shkollës dhe numrit të nxënësve vihet në konkludimin se shkollat e nivelit arsimor fillor dhe të ulët të mesëm në Komunën e Podujevës në përgjithësi kanë

hapsire te pamjaftueshme. Në nivel komunal, mesatarja e sipërfaqes shkollore për 1 nxënës është 3.47m². Ekzistojnë dallime të mëdha në mes të shkollave. Hapësira për 1 nxënës në 19 institucione shkollore është më e vogël se 3m². Gjendja më e rënduar paraqitet në shkollën “Emin Duraku” me vetëm 0.9 m² për 1 nxënës. Për dallim nga këto, në 4 institucione shkollore gjenda paraqitet e favorshme, ku hapësira për 1 nxënës është mbi 10m², derisa në shkollën Zahir Pajaziti në Orllan janë mbi 18 m² për 1 nxënës.

Tabela 8 Kualifikimi i personelit mësimor në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta

Nr	Shkolla	Sipërfaqja (m ²)	Nxënës	Sipërfaqja për nxënës (m ²)
1	Emin Duraku	411.81	443	0.9
2	Illir Konushefci	460.00	393	1.2
3	Musli Dumoshi	284.09	190	1.5
4	Naim Frashëri	2150.00	1219	1.8
5	Esat Mekuli	599.00	333	1.8
6	Shaban Shala	2526.36	1310	1.9
7	Hasan Ramadani	550.00	274	2.0
8	Kadri Kadriu	890.00	400	2.2
9	Luigj Gurakuqi	1690.00	727	2.3
10	Dëshmoret e Kombit	1250.00	532	2.3
11	Ditura	630.00	267	2.4
12	Kongresi I Manastirit	1930.00	796	2.4
13	Elfir Behrami	550.00	226	2.4
14	Pavarësia	844.52	340	2.5
15	Ali Ajeti	2121.00	839	2.5
16	Afrimi e Fahriu	1352.00	524	2.6
17	Xheladin Rekalju	1670.00	608	2.7
18	Naum Veqilharxhi	1047.00	370	2.8
19	Jetullah Gashi	685.50	234	2.9
20	Enver Maloku	2865.00	970	3.0
21	Lasgush Poradeci	1000.00	305	3.3
22	Hamit Sejdiu	2012.00	522	3.9
23	Zenel Hajdini	1500.00	369	4.1
24	Eqrem Çabej	930.00	223	4.2
25	Dr. Ibrahim Rugova	5000.00	1118	4.5
26	Rilindja	530.00	116	4.6
27	Ali Hadri	2920.00	630	4.6
28	Sheqë Merofci	1500.00	323	4.6
29	Shefki Kuleta	2477.00	476	5.2
30	Hyzriu e Samiu	2250.00	393	5.7
31	Shefki Latifi	1095.00	160	6.8
32	Nuhi Gashi	3085.00	450	6.9
33	Jahë Hasani	430.00	59	7.3
34	Sami Frashëri	810.00	81	10.0
35	Jetullah Islami	1284.00	123	10.4
36	Drita	3603.00	334	10.8
37	Zahir Pajaziti	3640.00	200	18.2

1.4.1.3 Arsimi i mesëm i lartë

Arsimi i mesëm i lartë – në komunën e Podujevës është i organizuar në:


- Arsimin e përgjithshëm (gjimnaze) dhe
- Arsimin profesional (shkollë e mesme ekonomike dhe shkollë e mesme teknike).

Arsimi i mesëm i lartë përfshin tri dhe katër vite të shkollimit për nxënësit e grup-moshave 15 deri 18-19 vjeç. Në komunën e Podujevës ky nivel i arsimit është i organizuar në 3 institucione arsimore që gjenden në zonën urbane të Podujevës, (Gjimnazi “Aleksander Xhuvani”, SHMT “Fan S. Noli”, dhe SHME “Isa Boletini”). Bazuar në shënimet e DA të komunës së Podujevës, numri i nxënësve që kanë ndjekur mësimet në këtë nivel në Vitin Shkollor 2013 – 2014 ishte 3958, kurse numri i mësimdhënësve 219. Kualifikimi i personelit arsimor në kete nivel arrin 89%.

Tabela 9 Kualifikimi i personelit mësimor në shkollat e nivelit të mesëm të lartë

Emri i shkollës	Vendi	Gjithsej Mësimdhënës	Të Kualifikuar		Të Pakualifikuar	
			Numri	%	Numri	%
"Gjimnazi "Alek. Xhuvani"	Podujevë	72	58	81%	14	19%
SHME "Isa Boletini"	Podujevë	75	73	97%	2	3%
SHMT "Fan S.Noli"	Podujevë	72	64	89%	8	11%
TOTALI		219	195	89%	24	11%

Raporti nxënës/mësimdhënës në shkollat nivelit të mesëm të lartë është 18.07 nxënës për 1 mësimdhënës.



Grafiku 8. Raporti i nxënës/mësimdhënës në shkollat e mesme të larta


Sa i përket numrit të nxënësve për një mësimdhënës ndërmjet shkollave nuk ka ndryshime të mëdha. Gjimnazi Aleksander Xhuvani ka një ngarkesë më të madhe me 21.71 nxënës/mësimdhënës dhe është pak mbi standardin e përcaktuar nga MASHT prej 21.3 nxënës për mësimdhënës. SHME Isa Boletini me 20.32 nxënës/mësimdhënës është poashtu mbi standardin e përcaktuar nga MASHT për shkollat profesionale prej 17.2. Ndërkaq, gjendje krejtësisht tjetër paraqitet në SHMT Fan Noli ku raporti

nxënës / mësimdhënës është 12.1 dhe është konsiderueshëm nën standardin e përcaktuar nga MASHT (17.2).

Ngjashëm me shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, problemi i hapsirës së pamjaftueshme shkollore paraqitet edhe tek shkollat e nivelit të mesëm të lartë. Raporti i hapsirës shkollore për 1 nxënës në shkollat e nivelit të mesëm të lartë leviz nga 2.1 m² në shkollën “Aleksandër Xhuvani”, 2.9 m² në shkollën “Isa Boletini” deri në 3.6 m² për 1nxënës në shkollën fillore “Fan Noli”.

Në të 3 shkollat e nivelit të mesëm të lartë mëimi zhvillohet në 2 ndrrime dhe gjendja fizike e objekteve shkollore paraqitet të jetë e kënaqshme.

Harta 4. Shtrirja hapësinore e objekteve shkollore



1.4.1.4 Shkollat Speciale

Në shkollën fillore “Kongresi i Manastirit” që gjendet në vendbanimin Gllamnik, zhvillohet mësimi special për persona me aftësi të kufizuara. Në këtë shkollë është një paralele speciale me gjithsejtë 15

nxënës dhe me dy mësimdhënës të kualifikuar. Nxënësit janë të moshave të ndryshme dhe me të meta të natyrave të veçanta, ku ju kushtohet një përkujdesje e veçantë nga personeli arsimor⁷

1.4.1.5 Shkalla e Analfabetizmit

Bazuar në shënimet e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, 7.8% e popullsisë mbi moshën 15 vjeçare nuk kanë pasë të përfunduar asnjë nivel shkollimi, që është mbi mesataren në Kosovë prej 6.2%. Me këtë shkallë të analfabetizmit, Komuna e Podujevës radhitet ndër komunat me nivelin më të madh të analfabetizmit. Vetëm 5 komuna të Kosovës kanë shkallë më të lartë se Podujeva.

1.4.2 Sistemi Shëndetësor

Në komunën e Podujevës si në tërë Kosovën e pas luftës së vitit '99, sistemi shëndetësor u ballafaqua me vështirësi të shumta në aspektin organizativ, infrastrukturor dhe financiar. Pas çlirimit të vendit, strukturat vendore me përkrahjen e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare investuan në shëndetësi dhe ndikuan në riorganizimin dhe zhvillimin e sistemit shëndetësor në tërësi. Gjatë kësaj periudhe shumica e objekteve shëndetësore të dëmtuara gjatë luftës janë rinovuar dhe janë ndërtuar shumë objekte të reja. U ofruan ndihma në pajisje dhe aparatura mjekësore moderne, u organizuan trajnime në lëmi të ndryshme të mbrojtjes shëndetësore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve kualitative dhe të leverdishme të kujdesit shëndetësor primar.

Në komunën e Podujevës investimet u përqendruan në reformimin e kujdesit parësor dhe avancimin e mjekësisë familjare si bartëse e këtij kujdesi. Në këtë drejtim u organizua për herë të parë shkollimi superior i mjekëve dhe personeli shëndetësor që sot e ngritin konceptin e mjekësisë familjare, në nivelin e kërkesave të Strategjisë shëndetësore të Kosovës 2005-2015, ku mjekësia familjare është sektor mjaft me rëndësi në zbatimin e prioriteteve shëndetësore kryesore dhe synimeve të identifikuar nga Ministria e Shëndetësisë. Kujdesi shëndetësor primar apo mjekësia familjare është shtylla kryesore e sistemit shëndetësorë, e cila udhëhiqet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS) në komunë. DSHMS organizon punën në shërbimet primare shëndetësor, shërbimet sociale dhe shërbimet e inspektimit sanitar, të cilat janë synime dhe obligime të MSH si dhe janë në përputhje me Ligjin për shëndetësi.

Në komunën e Podujevës sistemi shëndetësor ka mbulueshmëri relativisht të mirë të popullsisë dhe është i organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të fushave të specializuara mjekësore. Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është përgjegjësi e Qendrës kryesore të mjekësisë familjare-QKMF, në kuadër të së cilës, bazuar në shënimet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Komunës së Podujevës funksionojnë 4 Qendra të mjekësisë familjare (QMF) dhe 18 Ambulanca të mjekësisë familjare (AMF), të shpërndarë në 22 vendbanime të komunës⁸, me një dendësi prej 1 objekt shëndetësor në cdo 29 km².

⁷ Të dhënat nga Drejtoria Komonale për Arsim - Podujevë, 2014


⁸ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Podujevë;2014

Sipas shënimeve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale të Komunës së Podujevës gjatë vitit 2014 në institucionet shëndetësore të komunës së Podujevës janë realizuar gjithsej 345029 vizita mjeksore. Në gjithsej 23 institucione shëndetsore publike janë të punësuar gjithsej 184 punëtorë shëndetsorë, nga të cilët 28 janë qenë specialistë, 21 mjekë të mjeksisë së përgjithshme, 8 janë stomatologë dhe 127 janë infermierë, 4 prej të cilëve kanë të kryer fakultetin e infermierisë.

Tabela 10 Qendrat mjeksore

Niveli	Vendbanimi	Orari i Punës	Specialist	Mjek	Stomatolog	Gjithsej Mjek	Infermier
QKMF	Podujevë	24 ore	24	7	4	35	91
QMF	Kërpimëh	2 ndrrime	1	1	1	3	4
QMF	Lluzhan	2 ndrrime	1	1	1	3	6
QMF	Orllan	2 ndrrime	0	2	1	3	3
QMF	Podujevë	2 ndrrime	0	2	1	3	2
AMF	Bajçinë	1 ndrrim	0	0	0	0	1
AMF	Batllavë	1 ndrrim	0	1	0	1	2
AMF	Bradash	1 ndrrim	0	1	0	1	1
AMF	Dobratin	1 ndrrim	0	0	0	0	1
AMF	Dumnicë	1 ndrrim	0	1	0	1	1
AMF	Dyz	1 ndrrim	0	1	0	1	1
AMF	Gllamnik	1 ndrrim	1	0	0	1	3
AMF	Halabak	1 ndrrim	0	0	0	0	1
AMF	Herticë	1 ndrrim	0	0	0	0	1
AMF	Llapashticë	1 ndrrim	0	1	0	1	2
AMF	Lupç	1 ndrrim	0	0	0	0	1
AMF	Majac	1 ndrrim	1	0	0	1	1
AMF	Murgull	1 ndrrim	0	0	0	0	1
AMF	Pollatë	1 ndrrim	0	0	0	0	1
AMF	Sfeçël	1 ndrrim	0	1	0	1	1
AMF	Shajkofc	1 ndrrim	0	1	0	1	1
AMF	Shtedim	1 ndrrim	0	1	0	1	1
AMF	Ballofcë	1 ndrrim	0	0	0	0	0
Gjithsej			28	21	8	57	127

Harta 5. Objektet shëndetësore




Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), si bartëse e kujdesit primar, është e vendosur në qytetin e Podujevës dhe ofron shërbime në tri objekte me hapësirë më se 2000 m². Ky objekt është rindërtuar në vitet e '80ta me destinim shëndetësor që nga fillimi si objekt dhe sot gjendja fizike e tij është e kënaqshme. Në këtë institucion janë të punësuar gjithsej 126 punëtorë shëndetësor. Aktualisht në strukturën e punëtorëve shëndetësor janë 9 specialistë të fushave të ndryshme shëndetësore nga; 15 specialist të Mjekësisë Familjare, 7 mjek të mjekësisë së përgjithshme; 4 stomatolog dhe 91

infermier/teknik. Në këtë qendër puna është e organizuar në dy ndërrime, derisa emergjenca ofron shërbime 24 orë në ditë. Gjatë vitit 2014 në këtë qendër janë kompletuar gjithsej 286802 vizita Në komunën e Podujevës përpos QKMF-së, funksionojnë edhe 4 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 17 Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF), të shpërndara në tërë territorin e komunës. QMF dhe AMF, duke mos llogaritur QKMF dhe QMF në qytetin e Podujevës, mbulojnë me shërbime rreth 73% të popullatës së komunës. Stafi shëndetësor i QKMF-së është i angazhuar edhe për punë në teren duke bërë vizita të rregullta në QMF-të dhe AMF-të e komunës së Podujevës.

Qendrat e Mjekësisë Familjare funksionojnë kryesisht në objekte të reja gjegjësisht të renovuara të cilat kanë hapësirë të mjaftueshme (afersisht 200 m²). QMF-të punojnë me një ndërrim dhe në to kryesisht janë të angazhuar nga 2 mjekë të mjekësisë së përgjithshme dhe 1 stomatolog. Numri i përgjithshëm i personelit mjeksor që punon në 4 QMF-të është 8 mjek, 4 stomatolog dhe 15 infermierë. Gjatë vitit 2014 në QMF janë realizuar gjithsej 31297 shërbime shëndetësore. Numër më i madh i shërbimeve janë kryer në QMF Lluzhan, gjithsej 17883 shërbime.

Në komunën e Podujevës funksionojnë 18 AMF, të shpërndara në vendbanimet e komunës. AMF-të funksionojnë në objekte që në përgjithësi kanë gjendje të kënaqshme fizike dhe kanë hapësirë të mjaftueshme (nga 60 deri në 100 m², varesisht nga vendbanimi). AMF-të punojnë në një ndërrim dhe në to janë kryesisht të angazhuar nga 1 mjek dhe 1 infermier, me përjashtim të AMF në Gllamnik ku janë të angazhuar 3 infermier dhe në AMF-të në Llapashticë dhe Batllavë ku janë të angazhuar nga 2 infermier. Në AMF nuk ka të angazhuar stomatolog. Numri i përgjithshëm i personelit mjeksor që punon në 17 AMF-të është 11 mjek dhe 21 infermierë. Gjatë vitit 2014 në AMF janë realizuar gjithsej 26930 shërbime shëndetësore. Numër më i madh i shërbimeve janë kryer në AMF Bradash, gjithsej 2574 shërbime, kurse më së paku shërbime janë realizuar në AMF Murgull, gjithsej 95.

Kur të analizohet numri i personelit mjeksorë të angazhuar institucionet shëndetësore në raport me numrin e banorëve vërehet se në Komunën e Podujevës numri i personelit mjeksorë është dicka mbi standardin e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) e Republikës së Kosovës sa i përket numrit të mjekëve dhe infermierëve (1 mjek në 2000 banorë dhe 2 infermier në 2000 banorë) dhe nën standardin e përcaktuar nga MSH për numrin e Stomatologëve (1 stomatolog në 6000 banorë).



Grafiku 9. Raporti mjek dhe infermier në 2000 banorë dhe stomatolog në 6000 banorë në nivel komune

Siç shihet nga grafikoni i mësipërm, aktualisht, në institucionet shëndetësore të Komunës së Podujevës janë të angazhuar 49 mjek, derisa sipas standardit të përcaktuar nga MSH numri i mjekëve do të duhej të ishte 45. Ngjashëm me këte, numri i infermierëve është ndjeshëm më i lartë sesa standardi (127 kundrejt 89 në bazë të standardit). Në anën tjetër vërehet një mungesë e stomatologëve. Në bazë të standardit të MSH (1 stomatolog në 6000 banorë) numri i stomatologëve të nevojshëm është 15 përkundër 8 stomatologëve që janë të angazhuar aktualisht.

Kur të analizohet numri i personelit mjekësorë të angazhuar institucionet shëndetsore në raport me numrin e banorëve për vendbanimet dhe institucionet shëndetsore në veçanti, vërehen dallime të konsiderueshme.

Kur të analizohet raporti personeli shëndetësorë – numër i banorëve individualisht për secilin institucion vërehet një disproporcion i theksuar. Derisa në disa institucione ky raport e tjkalon shumëfish standardin e MSH, sic është rasti me AMF në Murgull ku raporti mjek dhe infermier është afro 15 (për dallim nga standardi prej 1 mjek dhe 2 infermier në 2000 banorë), në rastin e AMF në Gllanik ky raport është nën standardin e përcaktuar (0.5 mjek dhe 1.6 infermier). Megjithatë, këto vlera nuk duhet të mirren si vlera përfaqësuese për faktin se në këto qendra shëndetsore gravitojnë edhe banorë të vendbanimeve që nuk kanë qendra shëndetësore dhe për faktin se një numër i mjekëve dhe infermierëve nga QKMF-ja janë të angazhuar në teren dhe kryejnë vizita edhe në QMF-të dhe AMF-të e komunës.

Tabela 11. Raporti mjek dhe infermier në 2000 banorë dhe stomatolog në 6000 banorë në institucionet shëndetsore

Niveli	Vendbanimi	Zona	Numri i banoreve	Raporti Banor/Mjek	Raporti Banor/Infermier	Raporti Banor/Stomatolog
QMF	Kërpimëh	Malet dhe Pejsazhet	755	5.3	10.6	7.9
AMF	Bradash	Malet dhe Pejsazhet	2567	0.8	0.8	0.0
AMF	Dobratin	Malet dhe Pejsazhet	1576	0.0	1.3	0.0
AMF	Majac	Malet dhe Pejsazhet	1622	1.2	1.2	0.0
AMF	Murgull	Malet dhe Pejsazhet	135	0.0	14.8	0.0
AMF	Pollatë	Malet dhe Pejsazhet	239	0.0	8.4	0.0
QKMF	Podujevë	Qender	23453	2.6	7.8	1.0
QMF	Lluzhan	Qender	757	5.3	15.9	7.9
QMF	Podujevë	Qender	23453	0.2	0.2	0.3
AMF	Bajçinë	Qender	2358	0.0	0.8	0.0
AMF	Dumnicë	Qender	2975	0.7	0.7	0.0
AMF	Gllamnik	Qender	3794	0.5	1.6	0.0
AMF	Halabak	Qender	623	0.0	3.2	0.0
AMF	Llapashticë	Qender	2363	0.8	1.7	0.0
AMF	Lupç	Qender	2113	0.0	0.9	0.0
AMF	Sfeçël	Qender	1739	1.2	1.2	0.0
AMF	Shtedim	Qender	1148	1.7	1.7	0.0
QMF	Orllan	Turizem	844	4.7	7.1	7.1
AMF	Batllavë	Turizem	2334	0.9	1.7	0.0
AMF	Dyz	Turizem	573	3.5	3.5	0.0
AMF	Herticë	Turizem	741	0.0	2.7	0.0
AMF	Shajkoc	Turizem	1504	1.3	1.3	0.0

Vlera më përfaqësuese nxirren nëse bëhet grupimi i institucioneve shëndetësore në bazë të tre zonave hapsirore. Keshtu, në bazë të kësaj analize, vërehet se zona e cila ka mungesë të personelit mjekësorë është zona veri-perëndimore (Malet dhe Pejsazhet) ku raporti 1 mjek për 2000 banorë është 0.52 dhe raporti 2 infermier për 2000 banorë është 1.16. Në zonat e tjera, ky raport është mbi standardin e përcaktuar. Mungesa e stomatologëe është evidente në gjithë komunën.

Tabela 12. Raporti mjek dhe infermier sipas zonave hapsirore


Zona	Raporti Mjek/Banor	Raporti Stomatolog/Banor	Raporti Infermier/Banor
Malet dhe Pejsazhi	0.52	0.39	1.16
Qender	1.22	0.55	3.37
Turizem	1.31	0.79	2.10

Në sistemin shëndetësor primar bënë pjese edhe sektori privat. Sektori privat i shëndetësisë primare në komunën e Podujevës ka shënuar zhvillim të theksuar viteve të fundit. Sot në sektorin privat veprojnë më se 43 institucione shëndetësore-ordinanca private të cilat aktivitetin e tyre e zhvillojnë kryesisht në zonën urbane. Në këto ordianca ofrohen shërbime: pediatrike, internistike, gjinekologjike, stomatologjike dhe mjekësisë familjare, ku punojnë specialist të degëve përkatëse të cilët kanë një rol me rëndësi dhe në një mënyrë kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për banorët e komunës. Poashtu pjesë e sektorit privat janë edhe 17 barnatore dhe 6 laborator.

1.4.3 Papunësia

Në Kosovë shkalla e lartë e papunësisë është një sfidë shumë e madhe e cila reflektohet me probleme të shumta në shoqëri. Shkalla e papunësisë në nivel të Kosovës sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 është 35.3%⁹ dhe llogaritet më e larta në rajon. Vlerësohet se afro 30% e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 55% e popullsisë janë në moshë pune. Papunësia me shkallë më të lartë prek femrat me 41.6%.

Edhe pse, nuk ka të dhëna të sakta mbi shkallën e papunësisë në nivel komunal, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia është e lartë. Në bazë të numrit të punëkërkuësve, të paraqitur në zyrën e punës dhe punësimit të komunës së Podujevës, shkalla e papunësisë në komunën e Podujevës është afro 11% (sipas shënimeve të muajit Maj 2015). Megjithatë, kjo përqindje mendohet të jetë më e lartë për faktin se një numër i konsiderueshëm i personave të papunë nuk paraqiten në këtë zyre.




Grafiku 10. Punëkërkuësit sipas grupmoshës dhe gjinisë

⁹ Agjensioni i Statistikave të Kosovës

Kur të analizohet struktura e punëkërkesve sipas gjinisë, vërehet se papunësia më e lartë është e shprehur tek gjinia mashkullore, me 56% të kontingjentit të përgjithshëm të punëkërkesve. Përveç kësaj, papunësia më e lartë është e shprehur te grupmosha e moshës së mesme, 25 deri 39 vjeçare që përfaqsohet me 45% të të papunëve. Nuk vërehen dallime në numrin e të papunëve sipas gjinisë dhe grupmoshave. Tek të dy gjinitë, numri më i madh i të papunëve i përket grupmoshës 25-39 vjeçare, që përcillet me grupmoshën 15-24, 40-54 dhe mbi 55 vjeçare në fund.

Tek analiza e strukturës së kualifikimit të punëkërkesve, vërehet se papunësia më e lartë është e shprehur tek personat e pakualifikuar me 64% të kontingjentit të përgjithshëm të punëkërkesve.



Grafiku 11. Punëkërkesit sipas kualifikimit

Në shkallën e lartë të Papunësisë kanë ndikuar një varg faktorësh. Në radhë të parë mund të përmendën faktorët e përgjithshëm socio – ekonomik.

Situata e rëndë ekonomike e sidomos gjatë viteve të 90-ta, kur u mbyllen fabrikat, pastaj vonesa në privatizimin e ndërmarrjeve, humbja e interesimit për tu marr me bujqësi, parcelizimi shumë i madh i pronave, etj, kanë pas ndikim të madh në shkallën e papunësisë.

Në anën tjetër faktorët social i kanë ndihmuar kësaj gjendje të papunësisë ku niveli i ulët i arsimimit (me theks të veçantë tek femrat), familjet e mëdha në numër dhe popullsi kryesisht agrare, largimi i dhunshëm prej punës nga pushtuesi serb, gjatë viteve të '90 –ta, etj. ishin dhe mbeten si faktor në rritjen e shkallës së papunësisë. Të gjithë këta faktor të përmendur si më lartë dhe faktor të tjerë, kanë bërë që shkalla e papunësisë në Podujevë të jetë shumë e lartë.

1.4.4 Varfëria

Varfëria është një fenomen kompleks social i cili është vështirë të matet. Bazuar në shënimet e Agjencionit të Statistikave të Kosovës për vitin 2013 varfëria e përgjithshme në Kosovë ishte rreth 29%, ndërsa rreth 8% e popullsisë jeton në varfëri ekstreme. Në fillim të viteve të '90-ta, në Kosovë ndodhën largime të dhunshme nga puna të popullsisë shqiptare nga pushtuesi serb. Këto largime të dhunshme ndikuan drejtpërsëdrejti në shkallën e ulët të arsimit dhe shëndetësisë dhe zhvillim të pabalancuar ekonomik. Gjithashtu, shkatërrimet e shtëpive, bizneseve dhe ndërmarrjeve gjatë luftës së vitit 1998 - 1999 ndikuan drejtpërsëdrejti në varfërimin e popullsisë së Kosovës e cila ka prekur të gjitha komunat e Kosovës.

Duke u bazuar në të dhënat e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Podujevës, gjithëj 1099 ekonomi familjare janë të përfshira në programin për asistancë sociale. Kjo paraqet rreth 8% të të gjitha ekonomive familjare në komunën e Podujevës.


Tabela 13. Familjet me asistencë sociale

Vendbanimi	Numri i banoreve	Ekonomi familjare private	Numri i familjeve me Asistencë Sociale	Perqindja e familjeve me asistencë sociale
Bërvenik	72	11	0	0%
Muhazob	0	0	0	0%
Përpellac	0	0	0	0%
Radujevc	0	0	0	0%
Rakinicë	14	1	0	0%
Reçicë	0	0	0	0%
Surdull	27	4	0	0%
Sylevicë	63	6	0	0%
Tërnavicë	27	4	0	0%
Surkish	1091	169	1	1%
Siboc i Poshtëm	454	67	1	1%
Lupq i Poshtëm	2113	322	7	2%
Lupq i Epërm	275	38	1	3%
Sfeçël	1739	261	8	3%
Shakovicë	619	93	3	3%
Obrançë	3092	489	16	3%
Shajkoc	1504	235	8	3%
Lluzhan	757	115	4	3%
Penuhë	539	79	3	4%
Llapashticë e Poshtme	2701	389	16	4%
Gërdoc	1263	187	8	4%
Revuq	924	129	6	5%
Popovë	181	21	1	5%
Zakut	453	63	3	5%
Kunushec	204	125	6	5%
Kushevicë	873	38	2	5%
Sallabajë	506	75	4	5%
Metehi	1251	185	10	5%

Bajçinë	2358	342	19	6%
Tërnavë	853	125	7	6%
Llapashticë e Epërme	2363	321	18	6%
Llugë	1404	230	13	6%
Majac	1622	239	15	6%
Halabak	623	88	6	7%
Letanc	2080	299	22	7%
Gllamnik	3794	556	42	8%
Bradash	2567	394	30	8%
Dumnicë e Poshtme	2975	442	34	8%
Siboc i Epërm	961	155	12	8%
Kërpimëh	755	116	9	8%
Dobërdol	1106	173	14	8%
Peran	1241	182	15	8%
Metergoc	79	12	1	8%
Miroc	132	24	2	8%
Shtedim	1148	180	15	8%
Repë	484	68	6	9%
Dumosh	1207	176	16	9%
Bellopojë	1412	207	19	9%
Orllan	844	138	13	9%
Podujevë	23453	3792	364	10%
Pakashticë e Poshtme	292	41	4	10%
Batllavë	2334	346	35	10%
Lladoc	821	121	13	11%
Ballofcë	2131	362	41	11%
Hërticë	741	96	11	11%
Dobratin	1576	218	25	11%
Murgull	135	17	2	12%
Brecë	119	16	2	13%
Dyz	573	80	10	13%
Potok	61	8	1	13%
Sllatinë	130	16	2	13%
Velikarekë	544	85	11	13%
Kalaticë	89	15	2	13%
Merdar	188	29	4	14%
Pollatë	239	29	4	14%
Llaushë	980	128	19	15%
Livadicë	296	40	7	18%
Dumnicë e Epërme	497	60	11	18%
Kaçybeg	494	69	13	19%
Pakashticë e Epërme	732	102	21	21%
Brainë	268	42	9	21%
Godishnjak	353	53	12	23%
Barainë	98	15	4	27%
Turuçicë	109	15	5	33%
Zhiti	98	12	4	33%
Dvorishtë	143	19	8	42%

Buricë	246	40	18	45%
Blatë	9	1	1	100%
TOTALI	88499	13440	1099	8%

Harta 6. Shtrirja hapësinore e popullsisë me asistencë sociale, sipas vendbanimeve



Faktorët kryesorë që e shkaktojnë këtë përqindje të lartë të varfërisë, sidomos në disa nga vendbanimet e komunës së Podujevës janë: largësia e theksuar nga zona urbane (qendra), relievi, shkalla e ulët e arsimimit, kushtet jo të mira të banimit.

1.4.5 Kultura, Rinia dhe Sporti

Komuna e Podujevës ka pozitë të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore-sportive. Zhvillohen një numër i madh i aktiviteteve të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato kulturore, sportive, konferenca, (për ambient, mjekësi, telekomunikacion etj), ku të rinjtë mundohet të përcjellin mesazhe të qarta tek shoqëria e gjithmbarshme Llapiane. Të gjitha aktivitetet kulturore-sportive zhvillohen dhe organizohen në: Sallën e Kulturës, Palestrën Sportive, Stadiumin e Qytetit dhe Bibliotekën e Qytetit e në raste të veçanta shfrytëzohen edhe objektet shkollore dhe disa aktivitete mbahen edhe në ambient të hapur.

Kultura – Llapjanët kanë treguar gjithmonë një interes të madh për të kontribuar në art dhe kulturë. Kultura tregon të kaluarën dhe të tashmen e një populli. Në komunën e Podujevës zhvillimet kulturore kanë zënë vend që një kohë të gjatë. Në teatrin e qytetit kanë dalë shumë herë shfaqje e drama, që kanë bërë jehonë të madhe edhe në nivel vendi. Shumë artistë, këngëtarë dhe figura politike kanë origjinë nga Llapi. Në komunën e Podujevës veprojnë numër i konsiderueshëm organizata jo qeveritare dhe shoqëri kulturore-artistike. OJQ “Dili”, OJQ “Besiana”, Teatri Amator “Besiana”, OJQ “Artx”, OJQ “Pro Kult”, OJQ “Provo Ndryshe”, Klubi Letrar i të Rinjve, Valltaret e Qëndresës etj. Aktivitetet e tyre kryesisht janë të përqendruara në dramë, komedi, recitale të ndryshme, ambient, gara sportive dhe aktivitete të lira. Këto aktivitete zhvillohen në kryesisht në Sallën e Kulturës, Palestrën Sportive, Stadiumin e Qytetit dhe në objekte shkollore. Në komunën e Podujevës organizohen manifestime të kulturore për të shënuar festat apo datat e rëndësishme. Para vitit 1999 komuna e Podujevës ka pasur 14 biblioteka publike me 143.067 libra, derisa 13 nga degët e saj në vend kanë pasur 100.655 libra. Gjatë kohës së luftës u dogjën nga okupatori Serb, 10 biblioteka duke përfshirë edhe bibliotekën e Qytetit, me një fond prej 1249777 libra. Pas vitit 1999 komuna e Podujevës ka vetëm tre biblioteka (shumë të dëmtuara) me 18.090 libra. Fondi i këtyre librave dhe ekzemplareve janë kryesisht në gjuhë shqipe dhe një pjesë e vogël e tyre është në gjuhën angleze dhe gjermane. Ndërkaq, numri i lexuesve (regjistruar) gjatë vitit 2009 ishte 542.

Rinia- është thënë se rinia është syri më vigjilent i një kombi. Ashtu si në Kosovë edhe në komunën e Podujevës rinia përfaqësohet me grup moshën më të madhe. Rreth 57% e popullsisë së përgjithshme e përfaqëson rinia nën moshën 30 vjeç. Në dekadën e fundit si në tërë Kosovën edhe në komunën e Podujevës ndodhen ndryshime të theksuara socio-kulturore. Këto ndryshime ndodhën si pasojë e luftës së fundit dhe shkatërrimeve që ajo solli, në njërin anë, dhe në anën tjetër me hyrjen e shumë organizatave ndërkombëtare të cilat sollën përvoja të reja dhe investime në përmirësimin e infrastrukturës rinore në përgjithësi. Në këtë komunë mund të thuhet se kushtet për zhvillimin e aktiviteteve rinore janë relativisht të mira. Aktivitetet rinore zhvillohen në shtëpinë e kulturës, palestrën sportive, bibliotekën e qytetit, qendrën rinore të qytetit, stadiumin e qytetit, fushat e vogla sportive (të mbuluara), dhe në objekte shkollore etj. Por jo vetëm kaq, të rinjtë Llapjanë merren me

organizimin e kurseve dhe trajnimeve të ndryshme rinore me karakter edukativo arsimor. Një ndihmesë të madhe rinisë Llapjanë ja ofroj edhe shtrirja e internetit kryesisht në zonën urbane, e dal ngadalë është duke u shtrirë edhe në vendbanimet rurale. Mandej, themelimi i shumë organizatave rinore, qëllimi i të cilave është organizimi i aktiviteteve të ndryshme rinore etj. Edhe pse, të arriturat (përmirësimi i kushteve rinore) në dekadën e fundit janë të prekshme si do që të jetë mbetet edhe shumë për tu bërë.

Sporti – është njëri ndër lëmit më të preferuara nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Të rinjtë e komunës së Podujevës aktivitetet e tyre sportive i realizojnë në Palestrën Sportive, Stadiumin e Qytetit dhe në fushat e mbuluara Sportive. Ekzistojnë 9 fusha të vogla sportive (të mbuluara), dhe gjinden në; Lupç të Poshtëm (1), Podujevë (4), Sekiraqë (1), Llapashticë e Epërme (1), Lluzhan (1) dhe Sfeqëll (1). Në këtë komunë ekzistojnë një numër i madh i klubeve sportive si: KF Llapi, KF Besiana, KF Hysi, KF Gocat Llapjane, KF Futsall, KH Llapi, KK Fudoqi, KK Llapi, KK Besa, Ping Pongu Llapi, KA Llapi, KN Orllani, Klubi Kroni Fitnes.

Pjesa dërmuese e këtyre klubeve garojnë në nivele lokale, regjionale dhe nacionale, ku janë shpërblyer me tituj në fund të kampionateve.

1.4.6 Barazia gjinore

Barazi gjinore do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.¹⁰ Barazia gjinore është një ndër aspektet më të rëndësishme të barazisë dhe drejtësisë sociale. Ajo synon rritjen dhe përmirësimin e kushteve për gratë dhe burrat në të gjitha fushat e jetës, realizuar kjo nëpërmjet eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit.

Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik vlerësohet të jetë shumë i rëndësishëm, por vendi vazhdon të ndeshet me pabarazi gjinore. Pozita e pabarabartë ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë për qasje në shërbimet shëndetësore, shkalla e ulët e integritimit në ekonomi, si dhe numri i vogël i grave në poste drejtuese në administratën publike.

Sigurimi i barazisë gjinore nuk duhet të konsiderohet një problem vetëm i grave, por i të gjithë shoqërisë, as vetëm i një organizmi apo institucioni, por i të gjithë strukturave të shtetit, pasi vetëm atëherë dhe në këtë mënyrë do të mund të thyhen barrierat dhe të arrihet në realizimin e një barazie të vërtetë. Pas luftës, në Kosovë institucionet bënë një përparim në drejtim të përfaqësimit gjinorë. Në zgjedhjet e vitin 2004, ishte siguruar kuota prej 30% (me ligj) pjesëmarrje e popullsisë femërore në institucionet qendrore dhe lokale. Mirëpo, mbetet edhe shumë për t'u bërë në këtë drejtim.

Në komunën e Podujevës, përfaqësimi gjinorë është në shkallë jo të kënaqshme të përfaqësimit të femrës në institucionet komunale. Sipas të dhënave që janë marrë nga kuvendi komunal i Podujevës, administrata komunale dhe kuvendi komunal janë të përfaqësuar me 22.4% femra, ku prej tyre në poste udhëheqëse (drejtori) janë vetëm 4 femra, apo 1.5% të të punësuarve.

¹⁰ Ligji për Barazi Gjinore. Nr.2004/2

Situatë dukshëm më e mirë është në arsim, ku femrat janë të përfaqësuara me 45.5% të të punësuarve në arsim, përderisa prej tyre në poste udhëheqëse (drejtor dhe zëvendës drejtor) janë gjithsej 5 femra. Në shëndetësi, ndërkaq, mbi 65% e të punësuarve janë femra. Megjithatë, në poste udhëheqëse janë vetëm 2 femra.

Në Policinë e Kosovës në komunën e Podujevës femra është e përfaqësuar me 13%% police femra kurse në pozita udhëheqëse nuk ka femra.

Komuniteti i biznesit nga gjinia femërore përfaqësohet me afro 11%, derisa në shërbimet tjera (ujësjellës, zjarrfikës, PTK dhe KEK), numri i femrave të punësuar është simbolik.

Të dhënat e lartpërmendura tregojnë për pabarazi në komunën e Podujevës. Ashtu si në Kosovë, edhe në komunën e Podujevës pabarazia gjinore i ka edhe shkaqet e saj. Për më tepër se një shekull Kosova ishte nën okupim, ku mohohet e drejta për tu shkolluar, pastaj dominonin familjet patriarkale, ku të drejtë ekskluzive për tu shkolluar i kishte mashkulli. Mirëpo, në dhjetë vjetët e fundit femra dal ngadalë ka filluar të avancohet në të gjitha institucionet e vendit.

1.5 Vendbanimet

1.5.1 Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë

Tipologjia e vendbanimeve sipas madhësisë është e një rëndësie të veçantë nga se përmes kësaj metodologjie shihen qartë karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyra e organizimit të jetës në vendbanimet e asaj hapësire. Njëherit, vendbanimi më i madh nënkupton organizimin më të lehtë të jetës, nga se investimet në të janë më të arsyeshme dhe rentabile. Kurse vendbanimi më i vogël zakonisht është më vështirë të pajiset me infrastrukturë elementare, që është aq e nevojshme për jetën e banorëve të atij vendbanimi.¹¹

Vendbanimet në komunën e Podujevës kategorizohen në disa grupe të madhësisë:

- a) Vendbanimet e vogla deri 500 banorë.
- b) Vendbanimet e madhësisë së mesme 500 – 1999 banorë
- c) Vendbanimet e mëdha rurale 2.000-4999 banorë.
- d) Vendbanimet e karakterit urban

Bazuar në shënimet e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, vendbanimet e komunës së Podujevës kategorizohen me sa vijon:

¹¹ I.Ramadani (2004) Zhvillimi rural, Dukagjini, Pejë

Tabela 14 Madhësia e Vendbanimeve në Komunën e Podujevës

Madhësia e Vendbanimeve në Komunën e Podujevës (Viti 2011)		
Madhesia e Vendbanimit	Nr. i Venbanimeve	Pjesmarrja (ne %)
Vendbanimet e vogla deri 500 banorë.	36	46.2%
Vendbanimet e madhësisë së mesme 500 – 1999 banorë	30	38.5%
Vendbanimet e mëdha rurale 2.000-4999 banorë.	11	14%
Vendbanimet e karakterit urban	1	1.3%
TOTALI	78	100%

Numri më i madh i vendbanimeve te komunë së Podujevës hyjnë në grupin e vendbanimeve të vogla, deri në 500 banorë (36 vendbanime apo 46% e vendbanimeve të Podujevës).

Tabela 15 Vendbanimet e vogla deri ne 500 banore

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve
1	Muhazob	0
2	Përpellac	0
3	Radujevc	0
4	Reçicë	0
5	Bllatë	9
6	Rakinicë	14
7	Surdull	27
8	Tërnavicë	27
9	Potok	61
10	Sylevicë	63
11	Bërvenik	72
12	Metergoc	79
13	Kalaticë	89
14	Barainë	98
15	Zhiti	98
16	Turuçicë	109
17	Brecë	119
18	Sllatinë	130
19	Miroc	132
20	Murgull	135
21	Dvorishtë	143
22	Popovë	181
23	Merdar	188
24	Kunushec	204
25	Pollatë	239
26	Buricë	246
27	Brainë	268
28	Lupq i Epërm	275
29	Pakashticë e Poshtme	292
30	Livadicë	296
31	Godishnjak	353
32	Zakut	453

33	Siboc i Poshtëm	454
34	Repë	484
35	Kaçybeg	494
36	Dumnice e Epërme	497

Në kategorinë e vendbanimeve të mesme, prej 500 deri në 1999 banorë hyjnë gjithsej 30 vendbanime apo 38% e vendbanimeve të Podujevës.

Tabela 16 Vendbanimet e mesme, 500 - 1999 banore

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve
1	Sallabajë	506
2	Penuhë	539
3	Velikarekë	544
4	Dyz	573
5	Shakovicë	619
6	Halabak	623
7	Pakashticë e Epërme	732
8	Hërticë	741
9	Kërpimëh	755
10	Lluzhan	757
11	Lladoc	821
12	Orllan	844
13	Tërnavë	853
14	Kushevicë	873
15	Revuq	924
16	Siboc i Epërm	961
17	Llaushë	980
18	Surkish	1091
19	Dobërdol	1106
20	Shtedim	1148
21	Dumosh	1207
22	Peran	1241
23	Metehi	1251
24	Gërdoc	1263
25	Llugë	1404
26	Bellopojë	1412
27	Shajkoc	1504
28	Dobratin	1576
29	Majac	1622
30	Sfeçël	1739

Në kategorinë e vendbanimeve të mëdha rurale deri në 4999 banorë hyjnë gjithsej 11 vendbanime apo 14% e vendbanimeve të Podujevës.

Tabela 16 Vendbanimet e medha rurale me mbi 2000 banore

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve
1	Letanc	2080
2	Lupq i Poshtëm	2113
3	Ballofcë	2131
4	Batllavë	2334
5	Bajçinë	2358
6	Llapashticë e Epërme	2363
7	Bradash	2567
8	Llapashticë e Poshtme	2701
9	Dumnicë e Poshtme	2975
10	Obrançë	3092
11	Gllamnik	3794


Në kategorinë e vendbanimit të karakterit urban radhitet vetëm Podujeva, e cila është qendër komunale me 23453 banorë, në të cilën qendër gravitojnë 88499 banorë.

Podujeva si qendër komunale shtrihet në fushëgropën e Llapit duke zënë pozitë periferike ndaj territorit të Kosovës, në distancën prej 30 km nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina.

Podujeva në aspektin hapësinor-morfologjik i takon tipit të grumbulluar të vendbanimeve. Ndërsa në aspektin funksional është qendër e rëndësishme për territorin administrativ prej 628.7 km² dhe gravitimin e popullsisë prej 88499 banorë, të shpërndarë në 78 vendbanime.

Territori administrativ, respektivisht zona kadastrale e Podujevës zë sipërfaqen prej 890 ha, në të cilën jetojnë rreth 23453 banorë. Zona e ndërtuar e saj arrin në 280 ha, ose 31.4% të territorit dhe, dendësia e banimit në 26.3 b/ha. në raport me zonën kadastrale të saj.

Pjesëmarrja e numrit të banorëve të qytetit të Podujevës në raport me numrin e përgjithshëm të komunës ka ndryshuar dukshëm nga viti 1948 e deri sot.



Grafiku 12 Numri i popullsisë në qytetin e Podujevës, 1948-2011

Derisa në vitin 1948 Podujeva si qendër komunale kishte 2435 banorë, ose 5.8% të popullsisë së territorit të njëjtë administrativ, në vitin 2011 numri i popullsisë ishte 23453 banorë, ndërsa pjesëmarrja e numrit të banorëve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë së komunës arrin në 27%. Pra, numri i popullsisë në qytetin e Podujevës ka shënuar rritje prej afro 10 herë nga viti 1948.

1.5.2. Shtrirja territoriale e vendbanimeve sipas madhësisë

Madhësia mesatare e vendbanimeve në komunën e Podujevës është 1134.6 banorë, ndërsa nëse llogarisim vetëm numrin e popullsisë së vendbanimeve rurale, pa qytetin e Podujevës, atëherë madhësia mesatare e vendbanimeve për nga numri i popullsisë është 844.7 banorë. Dallimet në numrin e popullsisë të disa vendbanimeve janë të konsiderueshme, ndërsa nëse bëjmë krahasimet pa vendbanimin e Podujevës atëherë dallimet sillen në mes maksimumit 3794 banorë (Gllamniku) dhe minimumit prej 9 banorë (Bllatë). Këto dallime janë të kushtëzuara nga pozita e vendbanimit dhe gjeomorfologjia e terrenit. Prandaj, është me rëndësi edhe analiza e shtrirjes së këtyre vendbanimeve sipas zonave të lartësisë mbidetare.


Prezenca e disa vendbanimeve të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka rol të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve.¹²

Karakteristikë e rrjetit të vendbanimeve në komunën e Podujevës është numri më i madh i vendbanimeve të vogla (1-499 Banorë), me 36 vendbanime dhe grupit të madhësisë së mesme (500-1999 banorë), me 30 vendbanime. Vendbanimet e vogla shtrihen kryesisht në viset kodrinore-malore (mbi 700 m). Në zonën e ulët nën 700 m ka më së shumti vendbanime të kategorisë 1000-2000 banorë dhe vendbanimet e mëdha (mbi 2000 banorë) që janë 8 vendbanime rurale dhe një qendër urbane.

Tabela 17 . Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë demografike, 1991-2011


Vendbanimet sipas kategorive të madhësisë demografike	Numri i vendbanimeve			
	1991	%	2011	%
0-499	32	41	36	46
500-1999	38	49	30	39
2000-5000	7	9	11	14
Mbi 5000	1	1	1	1
Gjithsej	78	100.0	78	100.0

¹² .I.Ramadani (2004), Zhvillimi rural, Dukagjini, Pejë.




Grafiku 13 . Numri i vendbanimeve sipas madhësisë demografike, 1991-2011

Harta 7. Vendbanimet sipas madhësisë



Harta 8. Rrjeti i vendbanimeve

Tabela dhe grafikoni tregojnë se numri i vendbanimeve të kategorisë së vogël (deri në 500 banorë) dhe të madhe (2000 deri 5000 banorë) kanë shënuar rritje (nga 32 në 36 dhe nga 7 në 11 respektivisht), derisa numri i vendbanimeve të madhësisë së mesme (500 – 1999 banorë) është zvogëluar. Kategoria e vendbanimeve mbi 5000 banorë mbeti e njëjtë në periudhën 1991-2011, me vetëm një vendbanim (Podujeva).



Madhësia e vendbanimeve dhe dendësia e popullsisë në to dallojnë varësisht nga karakteristikat gjeo-morfologjike të terrenit.

Hapësirën e komunës e përbëjnë tri tërësi morfologjike që dallojnë nga njëra-tjera në bazë të karakteristikave gjeografike natyrore:

- zona fushore-bregore nën 700 metra lartësi mbidetare, me sipërfaqe prej 310.27 km² ose 49% të hapësirës së gjithmbarshme të komunës,
- zona kodrinore mlaore mbi 700 metra të lartësisë mbidetare, e cila përfshin sipërfaqen prej 318.43 km² ose 51.0% të komunës

Zona kodrinore-malore zë pozitën periferike të komunës, është kryesisht e pazhvilluar, me karakteristika të stagnimit ose shpopullzimit të popullsisë. Zona e ulët fushore zë pozitë qendrore, dhe karakterizohet me kushte më të volitshme për zhvillim. 13

Tabela 18 . Shrirja e vendbanimeve ne baze te lartesisë mbidetare

Lartësia mbidetare e vendbanimeve në Komunën e Podujevës			
Lartësia Mbidetare	Nr. i Venbanimeve	Pjesmarrja (ne %)	Dendësia
Deri ne 700m	46	59.0%	261
Mbi 700m	32	41.0%	52
TOTALI	78	100%	100%

Numri më i madh i vendbanimeve (46 apo 59% e vendbanimeve) shtrihen ne zonën deri 700 metra të lartësisë mbidetare. Kjo zone paraqet zonën më të populluar të komunës, me 261 banorë per km². 32 vendbanime apo 41% shtrihen në lartësi mbidetare mbi 700m. Dendësia e popullsisë në këtë zonë është 52 banorë për km².

Dendësia mesatare e vendbanimeve në komunë është 12.4 vendbanime në 100 km². Në dendësinë e rrjetit të vendbanimeve janë të dukshme dallimet varësisht nga pozita apo gjeo-morfologjia e terrenit.

Tabela 19. Dendësia dhe distanca mesatare e vendbanimeve

Dendësia e venbanimeve në bazë të lartësisë mbidetare në Komunën e Podujevës			
Lartësia Mbidetare	Nr. i Venbanimeve	Sipërfaqja (km ²)	Dendësia (100km ²)
Deri ne 700m	46	310.27	14.83
Mbi 700m	32	318.43	10.05
TOTALI	78	628.7	12.41

Në zonën deri 700 metra të lartësisë mbidetare, dendësia e vendbanimeve është 14.83 vendbanime në 100 km². Në zonën mbi 700 metra të lartësisë mbidetare dendësia e vendbanimeve arrin në 10 vendbanime në 100 km.

Dendësia e rrjetit të vendbanimeve shprehet edhe përmes largësisë hapësinore të vendbanimeve. Në bazë të kësaj, largësia mesatare ndërmjet vendbanimeve në nivel të komunal është 2.8 km, që është

¹³ . K. Doksiadis, Čovek i grad, Nolit, Bgd, 1982, f. 71.

më e madhe se në Rrafshin e Kosovës. Në viset kodrinore malore largësia është 3,7 km dhe në hapësirën nën 700 metra të lartësisë mbidetare largësia është 1.9 km (në Kosovë 2,76 km).

Vendbanimet të cilat shtrihen në zonën e ulët nën 700 metra të lartësisë mbidetare kanë përjetuar transformim të konsiderueshëm. Vendbanimet kodrinore-malore janë duke stagnuar në të gjitha segmentet. Nga kjo arsye këto vendbanime kanë tendenca të zbrazjes së popullsisë dhe shuarjes graduale.

Tabela 20. Struktura e madhësisë së vendbanimeve sipas zonave, 2011

Struktura e madhësisë së vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare						
Madhesia e Vendbanimit	Deri ne 700m		Mbi 700m		Gjithsej	
	Vendbanime	Banorë	Vendbanime	Banorë	Vendbanime	Banorë
Deri 500 banorë.	15	3642	21	2687	36	6329
500 – 1999 banorë	20	21134	10	9075	30	30209
2000-4999 banorë	10	26377	1	2131	11	28508
Mbi 5000 banorë	1	23453	0	0	1	23453
TOTALI	46	74606	32	13893	78	88499

Zona e ulët karakterizohet me numër të madh të vendbanimeve, popullsisë dhe rrjedhimisht edhe koncentrim më të madh të popullsisë. 59% e vendbanimeve të komunës së Podujevës shtrihen në zonën e ulët, deri në 700m lartësi mbidetare, në të cilat jetojnë mëse 84% e gjithë popullsisë së komunës (74606 banorë). Dendësia e popullsisë në këtë zonë është 261 banore / km². Në këtë zonë gjenden vendbanimet më të mëdha si dhe vet qyteti i Podujevës.

Procesi i shpërnguljes së popullsisë së këtyre vendbanimeve drejt qendrave urbane është në rrjedhat normale, ndërsa rritja popullore e vendbanimeve dhe transformimi fizik i tyre është shumë më i shpejtë në krahasim me vendbanimet kodrinore-malore.


Gjendje krejtësisht e kundërt paraqitet në zonën me mbi 700 metra lartësi mbidetare e cila karakterizohet me numër më të vogël të vendbanimeve dhe popullsisë dhe me koncentrim më të vogël të popullsisë. Në këtë zonë gjenden 41% e vendbanimeve të komunës së Podujevës, në të cilën jetojnë vetëm 16% e popullsisë së komunës (13893 banorë). Dendësia e popullsisë në këtë zonë është 52 banore / km². Në këtë komunë gjenden numri më i madh i vendbanimeve të vogla, deri në 500 banorë.

Faktet flasin se vendbanimet në hapësirat kodrinore-malore janë lënë anash në aspektin e zhvillimit ekonomik, kundrejt vendbanimeve që shtrihen në hapësirën nën 700 metra të lartësisë mbidetare, ku gjendet edhe vet qyteti i Podujevës. Prandaj, shumica e objekteve ekonomike dhe të funksioneve qendrore janë përqendruar në qytet. Qyteti dhe vendbanimet e mëdha tërheqin popullsinë në drejtim të tyre, duke krijuar fushat gravituese funksionale.¹⁴ Raport i tillë i qytetit ndaj hapësirës rrethuese

¹⁴ M. Vresk, Osnove urbane geografije, Zagreb.f. 158.


është i ngjashëm me atë të teorisë së fushave. Kështu p.sh. përreth qendrave të qytetit është një koncentrim më i madh i popullsisë, ndërsa duke shkuar nga periferia koncentrimi i popullsisë gjithnjë e më tepër zvogëlohet. Bërthamat urbane me potencialin e tyre demografik paraqesin "kupa" në "profilin popullativ" të hapësirës.¹⁵ Duke u larguar nga qendra, potenciali popullativ gjithnjë e më tepër arrin vlerat më të ulëta dhe, në këtë mënyrë, përfundon ndikimi i qendrës, ku mund të tërhiqet vija ndarëse e regjionit të qytetit në bazë të parimit të gravitetit popullativ.

Harta 9. Shtrirja e vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare



¹⁵ M. Vresk, Po aty, f. 78

Nëse e vështrojmë koncentrimin e popullsisë në raport me sipërfaqen, atëherë mund të konstatohet se përqendrimi i popullsisë, sidomos në zonën e ulët, ka arritur një shkallë mjaft të lartë. Derisa 28.6% e sipërfaqes së komunës gjendet nën 700 metra të lartësisë mbidetare, në këto hapësira në vitin 2003 jetojnë 101680 banorë ose 84% e popullsisë së komunës, kurse pjesëmarrja e sipërfaqeve mbi 700 metra të lartësisë mbidetare është 70.1%.



Grafiku 28. Pjesëmarrja sipërfaqeve, popullsisë dhe vendbanimeve sipas lartësisë mbidetare, 2003

Mirëpo, në këto sipërfaqe jetojnë vetëm 16.0% e popullsisë së komunës, që është si pasojë e kushteve të ndryshueshme natyrore në mes këtyre dy hapësirave dhe aktivitetit të njeriut, i cili është i lidhur kryesisht për hapësirat më të përshtatshme të komunës ku e ka zhvilluar aktivitetin ekonomik. Kështu, vendbanimet si qendra të aktivitetit të përgjithshëm njerëzor, krahas ndryshimeve shoqëro-ekonomike, në mënyrë të vazhdueshme e ndryshojnë edhe fizionominë e tyre, madhësinë, funksionalitetin dhe ndikimin e tyre në rrethinë e më gjerë.

Vendbanimet kodrinore-malore në përgjithësi kanë karakter agrar. Veprimtaria themelore e tyre është blegtoria dhe pylltaria e më pak lavërtaria. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është emigrimi i konsiderueshëm i popullsisë në drejtim të viseve të ulëta dhe në drejtim të qytetit për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore, mungesës së objekteve të standardit jetësor dhe lidhjes së dobët me qendrat e tyre.

1.5.3. Karakteristikat morfologjike–urbanistike të vendbanimeve

Vendbanimet e komunës së Podujevës janë formuar në mënyrë spontane, pa ndonjë rregull të planifikimit hapësinor apo urban. Madje, edhe pjesa më e madhe e vet qytetit të Podujevës është zhvilluar në mënyrë spontane, ndërsa vetëm një pjesë e qytetit është zhvilluar në bazë të planeve rregullative. Forma e parregullt e vendbanimeve është si pasojë e kushteve natyrore në terren, por edhe faktorëve shoqëror-ekonomik dhe historik.

Podujeva si qendër urbane vetëm me një pjesë të saj të vogël mund të konsiderohet me plan. Nga aspekti morfologjik-urbanistik, në komunën e Podujevës dallohen këta tipa të vendbanimeve:

Vendbanimet e tipit të grumbulluar karakterizohen me koncentrimin e konsiderueshëm të gjitha objekteve të cilat ndodhen afër njëra tjetrës, ndërsa madhësia e parcelave (oborreve- kopshteve) është më e vogël në krahasim me vendbanimet e tipit të shpërndarë. Ky tip i vendbanimeve kryesisht është prezent në zonën e ulët të fushës. Oborret ekonomike janë të madhësive të ndryshme, por zakonisht me sipërfaqe të vogla. Ndërsa ato janë të shfrytëzuara në mënyrë maksimale, qoftë në pjesën e përparme (kah rruga) apo në pjesën e mesme të tyre: Podujevë, Terrnavicë, Kaçibeg, Lladofc, Pakashticë e Poshtme, Peran, Shtedim, Siboc i Poshtëm, Surkish, Gërdoc, etj.

Nga dendësia e madhe dhe vendosja e parregullt e objekteve, në këto vendbanime, shpesh herë paraqiten vështirësi në instalimin e infrastrukturës urbane si dhe në mirëmbajtjen dhe sigurimin e higjienës. Në këto vendbanime është e ndarë zona e banimit nga ajo e punës. Shumica e këtyre vendbanimeve kanë pozitë të përshtatshme në raport me komunat e tyre kadastrale, nga rrugët publike, dhe kjo u mundëson lidhje të mirë mes veti, si dhe me qendrat tjera të rendit më të lartë.

Me rastin e asfaltimit të rrugëve që lidhin fshatrat në sistem, në këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë vijës së asfaltuar të fshatit me karakter rendor të objekteve. Kjo ndodh jo për arsye ekonomike (zgjerim apo avancim i ekonomive bujqësore), por kryesisht për t'u liruar nga dendësia e madhe dhe afrimi në rrugën kryesore. Ky proces njihet si transferimi i fshatit nga tipi grumbullor në tip rendor ose zbritja e fshatit në rrugë¹⁶.

Te këto vendbanime në disa raste vërehet edhe procesi i aglomerimit ose bashkimit të tyre për shkak të zgjerimit dhe afërsisë së tyre, varësisht nga kushtet gjeomorfologjike të terrenit: Podujeva – Letanci-Obrança-Llapashtica e Poshtme, pastaj Bajçina-Dobërdoli.

Disa vendbanime, për shkak të zgjerimit dhe formës aglomerative në të ardhmen mund të shndërrohen në qendra urbane. Tipi i grumbulluar i vendbanimeve është shumë më i përshtatshëm sepse ato paraqesin mundësi për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës me pajisje urbane dhe objekte të standardit shoqëror.¹⁷

Vendbanimet e tipit të shpërndarë janë prezent kryesisht në viset kodrinore-malore. Karakterizohen me ndërtimin e objekteve dhe lagjeve të vogla të shpërndara në tërë territorin kadastral.

Një numër i vogël nga këto vendbanime posedojnë elemente të centralitetit, ndërsa dendësia e popullsisë është e vogël. Vendbanime të këtij tipi janë: Bajçina, Llapashtica e Epërme, Merdari, Obrança, Bllata, Braina, Kushevici, Surdulli, Metergoci, Sylevica, Muhazobi etj.

Të gjitha këto vendbanime janë të organizuara në lagje dhe shtëpi të ndara nga njëra tjetra. Numrin më të madh të këtyre vendbanimeve, sidomos pas luftës, e ka përfshi procesi i shpopullimit. Shumë vendbanime nga to në të ardhmen do të mbeten vetëm si toponime në hartat gjeografike. E vetmja mënyrë për t'i shpëtuar këto vendbanime nga shuarja e plotë do të ishte ndërtimi i rrugëve dhe lidhja e tyre në sistem, formimi i qendrës në ndonjë lagje apo në terren të hapur, e kjo do të ndikonte pozitivisht dhe moralisht tek popullsia e këtyre viseve që të mbeten aty.

Vendbanimet e tipit gjatësor janë vendbanime të dendura me karakter rendor dhe shtrihen kryesisht përgjatë luginave dhe rrugëve nacionale ose lokale. Këto vendbanime shtrihen kryesisht në zonën e

¹⁶ .I. Ramadani (2004) Zhvillimi Rural, Dukagjini, Pejë, f. 235.

¹⁷ .I. Ramadani, po aty, f, f. 243.

ulët: Majac, Potok, Popovë etj. Këto vendbanime karakterizohen me parcela të vogla ndërtimore (oborret), ndërsa anën e tyre të ngushtë, në të shumtën e rasteve, e kanë të orientuar duke ndërtuar objektet buzë rrugës. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është se kanë tendenca të zgjerimit dhe bashkëngjijtes duke krijuar kështu korridore ndërtimore përgjatë rrugës.

Tabela 21. Popullsia dhe dendësia e banimit në zonat e ndërtuara, në ha

Zona	Nr.popull.	Zona e ndërtuar	Dendësia	Nr.lagjeve	Tipi
Zona e ulët 500-700 m	banorë	ha	ban/ha	lagjet	vendbanimi
1. Bajçinë	2358	79.0	29.8	16	shpërndar
2. Barainë	98	4.0	24.5	11	grumbulluar
3. Batllavë	2334	66.4	35.1	13	grumbulluar
4. Bellopojë	1412	42.3	33.3	14	grumbulluar
5. Bradash	2567	71.7	35.8	3	grumbulluar
6. Burincë	246	9.4	26.1	4	grumbulluar
7.Dumnice e Poshtme	2975	109.1	27.2	7	pak i dndur
8. Dumosh	1207	47.8	25.2	-	grubulluar
9.Gërdoc	1263	31.4	40.2	3	zgjatur
10. Gllamnik	3794	99.3	38.2	16	grumbulluar
11. Godishnjak	353	12.5	28.2	7	shpërndarë
12. Halabak	623	22.2	28.0	8	grumbulluar
13. Kaçibeg	494	11.3	43.7	-	grumbulluar
14. Kunushec	204	44.8	4.5	9	pak i dendur
15. Letanc	2080	59.1	35.1	8	grumbulluar
16. Livadhia	296	13.5	21.9	7	pak i dendur
17. Lladofc	821	20.5	40.0	2	grumbulluar
18.Llaspashtica Epërme	2363	89.5	26.4	15	shpërndarë
19.Llaspashtice Poshtme	2701	62.5	43.2	8	pak i dendur
20. Llaushë	980	32.1	30.5	2	shpërndarë
21. Llugë	1404	41.2	34.0	9	pak i dendur
22. Lluzhan	757	36.4	20.8	9	pak i dendur
23. Lupç i Eperm	275	13.1	21.0	8	grumbulluar
24. Lupç i Poshtëm	2701	62.5	43.2	10	grumbulluar
25. Majac	1622	53.0	30.6	12	zgjatur
26.Merdar	188	9.5	19.7	5	shpërndarë
27.Miroc	132	7.1	18.6	8	shpërndarë
28. Obrançë	3092	138.8	22.2	12	shpërndarë
29. Orllan	844	51.8	16.3	10	pak idendur
30.Pakashticë e Poshtme	292	6.2	47.1	2	grumbulluar
31.Penuhë	539	21.5	25.0	3	pak i dendur
32.Peran	1241	29.1	42.6	8	grumbulluar
33.Podujevë	23453	279.1	84.0	-	grumbulluar
34.Radujevc	0	6.2	0.0	-	-

35.Sallabajë	506	20.5	24.6	4	grumbulluar
36.Sfeçël	1739	55.1	31.5	7	grumbulluar
37.Shajkoc	1504	64.4	23.3	2	grumbulluar
38.Shakovicë	619	16.9	36.6	3	grumbulluar
39.Shtedim	1148	18.1	63.4	10	grumbulluar
40.Siboc i Epërm	961	45.9	20.9	10	grumbulluar
41.Siboc i Poshtëm	454	7.5	60.5	2	grumbulluar
42.Sllatinë	130	9.1	14.2	3	grumbulluar
43.Surkish	1091	19.6	55.6	2	grumbulluar
44.Ternavë	853	38.8	21.9	8	grumbulluar
45.Ternavicë	27	4.9	5.5	2	grumbulluar
46.Zakut	453	19.8	22.8	2	grumbulluar
Zona kodri.-malore mbi 700 m					
47. Balloc	2131	46.4	45.9	7	Shpërndarë
48. Bllatë	9	2.6	3.4	5	Pak i dendur
49. Brainë	268	30.7	8.7	4	shpërndarë
50. Brecë	119	6.9	17.2	4	grumbulluar
51. Bërvenik	72	13.2	5.4	7	shpërndarë
52.Dobërdol	1106	46.5	23.7	8	grumbulluar
53.Dobratin	1576	55.4	28.4	9	shpërndarë
54.Dyz	573	24.9	23.0	9	pak i dendur
55.Dvorishtë	143	8.2	17.4	8	shpërndarë
56.Dumnica Epërme	497	23.1	21.1	9	grumbulluar
57.Pakashtica Epërme	732	30.0	24.4	5	grumbulluar
58.Herticë	741	23.9	31.0	9	shpërndarë
59.Kalaticë	89	8.6	10.3	5	grumbulluar
60.Kërpimeh	755	22.2	34.0	4	grumbulluar
61.Kushevicë	873	16.0	54.5	7	shpërndarë
62.Muhazob	0	2.5	0.0	-	-
63.Metergoc	79	13.5	5.8	3	shpërndarë
64.Metehi	1251	39.7	31.5	3	grumbulluar
65.Murgull	135	9.3	14.5	2	grumbulluar
66.Pollatë	239	12.2	19.6	6	grumbulluar
67.Popovë	181	14.0	12.9	12	zgjatur
68.Potok	61	14.0	4.3	4	zgjatur
69.Perpellac	0	2.4	-	-	-
70.Rakinicë	14	0.3	46.6	7	grumbulluar
71.Reçicë	0	3.2	-	-	-
72.Repë	484	16.5	29.3	2	grumbulluar
73.Revuç	924	34.0	27.1	5	shpërndarë
74.Sylevicë	63	7.2	8.7	5	shpërndarë
75.Surdull	27	18.0	1.5	4	shpërndarë
76.Turuçicë	109	10.8	10.0	2	shpërndarë
77.Velikarekë	544	20.9	26.0	-	grumbulluar

78.Zhiti	98	5.7	17.1	2	grumbulluar
----------	----	-----	------	---	-------------

Një proces i tillë ka marrë hov sidomos kohëve të fundit, përkundër faktit se një trend i tillë në aspektin urbanistik dhe hapësinor është i pavolitshëm, ngase ato i përcjellin një mori problemesh e konfliktesh si dhe paraqesin pengesë në zhvillimin normal të komunikacionit ndërurban.¹⁸

Nga tabela shihet se vendbanimet kanë dendësi mjaft të lartë, ndërsa Podujeva si qendër urbane dallohet për nga dendësia e banimit nga vendbanimet tjera, me dendësinë e cila është në harmoni me karakterin e zhvillimit urban. Mesatarja e dendësisë së banimit është 26.6 b/ha ndërsa 34 vendbanime kanë dendësinë mbi mesataren, ose 51.4% e tyre. Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, vetëm 2557.8 ha, ose 4.1 % e territorit është zonë e mbuluar nga vendbanimet.

1.5.4. Karakteristikat funksionale të vendbanimeve

Sistemin e vendbanimeve në komunën e Podujevë e përbëjnë 77 vendbanime rurale dhe 1 qendër urbane, ndërsa funksionaliteti i këtij sistemi mbështet në aktivitetin ekonomik dhe koncentrimin e popullsisë. etj.


Vendbanimet e komunës së Podujevës mund t'i klasifikojmë sipas funksioneve themelore në këto tipe:

- vendbanimet rurale primare,
- vendbanimet me qendrën rurale,
- qendra komunale.

Në grupin e vendbanimeve primare të regjionit hyjnë ato vendbanime në të cilat jetojnë prodhuesit bujqësorë, ndërsa mungojnë funksionet eksterne ndaj vendbanimeve përreth. Në këto vendbanime zhvillohen vetëm ato funksione interne të cilat shërbejnë për përmbushjen e nevojave të përditshme të popullsisë së atij vendbanimi. Këto vendbanime paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë dhe njëkohësisht i takojnë kategorive më të vogla të fshatrave. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrës dhe në viset kodrinore-malore, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë, transformimi i vogël, lidhje e dobët me qendrën dhe zbrazja e tyre graduale. Këto vendbanime në të ardhmen do t'i përcjellin ndryshimet të konsiderueshme, kuptohet në aspektin negativ, veçanërisht ato vendbanime të cilat kanë më pak se 500 banorë, sepse shumica prej tyre ka pasur zvogëlim të numrit të popullsisë.

¹⁸ I. Ramadani , po aty, f. 247

Harta 10 . Organizimi funksional i vendbanimeve



Procesi i zbrzjes së territoreve kodrinore-malore në mënyrë spontane, sidomos në periudhën e pasluftës dhe zgjerimi i vendbanimeve dhe koncentrimi i popullsisë në zonat e rrafshëta, të cilat edhe ashtu kanë dendësi të madhe të popullsisë, mund të ketë pasoja negative në aspektin strategjik dhe konvencional për të ardhmen e komunës dhe Kosovës në tërësi. Nga kjo arsye konsiderojmë se duhet gjetur forma dhe mënyra për të ndaluar këtë proces negativ. Kjo mund të realizohet përmes:

- zhvillimit të turizmit rural,
- stimulimin e prodhimit të bujqësore, (blegtorinë) me organizim dhe teknologji bashkëkohore.
- lidhjen e vendbanimeve me ndërtimin e rrugëve,
- Ndryshimin e skemës së organizimit funksional përmes organizimit dhe zhvillimit të qendrave dhe bashkësive rurale,
- pajisjen e këtyre vendbanimeve me funksione të domosdoshme me të cilat do të përmbushin nevojat e përditshme të popullsisë.

Si vendbanime primare janë edhe një numër i fshatrave pranë qytetëve (Surkish, Shtedim, Livadhi, Letanc, Obrancë, Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme,) me numër të konsiderueshëm të popullsisë jobujqësore që punojnë në qytet dhe funksionojnë të lidhura me qytetin.

Vendbanimet me qendrën rurale- Janë ato vendbanime të cilat i bashkojnë dy e më tepër fshatra primare në një tërësi shoqërore-ekonomike dhe hapësimore. Në këto vendbanime, përveç funksioneve interne, janë të zhvilluara edhe funksionet eksterne të cilat u shërbejnë edhe popullsisë së vendbanimeve përreth. Këto vendbanime njëherit paraqesin njësitë polarizuese të zonës në hapësirë.

Nga funksionet shoqërore, në këto vendbanime ndodhet bashkësia lokale dhe zyra e vendit, shkolla fillore, ambulanca, shitoret me shumicë e pakicë për furnizimin e popullsisë, ndonjë veprimtari zejtare, etj. Këto vendbanime paraqesin tip kalimtar nga ato tradicionale-bujqësore, në të përziera, sepse në to jeton një numër i konsiderueshëm i popullsisë jobujqësore. Një numër i konsiderueshëm i këtyre vendbanimeve ndodhet jo larg qyteteve. Ato i karakterizon një shkallë mjaft e lartë e transformimit fizik, ekonomik e social. Numri i këtyre vendbanimeve në komunë arrin në 16, ose 20.5% nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve.

Vendbanimet, si qendra lokale, vazhdimisht përjetojnë transformim ngase tani në to vetëm se janë paraqitur shenjat e semi-urbanizimit si pasojë e veprimit të faktorëve urban, në një anë dhe prodhimit të modernizuar të bujqësisë në anën tjetër. Shumica e vendbanimeve (53 ose 68% e vendbanimeve) i takojnë kategorisë së madhësisë së vogël (deri në 1000 banorë). 13 vendbanime, apo 17% e vendbanimeve i takojnë kategorisë së mesme (1000-2000 banorë), kurse 12 vendbanime (ose 15%) konsiderohen si qendra lokale me mbi 2000 banorë.

Sa i përket vendbanimeve pranë-qytetëve ato paraqesin zona sub-urbane me karakteristika të veçanta:

- Karakterizohen me shkallë të lartë të transformimit.
- Kanë shkallë të ulët të autonomisë për shkak të varësisë nga qendra urbane,
- shkalla e deagrarizimit është mjaft e shprehur.

Këtij grupi i takojnë vendbanimet të cilat nuk kanë funksione qendrore. Këto vendbanime duhet të përfshihen në procesin e planifikimit, me qëllim që ato të mos shndërrohen në barriera të zhvillimit të përgjithshëm.

Në grupin e vendbanimeve urbane bën pjesë vetëm Podujeva si qendër komunale, me 23453 banorë, në të cilën janë të vendosura funksionet shoqërore-ekonomike që shërbejnë për tërë territorin.

1.5.5. Banimi

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 në komunën e Podujevës jetojnë 88499 banorë, në territorin prej 628.7 km².

Pjesa dërmuese e popullsisë në komunën e Podujevës (73.5 % e popullsisë) jeton në fshat.

Pjesa më e madhe e objekteve të banimit i takon karakterit individual, ndërsa në qendrën urbane janë një numër i vogël i objekteve banesore që i takon karakterit kolektiv. Numri i përgjithshëm i objekteve të banimit në kuadër të komunës së Podujevës është 12315, nga e cila shumë, 7891 objekte ose 64.1 % janë të ndërtuara në zonat rurale, ndërsa 4424 objekte të banimit, ose 35.9 % e tyre janë të ndërtuara në zonën urbane.

Në zonën e ulët të fushës vendbanimet zakonisht janë të tipit të grumbulluar, prandaj edhe dendësia e banimit është më e madhe. Në viset kodrinore-malore shumica e tyre janë të tipit gjysmë të dendur, të organizuara në lagje dhe të tipit të shpërndarë. Dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar në këto vendbanime është më e vogël. Pra, faktorët natyror (relievi) kanë ndikuar dukshëm në formën dhe dendësinë e vendbanimeve. Te vendbanimet që ndodhen afër qendrës urbane dhe atyre afër rrugëve, vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative. Për këtë arsye objektet e banimit dhe ato të bizneseve shtrihen në formë vargore. Kjo arsyetohet edhe me faktin se popullsia vazhdimisht po heq dorë nga bujqësia. Kjo dukuri njihet si eksod agrar.¹⁹

Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në zonën e ulët të fushës, ku shtrihet edhe numri më i madh i vendbanimeve të komunës, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjes së hapësirës banuese, kjo hapësirë gjithashtu disponon me një fond më cilësor banesor.

Dendësia mesatare e banimit në nivel të komunës arrin në 141 banorë në një km², në territorin e komunës kadastrale të qytetit arrin në rreth 2635 banorë në km², kurse në vendbanimet rurale është 105 banorë në km². Hapësirat me dendësi më të madhe janë rreth qendrës komunale dhe në zonën e rrafshët, ku dendësia e banimit arrin mbi 500 banorë në km² dhe kështu tejkalon mesataren e dendësisë së hapësirës së komunës.

Objektet e vjetra të banimi janë të pakta sepse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur t'i rezistoi kohës. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime, varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit, vendbanimet kodrinore-malore. Shumica e objekteve të banimit janë të rrethuara me mure, ndërsa në oborre dallohen edhe objektet tjera ekonomike bujqësore; shtalla për ruajtjen e bagëtisë, objektet për sigurimin e ushqimit të bagëtisë gjatë dimrit, hambarët, garazhet për automjete dhe teknikën bujqësore etj.

Deri para tri dekadash objektet e banimit ndërtoheshin me material të dobët; qerpiçi dhe druri, që zakonisht forma e objekteve i ngjante shkronjës L dhe T. Kohëve të fundit objektet e banimit ndryshuan tërësisht si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më

¹⁹ .I. Ramadani (2004) Zhvillimi Rural, Pejë.

shumë kate, kulmet me dy ujëra, ndërsa material ndërtimor janë; tullat, blloku i pjekur, betoni e hekuri. Tani objektet e banimit në fshat, fare pak dallojnë me ato në qytet. Nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit, si pasojë e mungesës së planeve dhe planifikimit.

Në vendbanimet rurale dendësia e banimit (në zonën e ndërtuar) është dukshëm më e ulët në raport me qytetin dhe këto vlera sillen rreth 26.6 banorë në ha. Ndërsa, në qytetin e Podujevës, dendësia e banimit arrin në 84 banorë në ha, që është dendësi normale për vendbanimet urbane. Gjendja e banimit në vendbanimet e komunës së Podujevës u dëmtua në masë të konsiderueshme në luftën e fundit, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i konsiderueshëm i objekteve të banimit dhe ekonomike, ndërsa pasojat po evitohen ngadalë.


Hapësira e banimit në raport me sipërfaqet e ndërtuara është dominante, me rreth 50% në raport me zonën e ndërtuar në vendbanimet rurale, kurse në vet qytetin hapësira e banimit dominon me rreth 80%. Kjo tregon se aktivitetet tjera janë në nivel shumë të ulët të zhvillimit të tyre.

Numri i anëtarëve për ekonomi familjare varion nga 6.7 anëtarë në vendbanimet rurale, në 6.2 anëtar në qendrën urbane, kurse mesatarja e numrit të anëtarëve për ekonomi familjare në nivelin komunal sillet në 6.6 anëtarë. Kjo gjendje është karakteristike për vendet e pazhvilluara ekonomikisht, ndërsa në këtë rast kjo është si pasojë e jetës së përbashkët (tradicionale) të dy e më shumë gjeneratave në një ekonomi familjare.

1.5.6. Vendbanimet joformale

Institucionet komunale, në bashkëpunim me ekipin për hartimin e planit zhvillimor komunal kanë identifikuar vendbanime joformale që duhet trajtuar urgjent. Gjatë analizës së vendbanimeve jo formale është identifikuar vetëm një vendbanim në tërë territorin e komunës së Podujevës. Lokacioni i këtij vendbanimi joformal gjendet në periferi të qytetit të Podujevës, (2.18 ha), e cila karakterizohet me objekte jo adekuate për banim, ku popullata jeton në objekte kontejner, me material të llamarinës, hekurit dhe letrës. Materiali ndërtimor i këtyre objekteve është shumë i dobët dhe i pa përshtatshëm për banim ngase gjatë dimrit kërkohet energji e madhe për ngrohje, ndërsa gjatë verës krijohen kushte të pa volitshme nga temperaturat e larta.

Harta 11. Vendbanimeve jo formale



Lokacioni i vendbanimit joformal gjendet në zonën kadastrale të qytetit të Podujevës, respektivisht në juglindje të kësaj zone. Ky vendbanim joformal karakterizohet me objekte jo adekuate për banim, ku popullata jeton në objekte kontejner. Sipërfaqja e përgjithshme e vendbanimit joformal është 2.18 ha. Në këtë lokacion janë të ndërtuara 18 objekte 2 katëshe me formë të banimit kolektiv, me 132 familje me rreth 858 banorë.

1.5.7. Shfrytëzimi i tokës

Në bazë të dhënave nga shërbimet komunale, digjitalizimit të imazheve satelitore, si dhe llogaritjeve tona, gjithnjë në kontekstin e shfrytëzimit dhe destinimit të sipërfaqeve në nivelin komunal, konstatohet se territori i komunës së Podujevës zë sipërfaqen prej 62870 hektar (628.7 km²), ose 5.7% të sipërfaqes së Kosovës. Në këtë territor tani jetojnë rreth 121 000 banorë të shpërndarë në 78

vendbanime, nga të cilat vetëm Podujeva është qendër e karakterit urban. Shumica e vendbanimeve shtrihen në viset e rrafshëta (500-700 metra të lartësisë mbidetare), duke zënë sipërfaqe të rëndësishme të tokës produktive, ndërsa shumë nga ato zgjerohen në mënyrë të pakontrolluar duke mbuluar kështu sipërfaqet më produktive bujqësore. Hapësirat kodrinore-malore kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në territorin e komunës por fatkeqësisht pak po shfrytëzohen dhe kohët e fundit gjithnjë e më tepër po braktisen. Kjo tregon për një shfrytëzim joracional të hapësirës në territorin e komunës së Podujevës. Zvogëlimi dhe degradimi i sipërfaqeve bujqësore nga ndërtimet dhe zgjerimi i pakontrolluar i vendbanimeve është brengë e cila kërkon menaxhim dhe zhvillim të qëndrueshëm. Mënyra e shfrytëzimit të tokës dhe destinimi i sipërfaqeve më së miri shihet dhe llogaritet përmes tabelës dhe hartës në vijim.

Harta 12 . Shfrytëzimi i tokës





Tabela 22 . Shfrytëzimi i tokës në ha

Hapësirat	ha	%
Pyje	29680.8	47.21
Bujqësia	18764.8	29.85
Vendbanimet	2589	4.12
Varrezat	77.33	0.12
Livadhe	3526	5.61
Kullosa	7293.8	11.60
Deponi për Mbeturina	61.6	0.10
Hapësira të lira	80.06	0.13
Degradim	47.05	0.07
Liqe	257.50	0.41
Lumej	77	0.12
Rrugë	415.86	0.66
Gjithsej	62870.8	100.00



Grafiku 14. Shfrytëzimi i tokës në %

Nëse llogarisim sipërfaqet bujqësore të kategorisë I-IV në raport me numrin banorëve, del se për një banor në komunën e Podujevës i takojnë vetëm 0.15 hektar, që është diçka mbi mesataren e Kosovës.

Varrezat- Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Podujevës, është miratuar edhe rregullorja për menaxhimin e varrezave:

Rregullorja komunale për menaxhimin e varrezave përmban:

Me këtë rregullore parashihen kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të varrimit si dhe rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e komunës.

Çdo vendbanim i banuar mund të ketë varreza,

Dy ose ma shumë vendbanime mund të kenë varreza të përbashkëta.


Stafi profesional për hartimin e planit të komunës së Podujevës ka identifikuar lokacionet e varrezave në tërë territorin e Komunës së Podujevës, ndërsa gjendja paraqitet në vijuese

1.6 Karakteristikat Fiziko – Gjeografike dhe Mjedisi

1.6.1 Ndërtimi gjeologjik dhe mbërthimi tektonik

Komuna e Podujevës nga aspekti gjeologjik është e ndërtuar prej formacioneve të ndryshme. Marrin pjesë formacione të Paleozoikut, Triasiku, Jurasiku, Kretaku i Sipërm, Neogjenit, Pliocenit dhe sedimentet e Kuaternarit

Harta 13. Harta gjeologjike



1.6.2. Karakteristikat litostratigrafike

Paleozoiku - Formacionet me të vjetra janë ato të rresheve sericite dhe filite të cilat ndërtojnë një brez në luginën e lumit Kaqanodoll, përkatësisht shtrihen në komunat e kadastrave Lupç i Poshtëm, pjesën perëndimore të Majacit, Lupç i Epërm dhe pjesën perëndimore të Popovës. Në pjesën lindore paraqiten shkëmbinj të acid dhe të ndërmjetëm si janë: granitet, dacitet, riolitet etj. Këto formacione shtrihen kryesisht në vendbanimet Orllan Turuqicë, Muhazob etj.

Jurasiku - formacionet e Jurasikut shtrihen pothuajse paralel me ato të paleozoikut. Përbëhen nga formacioni diabaz stallor dhe nuk ka shtrije aq të madhe në këtë komunë. Kanë shtrirje gjatësore prej Bellopoje në jug deri në Tërnavicë në veri. Në disa vende janë të ndërprera me formacione tjera. Përgjatë prishjeve të reja tektonike në kontak me formacionet e jurasikut paraqiten serpentinitet që nuk kanë shtrirje të madhe. Hasen në lokalitetet: Dobratin, Katunisht, Sallabajë, Zhiti etj.

Kretasiku - Në territorin e Podujevës janë mjaftë të përhapura formacionet e kretasikut të cilat përfaqësohen me disa njësi. Kretaku i poshtëm shtrihet si në pjesën veriore, verilindore dhe vazhdon kah jugu me një brez i cili tutje kah jugu zgjerohet dhe arrin deri te fshatrat Dyz dhe Brainë. Përfaqësohet prej formacioneve alevrolite, mergelet, gëlqerorët konglomeratik. Kretaku i sipërm senonian shtrihet në pjesën jugperëndimore të komunës. Përfaqësohet nga konglomeratet, mergelet, argjilitet, gëlqerorët ranor etj.

Plioceni – shtrihet në pjesën e ulët të komunës, përkatësisht në fushëgropën e Llapit. Shtrihet në të dy anët e Lumit Llap. Është i përfaqësuar me zhavorre, rëra, argjila, mergele, etj. Kompaktësinë e këtij formacioni e prishë lumi Llap, Dumnica, Batllava ku janë shtresuar formacione tjera.

Kuaternari - Sedimentet aluviale, në formë të tarracës lumore, janë të përfaqësuara përgjatë të dy anëve të rrjedhave ujore dhe përbëhen nga zhavorret, rëra, dhe suargjillat. Zhavorri përbëhet nga zajet (guralecët) e kuarcit dhe shkëmbinjte metamorfik. Sedimentet deluviale janë konstatuar në pjesën veriore të komunës, përkatësisht në rrëzë të shpateve malore (Metehi, Godishnjak, Penuhë). Sedimentet aluviale janë prezentë përgjatë të dy anëve të rrjedhave lumore dhe degëve të tyre, që përfaqësohen nga depozitimet zhavorreve dhe rërës. Shtrirja e këtyre sedimenteve si për kah trashësia ashtu edhe gjerësia është e ndryshme.

1.6.3. Tektonika

Në aspektin tektonik territori i komunës së Podujevës shtrihet në zonën tektonike të Vardarit. Kjo zonë është e ndarë në tri njësi tektonike. Kjo komunë shtrihet në zonën Qendrore të Vardarit e cila ka shtrirje VVP-JJL. Një pjesë e vogël e territorit që përfshinë ekstremin lindorë shtrihet në Zonën e Brendshme të Vardarit. Njësia Qendrore e Vardarit mund të ndahet në dy pjesë (verior dhe jugor), kufiri i të cilave kalon në lindje të Prishtinës që njihet si dislokacioni i Grashticës. Lëvizjet tektonike më të shprehura në këtë hapësirë kanë ndodhë gjatë mezozoikut që e dëshmojnë edhe formacionet e kësaj periudhe. Në këtë zonë kanë ndodhur edhe procese intrudive dhe efuzive vullkanike përgjatë plasave dislokative në triasik. Pas një qetësimi tektonik në mbarim të kretakut dhe fillim të paleogjenit territori i Kosovës me këtë edhe zona e Vardarit marrin veçori kontinentale.

Nga lëvizjet radiale të miocenit dhe pliocenit janë përfshirë edhe malet e ulëta në lindje të territorit të komunës. Lëvizjet tektonike radiale janë aktivizua përgjatë plasave të vjetra edhe pas fazës liqenore. Kjo është manifestua me shkarjen e sedimenteve liqenore që mbulojnë fundin e basenit, maskojnë relievin tektonik dhe vijat dislokative të bazës që ndodhet nën to.

Në miocen, me lëvizje radiale tektonike, krijohen basenet si forma negative që ndodhen në mes të maleve. Në pliocen këto lëvizje bëjnë thellimin dhe zgjerimin e baseneve dhe përfundon krijimi i relievit tektonik. Këto zhytje ose lëshime përgjatë dislokacioneve në hapësirën e Podujevës kanë qenë më të dobëta. Me përfundimin e krijimit të këtyre baseneve fillon faza liqenore e tyre.

Në këtë hapësirë format elementare te relievit tektonik janë malet dhe basenet neogjen si forma negative.

1.6.4 Seizmika



Territori i Kosovës karakterizohet me lekundje të forta nga tërmetet, vatrat e të cilëve kanë qenë jashtë territorit të Kosovës, Maqedonisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Sërbisë.

Lëkundjet lokale autoktone dhe seizmicitetit që janë aktive në shtetet fqinje dëshmojnë për renditjen e Kosovës në radhën e territoreve me aktevitet të lartë sizmik. Ky aktivitet dikton ndërmarrjen e studimeve të duhura të gjithanëshme, në mënyrë që, në bazë të analizës dhe sintezës së të dhënave komplekse të fituara, të jepet një pasqyrë e plotë, reale dhe e besueshme për vlerësimin e rrezikut sizmik në Kosovë.

Podujeva si tërësi shtrihet në mes zonave aktive sizmike të Kopaonikut dhe asaj të Prishtinës me 8 shkallë. Si regjion ka VII shkallë.

Në qoftë se e shqyrtojmë hartën e epiqendrave shihet qartë se me ekzistencën e hipoqendrave autoktone të tërmeteve karakterizohen rajonet e gjëra të terreneve si vijon: Ferizaj-Gjiilan-Viti-Kaçanik, Prishtinë, Skënderaj, Gjakovë-Rahovec-Prizren-Dragash dhe Pejë

Tabela 23. Harta e inteziteteve sizmike maksimale, 1900-2002, MEM-Instituti Sizmologjik


Zona e epiqendrava	Ferizaji, Gjiilani, Viti, Kaçaniku	Prishtina	Skënderaji	Peja	Gjakova, Rahoveci, Prizreni, Dragashi
Thellësia e hipoqendrës km.	15	5-10	10	10	20

Thellësia e hipoqendrave të këtyre tërmeteve është e ndryshme, por nuk i kalon 25 km. Kështu pra, bëhet fjalë për tërmete të cekta, që dëshmon qart se edhe tërmetet me shkallë të ulët të intensitetit, për shkak të thellësisë së vogël, në sipërfaqe mund të manifestohen me shkallë të lartë të intensitetit. Në bazë të të dhënave ekzistuese, thellësia mesatare e hipoqendrave për tërmetet në territorin e Podujevës lëvizë në kufinj të 10-15km.

Në bazë të dhënave nga Enti Sizmologjik i ish-Jugosllavisë të vitit 1987 për periudhë 1000 vjeçare komuna e Podujevës shtrihet në shakllën e IX shkall të Merkalit.

1.6.5. Relievi

Harta 14. Hipsometria e terrenit



Relievi është një faktorë i rëndësishëm fiziko-geografik për çdo hapësirë, andaj në planet zhvillimore komunale trajtohet nga aspekti i përshtatshmërisë së tij për zhvillim. Çka ofrojnë ato forma relievore, si shfrytëzohet hapësira që pa tjetër e ka bazën në ndonjë formë relievore.

Në territorin e kësaj komune hasen forma të ndryshme relievore që janë krijuar nga agjens të ndryshëm. Mund të dallohen tri tërësi kryesore relievore, në përfundim malet e Kopaonikut, majet e të cilave arrijnë deri 1770 metra. Në pjesën lindore ndodhen malet e ulëta, majet e të cilave nuk kalojnë 1100 metra, nga të cilat më të rëndësishme janë: Prugovci, Braina, malet e Turuqicës, Herticës etj. Në mes këtyre dy tërësive malore ndodhet fushëgropa e Llapit e shtrirë në drejtimin V-J, me gjatësi rreth 31 km. Gjatë fazës liqenore ka komunikua me basenin e Kosovës. Njëkohësisht në këtë fushëgropë është i koncentruar aktiviteti ekonomik, vendbanimet, popullsia, tokat e bukës etj. Në pjesët malore vendbanimet janë më të rralla por ndodhen pyjet dhe kulllosa. Pjesa përfundimtare ka rrëpira më të ashpra dhe më rrallë e

populluar. Pjesa lindore është më e ulët dhe lëshohet në fushëgropë me rrëpira më të buta prandaj është më e përshtatshme, për këto arsye është më e banuar.

Si rezultat i formave relievore rrjedh ekspozicioni i terrenit që në këtë komunë është i përshtatshëm ngase ka pakë sipërfaqe që është i ekspozuar kah veriu, verilindja dhe veriperëndimi. Pjesa jugore e komunës ka ekspozicion verior dhe në luginat lumore që janë prerë në male. Prej formave tjera relievore dallohen luginat lumore që fillojnë në male. Rëndësia e tyre është ngase ofrojnë kushte për shtrirjen e rrjetit rrugorë, por përgjatë tyre shtrihen edhe vendbanime. Më të rëndësishmet janë luginat e lumit Llap, lumit të Kaqandollit, lumit Batllava. Lumi Dumnica nuk ka luginë të shprehur lumore, ngase rrjedhja e tij kryesisht është nëpër fushëgropën e Llapit. Luginat relativisht të ngushta kanë rëndësi për akumulacione të ujit si është ajo e Llapit dhe Kaqandollit. Ekzistojnë luginat tjera por me dimensione mjaft të vogla si ajo e lumit të Tërnavës, lumit të Turuqicës, Brainës etj.

Nga analiza e formave relievore mund të dallohen katë hipsometrike. Ndarja në këto kate është e ndryshme varësisht prej problemeve që duhet të analizohen. Nga kjo strukturë e relievit mund të ndahen këto kate: në relievin fushorë-bregor deri në 700 m, 700-900m kodrinor, 900-1200 relativisht malore dhe mbi 1200 m malore. Deri në 700 m shtrihen 179.1 km², nga 700-900 metra lartësi

mbidetare shtrihen 195.1 km² , 900-1200 shtrihen 185.5 km² dhe mbi 1200m janë 69.0 km² sipërfaqe.

Tabela 24. Pjesëmarrja e sipërfaqeve sipas kateve hipsometrike

Katet hipsometrike	Sipërfaqja (km ²)	%
500-700m	179.1	28.5
700-900m	195.1	31.0
900- 1200m	185.5	29.5
Mbi 1200m	69	11.0
Gjithsej	628.7	100

1.6.6. Tokat


Komuna Podujevës përfaqësohet me tipa të llojlojshme të tokave: toka aluviale, deluviale, rendzinë, ranker, murme argjilore liqenore, e mesme e kuqërremtë, pseudogleje etj.

Tokat aluviale si toka hidromorfike të cilësisë së lartë shtrihen përgjatë lumit Llap, si dhe tokat tjera që kanë cilësi të mira kultivimi siç janë: deluviale, e mesme e kuqërremtë, rendzinat shtrihen po ashtu në fushëgropën e Llapit me trashësi mbi 25cm - b80> cm.

Tipi i llojeve tjera të tokës kanë përhapje në tërë territorin e komunës si: rankere, psudoglej, murrme argjilore etj.

Tabela 25. Lloji i tokave dhe sipërfaqet

Lloji i tokës	Sipërfaqja/ha
Toka aluviale	5842 ha
Toka deluviale	2918 ha
Toka rendzinë	4804 ha
Toka ranker	5025 ha
Murrme argjilore e liqenore	23 ha
E mesme e kuqërremtë	4228 ha
Toka psudogleje	4030 ha



Grafiku 15. Llojet e tokave

Harta 15. Përbërja Pedologjike




Tabela 26. Sipërfaqet e tokave bujqësore sipas klasave të bonitetit



Klasa	Sipërfaqe /ha	%
Klasa I	1683	3
Klasa II	5613	9
Klasa III	3232	5
Klasa IV	4794	8
Klasa V	6522	10
Klasa VI	38090	60
Klasa VII	2936	5
Gjithsej	62870	100

Burimi :ne bazë të hartës së hidroekonomisë së Kosovës

Në bazë të dhënave 15322ha ose 25% janë nën mbrojtje në bazë të ligjit të bujqësisë, ku kategoritë I-IV janë nën mbrojtje për përdorim për kultivim të kulturave të ndryshme bujqësore. Rreth ¼ e sipërfaqes së përgjithshme të komunës ka vlera të larta të bonitetit, ato shtrihen kryesisht përgjatë fushëgropës së lumit Llap.

Boniteti i klasës V-VI-VII shtrihen në rreth 75% të sipërfaqes së përgjithshme. Janë më pak kualitative për kultura bujqësore e sidomos ato të klasës VII.

Harta 16. Boniteti i tokës



Grafiku 16. Klasa e bonitetit në përqindje

1.6.7 Bota bimore, llojet dhe përhapja

Kushtet pedologjike, klimatike, lartësia e shprehur mbidetare kanë ndikua që të ketë lloje të ndryshme bimore dhe shtazore. Ky biodiversitet më karakteristik është për pjesën e maleve të Kopaunikut. Në zonat malore dhe kodrinore malore dominojnë pyjet, ka edhe sipërfaqe të zhveshura e barishta. Prej drunjëve dallohen pyjet gjethrënës si: ahu (*fagus sylvatica*), qarri (*quercus cerris*), bungu, shkoza

(*carpinus orientalis*). Disa trungje sipas Institutit për Mbrojtjen e Natyrës janë shpallur si monumente natyrore si plepit në Bajqinë dhe Orllan, trugu i qarrit në Pollatë, Dumnicë dhe Dobratin. Trungjet e ahut janë me dimensione mjaft të mëdha (gjatësia dhe trashësia e drurit). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (tilia kordata), frashri etj. Përhapje kanë edhe tipet tjera që janë të ulëta, sikurse lloji i shkurreve: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj.

Nga bimët barishtore dallohen lloje të ndryshme, si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjtëve, si edhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bimë që përdoren në mjekësinë popullore, që përdoren si çaj: çaji i malit (*origanum vulgare*), kantarioni (*hypericum perforatum*), kamomili (*matricaria chamomila*), dredhëza (*fragaria vesca*) etj. Prej drunjëve gjetembajtëse janë mbjellur disa hapësira pranë liqenit të Batllavës, mandej afër fshatit Dobërdol.

Në hapësirat e rrafshëta të komunës, fushëgropën e Llapit zakonisht rritet shëlgju (*salix alba*) në brigje të lumenjve, si dhe plepi që u përmend më lartë. Bimë të ulëta ka mjaft, si lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (*papaver rhoeas*), hithi (*urtia dioica*) formacionet e livadheve si tërfili dhe shkurre të rralla.

Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë: ujku (*canis lupus*), derri i egër, dhelpra, lepuri (*lepus europaeus*), iriqi (*ernaceus europeus*) etj. Kohët e fundit, jo vetëm në këtë hapësirë, ka filluar të paraqitet kaprolli (*capreollus chrysaetos*) i cili dikur ka qenë mjaft i përhapur.

Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si trishtili kokëzi (*parus major*), zogë i malit, pëllumbi i egër (*columbia livia*), kukapikthi (*dryobates major*), laraska (*pica pica*), qyqja (*cuculus canorus*) etj. Shpezë grabitqare që jetojnë janë shqiponja e zezë (*aquilachyretos*), petriti (*malco tinnunculus*). Shpezë shtegtarë që jetojnë janë dallëndyshja, lejleku etj.

Në lumenj jeton gjarpri i ujit (*natrix natrix*), gurit (*vipera ammodytes*), bollujca (*tropidonatus natrix*), kërmilli i vreshtës (*helix pomatia*), breshka e rëndomtë (*testudo bermanni*). Peshq ka disa lloje, në lumin Llap në pjesën e epërme dikur ka qenë mjaft i pasur me trofta të përroskave (*barbus barbus*) që jeton në ujëra të shpejta dhe ftohta, mustaku i përrenjve, bërcoku, mlyshi, krapuliqi, krapu (*cyprinus carpio*), shtuka (*esox lucius*) etj. Pjesë të kësaj komune shfrytëzohen për gjuajtje peshku sportive në liqenin e Batllavës dhe brigjeve të lumit Llap. Insekte ka shumë lloje si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje merimanga, kaçadreri (*lucanus cervus*), etj.

1.6.8 Kushtet dhe karakteristikat klimatike

Komuna e Podujevës ka klimë të mesme kontinentale. Në klimë ndikojnë faktorë mikroklimatik që japin disa specifika të vogla kësaj hapësire. Prej faktorëve mikroklimatik më të rëndësishmit janë fushëgropa e Llapit dhe malet që e rrethojnë nga të gjitha anët. Efekti i maleve është se kanë reshje më shumë, temperatura më të ulëta, bora qëndron më gjatë, janë të mbuluara me pyje etj. Dallimi në hipsometri prej 550 m kuota më e ulët dhe 1770 m paraqet diferencë prej 1220 m që e shprehur në temperaturë dallimi është 6,8 0C.

Për analizën e parametrave meteorologjike do të shfrytëzohen te dhënat nga stacioni i Podujevës.

1.6.8.1 Temperaturat e Ajrit

Temperaturat në këtë komunë oscilojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale. Për analizë do të shfrytëzohen temperaturat mesatare mujore 15 vjeçare, minimumet dhe maksimumet absolute.

Temperatura mesatare është 9,6 oC, muaji me i ftoftë është janari me temperaturë mesatare -2,1oC, muaji më i ngrohtë është korriku dhe gushti me 20,1oC. Muaji më i ftoftë me temperaturë ekstreme është janari me -27,2 oC, ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me 37,0oC. Amplituda më ekstreme për këtë periudhë është 64,2 oC. Në periudhën vegetative paraqiten temperatura negative që nganjëherë sjellin dëme në bujqësi.

Për jetën e përditshme ka rendësi lagështia relative e ajrit që paraqet shkallën e ngopshmërisë së ajrit me avull të ujit. Varësisht nga temperatura e ajrit varet edhe lagështia relative e ajrit. Në temperatura më të larta ajri ka kapacitet të pranojë më tepër lagështi.

Tabela 27. Temperaturat sipas muajve

Podujevë				
Muajt	Temperaturat mesatare	Maksimumi absolut	Minimumi absolut	Amplituda
I	-2,1	13,5	-27,2	40,7
II	-0,6	17,5	-25,5	43,0
III	3,5	24,0	-20,0	44,0
IV	9,3	26,0	-4,5	30,5
V	13,5	31,0	-2,0	33,0
VI	17,8	34,0	-1,5	35,5
VII	20,1	37,0	3,0	40,0
VIII	20,1	36,5	2,0	38,5
IX	16,1	34,6	-2,0	36,6
X	10,4	29,5	-6,5	36,0
XI	5,7	20,5	13,6	34,1
XII	1,4	18,0	19,0	37,0
Vjetore	9,6	37,0	-27,2	64,2
Dimri	-0,4	18,0	-27,2	45,2
Pranvera	8,8	31,0	-20,0	51,0
Vera	19,3	37,0	-1,5	38,5
Vjeshta	10,7	34,6	13,6	48,2
Per.vegje.	16,2	37,0	-4,5	41,5

Tabela 28. Lagështia mesatare relative e ajrit sipas muajve

Lagështia mesatare relative e ajrit në %												
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
84,0	84,2	83,1	76,0	75,3	73,0	72,5	72,5	75,3	79,8	86,8	87,0	79,1

Në tabelë shihet se muajt e ngrohtë kanë lagështi relative më të vogël, ndërsa muajt më të ftohtë lagështi relative më të lartë. Lagështia relative e ajrit dhe temperatura e ajrit kanë rendësi bioklimatike. Zakonisht gjatë muajve të verës kjo dukuri ndodhë në periudha të shkurtëra kohore, kur janë temperaturat e larta dhe shpejt fillojnë të zbresin. Gjatë zbritjes së temperaturës rritet lagështia e ajrit dhe krijon të ashtuquajturën zabullimë që ka efekte negative te personat e moshuar, që shoqërohet me vështësi në frymëmarrje, por ndihet ndjenjë e pakëndshme te e tërë popullata. Këto janë raste të rralla, zakonisht lagështia e ajrit është në kufij të asaj që mund të quhet kushte komode klimatike.

1.6.8.2 Reshjet

Sasia, forma e reshjeve dhe intensiteti i tyre janë karakteristika shumë të rëndësishme për hapësirën e një territori. Reshjet paraqesin vetëm një pjesë të qarkullimit të ujit dhe ripërtritjes së tij për një hapësirë të dhënë sidomos për territorin e komunës së Podujevës. Në territorin e kësaj komune nuk kalon asnjë lumë transit që kishte për ti ushqyer ujërat nëntokësore. Niveli i ujërave në këtë hapësirë varet drejtpërdrejt nga reshjet.

Sasia vjetore e reshjeve është 697 mm që është nën mesataren e Kosovës për këtë periudhë (784mm). Muaji më i lagësht është maji (77,5) ndërsa muaji më i thatë marsi me 42,3mm. Si shihet në tabelë gjatë periudhës vegjetative bien gati 50% e sasisë së reshjeve. Prej stinëve vjeshta është më e lagështa ndërsa vera është më e thatë me 147,9 mm. Nëse kalkulojmë sasinë e reshjeve me madhësinë e territorit të komunës së Podujevës del se mesatarisht bien 432 mil m³ ujë. Kjo është vlerë mesatare dhe duhet pasur parasysh se pika monitoruese është në pjesën e ultë. Me që territori i kësaj komune shtrihet në pjesë malore që kanë sasi të reshjeve më të lartë, atëherë sasia e reshjeve duhet te jetë më e madhe.

Reshjet oscilojnë dhe të rëndësishme janë rastet kur kjo sasi është maksimale dhe minimale ngase çrregullojnë ekuilibrin natyrorë në territorin që bien. Maksimumi absolut maksimal është 256mm në muajin maj që paraqet 36% të sasisë mesatare. Kjo komunë jo rrallë përfshihet nga moti i lig. Muaji me minimum absolut është gushti me 0 reshje dhe korriku me vetëm 0,4mm (40 mililitra për m²), që tregon se ndodhin thatësi.

Përkundër këtyre variacioneve ekstreme te sasia e reshjeve është shumë i rëndësishëm intensiteti i tyre. Mesataret mujore vjetore e shumëvjeçare fshehin në vete shpërndarjen e tyre. Sipas të dhënave në tabelë shihet se ka raste kur bien pa ndërpre edhe deri në 60mm në muajin tetor. Kjo është sasi relativisht e madhe në raport me mesataren vjetore.

Në praktikën klimatologjike analizohet raporti i temperaturave dhe sasisë së reshjeve për të bërë klasifikimin e muajve të thatë, të lagësht, mesatarisht të lagësht etj. Sipas kalkulimeve në bazë të vlerave mesatare për këtë territor, asnjë muaj nuk kualifikohet i thatë, korriku, gushti dhe shtatori konsiderohen muaj mesatarisht të thatë, ndërsa të gjithë të tjerët rangohen si muaj të lagësht.

Tabela 29. Sasia e reshjeve në milimetra

Muajt	Reshjet mesatare mm	Sasia absolute maksimale mm	Sasia absolute minimale mm	Maksimumi absolut ditor
I	69,1	75,5	2,6	25,5
II	53,0	118,2	3,0	27,0
III	42,3	108,4	12,5	26,0
IV	55,6	80,0	17,0	41,2
V	77,5	256,0	26,8	48,6
VI	64,0	124,0	17,2	47,5
VII	48,4	124,0	0,4	55,2
VIII	35,5	82,4	-	53,0
IX	46,0	149,2	13,5	30,0
X	72,9	163,2	1,4	60,0
XI	75,4	129,5	16,0	56,0
XII	57,4	149,7	3,0	28,0
Vjetore	697,1	988,7	401,4	60,0
Dimri	179,5			
Pranvera	175,4			
Vera	147,9			
Vjeshta	194,3			
Per.vegje	315,5			

Bora si reshje e zakonshme ka rëndësi të madhe, ngase akumulon rezerva uji deri kur ngritën temperaturat, ushqen ujërat nëntokësorë. Në territorin e kësaj komune nuk ka ndonjë qëndrim afatgjatë të borës.

Mesatarisht me borë janë 26 ditë, ndërsa me mbulesë bore janë 48,4 ditë, ose një muaj e gjysmë. Pjesa më e madhe vitit është pa mbulesë bore. Muaji që ka ditë me mbulesë bore më së shumti është shkurti me 11,7 ditë. Shtresa maksimale e borës është njaft e lartë edhe pse e rrallë megjithatë ndodhë ngase shkakton një varg problemesh në jetën e përditshme. Ne muajin janar trashësia maksimale e borës mund të jetë edhe 96 cm që jep sinjal të çartë se mund të paralizoj të gjitha aktivitetet.


Tabela 30. Sasia e reshjeve të borës

Muajt	Ditë me borë	Ditë me mbulesë bore	Lartësia max. e shtresës së borës cm
I	7	16	28
II	7,3	11,7	96
III	3,7	7,9	30
IV	1,3	0,5	5
V	0,3	-	-
VI	-	-	-
VII	-	-	-

VIII	-	-	-
IX	-	-	-
X	0,4	-	-
XI	2,3	3,8	30
XII	3,7	8,5	20
Vjetore	26,0	48,4	96
Dimri	18,0	36,2	96
Pranvera	5,3	8,4	30
Vera	-	-	
Vjeshta	2,7	3,8	30
Per. vegje	1,6	0,5	5


1.6.8.3 Erërat

Erërat me drejtimin e lëvizjes dhe shpejtësinë e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e kushteve të jetës. Erërat e thata dhe të ngruhta ndikojnë në rritjen e avullimit dhe humbjen e lagështisë nga toka dhe bimët. Erërat ndikojnë në komoditetin e ambientit të njeriut, në temperaturat fiziologjike të njeriut. Në temperatura të larta dhe erëra të dobëta organizmi dobësohet dhe vështirë reziston temperaturat e larta. Erërat zakonisht e zvogëlojnë temperaturën e organizmit duke e bartur nga sipërfaqja e trupit. Kështu në kushte të njëjta të temperaturës erërat dukshëm ndikojnë në kushtet e jetës. Në temperatura të ulëta era sado e vogël është e pakëndshme ngase e ulë shumë temperaturën e organizmit.



Grafiku 17. Trëndafili i erërave

Me së shumti fryjnë erërat veriore, jugore dhe më pak verilindore. Në grafik, drejtimet janë të shprehura në promil në mënyre që të eliminohet numri jo i njëjtë i ditëve gjatë muajve.



Grafiku 18. Shpejtësia e erërave

Shpejtësi me të madhe mesatare kanë erërat veriore dhe jugperëndimore. Për të gjitha erërat e drejtimet që i kanë shpejtësi mesatare 3-4 m/s, nuk kanë dallime ndërmjet tyre. Shpejtësia maksimale është te erërat jugore deri 18,9 m/s.

1.6.9. Hidrografia në komunën e Podujevës

Me që komuna e Podujevës përfshin sipërfaqe mjaft të madhe paraqiten pothuajse të gjitha llojet e ujërave. Territori i komunës së Podujevës ka një rrjet hidrografik i cili i drenon ujërat në drejtim të pellgut të Detit të Zi. Ujërat sipërfaqësor paraqiten në formë të përrockave, përrenjëve burimeve dhe lumenjëve. Nëpër këtë territor buron dhe shtrihet lumi Llap, i cili njëkohësisht është dega më e rëndësishme e lumit Sitnica. Lumi Llap buron nga malet e Kopaunikut, ndërsa si burim i tij meret bashkimi i lumit Murgulla me atë të Sllatinës në fshatin Pollatë. Mirëpo si degë duhet të merret lumi Murgulla²⁰. Pjesa burimore e lumit rrjedh nëpër lugina relativisht të ngushta dhe të rrëpita. Në fushëgropën e Llapit lumi hyn në fshatin Pollatë ku shpejtësia e lëvizjes zvogëlohet dhe mer karakteristika të lumit fushorë. Sistemi lumor i lumit karakterizohet me rrjet relativisht të dendur të rrjetit lumor. Gjerësia e lumit ndryshon për shkak të dinamikës që kanë lumenjtë, ajo sillet në nivele normale rreth 9-12 metra në pikën hidrometrike në Lluzhan, thellësi deri në 1,2m. Thellësia gjithashtu nuk është e njëjtë ngase shtrati ndërtohet nga thellimet ku uji është më i qetë dhe pjesët e cekëta ku thellësia është më e vogël. Gjatësia e këtij lumi në komune është 61 km, ndërsa deri në grykëderdhje në lumin Sitnica 82,7 km. Gjatë reshjeve intesive dhe shkrirjes së borës gjatë stinës së dimrit kur temperaturat rriten, lumi del nga shtrati dhe i përmbytë pjesët rreth tij duke shkaktuar dëme të konsiderueshme.

Lumi Llap vrojtohet në pika hidrometrike, në Lluzhan dhe në Milloshevë. Pika hidrometrike në Lluzhan funksionon prej vitit 1950 me disa ndërprerje. Në këtë pikë prej vitit 1981 është theluar shtrati i lumit dhe nivelet janë shënuar me vlera negative.

²⁰ R. Pllana, Hidrologjia e lumit Llap, Buletini i FSHMN, Prishtinë, 1981.

Tabela 31. Prurjet e ujërave

Muaji	1953-73		1951/70
	Niveli në cm	Prurja Q m ³ /s	Prurja specifike l/s/ km ²
I	64	5,2	8,2
II	77	7,8	10,6
III	86	9,1	12,3
IV	84	8,5	8,5
V	78	7,4	10,1
VI	56	3,1	2,5
VII	47	2,2	1,4
VIII	40	1,2	0,8
IX	43	1,8	0,7
X	48	2,6	1,5
XI	56	3,7	1,8
XII	60	6,3	3,0
Vjetore	61,6	4,9	5,3

Burimi: R. Pllana, Vode Kosovskog Basena, Disertacion i Doktoraturës, Prishtinë 1977.

Vlera mesatare e prurjeve është 4,9 m³ për periudhën e vrojtuar. Nivelet e ujit për këtë periudhë fillojnë të ngriten prej muajit shtator duke arritur vlerën maksimale në mars. Prej marsit fillon ulja e nivelit deri në muajin gusht. Prurjet më të larta janë në muajin mars me 9,1 m³, ndërsa në gusht me vetëm 1,3 m³. Prurjet maksimale mund të arrijnë deri 25m³. Me 27 shkurt të vitit 2004, pasi që kishte shtresë bore të konsiderueshme, me ngritjen e temperaturave dhe shkrirjen e borës niveli i ujit kishte arritur 4,32 m. Si pasojë e kësaj u përmbytën mjaft sipërfaqe dhe dëme tjera materiale.

Prurja specifike tregon se sa e ushqen lumin një km² ka mjaft variacione sipas muajve. Dallimet janë 12,3 për muajin mars me me 0,7 l/s/km² në muajin gusht.

Në këtë komunë janë edhe disa degë të rëndësishme që e shkarkojn ujin në lumin Lllap. Lumi Dumnica është degë e majtë e lumit Llap, me gjatësi 25,5 km dhe sipërfaqe të pellgut 87 km². Me që përdoret për ujitje është i lidhur me kanal me lumin Llap në gjatësi 2,8 km, me që gjatë stinës së verës ka pakë ujë.

Lumi Batllava ka sipërfaqe të pellgut 315 km² dhe derdhet në Llap afër Lluzhanit. Këtë lum e formojnë disa degë që bashkohen në Orllan. Në vitin 1965 është ndërtuar penda e lartë 40,5m me qëllim të shfrytësimit të ujit. Ky akumulacion ka kapacitet rreth 40 mil m³ ujë, në fillim është ndërtuar për nevojat e KEK-ut, më vonë është bashkangjitur edhe furnizimi i Prishtinës me ujë, tani janë kyqur shumë venbanime të kësaj komune si dhe qyteti i Podujevës.

Lumi i Kaqandollit është dega më e rëndësishme e djathtë e lumit Llap, me gjatësi 32,5 km dhe sipërfaqe 193,6 km².

Pellgu i lumit Llap në komunën e Pudujevës kryesisht përputhet me vijën e kufirit komunal, përveç me komunën e Prishtinës. Kështu ujërat e lumit të Ballabanit, nga venbanimet si: Koliq, Sharban Tërnavë, Rimanishtë i shkarkojnë ujërat në këtë komunë.

Në këtë komunë hasen disa burime termale dhe termominerale. Më të rëndësishëm janë burimi i Revuçës me prurje prej 10 l/s, dhe një tjetër në fshatin Dobratin. Burime mineralike ndodhen dy në

fshatin Sallabajë dhe një në Shakovicë. Burime termomineralike janë nga një në fshatin Sallabajë dhe në Shakovicë.

Ujërat nëntokësorë nuk janë të hulumtuar sa duhet në këtë komunë. Ujërat nëntokësorë ndodhen në sedimentet aluviale që shtrihen në fushëgropën e Llapit përgjatë lumenjëve Llap, Dumnicë, Batllavë. Trashësia e këtyre sedimenteve ujëmbajtëse është deri 6,5m. Niveli i ujit ndodhet në thellësi 2,6 m me ndryshime sezonale. Për shkak të pjerrësisë që e ka fushëgropa rritet shpejtësia e lëvizjes së ujërave nëntokësore dhe shkarkimi i tyre në lumenjë, prandaj verës dukshëm bie niveli i tyre.

1.6.10. Erozioni dhe vërshimet


Erozioni është njëra prej komponentëve mjaft me rëndësi për ta trajtuar ngase rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është prezent pothuaj në tërë territorin e komunës në forma dhe intensitet të ndryshëm.

Përshejtimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka inicuar edhe faktori njeri si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar mjedisor. Më tepër prezent është mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrenjve, përdorimit joadekuat të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj.


Tabela 32. Shkalla e erozionit

Kategoritë e erozionit për K. Podujevë	Sip._ha	%
Pa erozion	2588	4.11
Erozion shumë i dobët	278	0.44
Erozion i dobët	187674	29.70
Erozion i mesëm	20062	31.91
Erozion i fortë	18550	29.52
Erozion shumë i fortë	2718	4.32

Harta 17. Erozioni sipas vendbanimeve



Zonat më të rrezikuara nga erozioni janë në: Slatinë, Reçicë, Murgull, Tërnavicë, Sylevicë, Pakashticë e Epërme, Revuçë, Dobratin, Bradash.



Grafiku 19. Shkalla e rrezikut nga erozionet

Tabela 33. Kategoritë e erozionit në Kosovë

Kategoritë e erozionit për R. Kosovës	Sip_km ²	%
Erozion shumë i dobët	1097.5	10.2
Erozion i dobët	3680.2	34.3
Erozion i mesëm	3367.7	31.3
Erozion i fortë	1890.2	17.6
Erozion shumë i fortë	714.3	6.6

Krahasuar me gjendjen erozive të R. Kosovës shkalla e rrezikshmërisë me erozion të fortë dhe shumë të fortë është më e lartë në komunën e Podujevës se sa në Republikën e Kosovës për 11.64%.


Vërshimet - Përmbytjet si fatkeqësi elementare kërkojnë vëmendje të posaçme. Sot përmbytjet konsiderohen dukuri të cilat paraqiten në sezona të caktuara, janë të rrezikshme për jetën e njeriut dhe njëkohësisht shkaktojnë dëme të konsiderueshme materiale. Në vise ku përmbytjet janë dukuri të zakonshme, popullata pothuajse është familjarizuar me këtë dukuri. Veprohet nën sloganin se përmbytjet nuk mund të parandalohen, por mund të menaxhohen. Në këto vise punohet me parullën "të jetojmë me përmbytjet" që ka kuptimin se janë dukuri normale dhe të zakonshme. Në territorin e Kosovës ndodhin përmbytje për jo në përmasa sikurse në viset që kanë lumenj me përmasa të mëdha ose kanë reshje intensive dhe klime shumë të lagësht. Megjithatë, në çdo vend ku ka lumenj herët ose vonë do të ndodhin përmbytje. Nganjëherë edhe lumenjtë shumë të vegjël dinë të jenë të rrezikshëm. Përmbytjet te ne ndodhin në dy raste: e para është prej reshjeve intensive të shoqëruara edhe me mot të lig, e dyta gjatë procesit intensiv të shkrirjes së borës së akumuluar.

Nuk duhet anashkaluar faktorin njeri i cili në shumë mënyra e ndihmon këtë dukuri. Njeriu i stimulon përmbytjet përmes prerjes së pyjeve, ngushtimit të shtretërve të lumenjve, hedhjen e mbeturinave që shkaktojnë mufatje në shtretërit e lumenjve, lëvrimi joadekuat i tokës etj. Të gjithë këta faktorë ndikojnë që edhe në këtë komunë herë pas here të ndodhin përmbytje në përmasa të ndryshme.

Lumi Llap ka pellg relativisht të madh që drenon ujërat e kësaj hapësire dhe që jo rrallë del nga shtrati dhe shkakton dëme. Me qëllim të parandalimit të tyre në qytetin e Podujevës është rregullua shtrati i lumit në gjatësi 378 m, edhe në jug të Lluazhanit janë ndërtuar argjinatura në brigjet e lumit për pengimin e ujit që ti përmbyt në gjatësi 3,1 km.

Në pjesët tjera lumi bën mjaft dëme ngase rrjedh në terren të rrafshët dhe kanali i lumit nuk e përballon atë sasi uji. Pjesa më e rrezikuar është fushëgropa e Llapit sepse aty shpejtësia e ujit është më e vogël, ndërsa shtrati i lumit nuk mund ta përcjell.

Prej bashkimit të lumit të Murgullës dhe lumit Reçica në Pollatë dhe në drejtim të rrjedhjes së ujit të gjitha vendbanimet janë të rrezikuara nga përmbytjet (Pollata, Metehia, Kërpimehi, Zakuti, Dobërdoli, Bajçina, Bradashi, Letanci, Sveçla, Llapashtica, e Poshtme, Konushevc, Lluga, Lupçi i Poshtëm, Popova, Majaci). Në nivele ekstreme kur arrin lumi Llap e rrezikon edhe vet qytetin e Podujevës.



Grafiku 20. Nivelet maksimale ditore të ujit në lumin Llap dhe në prapaskenë fotografia pas qetësimit të përmytjeve

Si shihet në grafik, niveli i ujit maksimumin e ka arritë 4,3 metra me 27 shkurt, me që rast doli nga shtrati dhe në terrene të rrafshëta solli edhe dëme. Si shihet në foto edhe shtëpiza e pikës monitoruese është përmytë në ujë rreth 1m. Në këtë lumë janë të zakonshme nivelet e larta në muajin shkurt.

1.6.11. Ndotja e ujërave

Si në tërë territorin e Kosovës edhe në komunën e Podujevës ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë janë pa mbrojtje adekuate nga ndotja. Përdorimi i ujit në industri dhe amvisëri kthehet në shtratin e lumit i pa trajtuar që ka për pasojë ndërrimin e parametrave fiziko-kimik dhe biologjik të ujit. Shkarkimi i ujërave të zeza prej amvisërisë, bizneseve dhe industrisë, jo vetëm në këtë komunë po bëhet problem serioz. Teknologjia e shtrenjtë për trajtim të ujërave të zeza ka ndikuar që edhe me këto pakë veprimtari industriale e biznese tjera të kemi probleme serioze në degradimin e natyrës e sidomos të ujërave.

Në komunën e Podujevës operojnë 2921 biznese aktive me veprimtari të ndryshme që shkarkojnë ujërat e zeza të pa trajtuara në shtratin e lumenjve. Në bazë të dhënave komunale në Podujevë janë 78 vendbanime me 12,315 shtëpi banimi, ku jetojnë 122,179 banorë, ndërsa as një nga këto objekte banimi nuk i trajton ujërat e zeza. Të gjitha këto familje me sasi të ndryshme përdorin mjete për mirëmbajtjen e higjienës (acide, sapun, shampon etj) për amvisëri dhe shkarkimi i tyre është i drejtpërdrejt në lumenj. Burim potencial i ndotjes së ujërave janë edhe derdhja e vajrave motorike të përdorura që në mënyrë direkte apo indirekte ndotin ujërat sipërfaqësorë apo nëntokësorë.

Ujërat e zeza përmbajnë shumë lëndë që shpenzojnë oksigjenin e tretur, komponime të tretshme të fosforit dhe azotit, baktere dhe viruse patogjene, metale të rënda: Cd, Hg, Zn, Pb, Cr, etj, si dhe materie tjera që prishin cilësinë e ujit.

Tabela 34. Vlerat mesatare të analizave fiziko-kimike të ujërave sipërfaqësore sipas profileve në pellgjet e Kosovës 2005/2006/2007

Lumi	Pika monitoruese	Vlerat e TDS-mg/l			Vlerat e pH			Vlerat e O ₂ të tretur ne mg/l		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
Llapi	Reqicë	145	127	129	8.18	7.92	8.14	11.28	10.27	10.01
Llapi	Podujevë	216	216	217	8.02	7.91	8.05	9.14	8.01	7.79
Llapi	Milloshëvë	222	237	208	7.96	7.97	7.98	9.74	10.68	9.57

Të gjitha degët e lumit Llap si dhe burimet e tyre janë të pastërta dhe klasifikohen në kategorinë e parë për nga cilësia e ujit ngase janë larg vendbanimeve dhe nuk janë nën ndikimin e faktorit njeri.

lumi Llap hyn në kategorinë e dytë të cilësisë së ujërave pasi kalon nëpër vendbanime për shkak të shkarkimit të ujërave të zeza si dhe për shkak të hedhjes së mbeturinave të amvisërisë si dhe atyre tjera. Nga fshati Brecë deri në Lluzhan cilësia e ujit rangohet në kategorinë e dytë.

Nga Lluzhani e deri në grykëderdhje të lumit Sitnica kalon në kategorinë e III të klasifikimit.


Nga Liqeni i Batllavës e deri te grykëderdhja e lumit Llap, lumi Batllava kalon në kategorinë e dytë të klasifikimit.

Lumi Kaqandollit, nga fshati Popovë deri në grykëderdhje të lumit Llap, hyn në kategorinë II-të të klasifikimit.

Problem është edhe shkarkimi i ujërave të zeza në liqenin e Batllavës për shkak se këto vendbanime nuk kanë të organizuar sistemin e pastrimit të ujërave. Liqeni i Batllavës përdoret për furnizim me ujë të qytetit të Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit.

Problem serioz i gjendjes së tanishme është edhe shkarkimi i mbeturinave të amëvisërisë dhe hedhurinave të tjerave në shtretërit e lumenjve për shkak të mos organizimit të grumbullimit të mbetjeve urbane. Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit Llap. Mesatarisht çdo banorë shkarkon 16.46 m³/vit ujëra të zeza.

Harta 18. Ndotja e lumenjëve



Komuna e Podujevës, me 122179 banorë, shkarkon 4.74 l/s, ose 5497m³ ujëra të zeza të pa trajtuara në lumë brenda ditës, pa llogaritur këtu objektet publike, tregtare, hoteliere, industriale etj.

Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja, ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka. Përveç ndotjes kimike të ujërave, është edhe ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe parazitëve që janë të dëmshëm për shëndetin e njeriut, florën dhe faunën që jeton në lumenj. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet jetike për botën e gjallë që jeton në këto ujëra.

Shkarkimi i mbeturinave të ngurta në lumenj është dukuri tjetër negative në këtë komunë. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime që nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave por edhe mungesa e edukatës mjedisore.

1.6.12. Degradimi i lumenjëve


Në bazë të dhënave komunale si dhe vrojtimeve në terren, shtretërit e lumenjve janë kthyer në deponi hedhurinash, si ato të amvisrisë, mbeturina tjera urbane dhe rurale, pastaj shkarkimi i ujërave të zeza të vendbanimeve dhe industrisë si dhe nxjerrja e inerteve ka degradua ujin e lumenjve. Ndikim shumë të madh ka edhe uzurpimi i shtretërve të lumenjve dhe si pasojë ka ndodhur ndërrimi i rrjedhës natyrore të lumit, pastaj ndotja dhe shkatërrimi i biosferës në shtratin e lumit dhe përreth tij.

Pasojat e shfrytëzimit të inerteve në mënyrë të pa planifikuar në shtretërit e lumenjve shkaktojnë vërshime në tokat bujqësore dhe uljen e nivelit të ujërave nëntokësorë.

Vet rritja e bimëve të larta, pengesat natyrore dhe ato antropogjene kanë ndikuar negativisht në rrjedhën natyrore të lumit Llap dhe degët e tij.

Sipërfaqja ujore rreth 605ha në komunën Podujevës, në bazë të vrojtimeve dhe në bazë të analizave të bëra në GIS, kanë pësuar ndryshime për shkak të uzurpimeve të shtratit të lumenjve dhe për shkak të mbjelljes së bimëve të larta nga fermerët që kanë pronat përgjatë shtratit të lumit.

Harta 19. Vërshimet, mbeturinat ilegale, degradimi i tokës dhe lumenjëve



Ndikimet negative antropogjene janë prezentë në të gjitha rrjedhjet ujore që kalojnë në vendbanime nga hedhja e mbeturinave të ngurta, ku depozitimi i tyre shkakton degradim dhe ndotje që ndikon negativisht në arealin biogeografik të shtratit të lumit.

Hedhja e mbeturinave janë prezent në të gjithë lumenjtë e Komunës së Podujevës.

Janë identifikuar këto pika degraduese në shtretërit e lumenjve: Repë, Bajçinë, Peran, Obranqë, Podujevë, Sibofc i Epërm, Sallabajë, Lupç i Poshtëm. Këto janë pikat më të degraduara të shtratit të lumit Llap.

1.6.13. Ndotja e Ajrit

Ajri është element i rëndësishëm i mjedisit dhe domosdoshmëri për jetën. Ndotja e tij nga përzierja me substanca që futen në rrugë natyrore apo artificiale (burime antropogjenë), përbën shkakun kryesor të përkeqësimit të cilësisë së tij, i cili shkakton një sërë sëmundjesh humane dhe degradimin e elementeve të tjera të mjedisit.

Transporti është njëri ndër ndotësit kryesor të ajrit, ujit, dhe tokës. Pasojat tjera janë zhurma urbane, dridhjet, ndërrimi i klimës, varfëria e biodiversitetit, ndryshimi i pamjes së hapësirës dhe shumë ndodhi të jashtëzakonshme (fatkeqësi të ndryshme). Kjo ka të bëjë me hapësirat urbane, posaçërisht në qytetet e mëdha dhe në hapësirat jashtë tyre. Në këtë aspekt shkaktari kryesor është transporti automobilistik, për shkak se për punën e tyre përdoren lëndët djegëse fosile.

Kjo arsyetohet me fakte nga Ministria e Transportit se në Kosovë ekzistojnë 215.504 automjete, pa i llogaritur automjetet e KFOR-it, UNMIK-ut dhe rreth 25% të automjeteve që janë në Kosovë, por që nuk janë të regjistruara. Pastaj, sasia e derivateve që importohen në Kosovë, në bazë të të dhënave që janë marrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, është një sasi relativisht e madhe diell, deri 29.663.234 l dhe benzinë 24.550.368 l. Në anën tjetër, ndotës i ajrit i rëndësishëm është përdorimi i druve dhe thëngjillit për ngrohje dhe burim energjetik. Në hapësirat ku objekte banimi janë shtëpitë individuale dhe ngrohja është individuale, emetimi i tymit është i lartë dhe në sezonin e dimrit kur shoqërohet me mjegull është tejet i rrezikshëm, ngase në situata të tilla nuk ka erë që do ta shpërndante.


Njëri ndër problemet kryesore që paraqitet si pasojë e ndotjes nga transporti është emisioni i lartë i gazrave nga lëndët djegëse të automjeteve si: CO₂, NO_x, SO₂, CO₂. Emisionet nga automjetet shkaktojnë pjesën më të madhe të ndotjes me metalet e rënda si: Pb, etj. Koncentrimi më i madh i kësaj ndotjeje nga qarkullimi i automjeteve është përgjatë rrugës kryesore Prishtinë-Podujevë – Merdare.

Në bazë të këtyre rezultateve shihet se ekziston emision i gazrave të CO₂. Si pasojë e erërave që lëvizin në drejtim të komunës së Podujevës ndikim ka edhe Korporata Energjetike e Kosovës, ku ndikimet në ndotjen e ajrit ujit dhe tokës vërehen në Jugperëndim të komunës, si në Lupq të Poshtëm e me tutje.

Në bazë të dhënave komunale ndikim në ndotjen e ajrit për shkak të djegies së mazutit në një sipërfaqe lokale ka edhe Fabrika e Bllokave „Euro Bllok”.

Stacione matëse nuk ka në këtë regjion prandaj mungesa e të dhënave ka ndikuar në një përshkrim të gjendjes të tillë.

1.6.14. Degradimi i Tokës



Sipërfaqet e tokave që kanë pësuar degradim rrjedhin si pasojë e shfrytëzimit të pa kontrolluar të pyjeve, gurëthyesve, materialeve inerte etj. Këto veprimtari negative, sidomos prerja ilegale e pyjeve ka për pasojë rritjen e erozionit, vërshimet si dhe shkatërrimin e botës së gjallë bimore e shtazore. Vetëm gjatë vitit 2008 në komunën e Podujevës prerje ilegale janë rreth 10000m³ dru, si dhe nga pakujdesia zjarret kanë dëmtuar rreth 90 ha pyje.

Në bazë të dhënave komunale dhe vizitave në terren këto dukuri ndodhin në shumicën e vendbanimeve. Hedhja e mbetjeve në sipërfaqe të tokës në mënyrë të pa kontrolluar ndikojnë negativisht në biosferë ku degradimet janë në shkallë të rritjes

- Murgullë: Gurthyes
- Majac: Gurthyes

Prerja e rreth 10000 m³ dru e rritë sipërfaqen e zhveshur, ndërsa kjo ndikon në intensitetin e shpëlarjes së tokave, edhe ashtu të cekëta. Këto

dukuri janë prezentë në të gjitha vendbanimet rurale. Përkujdesja e vogël ndaj pyjeve ka ndikuar në zhvillimin e sëmundjeve, shumimin e insekteve të dëmshme dhe tharjen drunjëve (sidomos në llojet e bungut). Mjedisin jo i pastër dhe hedhja e mbeturinave të ngurta janë prezent në vendbanimet e komunës së Podujevës, ku janë krijuar deponime ilegale që kanë pasojë për botën bimore dhe shtazore, si dhe në vetë mjedisin ku jeton njeriu. Gjatë hulumtimeve në terren janë vënë re pika degradimi si pranë shtretërve të lumenjve në një pjesë të ndryshme të tokave të lira.

Sipërfaqet e degraduara sipas njësisë, GIS-it ne terren:

- Mbeturina ilegale të shpërndara në sipërfaqe të lira të tokës janë 61.5 ha
- Degradim toke në forma të ndryshme rrethe 46 ha dhe
- Degradim të lumenjve rreth 33 ha. Rreth 140 ha tokë të kategorive të ndryshme janë të rrezikuara nga degradimet të mënyrave të ndryshme

1.6.15. Trashëgimia kulturore

Trashëgimia kulturore e kësaj ane përmban një pasuri të madhe vlerash shpirtërore e materiale, me ngjarje e shkatërrime tragjike edhe të këtyre vlerave që nga antika e deri sot. Sipas të dhënave dhe zbulimeve historike e arkeologjike edhe komuna e Podujevës, pjesë e Dardanisë antike, është tejet e pasur me vlera materiale autoktone. Zbulime arkeologjike janë gjetur në shumë vendbanime të kësaj treve që datojnë nga shekulli i II-të e.s. Duhet theksuar se shumë monumente antike mendohet se janë

zhdukur plotësisht dhe në të shumtën e rasteve dalin vetëm në toponiminë e kësaj treve, ndërkohë që objektet e vjetra, për arsye të rrethanave historike, në pamundësi të kujdesit institucional, vazhdojnë të humbin gjurmët ose të dëmtohen shumë.

Qendër e rëndësishme e Dardanisë në kohën romake ishte Vendenisi (Gllamniku i sotëm). Këto mbetje arkeologjike janë prezentë në shumë vendbanime të komunës por ato që kanë mbetje me të theksuar dhe që sot ende ekzistojnë janë në: Gllamnik, Teneshdoll, Surkish, Popovë, Ballofc etj .

Monumentet arkeologjike të rëndësisë lokale, nacionale dhe internacionale është -Sarkogfagu i gjetur në Gllamnik me rëndësi nacionale. Ky sarkofag është i vendosur në muzeun e Kosovës në Prishtinë.

Monumentet arkitekturale të rëndësisë lokale, nacionale dhe internacionale janë:

Dy kullat në Herticë, ajo e Sali Agës dhe e Ajet Muçollit , Kompleksi në Reçicë, Përmendorja te Tabet e Lllashticës, Shtëpia Muze e Hasan Ramadanit , Kulla dhe oda e Dem Ahmetit kanë rëndësi nacionale.

Numri i monumenteve në këtë komunë, sipas të dhënave të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës dhe të dhënave plotësuese nga institucionet komunale janë:


Tabela 35. Trashëgimia kulturore

Vendbanimi	Gjurmë arkeologjike të shtëpive, tullave qeramikës, ujësjellësit, monumente te vjetra etj	Varreza të moçme ilire-romake	Objekt fetar
Perpellac	Mbetje arkeologjik	Varreza të moçme	
Kunushec	Arat e Qurshisë-mbetje arkeologjike, Shpati i Qejes-mbetje, lagjja Dedaj dhe Arat nën Drum janë mbetje arkeologjike të shumta	Varreza shumë të vjetra	
Halabak	Troja-mure me gurë dhe pjesë qeramike		
Surdull			Roga e Kishës
Tërrnavicë	Vanafc-gjurmë vendbanimi, Taravi-tulla, qeramikë, enë qeramike etj	Varreza të moçme	
Recicë	Remçiç-tulla, tjegulla, enë dheu	Varreza te vjetra	Gjurmë te një kishe ,Reka e Bolloshes-Bazilika
Sllatinë		Varrezat e menxhve,	Gjyteti i jerlive, Lugu i Kishës, Kulla e gurit të ugarit, Kulla e madhe dhe kulla e vogël,Kulla e Sllatinës, Kulla e „shpiave të shkive” Kulla e Destanit dhe e Beselicës
Dvorishtë	Tulla punim dore nga dheu etj	Varreza te lashta	
Brecë		Varreza te vjetra edhe sot ka skelete	Lagjja Jashari-gur të një kishe të vjetër,
Pollatë	Qarret e Monoviqe -Mbetje arkeologjike	Varreza te vjetra	Kish e Manastir
Repë		Në P varreza te vjetra	Gjurmë të një kishe të vjetër
Sylevicë	Themele te vjetra dhe vegla të ndryshme	Varreza	
Zhiti	Zidinat-mure te vjetra, themele, enë qeramike,		

	tjegulla, tulla etj		
Pakashticë e Epërme		Dy varreza të moçme që nuk dihen periudha	
Metehi	Llugë dhe Soisht-themele te shtëpive, gypa qeramike	Varreza te vjetra të gdhendura në formë koke me shkallë	
Revuq		Varreza te vjetra	
Dobratin	Vrella -Gypa te vjeter qeramike	Çuka-varreza te vjetra	Ne Veri të fshatit -kështjellë ilire
Dobërdol	Lagjja Selmani-Gypa qeramike	Varret e Hajdinve	
Bajçinë	Zabeli i Qitakëve -materiale të ndryshme, tulla, tjegulla etj	Lepaja- varreza te moçme	Perëndim të fshatit -kisha katolike
Dumnicë e Poshtme		Varreza te vjetra	Kishë e vjetër te Kroj i Kishës
Llaushë		Varreza te vjetra afër lagjes Fazlija	
Letanc	Rrjet ujësjellësi, dy burime uji dhe një mulli i vjetër		
Peran			Një kish e vjetër në mes Bradashit dhe Lkenasit
Obrancë	Seishta -gjurmë te objekteve të vjetra	Në disa pjesë të fshatit vërehen gjurmë te varrezave të moçme	
Llaspashticë e Epërme	Enë qeramike, gur me shkrime latine, kryqe nga guri, mure etj	Varreza te moçme	Kështjella, Gjyteti, Gradina Leshinca -Te qarri i kishës
Popovë	Mbeturina të objekteve të banimit	Rekë të Kaçanullit-varret e vjetra	Lagj.Potok-Kalaja e vjetër Te Guri Kishës
Llaspashticë e Poshtme			Te Qarri i kishës
Gllamnik	Është gjetur Altari i Hyjneshës Dardane, Vendebisi-Mozaiku i Orfeut	Varreza krishtere	Është zbuluar një pallat luksoz i shek.IV es
Surkish	Puset e Surkishit si dhe mbetje arkeologjike	Varrezat e vjetra	Gumurisht-gjurmë kisha,
Ballofc			Kalaja e Ballocit -fortifikata Laberion
Shtedim	Mbetje të ndryshme arkeologjike		
Podujevë	Altar i punuar nga guri		
Bradash	Materiale te vjetra arkeologjike -tulla, qeramikë, themele të shtëpive etj	Varreza te moçme Lagja Qakullve - varreza	Gurët e bardhë - karshi i sokolit: Kalaja, Kodra e kishës,afër lagjes Spahija Kisha ,afër urës një kish
Lupç i Epërm	Materiale banimi afër kalas	Varrezat e Krushqëve etj	Kalaja ne mes Mjacist dhe Lupçit,Përroi i Kishës
Majac	Gradina -materiale arkologjike		
Sallabaje			Ne veri - gjurmë të kishës
Lluzhan	Gjurmë të vjetra të materialeve ndërtimore		
Llugë	Gjurmë të vjetra të		

	materialeve ndërtimore		
Bellopoje	Te ledina-qeramikë enë dheu	Te Kreksi-varreza te vjetra	
Gërdoc	Seishta-mbetje arkeologjike	Varreza te vjetra	Kisha katolike
Dyz	Trojet-vendbanim i vjetër Vegla: sëpata, vegla pune	Varreza të vjetra afër shkollës	Lugu i kishës-Kish
Kaçibeg	Arat e Gerdoci-tjegulla, gurë, tulla, pus pa ujë etj		
Siboc i Poshtëm	Mbetje te shumta arkeologjike ne shumë pjesë të Sibovcit	Stelë gur varri	
Siboc i Epërm	Lagjja e Kolibagjive-mbetje te rëndësishme arkeologjike	Varrezë e një vajze me pllakë mermeri 5 tonë unazë dhe stoli bylyzyku	
Sfecël	Monedha metali Ilire me shkrim Alban dhe Dalmat,unaza,themele te objekteve,puse oxhaqe,	Varret e Kovaqve - varreza te moçme	Te Arat e Kishës -Gjendet themelet e kishës Laberoni jo larg bregut të lumit Llap
Shajkofc	Ara e Stanit- tjegulla, tulla etj	Ulica e Shajkocit-varreza të moçme	Te Kisha ne kufi me Herticen
Lladofc	Gur me shkronja latine		Rrafshina e kishes
Herticë	Kodra e Zezë dhe ne Lagjen e Pallomëve janë gjetur objekte te vjetra gypa qeramike,tjegulla grumbuj shkemish etj	Lagjja e Pallomeve-varreza te vjetra	Pllomët-kisha , Kisha te stanet, Qyteza ne çukë,,Karakollët në bjeshkët e Halitit etj
Turucicë	Kojuha-vend arkeologjik		
Rakinicë	Gjurme te mureve te vjetra		Kisha dhe konaku i kishës afër shkollës
Muhazob	Themele godinash		Ka shenja te kalasë dhe te kishës se fshatit
Metergoc	Copa qeramike	Varreza te vjetra	Livadhët e kishës
Bervenik	Gjurmë të qytetit të vjetër, tregut dhe mbetje tjera		Gjurmë të një kishë të vjetër Bederianë-Bazilika
Krushevicë	Në çukë dhe rruga e topit gjinden materiale te objekteve arkeologjike te banimit.	Katuni- varreza të vjetra	
Brainë	Çuka e Brainës_fortifikatë		Rrethojat e kështjellës, Zidi i çikës-gjurmë kështjelle, Gubavci-themelet e kishës
Baraina			Qyteza në çuk;relikte arkeologjike
Batllavë	Lagjja e Ratkocerve-tjegulla, tulla,gurë të themeleve etj		
Lupç i Poshtëm	Sharpanoll-Koka monumentale e Neolitit Lagjen Pireva-gurë, kryq, qeramikë etj	Varreza të vjetra	Kisha
Burice	Te Vjosa dhe Ara e Epërme - shkallë te shtëpive, themele, tjegulla etj		Te kisha janë gjetur skelete si dhe gërmadha e kishës
Kalaticë	Arat e Shtogjeve-grumbuj gurësh dhe gjurmë objektësh		
Zakut	Troje afër Llapit -themele te shtëpive banimi		

Harta 20. Trashëgimia kulturore



1.6.16 Trashëgimia natyrore

Llojlojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, geomorfologjik në Komunës së Podujevës, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore që kanë përhapje në territorin e

komunës, konsiderohen vlera të një trashëgimie natyrore. Deri më tani nuk ka pasë hulumtime të natyrës në këtë komunë. Vlerat e trashëgimisë natyrore, edhe pse pa mbrojtje institucionale të mjaftueshme, i kanë mbijetuar kohës.

Gjatë periudhës 2002-2006, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës (Tani Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit) ka bërë hulumtimin dhe evidentimin vlerave të reja të natyrës në 16 komuna të Kosovës. Këto vlera janë evidente edhe në komunën e Podujevës, ku këto zona janë propozuar për mbrojtje institucionale, për shkak vlerave të larta dhe të veçanta.

Tabela 36. Trashëgimia natyrore

Emri i Objektivit	Viti i vënies në mbrojtje dhe baza ligjore	Kategoria e mbrojtjes	Gjendja aktuale e tyre
1. Lisi i Qarrit (Q.Cerris) në Dobratin	1988 (GZK 48/87)	Monument natyror me karakter botanik	Trungu është në gjendje të mirë natyrore
2. Trungu i Plepit (Populus tremula) në Bajqinë	1959 (GZK 48/88)	Monument natyror me karakter botanik	Trungu në pjesën e poshtme është i djegur
3. Trungu i Qarrit (Q.cerris) në fshatin Pollatë	1988 (GZK 48/88)	Monument natyror me karakter botanik	Trungu është në gjendje të mirë natyrore
4. Trungu i Plepit (Populus Tremula) në fshatin Orllan	1987 (GZK 48/87)	Monument natyror me karakter botanik	Trungu është i djegur tërësisht
5. Burimi i Ujit natyror më Revuqë	1987 (GZK 18/88)	Monument natyror me hidrologjik	Burimi është në gjendje shumë të mirë natyrore
6. Trungu i Qarrit në fshatin Dumnicë të Poshtme	1988 (GZK 48/87)	Monument natyror me karakter botanik	Trungu është tharë si pasojë e goditjes nga rrufeja
7. Burimi i ujit termo-mineral në fshatin Shakovicë	1987 (GZK 14/88)	Monument natyror me hidrologjik	Burimi është duke u shfrytëzuar në mënyrë ilegale për nevoja komerciale dhe ka humbur origjinalitetin natyror
8. Burimi i ujit termo-mineral në fshatin Sallabajë	1987 (GZK 14/88)	Monument natyror me hidrologjik	Burimi është në gjendje të mirë


Lista e objekteve (zonave) natyrore të cilat Instituti i Monumenteve Natyrore të Kosovës i ka propozuar për mbrojtje janë:

1. Lugina dhe Qafa e Kaqandollit, Kaqandoll (Podujevë-Mitrovicë-Vushtrri)
2. Lokaliteti "Ushton Reka", Popovë
3. Kompleksi i Liqenit të Batllavës, Orllan-Batllavë
4. Vrella e Dobratinit dhe Kompleksi i trungjeve të ahut dhe të dushkut, Dobratin (Lagjja e Ajvazëve)
5. Trungu i Plepit, Murgullë
6. Dy trungje të dushkut, Llapashticë e Epërme, (varrezat e fshatit)
7. Trungu i Plepit, Orllan

8. Trungu i dushkut , Dyz
9. Trungu i plepit , Gërdoc

Zonë me karakter të veçantë është edhe Liqeni i Batllavës me karakter hidrologjik dhe ekonomiko-turistik që duhet të shtohet në listën për mbrojtje për shkak të vlerave të larta natyrore.

Harta 21. Trashëgimia natyrore




1.7. Zhvillimi Ekonomik

Organizimi administrativ i komunës së Podujevës daton që nga vitet e 60-ta. Është vlerësuar se zhvillimin më të hovshëm shoqëror dhe ekonomik, Podujeva e ka arritur në vitet e 80-ta. Në këtë periudhë veprimtarinë e vet e kanë zhvilluar 16 organizata ekonomike shoqërore me rreth 2,500 punëtorë. Gjatë viteve të 90-ta u themeluan rreth 200 ndërmarrje me kapital privat, kryesisht nga lëmi i tregtisë dhe shërbimeve. Gjatë luftës, të gjitha këto ndërmarrje u shkatërruan. Pasojat ekonomike të konfliktit të fundit kanë qenë të rënda dhe kanë ndikuar në shkatërrimin e shumë ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Shumica e ndërmarrjeve tregtare ndërprejnë aktivitetin e tyre, ndërsa në ato që kanë mbetur janë të punësuar përafërsisht 400 persona.

Dëmet që ka pësuar komuna e Podujevës në luftën e fundit kapin shumën prej 350 milion euro. Në periudhën e pasluftës, qoftë me ndihmën e donatorëve, por më tepër me financim vetanak, ka filluar veprimtaria ekonomike dhe, sipas evidencës në Komunën e Podujevës në fund të vitit 2002 kanë qenë të regjistruara 2,251 biznese, kryesisht në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve²¹. Nga ky vit, numri i biznesev ka shënuar një rritje të vazhdueshme. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014, në Podujevë janë të regjistruara 3122 biznese.

Shfrytëzimi i tokës ka rëndësi të veçantë për të kuptuar se cilat janë resurset e një territori, cilat janë format e shfrytëzimit të hapësirës dhe si duhet të bëhet planifikimi për shfrytëzimin dhe zhvillimin e ardhshëm të një territori të caktuar. Për të kuptuar se si është shfrytëzimi i tokës në komunën e Podujevës jemi mbështetur në të dhënat e AKK për vitin 2002. Sipas këtyre të dhënave gjendja e shfrytëzimit të tokës në komunën e Podujevës është si në vijim:




Grafiku 21. Struktura e shfrytëzimit të tokës

²¹ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2003-2006, faqe 6.

Nga grafikoni kuptojmë që shfrytëzimi i tokës për aktivitetet primare është si në vijim; 41% e territorit komunal është e mbuluar me pyje të cilët kryesisht janë dru për ngrohje, përdorim në ndërtimtari dhe jo dru industrial, 29% ara dhe kopshte dhe kryesisht kultura lavërtarie, 12% livadhe dhe 12% kullosa të cilat janë një fond i konsiderueshëm dhe një mundësi e mirë e zhvillimit të blegtorisë, kurse pemishtet, vreshtat dhe djerrinat zënë një sipërfaqe të vogël e cila në përqindje nuk kalon mbi 3%. Bizneset dhe aktivitetet minerare zënë një sipërfaqe shumë të vogël e cila është jo më shumë se 3%. Gjithashtu edhe shfrytëzimi i tokës për banim, infrastrukturë dhe objekte kulturore nuk kalon më shumë se 5% të totalit. Ndërsa lumenjtë dhe shtretërit e tyre përbëjnë 1% të sipërfaqes së përgjithshme në komunën e Podujevës.

1.7.1. Bizneset

Bazuar në shënimet e siguruar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, në komunën e Podujevës në vitin 2015 janë të regjistruara gjithsej 3972 biznese. Mbi 98% e bizneseve janë biznese të vogla me 1 deri në 9 punëtorë, derisa bizneset me 10 deri 49 punëtorë dhe ato me 50 deri 249 punëtorë bejnë pjesë me 0.9% respektivisht 0.2%. Gjithashtu, numri më i madh i punëtorëve janë të punësuar në biznese të vogla (1 deri 9 punëtorë) megjithatë raporti mes madhësisë së bizneseve është më i favorshëm krahasuar me numrin e ndërmarrjeve. Në bizneset me 1 deri 9 punëtorë janë të punësuar gjithsej 6104 punëtorë, apo 85.1% e të punësuarve, derisa në bizneset me 10 deri 45 punëtorë dhe 50 – 249 punëtorë janë të punësuar 622 apo 8.7% dhe 450 apo 6.3% të të punësuarve.



Grafiku 22. Ndarja e bizneseve ne baze te numrit te punetoreve

Tabela 37. Ndarja e Bizneseve ne Komunen e Podujeves

LLOJI I VEPRIMTARISË EKONOMIKE	Madhësia e Biznesit						Gjithsej Biznese	%	Gjithsej Punëtorë	%
	1 - 9 Punëtorë		10 - 49 Punëtorë		50 - 249 Punëtorë					
	Numri	Punëtorë	Numri	Punëtorë	Numri	Punëtorë				
ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES; SIGURIMI SHOQEROR I DETYRUAR	4	12	1	30	0	0	5	0.1%	42	0.6%
AKTIVITETE TË TJERA TË SHERBIMIT KOLEKTIV, SOCIAL DHE INDIVIDUAL	175	252	1	11	0	0	176	4.4%	263	3.7%
ARSIMI	26	63	0		0	0	26	0.7%	63	0.9%
BUJQËSIA, GJUETIA DHE SILVIKULTURA	172	264	1	15	0	0	173	4.36%	279	3.89%
HOTELE DHE RESTORANTE	362	548	2	63	0	0	364	9.2%	611	8.5%
INDUSTRIA NXJERRËSE	4	35	2	25	0	0	6	0.2%	60	0.8%
INDUSTRIA PËRPUNUESE	359	716	10	142	5	383	374	9.4%	1241	17.3%
NDERMJETËSIMI MONETAR DHE FINANCIAR	3	3	0	0	0	0	3	0.1%	3	0.0%
NDËRTIMI	351	888	9	129	0	0	360	9.1%	1017	14.2%
PASURITË E PATUNDËSHME, DHËNIA ME QIRA, INFORMATIKA, PUNA KERKIMORE SHKENCORE, TJERA AKTIVITETE PROFESIONALE	91	144	0	0	0	0	91	2.3%	144	2.0%
PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE, E GAZIT, E AVULLIT DHE E UJIT TË NGROHTË	1	2	0	0	0	0	1	0.0%	2	0.0%
SHËNDETSIA DHE VEPRIMTARI TË TJERA SOCIALE	59	76	0	0	0	0	59	1.5%	76	1.1%
TRANSPORTET, MAGAZINIMI DHE KOMUNIKACIONI	547	673	2	45	1	67	550	13.8%	785	10.9%
TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË. RIPARIMI I AUTOMOBILAVE, MOTOÇIKLETAVE, SENDEVE PERSONALE, PAJISJEVE SHTËPIAKE	1775	2428	9	162	0	0	1784	44.9%	2590	36.1%
TOTALI	3929	6104	37	622	6	450	3972	100%	7176	100%


Numri më i madh i bizneseve i takon veprimtarisë ekonomike të tregtisë me afro 45% të bizneseve dhe mbi 36% të të punësuarve. Pas tregtisë, numri më i madh i bizneseve i takojnë shërbimeve të transportit dhe komunikacionit me mbi 13% dhe afro 11% të të punësuarve dhe industrisë përpunuese

me mbi 9% të bizneseve dhe mbi 17% të të punësuarve. Nga kjo shihet se industria përpunuese ka rëndësi të madhe për punësim sepse punëson numër më të madh të punëtorëve në krahasim me veprimtaritë e tjera.

1.7.2 Bujqësia

Komuna e Podujevës është komunë kryesisht rurale pasi që mbi 70% e popullsisë jetojnë në zonat rurale. Komuna e Podujevës ka resurse të konsiderueshme që mundësojnë zhvillimin e bujqësisë. Komuna e Podujevës ka fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014 në Komunën e Podujevës janë gjithsej 33,295 hektarë tokë bujqësore.

Rreth 56% apo 18562 hektarë është tokë e punueshme që përdoret për lavërtari. Kullostat përbejnë 16% të tokës bujqësore (5186 hektarë) dhe pjesa tjetër përdoret për perimtari, pentari, vreshtari etj.



Grafiku 23. Pjesëmarja e tokës së punueshme për bujqësi

Lavërtaria tradicionalisht konsiderohet si sektori më i kultivuar në Komunën e Podujevës. Megjithatë, viteve të fundit vërehet zvogëlim i vazhdueshëm i sipërfaqeve të mbjella me kultura lavërtare. Kultura më e kultivuar është gruri me afro 4,380 hektarë, apo afro 24% të sipërfaqës së punueshme. Sipërfaqe të konsiderueshme zënë edhe misri me 16%, patatja me 10% dhe bimët foragjere si sana dhe jonxha me 17% dhe 15% respektivisht. Prodhimtaria në përgjithësi është e kënaqshme. Me prodhimtarinë më të madhe paraqitet patatja me afro 50,000 kg per hektarë dhe misri me 6500 kg për hektarë (Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014)

Tabela 38 Kultivimi i kulturave lavërtare dhe prodhimtaria

Kultura	Sipërfaqja (ne hektarë)	Prodhimtaria (kg/hektarë)
Grurë	4380	5000
Elb	22	3500
Thekër	112	3000
Misër	2928	6500
Tërshërë	1485	3500
Patate	1936	50000
Sanë	3200	6000
Jonxhë	2800	6500

Perimtaria është njëra nga veprimtaritë bujqësore që ka shënuar përparimin më të madh, sidomos viteve të fundit. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014 gjithsej 2169 hektarë janë të mbjellura me perime, nga të cilat 39 hektarë janë të mbjellura në sera. Perimet me prodhimtari më të madhe janë lakrat, domatet, specat dhe qepët.

Tabela 39. Prodhimtaria e Perimeve

Perimi	Prodhimtaria (ton/hektarë)
Speci	25-30
Domatja	40-50
Lakra	50-55
Karota	20
Qepa	25-30
Sallata	15
Spinaqi	15
Trangulli	30
Purrini	30
Lule Lakra	40
Hudhra	8

Perimet kanë një rol shumë të madh në zhvillimin e bujqësisë dhe kulturës ushqyese të një vendi për shkak se janë konsum i çdo shujte ushqimore si dhe vlera e tyre në treg është më e madhe se sa vlera e produkteve të tjera bujqësore, psh drithërave. Gjithashtu edhe prodhimtaria e tyre është shumfish më e madhe se sa e drithërave. Prandaj, kësaj dege duhet kushtuar rëndësi më të madhe me qëllim të zhvillimit të bujqësisë moderne në përgjithësi.



Sera "Argjenti" në fshatin Peran²²

Ngjashëm me perimtarinë, edhe kultivimi i pemëve ka shënuar një rritje të konsiderueshme. Mundësitë më të mëdha dhe kushtet e volitshme si tokësore ashtu edhe klimatike kanë mundësuar kalimin nga pemtaria ekstensive në atë intensive. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014 kultivimi i kumbullës zë sipërfaqën më të madhe me 25 hektarë. Prodhimtaria më e lartë i takon kultivimit të mollës dhe dardhës me afër 10000 kg për hektarë.

Tabela 40. Prodhimtaria e Perimeve

Pema	Sipërfaqja (ne hektarë)	Prodhimtaria (kg/hektarë)
Molla	6	8000 - 10000
Dardha	4	10000
Kumbulla	25	9000
Dredhëza	2	3000
Mjedra	4	6000 - 7000

Komuna e Podujevës ofron mundësi të mira për zhvillimin e blegtorisë. Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014 në komunën e Podujevës, në gjithsej 454 ferma janë 8760 krerë shtazë. Edhe pse kjo paraqet një numër të konsiderueshëm, gjendja në këtë degë bujqësore mund të jetë më e mirë duke marrë parasysh kushtet e favorshme që ekzistojnë.

Tabela 41 Prodhimtaria e Perimeve


Kafsha	Nr. i fermave	Numri i krerëve
Lopë	374	3740
Dele	70	4500
Dhi	10	520

²² www.Panoramia.com

Gjithashtu pylltaria është pjesë e veprimtarive primare, prandaj ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe në veçanti në zhvillimin e bujqësisë. Komuna e Podujevës ka një fond të konsiderueshëm të pyjeve. Bazuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal (SZHEL) 2011 – 2014, 29,050 hektarë të territorit të komunës është e mbuluar me pyje. Fondi i drurit industrial është i vogël dhe kryesisht fondi ekzistues përdoret për nevoja të djegies ose ngrohjes për banorët lokal si dhe për nevojat e ndërtimitarisë dhe më pak për punimin e artizanateve dhe veglave të punës.

Bujqësia si degë ekonomike shumë më rëndësi në komunën e Podujevës ka një traditë të mirë dhe kjo mund të kuptohet edhe nga numri i bizneseve të regjistruara dhe numri i të punësuarve në këtë sektorë i cili si duket është përcjellë me transformime të nevojshme.

Madhësia e parcelave në komunën e Podujevës është mbi mesataren e Kosovës. Sipërfaqja e tokës bujqësore është 33,295 hektarë me gjithsej 16244 parcela, ku mesatarja e madhësisë së parcelës është 1.65 ha²³.




Grafiku 24. Parcelizimi i tokave bujqësore

Nga grafiku i mësipërm kuptojmë se numri më i madh i parcelave i takojnë intervalit grupor të madhësisë 0.00-0.25 ha me pjesëmarrje 72.65%, pastaj intervali grupor i parcelave të madhësisë 0.25-0.50 ha përbën 17.14% të parcelave të gjithmbarshme dhe 0.50-1.00 ha përbën 7.21% të numrit të përgjithshëm të parcelave në komunën e Podujevës. Nga këto të dhëna kuptohet se 97% e parcelave në komunën e Podujevës janë të madhësisë deri në 1.00 ha, që tregon për një shkallë të lartë të parcelizimit në këtë komunë. Kurse pjesa tjetër janë të madhësisë mbi 1.00 ha dhe përbëjnë 3% të parcelave të gjithmbarshme në komunë. Numri i madh i pronave që kanë sipërfaqe të vogël mbetet njëra ndër sfidat kryesore për zhvillimin e bujqësisë në komunën e Podujevës.

Ne bazë të shënimeve të Agjensionit mbi Regjistrimin e Bizneseve për vitin 2015, Bujqësia si sektor shumë i rëndësishëm ekonomik në komunën e Podujevës përbën 4.4% të bizneseve dhe 3.9% të të punësuarve.

²³ AKK, Shfrytëzimi i tokës sipas komunave, 2002.




Grafiku 25. Biznesi dhe të punësuarit në bujqësi

Nga viti 2002 deri në vitin 2015 pjesëmarrja e bujqësisë apo agrobiznesit në raport me bizneset në tërësi është rritur prej 1.84%, sa ishte në vitin 2002, në 4.12% në vitin 2009 dhe në 4.36% në vitin 2015, ndërsa numri i të punësuarve ka shënuar zvogëlim krahasuar e vitin 2002. Grafiku tregon një indikator për transformime pozitive në rrafshin afatgjatë të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin modern të bujqësisë dhe sidomos të agrobiznesit. Nga grafiku shihet se numri i të punësuarve në vitin 2002 ka qenë më i madh se sa që është në vitin 2015 dhe ky indikator teoritikisht shpjegon se me avancimin profesional dhe tekniko-teknologjik në sektorin e bujqësisë edhe numri i të punësuarve ka rënë për shkak të zëvendësimit nga teknologjia.

1.7.3 Tregtia

Tregtia është një nga sektorët ekonomik shumë të fuqishëm dhe pas çlirimit të Kosovës është zhvilluar shumë shpejt dhe është bërë sektori më i zhvilluar ekonomik në Kosovës. Gjithashtu edhe në komunën e Podujevës, pas potencialit të madh bujqësorë, tregtia është sektori më i zhvilluar dhe biznesi më i parapëlqyer për shkak se ende mbetet i kushtëzuar nga norma e ulët e investimeve kapitale në biznes, mundësia më e lehtë e kontrollit të kapitalit sipas qasjes direkte, tradita, etj.

Nga të gjitha bizneset që janë aktive në komunën e Podujevës, tregtia zë vendin kryesor me rreth 45% të pjesëmarrjes në biznese dhe mbi 36% të të punësuarve në biznese. Numri më i madh i ndërrmarjeve tregtare dhe numri i të punësuarve në tregti i përkasin tregtisë me pakicë me mbi 66% të pjesëmarrjes së ndërrmarjeve tregtare dhe mbi 57% të të punësuarve në sektorin e tregtisë.



Grafiku 26. Bizneset tregtare


Sa i përket shpërndarjes së bizneseve tregtare në vendbanimet e komunës së Podujevës, është e kuptueshme se qendra më atraktive e vendosjes së tyre është qendra komunale-Podujeva. Qyteti i Podujevës me një pjesëmarrje prej mbi 84% të bizneseve tregtare dhe 86% të të punësuarve në tregti konsiderohet si qendër tregtare e komunës. Përqendrimi i bizneseve në qytetin e Podujevës rrjedh nga fakti se në këtë qytet ekziston e gjithë infrastruktura adekuate për funksionimin e një biznesi, duke përfshirë; shërbimet bankare, administratën, transportin, frekuentimi shumë dimenzional, koncentrimi më i madh i popullatës, fuqi punëtore e kualifikuar etj. Me të tjera fjalë, nëse do ta kishim këtë lloj të infrastrukturës edhe në vendbanime të tjera, koncentrimi i bizneseve do të ishte më i balancuar dhe më i shpërndarë.

Bizneset tregtare janë prezente edhe në vendbanimet tjera të komunës së Podujevës, por pjesa dërrmuese dhe më aktive e tyre shtrihen përgjatë rrugëve të karakterit nacional, rrugëve të asfaltuara dhe vendbanimeve me popullatë më të mëdha.

1.7.4. Turizmi

Komuna e Podujevës karakterizohet me potenciale të shumta të zhvillimit të turizmit vikendor dhe rural. Gjeomorfologjia e territorit të komunës së Podujevës e karakterizuar me dy masive malore, Kopaonikun dhe Gollakun, si dhe fushëgropa e Llapit së bashku me lumin Llap dhe liqenin e Batllavës i japin vlerë konkurruese komunës së Podujevës në Kosovë. Liqeni i Batllavës është liqeni më i madh në Kosovë dhe furnizon me ujë të pijshëm tri komua: Podujevën, Prishtinën dhe Obiliqin.


Gjatë sezonit veror ky liqen tërheq mijëra vizitorë të cilët vijnë për pushime në hapësirat përgjatë tij, ku në shumicën e rasteve manifestohet edhe me krijimin e problemeve të caktuara mjedisore. Në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 17/127, të datës 24.04.2013, është bërë përcaktimi i zonave të mbrojtura dhe masave mbrojtëse të burimit ujqor sipërfaqësor të Akumulimit të Batllavës.



Liqeni i Batllaves²⁴

Gjithashtu, edhe hoteleria është mjaft e zhvilluar, ku në komunën e Podujevës janë 364 biznese me 611 të punësuar. Pjesëmarrja e hotelerisë ndaj numrit të përgjithshëm të bizneseve në komunën e Podujevës është mbi 9%, kurse numri i të punësuarve në hoteleri përfaqëson rreth 8.5% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Shtrirja e bizneseve hoteliere është e shprehur kryesisht përgjatë rrugëve të karakterit nacional (nacionale – regjionale), rrugëve të asfaltuara si dhe objekteve dhe peizazheve tjera me atraktivitet të veçuar.

²⁴ www.Panoramia.com



Grafiku 27. Bizneset hoteliere

Rëndësi dhe vlera tjera turistike në komunën e Podujevës janë edhe objektet ose monumentet e trashëgimisë kulturore, të cilat janë të krijuara në periudha të ndryshme historike. Gjithashtu vlerësohet edhe trashëgimia më e re që ka vlerë të veçantë si: Kulla e dëshmorit të kombi Zahir Pajaziti si dhe shumë lapidare të të rënëve për çlirimin e Kosovës, të cilat monumente e pasqyrojnë ofertën turistike në këtë komunë.



Kulla e Dëshmorit të Kombit Zahir Pajaziti²⁵

²⁵ www.Panoramia.com



Përmendorja e Kaqndollit²⁶

1.7.5 Industria

Industria është njëra nga degët e rëndësishme ekonomike e cila luan një rol shumë të fuqishëm në zhvillimin e gjithmbarshëm të një vendi. Në kohën e ish-Jugosllavisë komuna e Podujevës bënte pjesë në “Regjionin Industrial të Kosovës Veriore” i cili përbëhej prej shtatë komunave: Leposaviqi, Mitrovica, Skenderaj, Glogovci, Vushtrria, Prishtina dhe Podujeva. Ky regjion karakterizohej me zhvillimin e metalurgjisë me ngjyra, prodhimi dhe përpunimi i qymyrit, prodhimi i energjisë elektrike, industria e tekstilit, industria e materialit ndërtimorë, etj²⁷. Në këtë regjion komuna e Podujevës ishte komuna me shkallë më të ulët të zhvillimit të industrisë dhe derisa komunat e tjera kishin rreth 14,000 të punësuar në degë të ndryshme të industrisë, komuna e Podujevës kishte rreth 1,000 të punësuar²⁸. Ky fakt tregon që edhe procesi i privatizimit të ndërmarrjeve industriale pas çlirimit të Kosovës është përcjellë me më pak telashe se sa në komunat fqinje.


Pas çlirimit të Kosovës zhvillimi i sektorit sekondar apo industrisë është përcjell kryesisht me zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme edhe në fushën e prodhimit. Bazuar në shënimet e Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve, në vitin 2015 në Podujevë janë të regjistruara gjithsej 740 ndërmarrje industriale me 2318 punëtorë, që paraqet 19% të numrit të përgjithshëm të bizneseve të regjistruara dhe mbi 30% të të punësuarve. Kjo tregon se sektori industrial krijon numër të madh të vendeve të punës dhe duhet t’i kushtohet rëndesi e vecantë.

²⁶ www.Panoramia.com

²⁷ Prof Dr. Asllan Pushka; Aspektet Gjeosociale dhe Gjeoekonomike në Kosovë, faqe 315.

²⁸ Prof Dr. Asllan Pushka; Aspektet Gjeosociale dhe Gjeoekonomike në Kosovë, faqe 295.

Numrin më të madh të bizneseve industriale e përbejnë bizneset në sektorin e industrisë përpunuese me mbi 50% të bizneseve dhe mbi 54% të të punësuarve të sektorit të industrisë.



Grafiku 28. Bizneset Industriale

Sektori i prodhimit zhvillohet me vështirësi jo vetëm në komunën e Podujevës por edhe në Kosovë. Njëra nga arsyet është se prodhimi nuk garantohej si dhe masat stimuluese nuk janë të mjaftueshme për këtë sektorë në mënyrë që të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme. Me fjalë të tjera, problematika nuk ndalet në politikat e qeverisjes lokale të komunës së Podujevës, por problematika është e karakterit nacional apo e politikave nacionale të Kosovës.

1.7.6 Minjerat dhe xehtetaria

Komuna e Podujevës është e pasur me resurse të shumta minerare dhe prej tyre më të njohura janë mineralet që përdoren në industrinë e ndërtimit si: Silikatet (sh), Karbonatet (ch), Graveli (gs), Kley (cl), pastaj, Nikeli (Ni), Plumbi (Pb), Zinku (Zn) dhe Alumini (Al)²⁹.


Sa i përket sasisë së këtyre rezervave nuk ekzistojnë të dhëna të sakta, kurse sa i përket shtrirjes së tyre mund të themi se pjesa dërrmuese e tyre shtrihet në anën jug-lindore dhe veri-perëndimore të komunës së Podujevës. Sigurisht që investimet në sektorin e minierave janë të kushtueshme dhe mund të themi se qeveria lokale as që mund të imagjinoj tash për tash eksploatimin e rezervave minerare në thellësi. Gjithashtu edhe qeveria qendrore ndodhet në të njëjtën gjendje financiare, kurse investitorët mund të jenë të interesuar pasi të kenë informacione të sakta në lidhje me rezervat, si dhe atëherë kur kushtet tekniko-ligjore të jenë më të favorshme. Vlen të theksohet se një pengesë e

²⁹ Mineral Map of Kosova 1:200,000; KPMM ose ICMM.

mundshme mund të jetë se këto rezerva shtrihen kryesisht përgjatë vijës kufitare me shtetin fqinjë, Serbinë. Ndërsa sa i përket resurseve minerare sipërfaqësore, disa prej tyre veç janë duke u shfrytëzuar nga kompanitë private vendore. Numri i gurthyesve në komunën e Podujevës është tre, dhe dy prej tyre ndodhen në afërsi të vendbanimit Metehi ndërsa një në Popovë.

Veprimtaritë e eksploatimit minerarë ushtrohen edhe nga 7 operator ilegal të cilët veprimtaritë e tyre i kanë të lokalizuara kryesisht në këto vendbanime, si; Repe, Podujevë, Majac, Lluzhan, Turiqec dhe Batllavë (2). Këta operator duhet që ti nënshtrohen legalizimit ose të mbyllët veprimtaria e tyre, por gjithsesi menaxhimi dhe monitorimi i këtyre aktiviteteve në komunën e Podujevës është çështje së cilës duhet kushtuar vëmendje e veçantë.

Harta 22. Resurset minerare



1.8. Infrastruktura

1.8.1 Infrastruktura Rrugore

Pozita gjeografike e komunës së Podujevës në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme nacionale, i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas, ku në nivel të komunës administrative janë të shtrira gjithsejtë 1225km rrugë të të gjitha kategorive. Nëse analizohet niveli i mbulshmërisë së sipërfaqes së komunës me rrugë të të gjitha kategorive del se ato janë të shtrira në gjithsejtë 497.7ha. Komuna e Podujevës karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Shtrirja e rruges nacionale Prishtinë – Merdar, kryesisht në pjesën qendrore dhe jug-lindore të komunës i'a ka shtuar rëndësinë kësaj hapësirë.

Në komunën e Podujevës ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve nacionale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Podujevës përbehet nga:


- Rrugët nacionale - M25 (Prishtinë - Merdarë)
- Rrugë regjionale - (R129 Podujevë-Mitrovicë, R128 Podujevë-Vushtri, R126 Podujevë-Pollatë, 125 Podujevë-Orllan, R127 Podujevë - Perpelac)
- Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 78 komuna kadastrale me gjithsej 78 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)
- Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).

Tabela 42. Rrjeta e rrugëve

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia km	%
1	Rrugë nacionale	18.8	1.53
2	Rrugë regjionale	80	6.53
3	Rrugë lokale	370.1	30.21
4	Rrugë e pa kategorizuar	756.3	61.73
Total		1225	100.00

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 1225 km, sa janë në komunën e Podujevës, rrugë nacionale janë 18.8km (1.53%), rrugë regjionale 80km (6.53%), rrugë lokale 370.1 km (30.21%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 756.3km (61.73%).

Duke iu referuar analizave të bëra ne nivel të komunës, janë nxjerrë edhe sipërfaqet e mbuluara me rrugë dhe aktivitete të tjera përcjellëse sipas kategorisë së tyre. Në tabelën në vijim do të paraqesim shtrirjen e rrugëve sipas gjatësisë ne km dhe sipërfaqen e tyre në ha.




Grafiku 29. Gjatësia e rrugëve sipas kategorive

Tabela 43. Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia	%	A	B	Total
		km				ha
1	Rrugë nacionale	18.8	1.53	16.54	4.51	21.05
2	Rrugë regjionale	80	6.53	47.44	14.23	61.67
3	Rrugë lokale	370.1	30.21	166.4	63.1	229.5
4	Rrugë e pa kategorizuar	756.3	61.73	185.48	0	185.48
Total		1225	100	415.86	81.84	497.7

A - sipërfaqja të mbuluara me asfalt dhe zhavorr - ha

B - Sipërfaqja që shfrytëzohen për sinjalizim dhe hapësira tjera - ha



Grafiku 30. Sipërfaqja në ha e rrugëve sipas kategorive

Bazuar në grafikun e lartëshënuar del se nga totali i përgjithshëm i sipërfaqes së rrugëve 497.7 ha sa janë në komunën e Podujevës, rrugë nacionale janë gjithsej 21.05 ha (4.23%), rrugë regjionale 61.67 ha ose (12.4%), rrugë lokale 229.5ha (46.1%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 185.48 ha ose (37.27%).

1.8.1.1 Rruga Nacionale/Magjistrale M2

Nëpër territorin e komunës së Podujevës kalon rruga e rëndësishme në nivel nacional e cila e lidhë Republikën e Kosovës dhe Republikën e Serbisë apo aksin rrugor Prishtinë – Podujevë – Merdar – Kurshumli e cila cilësohet si rrugë nacionale. Rruga nacionale Prishtinë–Merdarë (M25) kalon në pjesën qendrore dhe jug –lindore të komunës, e cila e përshkon atë në një gjatësi prej 18.8 km, si dhe lidhë 11 komuna kadastrale duke përfshirë edhe zonën urbane. Komunat kadastrale (vendbanimet) në të cilat kalon rruga nacionale M25 janë: Lupç i Poshtëm, Shakovicë, Lluzhan, Penuhë, Kunushec, Gllamnik, Llapashticë e Poshtme, Podujevë, Shtedim, Livadh, Merdar.

Rruga nacionale M25 është një arterie e fuqishme e transportit nacional dhe ndërkombëtarë për qarkullimin e mallrave dhe njerëzve, në të cilën është funksionale edhe pika kufitare dhe doganore e Merdarit. Pozita e mirë gjeografike i ka mundësuar kësaj komune lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor e cila i mundëson Kosovës një lidhjes selektive me korridorin e tetë nëpërmjet Nishit. Gjithashtu e karakterizon atë me komunikacion mjaft të dendur, si në transportin e mallrave po ashtu edhe atë të udhëtarëve. Rruga nacionale e cila shtrihet në territorin e komunës është e asfaltuar dhe menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës. Sipërfaqja e tokës e cila shfrytëzohet nga aktivitetet e rrugës nacionale është gjithsej 16.54 ha. Ndërsa sipërfaqe që janë të mbuluara me asfalt dhe aktivitete të tjera (sinjalizim) janë gjithsej 21.05 ha. Gjendja e rrugës nacionale në komunën e Podujevës, në përgjithësi është e mirë.

1.8.1.2 Rrugët Regjionale

Rrugët e kësaj kategorie i mundësojnë komunës së Podujevës lidhje shumë të mira në nivel regjional dhe kanë shtrirje në katër drejtime, me gjatësi prej 80 km. Gjithashtu, këto rrugë janë të asfaltuara dhe menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës:

- Rruga R-126 , Batllavë Podujevë – Pollatë me gjatësi prej 28.13 km
- Rruga R-125, Lluzhan - Batllavë – Orllan –deri në kufi me Serbi me gjatësi prej 25.31km
- Rruga R127 , Llapashticë e Poshtme - Podujevë - Perpelac me gjatësi prej 14.67km
- Rruga R128, Podujevë – Llapashticë e Epërme me gjatësi prej 3.38 km
- Rruga R129 , Bajçinë – deri në kufirin e KK të Mitrovicës me gjatësi prej 7.74km

Rruga regjionale R126 Batllavë – Podujevë – Pollatë i mundëson komunës së Podujevës lidhje të mira me rrugën nacionale Prishtinë – Merdar dhe rrugët regjionale R129, R125. Kjo rrugë i lidhë vendbanimet mjaft të rëndësishme si (Batllavë, Shajkoc, Sveqël, Surkish Podujevë, Obrancë, Peran, Bradash, Bajçinë, Dobërdol, Zakut, Pakashticë e Poshtme, skaji lindor i komunës kadastrave Revuq, Kërpimeh, skaji i komunës kadastrale Pakashticë e Epërm, Metehi, Repë dhe Pollatë). Kjo rrugë ka gjatësi 28.13 km.

Rruga regjionale R125, – krijon lidhje të mira në mes të Magjistralsë Prishtinë – Podujeve dhe pjesës lindore të komunës së Podujevës e deri të zona kufitare me Serbinë, si dhe u mundëson vendbanimeve të kësaj hapësirë që të kenë qasje të drejtpërdrejtë në rrugë kryesore. Kjo rrugë ka gjatësi prej 25.31 km, dhe i prekë komunat kadastrave të: Shakovicë, Llugë, Kaçybeg, Radujevc, Batllavë, Barainë, Orllan, Kalaticë dhe Bërvenik (Kufi me Serbinë).

Rruga regjionale R127, Llapashticë e Poshtme - Podujevë – Përpelac (Kufi me Serbinë) - shtrihet kryesisht në pjesën qendrore të komunës me gjatësi prej 14.67 km. Vendbanimet të cilat preken direkt nga kjo rrugë janë: Llapashticë e Poshtme, Llapashticë e Eperme, Obrancë, Podujevë, Letanc, Dumnicë e Poshtme, Përpellac.

Rruga regjionale R129, Bajçinë – Kufi me komunën e Mitrovicës (Bajgorë) - Krijon lidhje të mira në mes 2 komunave (Podujevës dhe Mitrovicës), shtrihet në pjesën perëndimore të komunës së Podujevës me gjatësi prej 7.74 km. Vendbanimet të cilat preken direkt nga kjo rrugë janë: Bajçinë dhe Dobratin.

Rruga regjionale R128 – kjo rrugë shtrihet në komunën kadastrale të Llapashticës së Epërme me gjatësi 3.38 km. Në pjesën lindore lidhet me rrugën regjionale R127.

Numri total i vendbanimeve që kanë qasje në rrugët nacionale dhe regjionale është 38, që d.m.th. se 48.7% e tyre kanë qasje direkte, ndërsa 51.3 % e vendbanimeve nuk kanë qasje direkte në rrugët nacionale dhe regjionale.

Tabela 44. Venbanimet me qasje në rrugët nacionale dhe regjionale

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve
1	Gllamnik	3794
2	Kunushec	204
3	Livadicë	296
4	Lupq i Epërm	275
5	Llapashticë e Poshtme	2701
6	Lluzhan	757
7	Merdar	188
8	Penuhë	539
9	Podujevë	23453
10	Shakovicë	619
11	Shtedim	1148
12	Bajçinë	2358
13	Barainë	98
14	Batllavë	2334
15	Bërvenik	72
16	Bradash	2567
17	Dobërdol	1106
18	Dobratin	1576
19	Dumnicë e Poshtme	2975
20	Kaçybeg	494
21	Kalaticë	89

22	Kërpimeh	755
23	Letanc	2080
24	Llapashticë e Epërme	2363
25	Llugë	1404
26	Metehi	1251
27	Obrançë	3092
28	Orllan	844
29	Pakashticë e Poshtme	292
30	Peran	1241
31	Përpellac	0
32	Pollatë	239
33	Radujevc	0
34	Repë	484
35	Sfeçël	1739
36	Surkish	1091
37	Shajkoc	1504
38	Zakut	453
TOTALI		66475
TOTALI I POPULLSISE		88499
% E POPULLSISE ME DALJE NE RRUGEN NACIONAL E REGJIONALE		75%

Numri i banorëve që lidhen me rrugët nacionale e regjionale dhe kanë qasje direkte në to është 66475, ose 75% e totalit të popullsisë së komunës. Pra, pjesa dërmuese e popullsisë kanë qasje në këto dy kategori të rrugëve. Kjo nga fakti se ato vendbanime që shtrihen përgjatë këtyre dy kategorive të rrugëve janë kryesisht vendbanime me numër më të madh të popullsisë në nivel komune, pra janë më atraktive për jetesë.


1.8.1.3 Rrugët Lokale

Rrugë lokale konsiderohen rrugët të cilat i lidhin të gjitha vendbanimet e komunës duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme të cilat mundësojnë lidhje të mira me to. Gjithsejtë rrugë lokale në komunën e Podujevës janë 370.1 km ose 30.2% nga totali i përgjithshëm i rrugëve.

1.8.1.4 Rrugë të pa kategorizuara

Rrugë të pa kategorizuara - konsiderohen të gjitha sipërfaqet të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të komunave kadastrale. Gjithsej rrugë të kësaj kategorie në tërë territorin e komunës së Podujevës janë 756.3 km ose 61.73%, e totalit të rrugëve. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.

Harta 23. Rrjeti i rrugëve



1.8.1.5 Gjendja e rrugëve në komunën e Podujevës

Nga të gjitha rrugët të cilat e përbëjnë rrjetin e rrugëve të komunës me gjatësi prej 1225 km, rrugë nacionale janë 18.8 km (1.53 %), rrugë regjionale 80 km (6.53%), rrugë lokale 370.1 km ose (30.21%) dhe rrugë të pa kategorizuara 756.3 km (61.73%). Dy kategoritë e para të rrjetit të rrugëve

janë të asfaltuara dhe mirëmbahen nga Ministria e Infrastrukturës. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara të këtyre dy kategorive në komunën e Podujevës është 98.8 km (8.06%). Ndërsa rrugët lokale të komunës të cilat kanë shtrirje prej 370.1 km (30.21%) nga të cilat 257.7 km (69.6%)³⁰ e tyre janë të asfaltuara. Rrugët e kategorisë së katërt (të pa kategorizuara) nuk janë ta asfaltuara dhe kanë shtrirje prej 756.3 km (61.73%). Tabela në vijim do të paraqes statusin e rrugëve sipas kategorisë.

Tabela 45 Kategorizimi i rrugëve në komunën e Podujevës

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia km	%	Rrugë të asfaltuara	%	Gjendja e rrugës
1	Rrugë nacionale	18.8	1.53	18.8	100.00	Mesatarisht e mirë
2	Rrugë regjionale	80	6.53	80	100.00	Mesatarisht e mirë
3	Rrugë lokale	370.1	30.21	257.7	69.6	E mirë
4	Rrugë e pa kategorizuar	756.3	61.73	0	0.00	Jo e mirë
Total		1225	100	175.3	14.3 %	

Nga tabela shihet se nga gjithsej 1225 km, rrugë sa ka në komunën e Podujevës, vetëm 175.3 km (14.3 %) e tyre janë të asfaltuara. Në tabelën në vijim do të paraqesim vendbanimet që kanë rrugë të asfaltuara.

Tabela 46. Vendbanimet me rrugë të asfaltuara në komunën e Podujevës

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve
1	Bajçinë	2358
2	Ballofcë	2131
3	Barainë	98
4	Batllavë	2334
5	Bellopojë	1412
6	Bradash	2567
7	Brainë	268
8	Dobërdol	1106
9	Dobratin	1576
10	Dumnicë e Epërme	497
11	Dumnicë e Poshtme	2975
12	Dumosh	1207
13	Dyz	573
14	Gllamnik	3794
15	Godishnjak	353
16	Halabak	623
17	Hërticë	741
18	Kaçybeg	494
19	Kunushec	204
20	Letanc	2080

³⁰ Të dhënat janë nga drejtoria e urbanizmit e komunes se Podujevës

21	Livadicë	296
22	Lladoc	821
23	Llapashticë e Epërme	2363
24	Llapashticë e Poshtme	2701
25	Llaushë	980
26	Llugë	1404
27	Lluzhan	757
28	Lupq i Epërm	275
29	Lupq i Poshtëm	2113
30	Majac	1622
31	Merdar	188
32	Metehi	1251
33	Murgull	135
34	Obrancë	3092
35	Orllan	844
36	Pakashticë e Epërme	732
37	Pakashticë e Poshtme	292
38	Penuhë	539
39	Peran	1241
40	Përpellac	0
41	Podujevë	23453
42	Pollatë	239
43	Radujevc	0
44	Repë	484
45	Sfeçël	1739
46	Shajkoc	1504
47	Shakovicë	619
48	Shtedim	1148
49	Siboc i Epërm	961
50	Siboc i Poshtëm	454
51	Surkish	1091
52	Tërnavë	853
53	Turuçicë	109
54	Velikarekë	544
55	Zakut	453
56	Zhiti	98
TOTALI		82786
TOTALI I POPULLSISE		88499
% E POPULLSISE ME RRUGE TE ASFALTUARA		94%

Nga tabela mund të shihet se nga gjithsej 78 vendbanime (sipas komunave kadastrave) sa ka në komunën e Podujevës, 56 prej tyre kanë rrugë të asfaltuara, përderisa 22 vendbanime nuk kanë rrugë të asfaltuara. Të gjitha rrugët qofshin ato të asfaltuara apo ato të pa asfaltuara janë të dëmtuara dhe niveli i dëmtimit të tyre është i ndryshëm. Duke u nisur nga parimi i pjesëmarrjes së popullsisë me

qasje në rrugë të asfaltuara mund të konstatojmë se nga 88499 banorë sa ka në komunën e Podujevës, 82786 banorë ose (94%) e popullsisë kanë qasje në rrugë të asfaltuar, çka do të thotë se pjesëmarrja e popullsisë në rrugë të asfaltuara është në gjendje të mirë e cila e tregon angazhimin e institucioneve qeveritare dhe atyre lokale në përmisimin e infrastrukturës rrugore si parakusht i zhvillimit ekonomik.

1.8.2. Rrjeti hekurudhor


Rrjeti hekurudhor në komunën e Podujevës është i karakterit nacional dhe ka shtrirje në pjesën qendrore të komunës së Podujevës, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit magjstral i cili lidhë dy shtete fqinjë (Republikën e Kosovës dhe Serbinë). Kjo linjë hekurudhore që kalon në pjesën qendrore të komunës së Podujevës, është një binarësh me gjatësi prej 22 km. Sigurisht se shtrirja e rrjetit hekurudhor e nivelit nacional ka një rendësi shumë të madhe për komunën, si dhe ka ndikua pozitivisht në zhvillimin socio-ekonomik të saj. Komunitat kadastrale të cilat preken nga rrjeti hekurudhor, përkatësisht kanë qasje direkte në këtë rrjet, janë gjithsejtë 10, duke filluar nga (Lupç i Poshtëm, skajin lindor të Majacit, Sallabajë, Lluzhan, Penuhë, Siboc i Epërm, Surkish, Podujevë, Livadicë, dhe Merdar).

Tabela 47. Pjesëmarrja e vendbanimeve dhe e popullatës në rrjetin hekurudhor

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve
1	Dumnicë e Poshtme	2975
2	Lluzhan	757
3	Lupç i Poshtëm	2113
4	Majac	1622
5	Merdar	188
6	Penuhë	539
7	Podujevë	23453
8	Sallabajë	506
9	Siboc i Epërm	961
10	Surkish	1091
TOTALI		34205
TOTALI I POPULLSISE		88499
% E POPULLSISE ME DALJE NE RRUGEN NACIONALE DHE REGJIONALE		39%

Nga tabela mund të konstatojmë se nga totali i përgjithshëm i popullsisë së komunës vetëm 34205 banorë apo 39% e popullsisë kanë qasje direkt në hekurudhë.

Harta 24. Rrjeti hekurudhor



1.8.3 Urat

Të gjitha urat e identifikuara në territorin e komunës së Podujevës, i takojnë dy kategorive të komunikacionit: Komunikacionit rrugor (96 ura) dhe komunikacionit hekurudhor (6 ura)

1.8.3.1 Urat në komunikacionin rrugor

Nga 96 ura të cilat janë të ndërtuara në rrjetin rrugor të komunës, 6 prej tyre shtrihen në rrugë nacionale dhe 9 në rrugë regjionale. Urat e tjera shtrihen në rrugë lokale dhe të pa kategorizuara, të cilat kanë gjatësi prej 5 deri 20m.


- Urat mbi nacionale - Konfiguracioni i terrenit ka imponuar që në gjithsej 18.8 km rrugë nacionale të ndërtohen 6 ura mjaft të rëndësishme për komunikacionin e rrugës nacionale (Lluzhan 2 , Podujevë 4,). Urat kryesore dhe më të rëndësishme mbi këtë kategori të rrugëve është ajo në dalje të zonës urbane, përkatësisht në pjesën jugore të zonës urbane (mbi lumin Llap me gjatësi prej 53 m, pastaj ajo në pjesën më jugore të komunës kadastrave të Lluzhanit, përkatësisht në kufirin kadastral të komunës kadastrale të Lluzhanit me Shakovicën, me gjatësi prej 80m. Të dy këto ura të rëndësishme janë të vendosura mbi lumin Llap. Urat e tjera kryesisht konsiderohen të vogla me gjatësi prej 1 deri 10m dhe shtrihen në rrugët lokale dhe të pa kategorizuara. Në përgjithësi janë në gjendje mesatarisht të mirë, me përjashtim të disa urave të cilat karakterizohen me gjerësi të vogël dhe të pa mjaftueshme.
- Urat mbi rrugë regjionale – janë të vendosura në të dy drejtimet e rrugëve regjionale, njëra është e vendosur në rrugën regjionale Pollatë – Podujevë (përkatësisht në komunën kadastrave të Repës me gjatësi prej 40 m, mbi lumin (Llap) dhe tjetra në komunën kadastrave të Bajçinës me 22 metra, dhe 2 ura në rrugën regjionale Lluzhan – Batllavë- Orllan (ura në komunën kadastrave të Shakovicës me gjatësi prej 32 m, mbi lumin Batllava dhe ajo në komunën kadastrale të Orllanit me gjatësi prej 36 m, mbi një pjesë të Liqenit Batllavë).

1.8.3.2 Urat në komunikacionin hekurudhor

Në rrjetin hekurudhor të komunës së Podujevës janë të ndërtuara gjithsejtë 6 ura prej të cilave 1 në Lupç të Poshtëm, 2 në Lluzhan,, 1 në Siboc i Epërm, 1 në Podujevë, 1 në Livadhi. Prej gjithsejtë 6 urave mbi rrjetin hekurudhor, 2 janë të ndërtuar mbi lumin Llap, dy mbi Nacionale dhe 2 ura në rrjedhat tjera. Urat më të rëndësishme mbi rrjetin hekurudhor janë ato të ndërtuara mbi nacionale, në periferi të zonës urbane, me gjatësi prej 25m, dhe mbi lumin Llap në Lupç të Poshtëm me 55 metra gjatësi.

Karakteristikë e komunikacionit hekurudhor është tuneli afër Merdarit (tuneli në komunën kadastrale të Merdarit me gjatësi prej 1500 m në rrjetin hekurudhor).


Harta 25. Rrugët dhe urat në komunën e Podujevës



1.8.4. Transporti publik

Në nivel lokal organizohet nëpërmjet të autobusëve, kombi-busëve dhe automjeteve të tjera të transportit dhe është mjaft mirë i organizuar. Shikuar nga numri i vendbanimeve që kanë transport publik, nga 78 vendbanime sa ka komuna e Podujevës, 40 prej tyre kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve, 21 nëpërmjet të kombi-busëve dhe 17 vendbanime nuk kanë transport publik.

Harta 26. Vendbanimet me tranport publik



Nga harta dhe tabela në vijim paraqiten vendbanimet të cilat kanë qasje në transportin publik sipas numrit të banorëve.

Tabela 48. Qasja në transportin publik në komunën e Podujevës

Nr.rend	Vendbanimi	Lloji i Transportit
1	Bajcine	Autobus
2	Ballofc	Minibus
3	Baraine	Pa transport publik
4	Batlave	Autobus
5	Bellopoje	Autobus

6	Bervenik	Autobus
7	Bllate	Pa transport publik
8	Bradash	Autobus
9	Braine	Pa transport publik
10	Brece	Minibus
11	Burice	Minibus
12	Doberdol	Autobus
13	Dobratin	Autobus
14	Dumnice e Eperme	Minibus
15	Dumnice e Poshtme	Autobus
16	Dumosh	Autobus
17	Dvorishte	Minibus
18	Dyz	Autobus
19	Gerdoc	Minibus
20	Gllamnik	Autobus
21	Godishnjak	Pa transport publik
22	Halabak	Autobus
23	Hertice	Autobus
24	Kacibeg	Autobus
25	Kalatice	Pa transport publik
26	Kerpimeh	Autobus
27	Krushevice	Pa transport publik
28	Kunushec	Minibus
29	Letanic	Minibus
30	Livadhia	Autobus
31	Lladofc	Minibus
32	Llaspashtice e Eperme	Autobus
33	Llaspashtice e Poshtme	Pa transport publik
34	Llaushe	Minibus
35	Lluge	Autobus
36	Lluzhan	Autobus
37	Lupc i Eperm	Autobus
38	Lupc i Poshtem	Minibus
39	Majac	Autobus
40	Merdar	Autobus
41	Metehi	Autobus
42	Metergoc	Pa transport publik
43	Mirofc	Pa transport publik
44	Muhazob	Pa transport publik

45	Murgulle	Minibus
46	Obrance	Minibus
47	Orllan	Autobus
48	Pakashtice e Eperme	Minibus
49	Pakashtice e Poshtme	Autobus
50	Penuhe	Autobus
51	Peran	Autobus
52	Perpellac	Autobus
53	Podujeve	Autobus
54	Pollate	Autobus
55	Popove	Autobus
56	Potok	Pa transport publik
57	Radujevc	Autobus
58	Rakinice	Pa transport publik
59	Recice	Pa transport publik
60	Repe	Autobus
61	Revuq	Minibus
62	Sallabaje	Pa transport publik
63	Sfeci	Autobus
64	Shajkofc	Autobus
65	Shakovice	Autobus
66	Shtedim	Autobus
67	Siboc i Eperm	Minibus
68	Siboc i Poshtem	Minibus
69	Sllatine	Minibus
70	Surdull	Minibus
71	Surkish	Autobus
72	Sylevice	Pa transport publik
73	Ternave	Autobus
74	Terrnavice	Pa transport publik
75	Turucice	Pa transport publik
76	Velikareke	Minibus
77	Zakut	Autobus
78	Zhiti	Minibus

Duke iu referuar tabelës së lartshënuar konstatohet se afro 94% e popullsisë së Podujevës kanë transport publik të organizuar nëpërmjet të autobusëve³¹ ose mini-busëve dhe vetëm rreth 6% e qytetarëve të komunës së Podujevës nuk kanë qasje në transport publik.

³¹ Të dhënat janë nga kuvendi komunal i Podujevës

Nga tabela mund të vërehet se transporti publik në komunën e Podujevës është mjaft mirë i organizuar. Të gjitha vendbanimet të cilat shtrihen në pjesën më të frekuentuar të komunës kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve dhe kombi-busve, ndërsa pa transport publik janë të gjitha ato vendbanime të cilat janë në zona të thella të komunës, ku përthyeshmëria e relievit është mjaft e madhe, si dhe numri i popullsisë së atyre vendbanimeve është mjaft i vogël.

1.8.5 Energjia Elektrike


Pozita gjeografike e komunës i mundëson një rrjet të rëndësishëm të furnizimit me energji elektrike. Përveç linjave të furnizimit me energji elektrike me kapacitet 35kv, të cilat vijnë nga drejtimi i Prishtinës (Obiliq – Mazgit – Koliq – Besian), në territorin e komunës kalojnë edhe linjat transite të tensionit të lartë Internacional (Prishtine – Besian – Krushevc 220KV) dhe Obiliq (Kosova B – Nish me kapacitet 400KV).

Furnizimi i qytetarëve të Podujevës me energji elektrike bëhet nëpërmjet të linjës së Prishtinës me kapacitet prej 220KV (Kosova B – Besian) deri tek trafo-stacionit kryesor, i cili gjendet në komunën kadastrale të Podujevës dhe ka gjatësi prej 30.67 km dhe linja Mazgit – Podujeve 35KV me gjatësi prej 25.88 km .

Shtrirja e rrjetës energjetike të komunës nga stacioni kryesor deri tek shfrytëzuesit në tërë territorin e komunës bëhet nëpërmjet të daljeve të listuara më poshtë:

1. Dalja e Batllavës
2. Dalja e Batllavës – Orllanit
3. Dalja e Podujevës 1
4. Dalja e Podujevës 2
5. Dalja e Podujevës 3
6. Dalja e Podujevës 4
7. Dalja e Sillosit
8. Dalja e Podujevës 5
9. Dalja e Ballovcit
10. Dalja e Fshatrave 1
11. Dalja e Fshatrave 2
12. Dalja e Livadicës
13. Dalja e Litancit
14. Dalja e Llaushës

Harta 27. Rrjeti Energjetik



Në rrjetën e furnizimit me energji elektrike të komunës sipas drejtimeve të shpërndarjes së shfrytëzuesve, janë të vendosura gjithsej 237 trafo-stacione të kapaciteteve të ndryshme. Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se nga 237 TS funksionale, 23 prej tyre janë individuale, ndërsa 214 të tjera janë kolektive. Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të energjisë (bazuar në orë regjistruese) është 14452 shfrytëzues, të cilat e furnizojnë komplet territorin e komunës me energji elektrike. Shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike mund të konstatojmë se 100% e popullsisë së komunës kanë qasje në rrjetin energjetik të Kosovës.

Në tabelën në vijim do të paraqesim numrin e përgjithshëm të: TS, statusin dhe numrin e shfrytëzuesve.

Tabela 49. Trafo-stacionet në komunën e Podujevës

Nr rendor	Emri i daljes	Nr-TS	Individuale	Kolektive	Nr. Kons.	%
1	Batlavë	19	1	18	933	6.45
2	Batlavë - Orllan	18	1	17	487	3.4
3	Podujevë 1	12	1	11	1460	10.1
4	Podujevë 2	7	0	7	1055	7.3
5	Podujevë 3	4	0	4	992	6.86
6	Podujevë 4	6	1	5	788	5.45
7	Podujevë 5	6	1	5	788	5.45
8	Silloosi	7	1	6	756	5.23
9	Ballovcit	29	4	25	1437	9.94
10	Fshatrat 1	28	3	25	1222	8.46
11	Fshatrat 2	29	3	26	1050	7.27
12	Livadica	14	1	13	674	4.66
13	Letanci	31	4	27	1575	10.89
14	Llausha	27	2	25	1235	8.54
	Totali:	237	23	214	14452	100%

Duke u bazuar në % e numrit të konsumatorëve sipas daljeve, shihet se dalja e Letancit përfshinë linjën me të rëndësishme të furnizimit me energji elektrike, sepse bënë furnizimin e 1575 shfrytëzuesve ose 10.89 % në nivel të komunës, ndërsa më pas vjen dalja e Podujevës 1 me 1460 shfrytëzues ose 10.1 % të shfrytëzuesve në komunë.

- Dalja e Letancit 10KV – si drejtim i parë për nga rëndësia e furnizimit të konsumatorëve (10.89%), ka gjithsejtë 31 trafo-stacione, me 1575 konsumatorë, prej tyre 4 trafo-stacione janë individuale (kryesisht biznese) dhe 27 trafo-stacione janë për furnizim kolektiv.
- Dalja e Podujevës 1 - 10KV - është drejtimi i dytë për nga rëndësia e furnizimit sipas numrit të konsumatorëve (10.1%), ka gjithsejtë 12 trafo-stacione, me 1460 konsumator, prej 12 TS një është individual dhe 11 kolektive.
- Dalja e Ballovcit 10KV - është drejtimi i tretë për nga rëndësia e furnizimit të popullsisë me energji elektrike ngase furnizon 9.94% të totalit të shfrytëzuesve të komunës. Ka gjithsej 29 trafo-stacione me 1437 konsumator. Katër TS janë individuale ndërsa 25 kolektive.
- Dalja e Llaushës 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 1235 shfrytëzues ose 8.54% e shfrytëzuesve, me gjithsej 27 trafo-stacione, prej të cilave 2 janë individuale dhe 25 kolektive.
- Dalja e Fshatrave 1 - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 1222 shfrytëzues ose 8.46% e shfrytëzuesve, me gjithsej 28 trafo-stacione prej të cilave 3 janë individuale dhe 25 kolektive.

- f) Dalja e Podujevës 2 - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 1055 shfrytëzues ose 7.3% e shfrytëzuesve, me gjithsej 7 trafo-stacione, prej të cilave të gjitha janë kolektive.
- g) Dalja e Fshatrave 2 - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 1050 shfrytëzues ose 7.27% e shfrytëzuesve, me gjithsej 29 trafo-stacione prej të cilave 3 janë individuale dhe 26 kolektive.
- h) Dalja e Podujevës 3 - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 992 shfrytëzues ose 6.86% e shfrytëzuesve, me gjithsej 4 trafo-stacione prej të cilave të gjitha janë kolektive.
- i) Dalja e Batllavës - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 933 shfrytëzues ose 6.45% e shfrytëzuesve, me gjithsej 19 trafo-stacione, prej të cilave 1 është individuale e 18 tjerat janë kolektive.
- j) Dalja e Podujevës 4 - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 788 shfrytëzues ose 5.45% e shfrytëzuesve, me gjithsej 6 trafo-stacione, prej të cilave 1 është individuale e 5 tjerat janë kolektive.
- k) Dalja e Podujevës 5 - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 788 shfrytëzues ose 5.45% e shfrytëzuesve, me gjithsej 6 trafo-stacione, prej të cilave 1 është individuale e 5 tjerat janë kolektive.
- l) Dalja e Sillosit - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 756 shfrytëzues ose 5.23% e shfrytëzuesve, me gjithsej 7 trafo-stacione, prej të cilave 1 është individuale e 6 tjerat janë kolektive.
- m) Dalja e Livadicës - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 674 shfrytëzues ose 4.66% e shfrytëzuesve, me gjithsej 14 trafo-stacione, prej të cilave 1 është individuale e 13 tjerat janë kolektive.
- n) Dalja e Batllavë Orllan - 10KV - është dalje në të cilin janë të kyçur gjithsej 487 shfrytëzues ose 3.4% e shfrytëzuesve, me gjithsej 18 trafo-stacione, prej të cilave një është individual e 17 të tjera janë kolektive.

Cilësia e furnizimit me energji elektrike – sipas statistikave të furnizimit me energji elektrike, si dhe gjendjes së rrjetës energjetike në nivel të komunës administrative të Podujevës, mund të vërejmë se ka një furnizim me energji elektrike në nivelin e kënaqshëm, nëse i referohemi % së popullsisë që përfshinë drejtimet e furnizimit me energji elektrike.

Tabela 50. Statusi i furnizimit me energji elektrike

Statusi i furnizimit me E.E.	Nr. kom. kadastrale	%	Nr. Popullsisë	%
Normal	66	84.6	114530	94
Dobët	12	15.4	7649	6
Total	78	100.00	122179	100.00

Nga tabela mund të vërejmë se nga gjithsej 78 komuna kadastrale sa ka Podujeva, 66 prej tyre ose 84.6 % e tyre kanë furnizim normal me energji elektrike, ndërsa 12 vendbanime ose 15.4 % e tyre kanë furnizim të dobët me energji elektrike.

Shikuar nga pjesëmarrja e popullsisë së vendbanimeve dhe cilësisë së furnizimit, mund të vërejmë se 94 % e popullsisë së komunës kanë furnizim normal me energji elektrike, ndërsa 6 % e popullsisë kanë furnizim të dobët me energji elektrike.

Ndriçimi Publik – është evident vetëm në zonën urbane të komunës dhe ka gjatësi prej 4150 metra³². Rrjeti i sistemit të ndriçimit është i përbërë prej 153 shtyllave, prej tyre metalike 80 ndërsa shtylla të drurit 73. Rrjeti është i shpërndarë në rrugën “Zahir Pajaziti” me 35 shtylla të metalta me lartësi (H=8.5 m) dhe me gjatësi 500 metra, rruga e “28 Nëntorit me 15 shtylla të metalta me lartësi (H=8.5 m) dhe me gjatësi 450 metra, rruga “Hakif Zejnullahu” me 30 shtylla të drurit me gjatësi 900 metra, rruga “Skenderbeu” me 30 shtylla të metalta me ndriçim me lartësi (H=9 m) dhe gjatësi 1000 metra , pjesa tjetër e rrugës “Skenderbeu” me 30 shtylla të drurit me lartësi (H=9 m) dhe gjatësi 1000 metra dhe rruga “Abdyl Lahu me 13 shtylla të drurit me lartësi (H=9 m) dhe gjatësi 300 metra.

1.8.6 Infrastruktura e furnizimit me ujë

Sistemi i ujësjellësit në komunën e Podujevës menaxhohet nga njësia operative e kompanisë regionale për ujë dhe kanalizim “Prishtina” në Prishtinë. Bazuar në rëndësinë e ujësjellësit dhe ndikimin e tij në kualitetin e jetës dhe mirëqenien e popullatës si dhe në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës, gjatë hartimit të planit zhvillimor komunal duhet gjithsesi të harmonizohen planet e investimeve kapitale me nevojën për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë në territorin e komunës. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, po ashtu dhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me këto shërbime.



Furnizimi me ujë të pijshëm në mënyrë të organizuar në komunën e Podujevës daton që nga vitet '50-ta. Stacioni i vjetër i pompimit në qytet furnizohej me ujë nga dy bunare-shpime me kapacitet 6 litra/sec, të vendosura në qendër të qytetit. Nga ky sistem furnizohej vetëm qyteti i Podujevës.

Sot komuna e Podujevës furnizohet me ujë nga dy drejtime:

- Nga fabrika e ujit në Shajkofc
- Nga sistemet e pompimit nga pusët e Peranit

Nga viti 1983 komuna e Podujevës furnizohet me ujë të pijshëm nga fabrika e përpunimit të ujit në Shajkofc-Albanik, ku prej deponisë qendrore të ujit të pijshëm, uji distribuohet në drejtim të deponisë së ujit të pijshëm në Podujevë përmes tubacionit magjstral me gjatësi 8.22 km, me diametër DN 300

³² Të dhënat janë nga Kuvendi komunal i Podujevës - Zyra për shërbime publike

mm, nga materiali daktil dhe me kapacitet $Q=130$ l/sec.33 Në këtë tubacion magjstral janë të kyqur nëntë vendbanime me gjithsej 16136 banorë ose 18.2 % të popullatës së komunës.

Tabela 51. Vendbanimet të kyqura në tubacionin magjstral Shajkovc-Podujevë

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve
1	Ballofcë	2131
2	Dumosh	1207
3	Gllamnik	3794
4	Lladoc	821
5	Llapashticë e Poshtme	2701
6	Sfeçël	1739
7	Surkish	1091
8	Shajkoc	1504
9	Shtedim	1148

Në qytet uji grumbullohet në deponitë kryesore me kapacitet 6000 m³, që ndodhet në lokacionin “te pishat” në kuotën 640 mm. Kjo deponi është e përbërë prej tre rezervuarve cilindrik, dy me kapacitet nga 1500m³ dhe një me 3000m³. Dy rezervuarët $Q=1500$ m³ aktualisht janë jofunksional për shkak të dëmtimeve-rrjedhjeve. Nga rezervuari $Q=3000$ m³ del tubacioni kryesor Ø 400 dhe me rrjetin primar Ø 250 degëzohet në qytet. Rrjeti i ujësjellësit i shtrirë në komunën e Podujevës ka gjatësi prej 40 km nga të cilat 17 km janë rrjet primar me diametër Ø 250 mm deri Ø 100 mm dhe 25 km rrjet sekondar shpërndarës me diametër Ø 90 mm deri Ø 32 mm.

Pjesa e konsiderueshme e rrjetit është e vjetruar, e ndërtuar nga materiali Azbest-çimento dhe një pjesë nga materiali PVC, derisa rrjeti i ri i ndërtuar pas vitit 2000 është nga materiali polietilen.

Në rrjetin primar furnizohen qyteti i Podujevës, Obrança, Llapashtica dhe një pjesë e Peranit, me gjithsej 30988 banorë, ose 35% e popullatës së komunës.

Në tabelën e mëposhtme janë të prezantuara vendbanimet e komunës të cilat janë të kyçura në tubacionin magjstral nga Shajkofci deri te degëzimi në Mazgit-Prishtinë, në gjatësi 24.6 km dhe me diametër DN 900 mm.

³³ Monografia-Kompanija ujësjellësi Rajonal” Prishtina”; Mr.sc.Ç.Bajrush;2007


Tabela 52. Vendbanimet të kyqura në tubacionin magjstral Shajkovci-Prishtinë

Nr	Vendbanimi	Numri i Banorëve
1	Batlavë	2334
2	Bellopojë	1412
3	Dyz	573
4	Gërdoc	1263
5	Godishnjak	353
6	Halabak	623
7	Kaçybeg	494
8	Kushevicë	873
9	Lupq i Poshtëm	2113
10	Llugë	1404
11	Lluzhan	757
12	Majac	1622
13	Penuhë	539
14	Sallabajë	506
15	Siboc i Epërm	961
16	Siboc i Poshtëm	454
17	Shakovicë	619
18	Tërnavë	853

Në këtë tubacion magjstral janë të kyçur 18 vendbanime të komunës me gjithsej 17753 banorë, ose 20% të popullatës së përgjithshme në komunë. Në sistemin qendror të furnizimit kanë qasje 27 vendbanime ose rreth 34% të komunave kadastrale

Drejtimi tjetër nga sistemi i pompimit, nga pusët e Peranit, fillon të funksionojë rreth viteve të '80-ta dhe njihet si faza e parë e furnizimit me ujë në komunë. Uji merret nga tri shpime-bunare bazë me thellësi 7-9m të vendosura në teritorin e vendbanimit Peran. Dy nga këto puse kanë diametër 400mm dhe një me diametër 1000mm. Uji nga këto shpime derdhet në pusin kryesor përmbledhës me thellësi 9m dhe diametër 3700mm. Pompat në sistemin e Peranit, të tipit zhytës dhe centrifugale, furnizojnë rrjetin me pompim me kapacitet $Q=20$ litra/sec. Në këtë sistem uji dezinfektohet në të dy mënyrat, me klor gaz dhe të lëngët.

Harta 28. Shtrirja e rrjetit te ujësellsit




Në komunën e Podujevës, në sistem të ujësellsit kanë qasje gjithësejt 64877 banorë ose 73% të popullatës së përgjithëshme në komunë.

Nga të dhënat e njësisë operative në Podujevë për vitin 2014 raportohet një inkasim prej 51.38% nga amvisëritë, 64.73% nga bizneset e vogla, 91.62% nga bizneset e mëdha dh 91.61% nga institucionet. Totali i inkasimit të faturave të ujit ishte 64.59% dhe krahasuar me vitet paraprake tregon një rritje të lehtë. Përkundër përmirësimit të inkasimit problem në veti paraqesin humbjet e ujit në sistemin distributiv të cilat llogariten të jenë në shkallë mjaftë të lartë, prej 40% deri 60%. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Faktorët kryesor që

ndikojnë në këtë shkallë të lartë vlerësohet të jenë: rrjeti i vjetruar i ujësjellësit, kyçjet ilegale, mosmatja e saktë e ujit etj. Sasia e ujit që është në dispozicion (konsumimi mesatar ditor për banorë), vlerësohet të jetë përafërsisht 90-100 litra në ditë. Krahasuar me nivelet e BE-së, konsumimi i ujit për kokë banori është i ulët. Vetëm për qytetin e Podujevës, në proporcion me rritjen e numrit të banorëve, nevoja për ujë është 12600m³ në ditë ose 265 litra/sec.³⁴

Dezinfektimi i ujit të pijes bëhet me klor në sistemin e pompimit, ku është i instaluar sistemi i klorizimit me gaz, por aktualisht bëhet me klor të lëngët për arsye të mungesës së klorit të gazët. Kjo mënyrë nuk është konform standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore dhe reflektohet në cilësi të ujit. Cilësia e ujit për pije nga ujësjellësi i Podujevës kontrollohet nga IKSHPK-Prishtinë që nga fillimi i funksionimit të ujësjellësit. Frekuenca dhe numri i pikave të testimit përcaktohet në përputhshmëri me standardet e parapara me IA 2/99.



Grafiku 31. Cilësia e ujit për pije nga sistemi qendror i furnizimit, 2002-2008

Nga rezultatet laboratorike të mostrave të ujit për pije të ekzaminuar në laboratorët e IKSHPK-së, gjatë viteve 2005-2006 raportohet nivel i lartë i ndotjes bakterore. E tëra kjo ndodhë për shkak të mosfunksionimit të sistemit të dezinfektimit, dëmtimeve dhe punimeve në rrjetin shpërndarës si dhe përdorimi i klorit të lëngët i cili nuk i arrin standardet e parapara për dezinfektim të ujit për pije.³⁵

Furnizimi në vendbanimet rurale

Pjesa e popullatës së komunës që nuk kanë qasje në sistemin qendror të furnizimit, që llogaritet të jetë rreth 27%, furnizohet me ujë të pijshëm nga sisteme të vogla lokale, të cilat nuk menaxhohen nga ujësjellësi. Këto sisteme shfrytëzojnë burimet natyrore me kapacitet të vogël dhe furnizojnë disa shtëpi ose lagje të fshatit. Këto sisteme të vogla nuk e dezinfektojnë ujin dhe nga të dhënat e IKSHPK


³⁴ Raporti i njësisë operative Podujevë KUR "Prishtina"

³⁵ Raporti vjetor-IKSHPK, uji/sanitacioni/ 2008; Prishtinë

pothuajse të gjitha mostrat e mara nga këto sisteme rezultojnë me kontaminim bakteror dhe nuk janë ujëra të sigurta për pije nga aspekti higjienike.

Pjesa e tjetër e popullatës, e cila nuk është e kyçur në ujësjellës qendror ose në ujësjellës lokal, furnizohen me ujë nga bunarët e cektë dhe të pambrojtur (7-8m thellësi dhe shtyllë ujore 2-3m). Këta bunarë/kaptazha të pambrojtur nuk janë të ndërtuar sipas standardeve për bunarin higjienik. Kjo flet se uji në bunarë është sipërfaqësor me mundësi të madhe të ndotjes dhe me keqësimin e cilësisë së ujit për pije. Nga aspekti shëndetësor këta bunar janë faktor rreziku permanent dhe e rëndon situatën epidemiologjike. Me qëllim të përcjelljes së cilësisë së ujit të pijshëm në këtë rajon, IKSHPK-Prishtinë gjatë vitit 2001-2009 ka bërë testimin e ujit nga këta bunarë si dhe përcaktimin e rrezikut të ndotjes së tyre. Rezultatet flasin për nivel të lartë të kontaminimit:

- 65% të mostrave kanë kontaminim bakterorë,
- 30% të mostrave kanë vlera më të larta të Nitriteve, Nitrateve, Amoniakut
- 65% të mostrave nuk janë ujëra të pijshëm



Grafiku 32. Cilësia e ujit për pije në vendbanimet rurale,2000-2008


Bazuar në rezultatet e përcaktimit të rrezikshmërisë të ndotjes së bunarëve, gjatë viteve 2002-2008, 10% të bunarëve kanë rrezik të lartë të kontaminimit dhe 30% të bunarëve kanë rrezik të mesëm të kontaminimit.

1.8.7 Sistemi i kanalizimit

Sistemi i kanalizimit në komunën e Podujevës ka shënuar një zhvillim të theksuar viteve të fundit. Në bazë të shënimeve të drejtorisë për shërbime publike të Komunës së Podujevës aktualisht sistemi i kanalizimit i ujërave fekale është i shtrirë në një gjatësi të përgjithshme prej 423 km. Përpos instalimit të sistemit të kanalizimit në zonat rurale, është bërë edhe përmirësimi i sistemit ekzistues të

kanalizimit. Sot, i tërë qyteti i Podujevës, zona urbane e komunës, është i kyqyr në sistemin e kanalizimit. Sa i përket zonave rurale, aktualisht sistemi i kanalizimit është i instaluar në 62 fshatra të komunës (96.41% e ekonomive familjare).

Harta 29. Rrjeti i kanalizimit



Të gjitha ujërat e këtyre sistemit të kanalizimit, kryesisht jo të trajtuara shkarkohen në rrjedhat e lumit Llap dhe në këtë mënyrë shkaktojnë ndotje të lumit, tokës dhe sigurisht edhe ujërave nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës dhe për mjedisin në tërësi³⁶

Sistemi i rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferik është në mbikëqyrje të ndërmarrjes për menaxhim të mbeturinave. Rrjeti i kanalizimit të ujrave atmosferik është i shtrirë vetëm në zonën urbane në një gjatësi prej 25km, me kapacitet \varnothing 200 mm - \varnothing 400mm, me puseta të vendosura në largësi 40-50 m për gjatë rrugëve të qytetit. Këto puseta janë të vjetruara dhe të dëmtuara dhe mirëmbajtja e tyre është e vështirësuar. Pjesa më e madhe e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferike janë të rehabilituara me ndërtimin e rrugëve pas vitit 2000. Ujërat atmosferike derdhen në lokacionin të ndryshme përgjatë rrjedhjes së lumit Llap³⁷.

1.8.8. Telekomunikacioni

1.8.8.1 Telefonia Fikse

Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Podujevës është i lidhur nëpërmjet fibrës optike, i cili i përket linjës së trasesë Prishtinë–Podujevë. Ky rrjet menaxhohet nga njësi e PTK-së në Podujevë e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik. Kapaciteti total i centralit të postës në Podujevës është gjithsej 7200 qifte³⁸, prej të cilave 1771 shfrytëzohen, ndërsa pjesa tjetër është e pa shfrytëzuar.

Nga gjithsejtë 78 komuna kadastrale (78 vendbanime) sa ka komuna administrative e Podujevës, vetëm 12 (15.4%) e komunave kadastrale (12 vendbanime), kanë qasje direkt në rrjetin e telefonisë fikse. Telefonia fikse është e shtrirë në 12 vendbanime me gjithsej 7200 qifte. Vendbanimet në të cilat është i shtrirë rrjeti janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 53. Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse në komunën e Podujevës

Nr.rend	Vendbanimi	Nr i qifteve	Numri i popullsisë
1	Podujevë	4800	23453
2	Lluzhan	1200	757
3	Bellopoje		1412
4	Lluge		1404
5	Lupç i Poshtem		2113
6	Ternave		853
7	Kerpimeh	1200	755
8	Doberdol		1106
9	Metehi		1251
10	Pakashtice e Epërme		732

³⁶ Raporti i ujësjellësit Podujevë-2008/2009

³⁷ Ndërmarrja për menaxhim të mbeturinave "Pastrimi"-Podujevë-2009

³⁸ Zyra e PTK-së në komunën e Podujevës

11	Pakashtice e Poshtme	292
12	Revuq	924
Total banorë komuna e Podujevës		88499(100%)
Pop. me qasje ne tel. fikse		35052 banorë
% e pop. Me qasje ne tel fikse		(40%)

Nga tabela mund të shohim se rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Podujevës është i shtrirë në 15.4% të vendbanimeve me gjithsej 40% të popullsisë. Nga kjo mund të konstatojmë se pjesëmarrja e popullsisë në nivel të komunës nuk është e kënaqshme dhe se ky rrjet mbulon një pjesë të vogël të vendbanimeve, por kryesisht me numër të madh të popullsisë. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të përmendet se shfrytëzimi i këtij rrjeti nga qytetarët e komunës është shumë i vogël dhe nuk e kalon shifrën prej 24.6%, çka do të thotë se ka edhe shumë punë për të bërë deri në sensibilizimin e qytetarëve për të shfrytëzuar mundësitë dhe kapacitetet që i ofrojnë shërbimet e telefonisë fikse.

1.8.8.2 Telefonia Mobile

Në territorin e Podujevës është e mbuluar mjaftë mirë. Të gjitha vendbanimet e Podujevës kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobil sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunës është 27 sosh.

1.8.8.3 Shërbimet e Internetit

Ekzistojnë disa operator të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Podujevës. Territori i komunës nuk është i mbuluar plotësisht me shërbime të internetit, kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore dhe disa pjesë të vendbanimeve rurale. Kryesisht interneti në zonat rurale është i shpërndarë në nivel të internet kafe-ve, të cilat ofrojnë shërbime në vendbanime të ndryshme, si dhe kanë qëllime komerciale. Operatorët me ndikim më të madh që ofrojnë shërbime të internetit në komunën e Podujevës janë:

- PTK - Darda NET, nëpërmjet të telefonisë fikse
- IPKO – ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale) dhe
- KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale)


1.8.8.4 Radiotelevizioni

Rrjeta e Radiotelevizionit në komunën e Podujevës është e shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës. Në këtë komunë ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

- Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV21 dhe KTV,
- Radio - lokale – Radio Llapi,

- Radio-televizionet nëpërmjet antenave Satelitore,
- Radio-televizionet nëpërmjet sistemeve kablllore.

Harta 30. Antenat e telefonisë mobile



1.8.9 Menaxhimi i mbeturinave

Në komunën e Podujevë menaxhimin dhe shërbimin e grumbullimit, bartjen dhe deponimin e mbeturinave e kryen KUR „PASTRIMI” Shoqëria aksionare-Prishtinë, njësia operative në Podujevë. Në këtë ndërmarrje janë të punësuar 33 punëtor të cilët merren me grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave të ngurta nga amvisnit dhe industria.

Kjo kompani i kryen shërbimet në zonën urbane dhe para lagjet e qytetit. Veprimtarinë e tyre nuk e kanë të shtrirë në vendbanime rurale, me përjashtim të kërkesave individuale të qytetarëve. Në bazë të analizave ky shërbim është ende në shkallë të ultë, ngase vetëm 35-40% të popullatës në komunë janë të mbuluara me këto shërbim. Nga gjendja reale e paraqitur në bazë të faturimit kjo njësi ofron shërbim për:

- 650 objekte biznesi nga të cilët faturimi i realizuar është 30.77% ,
- 2800 amvisni me vetëm 39.38% inkasim.
- Objektet e industrisë (7-8 prodhimtari në komunë) kanë kontrata të veçanta dhe realizimi i faturave është 100% të kontratës. Në këtë grup numërohen institucionet shoqërore (shëndetësi, banka, shkolla, komuna, institucionet fetare etj).

Mesatarisht grumbullohen 20 000 kg mbeturina në ditë ose 350-400 ton në muaj. Po që se merret mesatarja e sasisë së përgjithshme të mbeturinave për kokë banori për një ditë që në Kosovë është 2 kg, atëherë vlerësohet se sasia mesatare e prodhimit të mbeturinave në komunën e Podujevës është 95632kg /në ditë ose 34 905 680 kg në vit (34906 t).

Në territorin ku vepron kjo ndërmarrje mbeturinave mblidhen në sistem derë në derë. Gjithashtu janë të shpërndarë 50 kontejner 1.1m³ dhe 4 kontejner të mëdhenj 7 m³ të vendosur në lokacionin e tregut dhe institucionet-prodhimtaritë me kontratë të veçantë. Kjo njësi operative për bartje të mbeturinave posedon 2 kamion special-mulli për kontejner të vegjël dhe një kamion për kontejner të mëdhenj, si dhe 2 kamion-kiper të cilët aktivizohen gjatë vikendit për bartjen e mbeturinave ilegale. Sasi e mbeturinave të grumbulluara bartet në lokacionin e deponisë në Dumnice, e ndërtuar nga AER në vitin 2005. Kjo deponi nuk i përmbush standardet meqë paraprakisht nuk ka klasifikim ose ndarje të mbeturinave, hedhurinat e lëngëta dhe ujërat nga deponia nuk mblidhen dhe nuk trajtohen, gazrat nga deponia lëshohen në mënyrë të pakontrolluar etj. Si e tillë kjo deponi paraqet rrezik permanent për ndotje të mjedisit dhe rrezikon shëndetin e banorëve të komunës.

Në vendbanimet rurale të komunës ekzistojnë shumë deponi të egra, shpesh herë nga 2-3 sosh në çdo vendbanim. Nga këto deponi ilegale, edhe pse nuk janë në mbikëqyrje të kompanisë, shpesh herë me iniciativë të kuvendit komunal bëhet grumbullimi i tyre dhe bartja në deponin qendrore ku çmimi për një ton është 6€.

Pos menaxhimit dhe organizimit të mbeturinave, kompania bënë edhe pastrimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferik. Ky rrjetë i gjatë 20-25 km është i shtrirë në zonën urbane dhe disa para lagje. Gjatë sezonit veror rrugët pastrohen çdo ditë në orët e natës. Uji për këtë qëllim merret nga pusi i kompanisë i cili ndodhet në vendbanimin Peran. Brengosë fakti se për shkak të mungesës së mjeteve për punë, nuk ka mundësi të mirëmbajtjes së rrugëve gjatë sezonit dimëror.


1.9. Kapacitetet Investive

Buxheti i komunës së Podujevës përbëhet prej të hyrave vetanake dhe të hyrave apo transfereve qeveritare.

Në bazë të analizës së buxhetit të komunës për periudhën 5 vjecare, 2011 – 2015, vërehet një rritje e vazhdueshme e buxhetit prej mesatarisht 4% në vit dhe rritje të përgjithshme prej afro 15% (të gjitha të dhënat janë marrë nga Ministria e Financave e Kosovës).

Tabela 54. Buxheti i komunës së Podujevës, 2011 - 2015

Viti	Grantet Qeveritare	Te Hyrat Vetanake	Totali
2011	14,823,839.00	1,075,000.00	15,898,839.00
2012	14,659,214.00	1,400,000.00	16,059,214.00
2013	15,171,350.00	1,350,000.00	16,521,350.00
2014	15,632,935.00	1,417,500.00	17,050,435.00
2015	16,708,901.00	1,597,592.00	18,306,493.00



Grafiku 33. Të hyrat e buxhetit komunal


Mbi 90% e buxhetit e ka burimin nga transferet qeveritare dhe pjesa tjetër nga të hyrat vetanake. Kjo përqindje ka shënuar oscilime të vogla gjatë këtij 5 vjecari. Të hyrat nga transferet qeveritare përqindjen më të lartë në raport me buxhetin total e kanë pasur në vitin 2011 me 93%. Pas këtij viti kjo përqindje është zvogëluar në 91%.

Të hyrat vetanake të buxhetit të komunës krijohen nga tatimi në pronë, taksat komunale, ngarkesat komunale dhe të hyrat e tjera. Të hyrat vetanake të komunës së Podujevës kanë shënuar rritje të vazhdueshme nga viti 2011. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje prej afro 50% nga viti 2011, që tregon për një punë të mirë të organeve komunale në arkëtimim e taksave dhe ngarkesave komunale, të cilat edhe e kanë shënuar rritjen më të madhe krahasuar me elementet e tjera të të hyrave vetanake.

Tabela 55. Te hyrat vetanake te komunës se Podujevës, 2011 - 2015

Viti	Tatimi ne Prone	Taksat Komunale	Ngarkesat Komunale	Te Hyrat e Tjera	Totali
2011	200,000.00	480,000.00	160,000.00	235,000.00	1,075,000.00
2012	230,000.00	720,000.00	240,000.00	210,000.00	1,400,000.00
2013	280,000.00	705,000.00	235,000.00	130,000.00	1,350,000.00
2014	310,000.00	600,000.00	470,000.00	37,500.00	1,417,500.00
2015	312,000.00	704,592.00	456,000.00	125,000.00	1,597,592.00

Pjesa më e madhe e të tyrave vetanke vijnë nga taksat komunale të cilat kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Taksat komunale në pjesëmarrjen e përgjithshme bëjnë pjesë me mbi 45%. Burimi i dytë i të hyrave vetanake janë ngarkesat komunale dhe në fund vijnë tatimi në pronë dhe të hyrat e tjera.




Grafiku 34. Të hyrat buxhetore vetanake komunale

Transferet qeveritare përbejnë mbi 90% të të hyrave buxhetore të komunës. Siç u përmend edhe më lartë, transferet ose grantet qeveritare përbëhen prej katër nënkategorive buxhetore (sic paraqitet në tabelën e mëposhtme). Të hyrat nga transferet qeveritare kanë shënuar rritje prej afro 12% nga viti 2011.

Tabela 56 Transferet Qeveritare te komunës se Podujevës, 2011 - 2015

Viti	Granti i Pergjithshem	Granti per arsim	Granti per shendetesi	Financime Tjera	Totali
2011	5,484,706.00	7,345,125.00	1,949,767.00	44,241.00	14,823,839.00
2012	5,813,557.00	6,846,965.00	1,998,692.00	-	14,659,214.00
2013	6,295,712.00	6,846,965.00	2,028,673.00	-	15,171,350.00
2014	6,445,712.00	7,228,793.00	1,958,430.00	-	15,632,935.00
2015	6,869,251.00	7,747,268.00	2,092,382.00	-	16,708,901.00




Grafiku 35. Transferet qeveritare

Pjesëmarrjen më të madhe në transferet qeveritare e kanë grantet specifike për arsim. Edhe pse ato kanë shënuar oscilime të vogla, megjithatë kane mbetur si burim kryesor i të hyrave buxhetore. Kategoritë e tjera te transfereve qeveritare kanë shënuar pjesëmarrje pak a shumë të njëjtë gjatë tërë periudhës 5 vjecare.

Në bazë të analizës së kategorive të shpenzimit të buxhetit, vërehet se shpenzimet operative mbesin në shkallë më të lartë në raport me shpenzimet kapitale. Gjatë periudhës 2011 – 2015 raporti në mes të shpenzimeve operative dhe shpenzimeve kapitale ka shënuar rritje, duke lëvizur nga 63% - 37% në vitin 2011 deri në 71% - 29% në vitin 2015.

Tabela 57 Shpenzimet buxhetore te komunës se Podujevës, 2011 - 2015

Viti	Pagat dhe Meditjet	Mallrat dhe Sherbimet	Shpenzimet Komunale	Subvecone dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Totali
2011	8,729,433.00	808,588.00	292,580.00	149,548.00	5,918,690.00	15,898,839.00
2012	8,926,236.00	852,457.00	284,000.00	175,000.00	5,821,521.00	16,059,214.00
2013	8,921,529.00	991,281.00	330,427.00	330,427.00	5,947,686.00	16,521,350.00
2014	9,042,600.00	1,128,957.00	339,355.00	555,000.00	5,984,523.00	17,050,435.00
2015	11,000,000.00	1,061,718.00	324,500.00	692,000.00	5,228,275.00	18,306,493.00



Grafiku 36.Pasqyra financiare, 2011 - 2015

Nga grafiku vërehet se në ndarjet buxhetore, pagat dhe meditjet përbëjnë pjesën kryesore të buxhetit, me afro 56% të buxhetit. Afro 35% e buxhetit është i alokuar për shpenzime kapitale dhe pjesa tjetër

janë shpenzime të tjera operative. Nga grafikoni verëhet se shpenzimet për projekte kapitale kanë shënuar zvogëlim, derisa verëhet ngritje e shpenzimeve për paga dhe meditje, sidomos për vitin 2015.

Ne baze të të dhënave nga Ministria e Financave e Kosovës, vlerësohet se buxheti i komunës së Podujevës për 2 vitet e ardhshme do të shënoj një zvogëlim në krahasim me buxhetin e vitit 2015 (shih tabelën e mëposhtme). Si faktor kryesor i zvogëlimit të buxhetit duket të jetë zvogëlimi i shumës së transfereve qeveritare të planifikuara për komunën e Podujevës për Vitin 2016 (259,911 Euro) dhe 2017 (51,018 Euro). Njëkohësisht, vlerësohet se të hyrat vetanake do të vazhdojnë të rriten.

Tabela 58 Buxheti I planifikuar i komunës se Podujevës, 2016 - 2017

Viti	Grantet Qeveritare	Te Hyrat Vetanake	Totali
2015	16,708,901.00	1,597,592.00	18,306,493.00
2016 (Vleresim)	16,413,990.00	1,632,592.00	18,046,582.00
2017 (Vleresim)	16,611,883.00	1,643,592.00	18,255,475.00

Ne bazë të buxhetit të planifikuar, vlerësohet se do të ketë një ngritje të lehtë të shpenzimeve kapitale dhe zvogëlim të shpenzimeve operative, krahasuar me vitin 2015.

Tabela 59 Shpenzimet e planifikuara te komunës se Podujevës, 2016 - 2017

Viti	Pagat dhe Meditjet	Mallrat dhe Sherbimet	Shpenzimet Komunale	Subveçione dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Totali
2015	11,000,000.00	1,061,718.00	324,500.00	692,000.00	5,228,275.00	18,306,493.00
2016 (Vleresim)	10,106,085.92	1,082,794.92	360,931.64	360,931.64	6,135,837.88	18,046,582.00
2017 (Vleresim)	10,223,066.00	1,095,328.50	365,109.50	365,109.50	6,206,861.50	18,255,475.00

1.10 SWOT Analiza

Pas përfundimit të profilit komunal, ku janë përshkruar në mënyrë shumë konkrete të gjitha fushat tematike me të dhëna dhe analiza, është bërë edhe SWOT analiza. Kjo metodë e analizës në planifikim shërben për identifikimin e të gjitha përparësive dhe mundësive që ka komuna dhe në anën tjetër të gjitha dobësitë dhe rreziqet. Analiza pra shërben që në të ardhmen, gjatë procesit të hartimit të planit komunal të shikohen mundësitë për shfrytëzimin e të gjitha përparësive dhe mundësive që ka komuna dhe në anën tjetër, do të tentohet që dobësitë dhe rreziqet të evitohen apo të minimizohen.

SWOT analiza është punuar në katër pjesë, duke u bazuar në katër fushat tematike që është hartuar profili komunal. Në fillim është bërë SWOT analiza për fushën e popullsisë, zhvillimit social dhe vendbanimeve, pastaj në fushën e mjedisit dhe shfrytëzimit të tokës, zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës. Bazuar në gjendjen ekzistuese dhe të dhënat nga këto fusha tematike janë identifikuar veç e veç përparësitë, mundësitë, dobësitë dhe rreziqet për këto katër fusha.

Popullsia, gjendja sociale dhe vendbanimet

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Staf profesional në administratën komunale ○ Popullsi në moshë të re dhe e tipit progresiv (nën 30 vjeç) ○ Popullsi e orientuar drejt vlerave arsimore ○ Kuadër i kualifikuar (arsim dhe shëndetësi) ○ Popullsi e shëndosh ○ Fusha sportive: stadiumi, palestra sportive, fusha të mbuluara me masë plastike ○ Sipërfaqe të mjaftueshme të tokave jo produktive për zgjerim të qytetit ○ vendbanime të grumbulluara në masë të konsiderueshme 	Mundësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Ngritja e shërbimeve administrative ○ Programe profesionale për të papunët sipas kërkesave të tregut ○ Rritja e fondeve për sigurimin social ○ Organizimi i programeve për zhdukjen e analfabetizmit ○ Zgjerim dhe ngritje e cilësisë së hapësirës edukative arsimore ○ Përfshirje e edukimit para fillor në të gjitha shkollat fillore ○ Rritja e numrit të kuadrit profesional në arsim dhe shëndetësi ○ Ngritja profesionale e personelit mjekësor dhe arsimor (programe profesionale)
	Dobësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Gjendja jo e mirë e disa objekteve arsimore dhe shëndetësore dhe infrastruktura përcjellëse. ○ Mungesë e kuadrit mjekësor profesional në sistemin shëndetësor ○ Shkalla e lartë e papunësisë kryesisht te të rinjtë ○ Shkalla e lartë e varfërisë së përgjithshme dhe asaj ekstreme ○ Mungesë e barazisë gjinore ○ Mungesë e sipërfaqeve banese për kokë banori ○ Tipi i vendbanimeve të shpërndara ○ Jo funksionaliteti i vendbanimeve ○ Mungesa e infrastrukturës, sidomos në vendbanimet kodrinore-malore 	Kërcënimet <ul style="list-style-type: none"> ○ Mungesa e donacioneve në programe profesionale ○ Mungesë e programeve për zvogëlimin e papunësinë, zhdukjen e analfabetizmit, sigurimin social dhe shëndetësor etj ○ Ndërtime ilegale në toka bujqësore të cilësisë së lartë ○ Ndërtime përgjatë vijave komunikative dhe rrezikim i korridoreve
NEGATIVË		

Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Pozita e volitshme gjeografike ○ Sipërfaqe të mjaftueshme dhe kualitative të tokave bujqësore ○ Pasuri me trashëgimi kulturore dhe natyrore ○ Resurset ujore – shfrytëzimi lumi Llap dhe liqenit të Batllavës ○ Resurset natyrore-ujërave minerale ○ Ekzistimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, bujqësisë etj 	Mundësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore ○ Peizazhe të përshtatshme për pushim dhe rekreacion ○ Vetëdijesimi i popullatës për mbrojtjen e ambientit ○ Harmonizimi i zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit ○ Favorizimi i bujqësisë, blegtorisë dhe bletarisë ○ Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe shpallja e zonave mbrojtëse ○
	Dobësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Humbja e tokës bujqësore nga zhvillimet e paplanifikuar ○ Mungesa e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza ○ Hedhja e paplanifikuar e mbeturinave në mjedise të ndryshme ○ Ndotja e lumenjve nga hedhja e mbeturinave dhe nxjerrja e inerteve ○ Degradim i shtretërve të lumenjve 	Kërcënimet <ul style="list-style-type: none"> ○ Zgjerimi i vendbanimeve jo formale ○ Ndërtimet në toka bujqësore dhe rrezikimi i korridoreve ○ Fatkeqësitë e mundshme natyrore: tërmetet, erozionet e pakontrolluara, vërshimet ○ Dëmtimi i vazhdueshëm i pyjeve ○ Investimet jo të mjaftueshme në mjedis ○ Përhapja e epidemive për mungesë të sistemit të kanalizimit qendror fekale, të ujërave të zeza dhe mbeturinave. ○ Mungesa e monitorimit të ndotësve ○ Mbrojtja jo e mirë nga vërshimet dhe erozionet ○ Degradimi i pyjeve, lumenjve dhe tokës bujqësore
NEGATIVË		

Zhvillimi ekonomik

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Pozita e mirë gjeografike ○ Vendkalim kufitare ○ Fond i madh i tokës bujqësore ○ Fond i madh i kullosave dhe livadheve ○ Rrjet i mirë i infrastrukturës rrugore nacionale ○ Qasje e madhe e popullsisë në shërbimet e transportit publik ○ Zhvillim i tregëtisë së brendshme ○ Zhvillim i turizmit vikendorë në liqenin e Batllavës. 	Mundësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Tërheqja e kapitalit investiv nga jashtë ○ Bashkëpunimi ndërkufitar ○ Zhvillim i bujqësisë moderne ○ Zhvillim i blegtorisë ○ Zhvillim i perimtarisë-pemtarisë ○ Zhvillim i turizmit rural, vikendor, malorë dhe gjuetisë në malet e Gollakut dhe Kopaonikut ○ Eksploatimi i qëndrueshëm i minierave sipërfaqësore ose gurthyesve ○ Rritja e buxhetit komunal ○ Shtrirja e taksave për leje ndërtimi edhe në zonën rurale.
	NEGATIVË	Dobësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Infrastruktura fizike jo cilësore ○ Mosshfrytëzimi i potencialeve ujore për ujitje ○ Mungesë të strategjisë së zhvillimit të bujqësisë dhe turizmit ○ Të ardhurat e ulëta për kokë banori ○ Shkallë e lartë e papunësisë ○ Shkallë e lartë e fragmentimit të pronave ○ Mosaktivizimi i ndërmarrjeve industriale ○ Mosfeksionim i linjës hekurudhore ○ Mosshfrytëzimi ose moseksploatimi i pasurive minerare

Infrastruktura

	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Lidhjet e mira përmes rrugëve nacionale dhe regjionale, si dhe atë të rrjetit hekurudhor ○ Qasja e vendbanimeve në infrastrukturë të asfaltuar ○ Qasja e popullsisë në transport publik ○ Qasja e popullsisë në telefoni fikse ○ Qasja e vendbanimeve në telefoni mobile • Shtirja e rrjetit të internetit 	Mundësitë <ul style="list-style-type: none"> ○ Mirëmbajtja e rrugëve lokale të asfaltuara ○ Menaxhimi adekuat i rrjetit të ujit të pijes ○ Menaxhim adekuat i transportit publik ○ Shtirje e internetit në të gjitha vendbanimet ○ Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike ○ Shtirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanime ku mungon ○ Ndërtimi i një impianti të ujërave të zeza ○ Ndriçimi i rrugëve në zonat të frekuentuar me popullsi të dendur
	Dobësitë <ul style="list-style-type: none"> a) Gjendja fizike jo e mirë e disa rrugëve lokale ○ Mos menaxhimi i të gjithë rrjetës së furnizimit me ujë ○ Menaxhimi i dobët i linjave të transportit publik në viset rurale ○ Gjendja fizike jo e mirë e rrjetit të energjisë elektrike. ○ Jo funksionimi adekuat i linjave hekurudhore 	Kërcënimet <ul style="list-style-type: none"> ○ Funksionim jo i mirë i linjave ndër shtetërore me Serbin ○ Probleme në qasjen e disa vendbanimeve periferike në infrastrukturë teknike (rrugore, rrjetit të kanalizimit, ujit të pijes, telefonisë mobile dhe fikse, etj.)
NEGATIVE		

1.11. Sfidat e Identifikuara

Bazuar në gjendjen ekzistuese (profilin) komunale janë identifikuar sfidat kryesore si çështje më të theksuara me të cilat aktualisht përballet komuna e Podujevës. Sfidat me të cilat përballet komuna e Podujevës janë:

1. Shërbime jo efektive administrative
2. Mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve në arsim dhe shëndetësi
3. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë
4. Shpërngulja e popullsisë nga viset rurale-kryesisht i brezit kufitar
5. Mungesa e qendrave sekondare dhe infrastrukturës urbane
6. Ndotja dhe degradimi i mjedisit
7. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
8. Humbja e tokës bujqësore nga zhvillimet e pa kontrolluara

9. Ekonomi e pa zhvilluar dhe jo e balancuar
10. Infrastruktura jo cilësore dhe e pa mjaftueshme

- **Sfida 1. Nivel i pakënaqshëm në administratë**

Shërbimet administrative në komunën e Podujevës nuk janë në nivel të kënaqshëm.

- **Sfida 2. Mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve në arsim dhe shëndetësi**

Përkundër investimeve të konsiderueshme në komunën e Podujevës, gjendja fizike e objekteve arsimore dhe shëndetësore nuk e arriti nivelin e dëshiruar. Njëkohësisht mungojnë pajisjet teknike për arsim dhe shëndetësi. Në disa vendbanime paraqitet si problem mungesa e hapësirës shkollore, derisa në shëndetësi paraqitet mungesë e kuadrit të kualifikuar dhe suficitit i stafit mjekësorë (mbi standardin e përcaktuar nga Minsitria e Shëndetësisë).

- **Sfida 3. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë**

Në komunën e Podujevës ekziston shkallë shumë e lartë e papunësisë dhe varfërisë. Papunësia më e lartë është e shprehur te grupi i moshës së mesme e popullsisë 25-39 vjeç (45%). Krahas shkallës së lartë të papunësisë paraqitet edhe shkallë mjaft e lartë e varfërisë në komunën e Podujevës. Të dhënat tregojnë se rreth 8% e ekonomive familjare janë në programin e asistencës sociale.

- **Sfida 5. Mungesa e qendrave sekondare dhe infrastrukturës urbane**

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme urbane si dhe mungesa e qendrave sekondare paraqet vështësi në realizimin e kërkesave të qytetarëve.

- **Sfida 6. Ndotja dhe degradimi i mjedisit**

Problemet mjedisore janë prezent pothuajse në tërë territorin e komunës. Shfrytëzimi i pa kontrolluar dhe pa plan i mjedisit po përcillet me probleme të natyrave të ndryshme. Shfrytëzimi i inerteve dhe pyjeve ndikojnë negativisht në mjedis dhe ambientin shoqëror.

- **Sfida 7. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore**

Komuna e Podujevës është e pasur me trashëgimi natyrore dhe kulturore, mirëpo kujdesi jo i mjaftueshëm ndaj tyre po ndikon në degradimin e saj.

- **Sfida 8. Humbja e tokës bujqësore nga zhvillimet e pa kontrolluara**

Ndërtimet pa plan po ndikojnë në shqyrtimin dhe mjedis në shumë mënyra- shkatërrimi i zonave të gjelbra, shfrytëzimi i tokës bujqësore të kategorisë II-IV, deformimi i linjave të ndërtimit dhe uzurpimin e pronës publike etj.

- **Sfida 9. Ekonomi e pa zhvilluar**

Konsiderohet se shkalla e papunësisë në komunë e Podujevës është shumë e lartë. Kjo tregon edhe për gjendjen e mirëqenies njerëzore në këtë komunë duke shprehur rëndimin më negativ që ka komuna e Podujevës. Gjithashtu edhe të ardhurat për kokë banori janë të vogla për shkak të shkallës së lartë të papunësisë, pagave të vogla si dhe familjet me shumë anëtarë kushtëzojnë të ardhura të vogla në Komunën e Podujevës.

- **Sfida 10. Infrastrukturë jo cilësore dhe e pa mjaftueshme**

Në infrastrukturë arritjet janë të dukshme, mirëpo akoma mbetet shumë punë për tu bërë. Qasja e popullsisë në rrugë të kualitetit të lartë, rrjet të kanalizimit, shërbime të internetit, në valët e TV-së kombëtare, etj, të gjitha këto arritje po reflektohen në standardin jetësor të qytetarëve.

1.12. Potencialet lokale të identifikuara

1. Popullsi e shëndoshë dhe e re
2. Numër i konsiderueshëm i emigranteve
3. Afërsia e vendbanimeve me qendrën urbane
4. Sipërfaqe e konsiderueshme dhe cilësore e tokës
5. Sipërfaqe e konsiderueshme e mbuluar me pyje
6. Fond të konsiderueshëm të kullosave
7. Fuqia punëtore
8. Resurset ujore
9. Traditë në aktivitete agrare dhe tregtare
10. Mundësi reale të zhvillimit të turizmit në zonën me peizazh malorë
11. Mundësi atraktive për vendosje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
12. Gatishmëria e participimit të qytetarëve në projektet e përbashkëta me komunën
13. Shtrirja e planifikuar e vazhdimit të autostradës Durrës - Morinë – Prishtinë, drejt Merdarit.

“VIZIONI, PARIMET DHE CAQET”

FAZA E DYTË

2. VIZIONI PËR KOMUNËN E PODUJEVËS

Bazuar në të dhëna dhe nga situata ekzistuese e komunës së Podujevës, analiza e përparësive, mundësive, dobësive dhe rreziqeve, është përcaktuar edhe vizioni për të ardhmen e komunës. Ky vizion përqendrohet kryesisht në zgjidhjen apo minimizimin e problemeve kryesore me të cilat përballet komuna e Podujevës. Që në fillim është përshkruar deklarata e vizionit e cila në pika të shkurtra e përmbledh tërë parashikimin e këtij plani për zhvillimin e komunës në të ardhmen. Deklarata përmbledh parashikimet e dëshiruara të zhvillimeve të ardhme në të gjitha fushat e zhvillimit si: Zhvillimi ekonomik, social, kulturor, mjedisor, të infrastrukturës etj. Deklarata e vizionit shpreh zhvillimin e ardhshëm të komunës në formë të përmbledhur sikurse parathënia e një libri e cila përshkruhet me disa fjalë dhe kjo deklaratë është si në vijim:

Komunë me administratë efikase, zhvillim të qëndrueshëm dhe të harmonizuar ekonomik e social, me mundësi punësimi dhe zvogëlim të shkallës së varfërisë, me sistem të avancuar arsimor dhe shëndetësor, infrastrukturë e ndërtime të planifikuara, shfrytëzim racional të mjedisit, duke mbrojtur vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore.

Përmes kësaj deklarate dallohen qartë qëllimet e përgjithshme që duhet të arrihen në të ardhmen. Qëllimet janë mjaft të qarta dhe të dallueshme sipas fushave të ndryshme. Përmes realizimit të këtyre qëllimeve, njëkohësisht jepen edhe zgjidhje edhe për sfidat që janë identifikuar më parë.

Vizioni për komunën e Podujevës parasheh zhvillime konkrete dhe të realizueshme siç janë:

- Përmirësimi i shërbimeve administrative
- Zhvillim të harmonizuar ekonomik dhe social
- Mundësi punësimi dhe zvogëlim të shkallës së varfërisë
- Sistem më të avancuar arsimor dhe shëndetësor
- Planifikim të ndërtimeve dhe infrastrukturë adekuate
- Shfrytëzim racional të mjedisit
- Mbrojtje të vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Në të gjitha këto fusha ekzistojnë probleme të theksuara të cilat do të gjejnë zgjidhje në të ardhmen. Këto fusha janë të përfshira në formë të qëllimeve të përgjithshme, por te pjesa e qëllimeve do të përshkruhem më konkretisht edhe synimet si veprime më specifike që duhet të arrihen.

2.1 Parimet e përgjithshme të zhvillimit

Parimet e përgjithshme të Planit Zhvillimor Komunal bazohen në dokumentet të rëndësishme për planifikim hapësinor:

- Ligji për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, Ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-106 dhe Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor.
- Parimet Udhëzuese për Zhvillimin e Qëndrueshëm Hapësinor të BE – ESDP
- Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm –Agjenda 21 - është fryt i Bashkësisë botërore që u mbledh në [Brazil] në vitin 1992 nën kujdesin e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Ambientin dhe Zhvillimin që e ka njohur këtë parim thelbësor si pjesë e asaj që njihet si Agjenda 21.
- Bashkimi Evropian ka miratuar një shprehje të ngjashme të politikës dhe të parimeve si pjesë e Perspektivës së Zhvillimit Hapësinor Evropian. Objektivi i gjere është të lehtësojë akordimin e tokës për përdorimet që japin përfitimet me të mëdha të qëndrueshme dhe të nxisë kalimin drejt një menaxhimi të qëndrueshëm dhe të integruar të burimeve të tokës. Në terma me specifike, objektivat janë si me poshtë vijon:
- Te rishikoje dhe të zhvilloje politika për të mbështetur përdorimin me të mire të mundshëm të tokës dhe të menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të tokës.
- Të përmirësoje dhe të përforcojë sistemet e planifikimit, menaxhimit dhe të vlerësimit për token dhe burimet e tokës.
- Të forcoje institucionet dhe mekanizmat koordinuese për token dhe për burimet e tokës.
- Të krijojë mekanizma për të lehtësuar angazhimin aktiv dhe pjesëmarrjen e të gjithë të interesuarve, veçanërisht të komuniteteve dhe të njerëzve në nivel vendor, ne vendim marrjen për përdorimin dhe menaxhimin e tokës.
- Parimet e qeverisjes së mirë urbane – Agjenda e Habitatit
- Parimet bazë mbi të cilat do të fokusohen zhvillimet e përgjithshme të komunës së Podujevës në raport me parimet ndërkombëtare janë:
- Promovimin e interesave të përbashkëta të komunës duke mbrojtur dhe zhvilluar resurset natyrore dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.
- Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike.
- Promovimin e transparencës së plotë në planifikim dhe procesin e marrjes së vendimeve duke iu lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme.
- Promovimin e të drejtave të barabarta ekonomike dhe shoqërore për të gjithë kosovarët.
- Promovimin e kualitetit të përmirësuar të jetës dhe forma të balancuara të vendbanimeve.
- Promovimin e harmonizimit me parimet dhe planet e vazhdueshme të zhvillimit hapësinor Evropian.

2.2 Parimet e qeverisjes së mirë

- Qëndrueshmëria - të ketë qasje të integruar e cila përfshin elementet hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunë.

- Subsidiariteti – marrja e vendimeve mbi baza të hierarkisë nga niveli qendror në atë lokal dhe zbatimi sa më efikas.
- Barazia - plani duhet të merr parasysh aspektet e barazisë: minoritetet, femrat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara (adresimi i nevojave të grupeve të tilla përmes pjesëmarrjes publike) të ketë në konsideratë aspektet e ndjeshmërisë gjinore.
- Efikasiteti - ti prijë zhvillimit strategjik në territorin e komunës dhe të trajtojë çështjet e rëndësishme strategjike për fushat përkatëse.
- Transparenca – të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të kenë arsyen, dhe personat përgjegjës duhet të jenë transparent për zhvillimet në hapësirë.
- Pjesëmarrja – në këtë rast plani zhvillimor komunal si projekt shumë i rëndësishëm për të ardhmen e komunës duhet të përfshijë pjesëmarrje të gjerë me qëllim të përfaqësimit të interesave të të gjithëve pa dallime.
- Përgjegjshmëria – për të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të jemi të përgjegjshëm. Këtë duhet ta bëjë si sektori publik, privat dhe deri te qytetari më i thjeshtë.

2.3 Qëllimet afatgjate të zhvillimit

Në këtë pjesë janë prezantuar të gjitha qëllimet e përgjithshme që duhet të arrihen në zhvillimin e ardhshëm të komunës. Gjithashtu në kuadër të këtyre qëllimeve të përgjithshme janë specifikuar edhe qëllimet më konkrete apo specifike.

Qëllimi 1. Administratë funksionale dhe efikase

Synimi 1 (Q1S1): Kuadër profesional

Synimi 2 (Q1S2): Avancimi i sistemit elektronik

Synimi 3 (Q1S3): Digjitalizimi i administratës

Qëllimi 2. Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi

Synimi 1 (Q2S1): Ndërtimi i objekteve shkollore në ato vendbanime ku janë identifikuar kërkesat

Synimi 2 (Q2S2): Zgjerimi i hapësirave dhe ngritja e cilësisë fizike të objekteve arsimore dhe shëndetësore

Synimi 3 (Q2S3): Rritja e numrit të kuadrit të kualifikuar profesional, në arsim dhe shëndetësi

Synimi 4 (Q2S4): Programe dhe trajnime të vazhdueshme profesionale në arsim dhe shëndetësi

Synimi 5 (Q2S5): Sigurimi i pajisjeve teknike për shërbime arsimore dhe shëndetësore

Synimi 6 (Q2S6): Shtirja e arsimit para fillor edhe në vendbanimet tjera

Qëllimi 3. Zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë

Synimi 1 (Q3S1): Organizimi i programeve dhe trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut

Synimi 2 (Q3S2): Sigurimi i punës sezonale

Synimi 3 (Q3S3): Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme

Qëllimi 4. Krijimi i kushteve më të mira në viset rurale

Synimi 1 (Q4S1): Lidhje funksionale me qendrën urbane

Synimi 2 (Q4S2): Ofrim adekuat i shërbimeve publike

Qëllimi 5. Zhvillim kompakt dhe funksional i vendbanimeve

Synimi 1 (Q5S1): Formimi i qendrave sekondare

Synimi 2 (Q5S2): Përpilimi i Hartës Zonale të Komunës në përputhshmëri me Ligjin Nr. 04/L-174 e cila do të trajton sipërfaqen deri në nivel të Kushteve Ndërtimore (sipas nenit 16).

Synimi 3 (Q5S3): Zgjidhje për ndërtimet ilegale dhe vendbanimeve joformale

Qëllimi 6. Mjedis të pastër me shfrytëzim racional dhe mbrojtje efikase

Synimi 1 (Q6S1): Parandalimi dhe largimi i mbeturinave nga trupat ujor dhe mjedise tjera

Synimi 2 (Q6S2): Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale ne lumenj si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim te ujërave të zeza

Synimi 3 (Q6S3): Ndërmarrja e masave anti-erozive

Synimi 4 (Q6S4): Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve

Synimi 5 (Q6S5): Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore

Synimi 6 (Q6S6): Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve

Qëllimi 7. Zhvillim i harmonizuar dhe i qëndrueshëm ekonomik

Synimi 1 (Q7S1): Zhvillim dhe rritje e prodhimtarisë në bujqësi (drithërave, pemëtarisë dhe perimtarisë)

Synimi 2 (Q7S2): Përkrahja e zhvillimit të blegtorisë dhe bletarisë

Synimi 3 (Q7S3): Funksionalizimi i zonave industriale

Synimi 4 (Q7S4): Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore (drurit, inerteve etj)

Synimi 5 (Q7S5): Krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit

Synimi 6 (Q7S6). Krijimi i kushteve për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme

Qëllimi 8. Infrastrukturë e planifikuar

Synimi 1 (Q8S1): Asfaltimi i rrugëve për zonat me prioritet.

Synimi 2 (Q8S2): Përmirësim i rrjetit energjetik

Synimi 3 (Q8S3): Ndriçimi i rrugëve në zona të frekuentuara,

Synimi 4 (Q8S4): Shtrirja e telefonisë fikse dhe internetit në zonat me prioritet.

Synimi 5 (Q8S5): Zgjerim dhe kontroll i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

Synimi 6 (Q8S6): Organizim i grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre.

2.4 Prioritetet Strategjike

- 1. Zhvillim i harmonizuar dhe i qëndrueshëm ekonomik**
- 2. Zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë**
- 3. Mjedis të pastër me shfrytëzim racional dhe mbrojtje efikase**
- 4. Zhvillim kompakt dhe funksional i vendbanimeve**

- 5. Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi**
- 6. Administratë funksionale dhe efikase**
- 7. Infrastrukturë e planifikuar**

“KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR”

FAZA E TRETË

3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË KOMUNËS

Bazuar në procesin e planifikimit hapësinor dhe në Ligjin për Planifikim Hapësinor 2003/14, Ligjin L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, faza e tretë e planit duhet të përmbaj kornizën e zhvillimit hapësinor. Kjo fazë e zhvillimit hapësinor shpreh parashikimin e dëshiruar hapësinor për territorin e komunës së Podujevës. Përcakton konceptin hapësinor të strategjive për implementim, planet e veprimt dhe të vendimmarrjes. Korniza e zhvillimit hapësinor në komunën e Podujevës përmban:

1. Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor
2. Strukturën dhe lokacionin hapësinor për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm ku do të adresohen çështjet si:
 - a) Zhvillimi ekonomik, rigjenerimi, përfshirë turizmin, rekreacionin, tregtinë dhe veprimtaritë tjera ekonomike.
 - b) Infrastrukturën – transportin komunal, komunikimet, etj.
 - c) Popullsinë, banimin, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgiminë, etj.
 - d) Mjedisin, përfshirë trashëgiminë natyrore dhe resurset, peizazhet etj.
3. Shënjimi i zonave urbane ekzistuese dhe të propozuara për të ardhmen dhe zonave tjera jashtë zonës urbane.
4. Shënjimi i ndërtimeve të rëndësishme, projekteve strategjike, ose zonave të veçanta të cilat veç janë aprovuar në Planin Hapësinor të Kosovës.
5. Vlerësimi i ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor i kornizës së propozuar.
6. Plani Lokal i veprimt ne mjedis.

3.1. Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor

Formulimi i koncepteve rrjedh nga analiza e gjendjes ekzistuese të zhvillimit hapësinor të komunës së Podujevës, ku janë analizuar faktorët natyror në mënyrë detale, ndërsa nga ky kompleks janë dalluar tri tërësi hapësinore të cilat ndryshojnë për nga karakteristikat e tyre natyrore, niveli i zhvillimit socio-ekonomik dhe parashikimet e aktivitetit të ardhshëm human. Në bazë të këtyre koncepteve mundësohet marrja e vendimeve për kahet e zhvillimit të ardhshëm në këtë hapësirë.

Në këtë kompleks hapësinor dallohen tri tërësi me karakteristika të veçanta natyrore, mjedisore dhe humane:

1. Tërësia hapësinore nën 700 metra të lartësisë mbidetare, e rrafshët dhe pjesërisht me relief të valëzuar, me tokë bujqësore të cilsisë së lartë, me numrin më të madh të vendbanimeve dhe koncentrimin e popullsisë.
2. Tërësia e pejzazheve malore në anën veriore, e pasur me pyje dhe kullosa, me dendësi të vogël të banimit dhe me infrastrukturë pak të zhvilluar.
3. Tërësia e viseve kodrinore-malore në anën lindore, me pejsazhe të bukura natyrore, me dendësi të vogël të banimit dhe me infrastrukturë pak të zhvilluar, por me perspektivë premtuese për zhvillimin e turizmit.

Pra, diversiteti natyror i kësaj komune ka kushtëzuar një strukturim të tillë që ofron edhe mundësi për aktivitete të llojllojshme të shoqërisë njerëzore.

Bazuar në fazën e parë të planit zhvillimor komunal, ku trajtohet profili i gjendjes ekzistuese, konsiderohet se Komuna e Podujevës ofron mundësi për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe perspektivë për banorët e saj. Natyra e qetë e maleve në anën veri-perëndimore dhe lindore paraqet ambient të përshtatshëm për pushim dhe rekreacion, si dhe aktivitete tjera me karakter ekonomik. Në anën tjetër, pjesa qendrore e fushës së Llapit, nëpër të cilën kalojnë dy lumenj shumë të rëndësishëm për komunën e Podujevës, Lumi Llap dhe lumi i Dumnicës, të cilët ofronjnë potencial dhe kushte të mira për sektorin e agrikulturës, zhvillimin e bizneseve, vendbanimeve dhe infrastrukturës moderne.

Zona fushore e komunës së Podujevës ofron perspektivë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, ku dominon agrobiznesi si dhe aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe shërbyese. Kjo zonë, e cila do të quhet “Zona Aktive Zhvillimore” karakterizohet me zhvillim të gjithmbarshëm, me përqendrim të madh të popullsisë dhe aktivitete në tregti e biznese, të cilat qëndrojnë ngushtë të lidhura edhe me zhvillimin e komunikacionit e transportit, si dhe zhvillimit të bujqësisë, por njëkohësisht edhe me ndikime të theksuara mjedisore. Kjo zonë është edhe zona më e ndërlikuar në kuptimin e planifikimit dhe menaxhimit hapësinorë në komunën e Podujevës, prandaj duhet kushtuar vëmendje e veçantë gjatë procesit të hartimit të PZHK-së, si dhe duhet llogaritur në fleksibilitetin e implementimit të PZHK-së.

Zona veri-perëndimore dhe lindore e komunës së Podujevës karakterizohet me resurse të theksuara natyrore (pyje dhe potencial ujor), dendësi të vogël banimi, rrjet të dobët të infrastrukturës lokale si dhe me tendencë të largimit të popullsisë nga këto anë. Në zonën lindore ndodhet edhe liqeni i Batllavës, si burim kryesor i ujit për komunën e Podujevës dhe me gjerë, që ofron mundësi për rekreacion, furnizim, ujitje etj. Vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet mbrojtjes dhe menaxhimit efektiv të resurseve ujore. Mbrojtja dhe menaxhimi i pellgut të lumit Llap dhe rrjedhave tjera ujore është i një rëndësie të veçantë nga se vazhdimisht po rrezikohen nga veprimet e pa kontrolluara të njeriut. Mbrojtja, zhvillimi dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe potencialeve të kësaj komune mundëson hapjen e perspektivave të reja për zhvillimin të gjithmbarshëm.

Qyteti i Podujevës ofron mundësi për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në njërin anë, kurse në anën tjetër, potencialet ujore, pejzazhet malore, kullosat e shumta, pyjet, mundësojnë ndërtimin e akumulacioneve të mundshme ujore për rekreacion dhe energjetikë, zhvillimin e turizmi, rekreacionit, blegtorisë, bujqësisë, industrisë së drurit etj, ndërsa të gjitha aktivitetet tjera që e dëmtojnë dhe ndotin ambientin duhet doemos t’i nënshtrohen masave të mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe të ndalen.

Në zonat rurale propozohet favorizim dhe ofrim i shërbimeve me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së jetës; shkolla, shërbime mjekësore, infrastrukturë teknike. Kjo do të ndikonte në stabilizimin e migrimëve dhe rritjen e numrit të popullsisë në fshat.

Në komunën e Podujevës janë prezentë 78 vendbanime. Ofrimi i shërbimeve dhe infrastrukturës në vendbanimet e vogla dhe me karakter shpërndarës është joefikas dhe kjo shprehet me kosto të lartë. Duhet përcaktuar pikat më të përshtatshme dhe të favorshme për ofrimin e shërbimeve, ndërsa kjo do

të reflektohet në koncentrimin e popullsisë e jo në dezintegrim të saj. Kjo është një nga arsyet e largimit të popullsisë nga fshati. Me formimin e disa qendrave sekondare dhe lokale do të minimizoheshin këto probleme, kurse popullsia do të vendoste përfundimisht për të jetuar në fshat sepse shërbimet do të ishin afër.

Stimulimi i ndërtimeve me karakter banimi dhe ekonomik në qendrat sekondare do të ketë trajtim të veçantë ndaj tokës bujqësore të produktivitetit të lartë (klasa II-IV). Për çdo vendbanimin do të parashihen kufijtë e mundshëm të zgjerimit dhe do të përcaktohen kufijtë e lejuar të ndërtimit me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore

3.2 Skenarët e zhvillimit hapësinor

Shtirja hapësinore e aktiviteteve zhvillimore në komunën e Podujevës ka disa karakteristika jo të favorshme:

- Zhvillim jo të balancuar hapësinor - Koncentrimi i zhvillimeve në zonën fushore, konkretisht hapësira në mes të dy lumenjve dhe anëve të tyre. Në këtë zonë është e koncentruar pjesa dërmuese e popullsisë dhe vendbanimeve të komunës, veprimtaritë ekonomike, sociale, politike, nyjet kyçe të infrastrukturës dhe komunikimeve, si dhe ekzistojnë konfliktet me zënie e tokës bujqësore që është e koncentruar po ashtu në këtë hapësirë. Toka bujqësore përshkohet nga dy lumenjtë e komunës së Podujevës: Lumit Llap dhe Dumnica.
- Zhvillimet lineare – Pothuajse të gjitha zhvillimet dhe aktivitetet (vendbanimet, popullsia dhe i tërë zhvillimi ekonomik) janë të koncentruara përgjatë akseve kryesore rrugore.
- Shfrytëzim jo racional i resurseve – Fondi i tokës bujqësore është i konsiderueshëm në komunën e Podujevës. Por, në këto sipërfaqe janë të koncentruara numri m Vendbanimet, popullsia dhe tërë zhvillimi ekonomik i madh i vendbanimeve dhe zhvillimet tjera. Nga ndërtimet e pa planifikuara po rrezikohen vazhdimisht tokat më produktive. Gjithashtu shfrytëzimi i pyjeve në disa pjesë të komunës është duke u shfrytëzuar në mënyrë jo racionale.


Gjatë analizës së gjendjes ekzistuese, gjegjësisht hartimit të fazës së parë, hartës së shfrytëzimit të tokës dhe analizave të tjera me karakter të veçantë, konstatohet se në komunën e Podujevës janë prezentë dy koncepte zhvillimore, të cilat kanë evoluar pa ndonjë rregull të caktuar. Këto dy koncepte zhvillimore janë: koncepti linear dhe koncepti monocentrik.

3.2.1 Zhvillimi linear

Ky skenar i zhvillimit përcjell kryesisht vijat ose korridoret rrugore të karakterit nacional sic janë rruga M25, R126, R125, R128, si dhe të disa rrugëve të rëndësishme lokale që lidhin qytetin dhe vendbanimet tjera në mes vete. Zhvillimet përgjatë rrugëve M25, R126, R125 janë më të theksuara dhe kanë kryesisht shtirje lineare. Gjithashtu në një dimension pak më të madh të karakterit mjedisor, zhvillimet lineare shtrihen përgjatë dhe në mes dy lumenjve (Llapi dhe Dumnica), si dhe në dy anët e tyre duke filluar nga jugu në drejtim të veriut. Mu në këtë zonë ose korridor kemi të bëjmë

me përqendrimin e shumë vendbanimeve, aktiviteteve ekonomike-shërbyese, rrjetit të infrastrukturës dhe transportit, prezencës së tokës kualitative (II-IV) dhe me dendësi të madhe të popullsisë.

Harta 31. Koncepti linear



Koncepti linear në përgjithësi nuk është i qëndrueshëm dhe krijon më shumë konflikte sesa zgjidhje, duke rritur shkallën e investimeve, rrezikon sigurinë e banorëve, ndikon drejtpërdrejt në keqësimin e mjedisit jetësor të banorëve, rritë koston e transportit, rritë koston e mirëmbajtjes së infrastrukturës së përgjithshme fizike si dhe krijon vështirësi në zhvillimin dhe menaxhimin e çështjeve me të cilat përballet komuna e Podujevës.

Përmes këtij skenari zhvillimet kanë këto rrjedhoja:

- Në aspektin hapësinor vendbanimet zhvillohen përgjatë rrugëve kryesore duke formuar korridore dhe duke marr formën e zgjatur,
- Të gjitha aktivitetet ekonomike zhvillohen përgjatë rrugëve nacionale, regjionale dhe disa rrugëve me rëndësi lokale.
- Shpërndarja e shërbimeve themelore vështirësohet,
- Vendbanimet bashkohen mes veti dhe humbë identiteti i tyre.

Përparësitë:

- Zhvillimi i zonave rurale përgjatë korridoreve,
- Qasje e mirë në infrastrukturë rrugore.

Dobësitë:

- Disa zona të komunës mbeten të pazhvilluara,
- Zhvillimi i dobët i qendrës urbane,
- Zënia e tokës bujqësore,
- Shpenzime të larta për kyçje në infrastrukturë,
- Rritje e distancave ndaj shërbimeve.
- Zhvillim dispers i vendbanimeve.
- Pengesa në zhvillimin e komunikacionit dhe rrezikim i banorëve, etj.

Konkluzion: Ky skenar, bazuar në vlerësimin e përparësive dhe dobësive dëshmon se nuk është i favorshëm për zhvillim të mëtejshëm.


3.2.2 Zhvillimi Monocentrik

Koncepti themelor i këtij zhvillimi është se qendra urbane zhvillohet gjithnjë e më tepër në raport me rrethinën, ndërsa vendbanimet rurale ngecin në zhvillimin ekonomik dhe social. Veprimtaritë ekonomike koncentrohen kryesisht në qytet dhe në disa vendbanime tjera më të mëdha. Zona urbane dhe vendbanimet tjera shtrihen kryesisht përgjatë korridoreve të rëndësishme rrugore. Tokat bujqësore të cilësisë së lartë vazhdimisht mbulohen dhe humbin nga ndërtimet e pakontrolluara.

Zonat rurale ngecin në nivel të zhvillimit ekonomik dhe kanë infrastrukturë të zhvilluar dobët. Vendbanimet rurale përfshihen nga problemet sociale dhe largimi nga fshati drejt qytetit. Niveli i shërbimeve mbetet i ulët për shkak të lidhjeve të dobëta me qendrën kryesore dhe qendrat lokale. Qendrat lokale mbesin të dezintegroara në sistemin urban. Vendbanimet që ndodhen larg qendrës stagnojnë dukshëm në të gjitha aspektet e zhvillimit. Kjo formë zhvillimore ka tendencë të stagnimit dhe boshatisjes së këtyre vendbanimeve dhe zonës ku këto vendbanime shtrihen, kryesisht si rezultat i mungesës së infrastrukturës bazë fizike dhe sociale. Si rrjedhojë e kësaj vazhdon të rritet edhe më tej shkalla e mosinteresimit për të investuar, punuar dhe jetuar në këto zona.

Zbrazja e vendbanimeve kodrinore-malore zvogëlon dhe humbë efektin dhe bazën e valorizimit ekonomik në këto hapësira me rëndësi, ndërsa në anën tjetër kjo paraqet problem strategjik ngase këto hapësira janë zona kryesisht kufitare.

Harta 32. Koncepti monocentrik



Përparësitë:

- Bizneset zhvillohen spontanisht

Dobësitë:

- Zhvillim i pakontrolluar i vendbanimeve në tokat bujqësore,
- Fluks i shtuar i emigrantëve nga zonat rurale drejt qytetit,
- Zhvillim i pakontrolluar i ndërtimeve në zonën urbane dhe pamundësi e përcjelljes së trendëve të urbanizimit në zonën urbane nga zgjerimi i pakontrolluar,

- Humbje e kontaktit dhe lidhjeve me peizazhet e bukura malore, si dhe humbje e mbështetjes së shfrytëzimit të pasurive natyrore në viset malore,
- Lidhje e dobët e vendbanimeve rurale me zonën urbane,
- Centralizimi i institucioneve,
- Qasja e dobët e fshatrave në infrastrukturën sociale,
- Trafik i ngarkuar në qytet dhe ngarkesë në të gjitha institucionet; arsim, shëndetësi etj.

Konkluzion: Ky skenar, bazuar në vlerësimin e përparësive dhe dobësive, nuk është i favorshëm për zhvillim të mëtejshëm.

3.2.3 Zhvillim i kombinuar (policentrik dhe linear)

Koncepti policentrik ofron zgjidhje më të favorshme për zhvillim të mëtejshëm të komunës, duke mos i penguar disa aktiviteteve ekonomike dhe duke i orientuar zhvillimet e ardhme drejt arritjes së qëndrueshmërisë së tyre. Si rrjedhojë e këtij kombinimi konstatohet se koncepti i zhvillimit të ardhshëm të komunës së Podujevës është koncepti policentrik dhe linear. Qëllimi kryesor i këtij koncepti është zhvillimi i tërë hapësirës komunale, bazuar në shfrytëzimin racional të të gjitha mundësive dhe resurseve lokale, si dhe në ruajtjen e vlerave mjedisore për gjeneratat e ardhshme. Sipas këtij koncepti, zhvillimet lineare nuk do të favorizohen, ndërsa ato ekzistuese duhet të monitorohen dhe rehabilitohen aq sa të jetë e mundur. Me këtë koncept komuna e Podujevës është e organizuar me një qendër urbane (Podujeva), tri qendra sekondare (Orllani, Lluzhani, Kërpimehi) si dhe bashkësitë lokale.


Zhvillimi policentrik mundëson shpërndarjen e aktiviteteve brenda vendbanimit ose disa vendbanimeve, ndërtimin, rehabilitimin dhe pajisjen me infrastrukturë të nevojshme, qasje në transport, qasje të mirë në shërbime sociale dhe krijimin e kushteve të favorshme për punë dhe rekreacion në të gjitha vendbanimet. Gjithashtu ky orientim mundëson gjallërimin e aktiviteteve edhe në vendbanimet që ndodhen larg qendrës urbane përmes ofrimit të infrastrukturës elementare dhe shfrytëzimit të resurseve lokale për zhvillim të mëtejshëm.

Koncepti policentrik do të merr në konsideratë edhe zhvillimin e qëndrueshëm, i cili arrihet me shfrytëzim racional dhe të kujdesshëm të resurseve jo vetëm për plotësimin e nevojave të tanishme por edhe për gjeneratat e ardhshme. Pra, zhvillimi i qëndrueshëm tenton ti plotësojë nevojat apo kërkesat e tanishme duke mos rrezikuar mundësitë dhe perspektivën e gjeneratave që vijnë.

Përmes konceptit të kombinuar (policentrik dhe linear) do të realizohen zhvillime të dëshiruara në fushat, si:

1. Mbrojtje efikase e tokës bujqësore dhe zhvillim i bujqësisë
2. Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve dhe kullosave
3. Administratë efikase dhe e decentralizuar
4. Infrastrukturë adekuate me qasje të mirë
5. Vendbanime kompakte dhe funksionale
6. Ekonomi të zhvilluar dhe të balancuar
7. Mjedis të pastër dhe atraktiv

Harta 33. Koncepti i kombinuar policentrik dhe linear



Efektet e këtij skenari janë:

- Zhvillim i balancuar në mes qytetit dhe zonave rurale të komunës
- Zhvillimi i vazhdueshëm i qendrave sekondare (Orllani, Lluzhani, Kerpimehi)
- Qendrat sekondare dhe lokale u ofrojnë të gjitha vendbanimeve tjera shërbime institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale,
- Zonat rurale fitojnë perspektiva zhvillimore në bazë të qendrave sekondare dhe resurseve që disponojnë,

- Zonat ndërtimore të vendbanimeve përkufizohen qartë, ndërsa vendbanimet ndahen mes veti me gjelbërim,
- Zonat e rrafshta zhvillojnë bujqësinë moderne, ndërsa në viset kodrinore-malore zhvillohet blegtoria dhe turizmi,
- Fluksi i largimit të banorëve nga vendbanimet periferike do të zvogëlohet ose edhe ndërpritet,
- Qendrat sekondare duhet të sigurojnë tokë të mjaftueshme për banim dhe biznes,
- Në vendbanimet me funksione qendrore vendosen shërbimet kryesore publike; administrata publike, shkollat dhe qendrat shëndetësore,
- Qendrat duhet të ofrojnë shërbime dhe produkte të nevojshme për përdorim afatshkurtër dhe afatmesëm,
- Qendrat sekondare do të jenë nyje të rrjetit të infrastrukturës rrugore lokale.

Përparësitë:

- Zhvillim i qendrave sekondare,
- Zhvillim ekonomik i zonave rurale,
- Zhvillim kompakt dhe dendësim i ndërtimeve,
- Ruajtja e tokës bujqësore,
- Minimimizim i shpenzimeve në infrastrukturë,
- Zvogëlim i distancave brenda vendbanimeve,
- Lidhje e mirë e fshatrave me qendrën urbane,
- Shtrirje e volitshme e institucioneve dhe e infrastrukturës teknike dhe sociale,
- Koncentrim i burimeve përmes qendrave sekondare.

Dobësitë:

- Ngadalësim i zhvillimit të qytetit ngase vjen në shprehje ndarja e mjeteve në mënyrë të barabartë.

Konkluzion: Qëllimet e zhvillimit të ardhshëm hapësinor janë zhvillimi i balancuar ekonomik, social, i infrastrukturës, mbrojtjes së mjedisit dhe shfrytëzimit racional të resurseve.

Me qëllim të realizimit të përshtatshëm të zhvillimeve hapësinore dhe menaxhimit të tyre, është bërë kombinimi i konceptit policentrik (shpërndarjes së administratës dhe disa shërbimeve) dhe konceptit linear (ekzistues). Sipas këtij koncepti, komuna e Podujevës do të ketë zhvillim policentrik dhe linear, me tendencë të vazhdueshme të zhvillimit të qëndrueshëm.

3.3 Struktura e zhvillimit hapësinor


3.3.1. Zonat kryesore hapësinore

Komuna e Podujevës karakterizohet me tri zonat (tërësi) kryesore hapësinore, të cilat kanë dallime të theksuara në aspektin ekonomik, social, mjedisor, të infrastrukturës dhe shërbimeve. Këto tri tërësi karakterizohen me veçoritë e tyre hapësinore specifike dhe potencialeve për zhvillimin e ardhshëm. Duke marr parasysh veçoritë e tyre natyrore, resurset dhe mundësitë zhvillimore, këto zona

karakterizohen me funksione të veçanta. Zona Qendrore e komunës është hapësira më e populluar, me veprimtari ekonomike të bazuara në agrikulturë biznese dhe shërbimet themelore të cilat i ofron. Zona Veri-Perëndimore paraqet një kompleks kryesisht malor, në të cilën zhvillimi do të mbështetet në veprimtari të ekonomike të resurseve të natyrës dhe peizazheve, blegtorisë e turizmit, ndërsa Zona Lindore, kryesisht kodrinore malore dhe me potenciale ujore, paraqet bazë për zhvillimin e turizmit, blegtorisë dhe prodhimeve ekologjike bujqësore.

- 1.Zona Qendrore – Aktive
- 2.Zona Veri-perëndimore – Malet dhe Pejzazhet
- 3.Zona Lindore – Kodrinat dhe Turizmi

Harta 34. Zonat hapësinore



3.3.2. Zhvillimi Ekonomik

Komuna e Podujevës ka një bazë mjaft të mirë të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset ekzistuese. Në këtë komunë ekziston mundësia e zhvillimit të shumë sektorëve ekonomik, filluar nga veprimtaritë primare ekonomike, ato sekondare, terciare e shërbyese. Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kulloza, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve primare ekonomike. Gjithashtu, kjo komunë ka bazë të mirë edhe në veprimtari industriale, ndërsa bukuritë natyrore e sidomos liqeni i Batllavës ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin e turizmit. Podujeva duhet të ofroj shërbime edhe më efikase në të ardhmen dhe kjo mund të realizohet me një angazhim serioz dhe profesionalizëm. Tërë planifikimi për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të komunës duhet të mbështetet në potencialet ekzistuese natyrore dhe në avancimin e më tej të resurseve humane. Qëllimi kryesor është që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duke i shfrytëzuar resurset në mënyrë racionale, por gjithsesi duke i lënë mundësinë edhe gjeneratave që vijnë për ti shfrytëzuar ato resurse. Hapësira e komunës së Podujevës ka dallime të theksuara sa i përket strukturave ekonomike, sociale dhe natyrore. Bazuar në këto dallime, edhe propozimi i zhvillimit ekonomik do të ketë një diversitet të pasur. Tri zonat e komunës të ndara sipas strukturës së propozuar do të kenë zhvillim bazuar në resurset ekzistuese dhe kështu do të arrihet një zhvillim i balancuar ekonomik në tërë territorin e komunës.

3.3.2.1 Zona Qendrore – Aktive

Zona Qendrore-Aktive konsiderohet si zona që ka potencialin më të madh për një zhvillim më të hovshëm ekonomik. Në këtë pjesë janë të koncentruara pjesa më e madhe e vendbanimeve, popullsisë, shërbimeve, komunikacionit etj. Zhvillimi i ardhshëm i kësaj zone duhet të orientohet drejtë avancimit të disa prej veprimtarive aekonomike siç janë: bujqësia, industria, bizneset, shërbimet etj.

Koncentrimi i madh i vendbanimeve, infrastrukturës dhe veprimtarive të shumta ekonomike në këtë zonë mund të përcillet me konfliktin e zënies së tokës bujqësore kualitative. Për këtë arsye kërkohet që zhvillimet dhe ndërtimet në të ardhmën të jenë në kontroll të plotë dhe ato të ndodhin me plan. Zgjerimi pa kontroll i vendbanimeve dhe ndërtimet përgjatë akseve rrugore do të ndikonin në zvogëlimin e sipërfaqeve bujqësore dhe kjo më pas do të ketë ndikim negativ në zhvillimin e bujqësisë.

- Zhvillimi modern i bujqësisë – Kjo zonë ka sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore. Gjithashtu kushtet për kultivimin e drithërave dhe pemëve e perimeve janë mjaft të përshtatshme, andaj duhet bërë hapa konkret në zhvillimin intensiv të bujqësisë në këtë zonë. Së pari, institucionet komunale duhet të respektojnë vijën e zgjerimit të vendbanimeve sipas propozimit në këtë plan, pasi që kjo zonë është mjaft aktive në aspektin e zhvillimit dhe kërkohet kontroll i plotë i zgjerimit të vendbanimeve në tokat bujqësore kualitative. Element tjetër që ndikon negativisht në zhvillimin e bujqësisë është edhe shkalla e lartë e parcializimit të pronave dhe për këtë kërkohet të ndërmerret një aktivitet serioz për riorganizimin e pronave dhe shfrytëzimin efikas të tyre. Përkrahja e popullatës vendore për tu marr me bujqësi është

një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e bujqësisë pasi se kjo do të ndikoj në shfrytëzimin dhe punimin e tokës si dhe rritjen e prodhimitarisë bujqësore. Përkrahja duhet të organizohet në forma të ndryshme, filluar nga përkrahja financiare, zhvillimi i politikave bujqësore, stimulimi më pajisje moderne për bujqësi si dhe farëra të përshtatshme etj.

- **Industria** – Kjo degë ekonomike ka mbetur në nivel të ulët të zhvillimit edhe pse është sektor shumë i rëndësishëm ekonomik pasi që punëson numër më të madh të fuqisë punëtore. Element mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e industrisë në komunën e Podujevës është aktivizimi i ndërmarrjeve industriale dhe shpejtimi i procesit të privatizimit. Lëndët e para të kësaj komune si materiali ndërtimor, mineralet, prodhimet bujqësore dhe blegtorale janë një bazë e mirë që mund të ndikojnë dukshëm në zhvillimin e degëve të ndryshme të industrisë në këtë komunë. Gjithashtu edhe zhvillimi i industrisë ushqimore duhet të jetë faktor kyç i zhvillimit të bujqësisë në tërësi, bazuar në faktin se në njërin anë ekziston qasje e mirë në rrjetin e infrastrukturës dhe transportit shtetëror si dhe afërsia me qendrat e mëdha urbane, ndërsa në anën tjetër mund të krijohet lëndë e parë e mjaftueshme për përpunim si dhe kërkesa për produkte ushqimore cilësore në qendrat e tjera urbane (Prishtinë, Mitrovicë etj). Në komunës e Podujevës ekzistojnë mundësi të mira për zhvillimin veprimtarive të ndryshme industriale andaj duhet të caktohen edhe zona të veçanta të biznese. Këto zona do të jenë lokacione të cilat plotësojnë disa kriteret bazë, duke filluar nga qasja në rrugët e karakterit shtetëror, plotësimi i nevojave të infrastrukturës tjetër teknike (rrymë, ujë, kanalizim, telefoni, etj), qasje e shpejt në qendrat e mëdha urbane, posedim të tokës në pronësi të komunës ose gatishmëri e komunitetit për ndërrim ose shitje të tokës në lokacione specifike etj. Zonat të cilat i plotësojnë kriteret e lartpërmendura janë: hapësira afër rrugëve kryesore dhe vijës hekurudhore, me stacione treni, gjë që i favorizon karshi zonave tjera potenciale në komunën e Podujevës.
- **Zhvillimi i tregtisë** – Podujeva si komunë dhe si qendër urbane konsiderohet edhe tani si qendër e rëndësishme tregtare. Kjo zonë përfshinë numrin më të madh të vendbanimeve dhe popullsisë së komunës së Podujevës dhe gjithashtu pozita e përshtatshme japin mundësi të mirë për zhvillimin e tregtisë. Tregtia si veprimtari ekonomike vazhdimisht duhet të përkrahët dhe të stimulohet për faktin se kjo veprimtari ekonomike aktualisht përfshinë numër të madh të ndërmarrjeve dhe të punëtoreve. Përkrahja duhet të realizohet përmes politikave të caktuara ku tregtarët e komunës do të zgjerojnë aktivitetin e tyre dhe të bëhen me konkurrencë serioze edhe në rajon.
- **Turizmi** – Në këtë zonë ekzistojnë objekte të rëndësishme si hotele, motele, restorane etj. dhe gjithashtu edhe në të ardhmen këto veprimtari duhet të përkrahen dhe të zhvillohen. Ato do të kenë ndikim të konsiderueshëm në rritjen e zhvillimit të turizmit ditë dhe vikendore jo vetëm për banorët e komunës por edhe më gjerë. Gjithashtu kjo hapësirë është e pasur edhe me objekte të rëndësishme të trashëgimisë kulturore që ofron një bazë të mirë për zhvillimin e turizmit kulturor. Hoteleria, motelet, restorantet dhe pishinat do të ofrojnë shërbime për nevojat e banorëve të komunës, por do të kenë ndikim në rritjen e mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik të komunës. Prezenca e disa monumenteve kulturore kanë vlerën e vet në

atraksionin turistikë të kësaj komune. Peizazhi që ofron kjo zonë është imponant, për faktin se nga cilido vendbanim mund të shihen masivet malore të cilat shtrihen në tri anët e kësaj zone. Gjithashtu kombinimi i zonës së ndërtuar me korridoret e gjelbër natyrorë (kryesisht përgjatë rrjedhës së lumenjve dhe hapësirave të vogla me pyje) krijon një ambient të veçantë dhe atraktiv i cili duhet të mbrohet dhe zhvillohet.

- Transporti publik – Dendësia më e madhe e popullsisë dhe vendbanimeve kërkon një transport të mirëfillt dhe të përshtatshëm. Në këtë zonë kërkohet që në të ardhmen të përmirësohet transporti publik ku qytetarët do të kenë qasje më të mirë. Shtrirja e rrjetit të transportit dhe qasja e të gjitha vendbanimeve në të, përmirësimi në rritjen e komoditetit në mjetet e transportit publik, respektimin rigoroz të itinerareve, duhet përmirësuar vazhdimisht.
- Shërbimet – Në këtë zonë gjendet edhe qendra komunale e komunës së Podujevës dhe kjo tregon se shërbimet kryesisht janë të përqendruara në këtë pjesë. Në të ardhmen kërkohet që të rritet efikasiteti i shërbimeve dhe kjo mund të arrihet përmes decentralizimit të shërbimeve edhe në qendrat tjera sekondare. Kjo do të ndikoj në shkarkimin e qendrës komunale ekzistuese dhe ofrimin e shërbimeve më afër qytetarëve. Gjithashtu edhe digjitalizimi i administratës është një element mjaft i rëndësishëm që do të ndikoj në të ardhmen në shpejtimin e realizimit të shërbimeve për qytetar. Prania e vet qendrës komunale në këtë zonë ka ndikuar në përqendrimin e tërë kapacitetit intelektual të komunës, administratës, arsimit, shëndetësisë, ndërsa ngritja e tri qendrave tjera sekondare mundëson zhvillimin e balancuar socio-ekonomik brenda territorit të komunës. Në qendrën komunale, në Podujevë, do të realizohen shërbimet e nivelit komunal, ndërsa qendrat sekondare do ta lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për qytetarët që ndodhen larg qendrës komunale.

3.3.2.2 Zona Veri-perëndimore – Malet dhe Peizazhet

Pjesa më e madhe e kësaj zone përfshin tërësinë malore të Shalës së Bajgorës dhe është një hapësirë që përbëhet kryesisht nga sipërfaqet pyjore, livadhet dhe kullosat. Zona malore e Shalës së Bajgorës karakterizohet me vlera natyrore dhe peizazhe tërheqëse për bukuritë natyrore.

- Pylltaria – Sipërfaqet e konsiderueshme me pyje në këtë zonë mundësojnë zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit, duke stimuluar edhe përpunimin e drurit dhe artizanatëve. Mbrojtja e pyjeve nga prerja e pakontrolluar për nevoja të përpunimit, duhet të ndalet dhe të zhvillohen politika profesionale në bashkëpunim me Agjensionin Pyjor të Kosovës për shfrytëzimin racional të pyjeve si dhe realizimi i vazhdueshëm i ripyllëzimit.
- Blegtoria – Sipërfaqet e konsiderueshme të kullosave dhe livadheve janë potencial i rëndësishëm i kësaj zone për zhvillimin e blegtorisë. Banorët lokal në këto vendbanime duhet të stimulohen për zhvillimin e bujqësisë. Prodhimet blegtorale ekologjike në këtë pjesë do të ndikojnë në zhvillimin e blegtorisë dhe njëherit edhe në zhvillimin ekonomik të zonës në përgjithësi. Stimulimi duhet të orientohet në rritjen e numrit të bagëtisë dhe më pas edhe rritjen e prodhimit blegtorale duke prodhuar eko-produkte që do të ishin shumë konkurruese në treg.

- Bletaria – Ka bazë të mirë për zhvillimin ekonomik të kësaj zone. Ekonomitë familjare në vendbanimet e kësaj zone duhet të stimulohen për zhvillimin e bletarisë si veprimtari e cila është shumë profitabile dhe si rrjedhojë ka shumë mundësi të pengojë shpopullimin e zonës që është një nga problemet kryesore të kësaj zone.
- Turizmi – Natyra e bukur e kësaj zone me vegjetacion të pasur pyjor, peizazhe karakteristike, veçori të shumta gjeomorfologjike etj. janë faktor që kjo zonë të tërheq numër të madh të vizitorëve. Për ta zhvilluar turizmin në shkallë më të lartë, kërkohet që këto potenciale turistike të shoqërohen edhe me infrastrukturë të nevojshme dhe shërbime efikase turistike. Për tu realizuar një kombinim i tillë duhet të rregullohet infrastruktura e nevojshme dhe të ndërtohen objekte shërbyese turistike sipas rregullave të caktuara të ndërtimit me qëllim që ndërtimet të mos jenë pa kontroll dhe më pas të sjellin efekte negative.

3.3.2.3 Zona Lindore – Natyra dhe Turizmi

Zona e vlerave natyrore lindore shtrihet në terrenet kodrinore-malore të Gollakut. Në këtë zonë shtrihen kryesisht pyjet dhe kullosat si dhe fondi i tokave bujqësore të kategorive III-VI-VII-VIII. Peizazhet natyrore në këtë zonë janë mjaft atraktive për rekreacion dhe turizëm. Mund të thuhet se pyjet dhe kullosat, uji-liqeni, janë resurset natyrore më të rëndësishme të Zonës Lindore të komunës. Për ta zhvilluar këtë zonë në mënyrë të qëndrueshme duhet pasur parasysh parimet kryesore të zhvillimit sic janë shfrytëzimi i resurseve për nevoja momentale dhe ruajtja e tyre për nevojat e gjeneratave të ardhshme.

- Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë – Kullosat dhe livadhet janë potencial ku duhet të mbështetet zhvillimi i blegtorisë në të ardhmen, ndërsa sipërfaqet me tokë bujqësore të shfrytëzohen për zhvillimin e bujqësisë. Pylltaria dhe bletaria gjithashtu janë veprimtari ekonomike me rëndësi të veçantë për zhvillimin e kësaj zone. Që të realizohet zhvillimi i këtyre veprimtarive kërkohet stimulim dhe përkrahje e vazhdueshme për popullatën e kësaj ane që të merren me këto aktivitete.
- Zhvillimi i blegtorisë – Fondin e konsiderueshëm të livadheve e kullosave me sipërfaqe prej 2411 ha, si dhe tradita dhe gatishmëria e banorëve të kësaj ane për ta zhvilluar këtë veprimtari primare, janë bazë e mirë për zhvillim të kësaj zone. Zhvillimi i kësaj veprimtarie primare do të mundësoj edhe zhvillimin ekonomik të vendbanimeve të kësaj ane, por njëkohësisht do të mundësoj edhe zhvillimin e bizneseve në zonën aktive zhvillimore për shkak të posedimit të kushteve më të përshtatshme infrastrukturore.
- Pylltaria si aktivitet ekonomik – Edhe në këtë zonë ekzistojnë sipërfaqe të konsiderueshme me pyje dhe kërkohet një plan për shfrytëzim dhe mbrojtje të pyjeve. Mbrojtja e pyjeve ka rëndësi të veçantë për ruajtjen e mjedisit të shëndosh dhe atraktiv ndërsa shfrytëzimi racional i tyre do të ndikoj në zhvillimin e industrisë së drurit, mobileve dhe artizanateve me kapacitet të kufizuar.
- Turizmi – Në këtë zonë ekzistojnë parakushte mjaft të favorshme për zhvillimin e turizmit edhe në të ardhmen. Në këtë zonë ndodhet edhe liqeni i Batllavës, i cili i jep vlerë të veçantë kësaj zone. Resurset e shumta që ka kjo zonë përfshijnë peizazhin, pyjet, burimet ujore dhe

ujërat rrjedhëse, format e ndryshme relievore dhe luginat e përshtatshme për pushim. Për ta realizuar një zhvillim të mirëfilltë të turizmit në këtë zonë kërkohet që të investohet edhe në rregullimin e infrastrukturës turistike. Për faktin se zona e liqenit të Batllavës ka vlera të rëndësishme natyrore dhe strategjike për të cilën kërkohet një kujdes i veçantë për mbrojtjen e saj, Qeveria e Kosovës, me vendimin nr. 17/127, të datës 24.04.2013, ka bërë përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe masave mbrojtëse të burimit ujor sipërfaqësor të Akumulimit të Batllavës.

3.3.3 Parashikimet Demografike

Në procesin e planifikimit zhvillimor rol të veçantë luan edhe parashikimi i popullsisë për të ardhmen. Kjo nga fakti se i tërë ky planifikim behet për njerëzit që jetojnë sot në komunën e Podujevës si dhe për gjeneratat që vijnë.

Parashikimi demografik është proces i kompleks pasi që duhet të analizohen numër i madh i faktorëve që mund të ndikojnë në trendet e popullsisë. Si rezultat i dinamizmit të madh të popullsisë, elementet popullore mund të pësojnë ndryshime nga viti në vit dhe në këtë mënyrë të ndryshojnë trendet përcaktuese.

Bazuar në elementet bazë të zhvillimit demografik në komunën e Podujevës, janë dhënë edhe rezultatet e parashikimit demografik. Këto rezultate japin vlera për parashikimin demografik deri në vitin 2020.

Gjatë vlerësimit të popullsisë komunën e Podujevës deri në vitin 2020 janë llogaritur dy komponentët themelore që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen demografike siç janë: shtimi natyror dhe migrimi. Vlerësimet për vitin 2020 janë bërë në bazë të shënimeve të publikuara nga Enti Statistikor i Kosovës për vlerësimin e popullsisë 2011 – 2014.

Tabela 60. Projeksioni Demografik per komunën e Podujevës per vitin 2020

Viti	Gjithsej popullsia (Viti Paraprak)	Bilanci Shtimit Natyror	Bilanci i Migrimeve	Rritja e përgjithshme	Gjithsej Popullsia
2011	88,499	1,015	(637.00)	378	88,877
2012	88,877	1,245	(937.00)	308	89,185
2013	89,185	1,383	(1,517.00)	(134)	89,051
2014	89,051	1,103	(3,318.00)	(2,215)	86,836
2020	86,836	1186.5	(1602)	(415)	84,341

Duke marrë për bazë mesatarën 4 vjecare, 2011 – 2014, janë përcaktuar trendet e shtimit natyror dhe migrimeve dhe rritjes së përgjithshme të cilat mundësuan vlerësimin për numrin e përgjithshëm të popullsisë për vitin 2020. Në bazë të këtyre trendeve komuna e Podujevës në vitin 2020 pritet të ketë gjithsej 84,341 banorë. Zvogëlimi i numrit të popullsisë është rezultat i migrimit të lartë, sidomos ndërkombëtar, që është duke ndodhur në gjithë Kosovën, sidomos dy vitet e fundit. Bilanci i negativ i migrimit ka shënuar rritje të vazhdueshme nga viti 2011. Bilanci negativ i migrimit është më i lartë sesa bilanci pozitiv i shtimit natyror që ndikon që komuna e Podujevës të ketë bilanc negativ të

shtimit natyror prej 415 banorë në vit. Migrimi ndërkombëtar është sfidë e madhe, jo vetëm për autoritetet komunale të komunave, por edhe për vet qeverinë e Kosovës, pasi që ky është problem i përgjithshëm i shoqërisë kosovare. Arsyeja kryesore e migrimit të popullsisë janë shkaqet ekonomike, andaj komuna dhe qeveria e Kosovës duhet të përpilojnë plane atraktive për punësimin e popullsisë në mënyrë që të behet zvogëlimi i migrimit dhe rritjes negative të popullsisë.

Në mungesë të shënimeve ka qenë e pamundur të bëhet vlerësimi mbi numrin e popullsisë për vitin 2020 për secilin vendbanim. Megjithatë, mund të konkludohet se vendbanimet në zonat e thella malore, dhe ato më larg qendrës urbane dhe rrugëve nacionale dhe regjionale janë më pak atraktive dhe do të vazhdojnë të kenë rritje negative të popullsisë.

3.3.4 Vendbanimet

Me qëllim të organizimit sa më funksional dhe zhvillimit të kontrolluar të vendbanimeve, Plani Zhvillimor Komunal propozon shfrytëzim racional të tokës, me rritje të dendësisë së banimit.

Ky qëllim do të arrihet me shfrytëzimin racional të zbrazëtirave brenda zonave të ndërtuara, nga se vendbanimet në komunën e Podujevës, në shumicën e rasteve, janë të tipi të shpërndarë dhe ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtime brenda strukturës së tyre fizike, ndërsa kjo do të reflektohej në dendësimin e tyre. Kjo do të ndikonte në zhvillimin efikas të infrastrukturës, uljen e shpenzimeve për investime në infrastrukturë, si dhe qasjen më të lehtë të banorëve në këtë sistem, ndërsa në anën tjetër do të zvogëlohen distancat në shërbime tjera si: shkolla, institucione shëndetësore, administratë, etj. Kujdes i veçantë duhet ti kushtohet ruajtjes së tokës bujqësore, aty ku ato vendbanime tangojnë me sipërfaqet produktive, pastaj zhvillimit të infrastrukturës dhe aktiviteteve tjera.

Për minimizimin e konfliktit në mes tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të ndërtuara dhe atyre në zhvillim, vendbanimet do të zhvillohen brenda kufirit të zonës së ndërtuar, nga se ato janë zhvilluar në mënyrë disperse, ndërsa sipërfaqet e lira brenda kufijve ndërtimor janë të konsiderueshme. Në këtë mënyrë do të parandalohet zhvillimi dispers, ndërsa në anën tjetër, dendësimi i këtyre vendbanimeve do të shprehet pozitivisht gjatë zhvillimit të më tejme të tyre. Vetëm një zhvillim kompakt i vendbanimeve mund ta kursej sipërfaqen e kufizuar të tokës nga ndërtimet e pakontrolluara, ndërsa në anën tjetër vendbanimet ndryshojnë strukturën e tyre fizike duke u shndërruar në zona tërheqëse dhe funksionale për banorët.

3.3.5 Administrimi Territorial

Podujeva si qendër kryesore, e organizuar në sektor dhe njësi lokale brenda strukturës urbane, dhe qendrat sekondare: Lluzhani, Orllani dhe Kerpimehi, do të jenë qendra të rëndësishme ku ofrohen shërbimet kryesore të komunës dhe zhvillohen veprimtaritë kryesore ekonomike. Kjo u mundëson qendrave sekondare të avancojnë veprimtaritë shërbyese dhe në këtë mënyrë të zvogëlojnë distancat mes banorëve dhe shërbimeve.

Nga aspekti i shërbimeve administrative të territorit të komunës parashihet kjo formë organizative:

- Podujeva qendër administrative komunale – Qendra kryesore administrative dhe politike për tërë komunën do të jetë vet qyteti i Podujevës. Në këtë qendër urbane do të funksionoi

administrata qendrore komunale, strukturat udhëheqëse dhe politike, shërbimet kryesore komunale etj.

- Themelimi i tri njësive administrative në Lluzhan, Orllan dhe Kerpimeh. Decentralizimi i shërbimeve kryesore u mundëson qendrave sekondare të ngrisin veprimtaritë shërbyese dhe në këtë mënyrë të përmirësojnë qasjen e banorëve në shërbime. Podujeva si qendër kryesore dhe qendrat sekondare, Lluzhani, Orllani dhe Kerpimehi si nën-qendra, do të jenë vendbanime të rëndësishme ku zhvillohen veprimtaritë kryesore ekonomike dhe ofrohen shërbimet kryesore të komunës. Decentralizimi i shërbimeve në këtë formë ofron shërbimet për qytetarë, ndërsa struktura organizative e shërbimeve propozohet si në vijim:
 - Podujevë – Nën administrimin e qytetit të Podujevës janë 31 vendbanime. Në këtë qendër shërbimet i kryejnë rreth 63988 banorë, ndërsa në bazë të projeksionit demografik të paraqitur më lartë, do të ketë 60726 banorë

Tabela 61. Vendbanimet nën administrimin e qytetit të Podujevës

Nr	Vendbanimi	Sipërfaqja (km ²)	Numri i Banorëve 2011	Dendësia e Popullsisë 2011
1	Bajçinë	9.10	2358	259
2	Ballofcë	10.32	2131	206
3	Bradash	15.30	2567	168
4	Buricë	2.74	246	90
5	Dobërdol	6.50	1106	170
6	Dobratin	15.68	1576	101
7	Dumnicë e Epërme	7.44	497	67
8	Dumnicë e Poshtme	19.78	2975	150
9	Dumosh	3.43	1207	352
10	Gllamnik	9.37	3794	405
11	Kunushec	5.26	204	39
12	Letanc	3.15	2080	660
13	Livadicë	2.35	296	126
14	Lladoc	4.70	821	175
15	Llapashticë e Epërme	21.71	2363	109
16	Llapashticë e Poshtme	8.03	2701	336
17	Llaushë	9.99	980	98
18	Merdar	3.00	188	63
19	Miroc	3.65	132	36
20	Obrançë	5.84	3092	529
21	Penuhë	4.34	539	124
22	Peran	3.35	1241	370
23	Përpellac	5.57	0	0
24	Podujevë	8.90	23453	2635
25	Sfeçël	5.54	1739	314
26	Siboc i Epërm	5.80	961	166
27	Siboc i Poshtëm	1.42	454	320

28	Surkish	2.18	1091	500
29	Shajkoc	9.45	1504	159
30	Shtedim	3.40	1148	338
31	Velikarekë	6.58	544	83
TOTAL		223.87	63988.00	285.83

- Lluzhan – Nën administrimin e qendrës sekondare të Lluzhanit janë 17 vendbanime. Në këtë qendër shërbimet i kryejnë rreth 15382 banorë, ndërsa në bazë te projeksionit demografik të paraqitur më lartë, do të ketë 14338 banorë. Paraqet qendrën sekondare më të madhe për nga numri i banorëve.

Tabela 62. Vendbanimet nen administrimin e qendres sekondare te Lluzhanit

Nr	Vendbanimi	Siperfaqja (km ²)	Numri i Banorëve 2011	Dendësia e Popullsisë 2011
1	Batllavë	17.26	2334	135
2	Bellopojë	5.80	1412	243
3	Dyz	9.12	573	63
4	Gërdoc	5.90	1263	214
5	Godishnjak	2.60	353	136
6	Halabak	6.56	623	95
7	Kaçybeg	1.36	494	363
8	Lupq i Epërm	7.45	275	37
9	Lupq i Poshtëm	8.23	2113	257
10	Llugë	3.16	1404	444
11	Lluzhan	4.44	757	170
12	Majac	14.35	1622	113
13	Popovë	17.59	181	10
14	Radujevc	1.92	0	0
15	Sallabajë	2.50	506	202
16	Shakovicë	1.64	619	377
17	Tërnavë	9.03	853	94
TOTAL		118.91	15382.00	129.36

- Kerpimeh – Nën administrimin e qendrës sekondare të Kerpimehit janë 17 vendbanime. Në këtë qendër shërbimet i kryejnë rreth 5906 banorë, ndërsa në bazë te projeksionit demografik të paraqitur më lartë, do të ketë numër përafërsisht të njejtë të banorëve. Paraqet qendrën sekondare më të madhe për nga sipërfaqja me 166.9 km².

Tabela 63. Vendbanimet nen administrimin e qendres sekondare te Kerpimehit

Nr	Vendbanimi	Siperfaqja (km ²)	Numri i Banorëve 2011	Dendësia e Popullsisë 2011
1	Brecë	9.55	119	12
2	Dvorishtë	5.90	143	24
3	Kërpimeh	6.03	755	125
4	Metehi	6.87	1251	182
5	Murgull	37.53	135	4
6	Pakashticë e Epërme	15.30	732	48
7	Pakashticë e Poshtme	0.90	292	324
8	Pollatë	6.90	239	35
9	Potok	3.05	61	20
10	Reçicë	10.38	0	0
11	Repë	11.79	484	41
12	Revuq	7.92	924	117
13	Sllatinë	13.47	130	10
14	Sylevicë	10.43	63	6
15	Tërnavicë	6.31	27	4
16	Zakut	2.23	453	203
17	Zhiti	12.34	98	8
TOTAL		166.90	5906.00	35.39

- Orllan – Nën administrimin e qendrës sekondare të Orllanit janë 13 vendbanime. Në këtë qendër shërbimet i kryejnë rreth 3223 banorë, ndërsa në bazë te projekcionit demografik të paraqitur më lartë, do të ketë numër përafërsisht të njëjtë të banorëve. Paraqet qendrën sekondare më të vogël për nga numri i popullsisë.


Tabela 64. Vendbanimet nen administrimin e qendres sekondare te Orllanit

Nr	Vendbanimi	Siperfaqja (km ²)	Numri i Banorëve 2011	Dendësia e Popullsisë 2011
1	Barainë	5.91	98	17
2	Bërvenik	4.00	72	18
3	Bllatë	2.19	9	4
4	Brainë	16.65	268	16
5	Hërticë	22.59	741	33
6	Kalaticë	3.27	89	27
7	Kushevicë	4.13	873	211
8	Metergoc	16.37	79	5
9	Muhazob	4.35	0	0
10	Orllan	17.47	844	48
11	Rakinicë	4.16	14	3
12	Surdull	2.60	27	10

13	Turuçicë	15.33	109	7
TOTAL		119.02	3223.00	27.08

- Qendrat e përcatuara lokale janë: Dumnicë e Poshtme, Shtedim, Sveqël, Hërticë, Bërvenik, Lupç i Poshtëm, Tërnavë, Batllavë, Orllan, Llužhan, Gllamnik, Llapashticë e Epërme, Bajçinë, Kërpimëh, Pollatë, Zhiti. Këto paraqesin mikroqendra funksionale për rrethinën e tyre të ngushtë. Qendrat sekondare dhe qendrat e bashkësive lokale duhet të kenë qendrat e bashkësisë (komunitetit). Këto qendra ushtrojnë funksionet publike administrative dhe ofrojnë hapësirë për kulturë, shërbime postare, shërbime financiare (njësi bankare), asociacione dhe klube shoqërore, të sigurisë publike, etj.

Harta 35. Organizimi administrative



3.3.6 Zhvillimi i Vendbanimeve

Në bazë të analizave të gjendjes ekzistuese–profilin, konkludohet se dendësia e banimit është e vogël pothuajse në të gjitha vendbanimet, përfshirë edhe disa lagje të qytetit të Podujevës, ndërsa kjo do të reflektohet në shfrytëzimin joracional të tokës. Vendbanimet si njësi antropogjeografike zhvillohen në bazë të shtimit natyror dhe proceseve tjera demografike. PZHK definon zonat e zhvillimit të ardhshëm, brenda së cilave është i lejuar ndërtimi dhe zhvillimi i aktiviteteve brenda këtyre zonave. Parashikimet demografike nuk paraqesin nevojën për zgjerimin e sipërfaqeve të ndërtuara jashtë zonave aktuale nga se vendbanimet disponojnë hapësira të zbraza brenda zonave aktuale ndërtimore. Shumica e vendbanimeve shtrihen në zonën e ulët, ndërsa pjesa dërmuese e popullsisë së komunës jeton në këtë zonë e cila karakterizohet me tokën më cilësore bujqësore, që njëherit është edhe hapësira më vitale për zhvillimin e ardhshëm të komunës. Nga kjo arsye, vendbanimet do të zhvillohen në konceptin e dendësimit, gjegjësisht në plotësimin e zbrazës brenda zonave të ndërtuara.

Për arritjen e këtyre qëllimeve duhet marrë për bazë elementet në vijim:

- Dendësia e popullsisë
- Parashikimet dhe proceset demografike
- Sipërfaqet e ndërtuara ekzistuese
- Kategoria e tokave

Kërkesat dhe nevojat për tokë ndërtimore deri në vitin 2020 bazohen në prognozatat demografike dhe zhvillim ekonomik:

- Qyteti do të zhvillohet brenda kufirit të përcaktuar urban, duke plotësuar zbrazërat e sipërfaqeve të pa ndërtuara, ndërsa ndërtimi i lartë duhet përkrahur me qëllim të rritjes së dendësisë dhe ruajtjes së tokës. Kjo sipërfaqe është rreth 100 ha, që do të plotësohet me objekte banimi, infrastrukturë dhe shërbime etj. PZHK duhet do të siguroj tokë për industri dhe biznese, zonat qendrore, zonat mikste dhe zonat për përdorim të përbashkët (komunale)
- Qendrat sekondare si dhe vendbanimet përreth do të sigurojnë tokë të mjaftueshme banimi për banorët lokal. Sigurimi mesatar i tokës për banim prej 2 ha për vendbanime pa funksione dhe nga 5 ha për qendra sekondare llogaritet të jetë i mjaftueshëm për zhvillim të mëtejshëm.

Shuma e përgjithshme e nevojës për tokë për zhvillimin e vendbanimeve rurale dhe qendrave sekondare do të arrij në rreth 200 ha. Shumica e tokës së siguruar për ndërtim janë sipërfaqe të lira brenda zonës ndërtimore.

Qendrat sekondare do të sigurojnë tokë për zona mikste (rreth 2 ha) për furnizim të ndërmarrjeve të vogla dhe tregtisë.


Vendbanimet pranëqytetëse do të sigurojnë tokë për zhvillimin e zonave mikste brenda strukturës së vendbanimeve.

Shuma e përgjithshme e nevojave për tokë ndërtimore për zhvillimin e të gjitha vendbanimeve, duke përfshirë edhe qytetin e Podujevës, do të arrijë në rreth 300 ha.

Për shfrytëzim racional të tokës (me rastin e zgjerimit jashtë kufirit të zonave ndërtimore) rekomandohet ti jepet prioritet zhvillimit në tokë jo produktive.

Zhvillimi i politikës për sigurimin e tokës ndërtimore dhe aktiviteteve tjera lidhur me zhvillimin e vendbanimeve do të realizohet në faza.

Harta 36. Zgjerimi i vendbanimeve



3.3.7 Vendbanimet Joformale

Institucionet komunale, në bashkëpunim me ekipin për hartimin e planit zhvillimor komunal kanë identifikuar vendbanime joformale që duhet trajtuar urgjent. Në komunën e Podujevës është identifikuar një vendbanim jo formal i cili gjendet në zonën kadastrale të qytetit të Podujevës. Ky

vendbanim është i ndërtuar nga objekte me material shumë të dobët dhe me kushte shumë të vështira për jetesë. Aty jetojnë 132 familje me rreth 858 banorë.

Vendbanimet joformale janë definuar si vendbanime njerëzore të cilat, nuk u mundësojnë banorëve të tyre t'i gëzojnë të drejtat e tyre me standarde të jetesës adekuate.

Plani për Zbatimin e Standardeve për Kosovën, agjendat ndërkombëtare dhe Udhëzuesi për planifikimin hapësinor të vendbanimeve joformale (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) do të përdoret si kornizë për trajtimin e vendbanimeve joformale.

Propozim: Komuna e Podujevës në të ardhmen duhet që të realizoj projekt të veçantë për ndërtimin e një objekti të banimit kolektiv me standarde adekuate për vendosjen e këtyre banoreve.

3.4. Infrastruktura sociale dhe trashëgimia

3.4.1 Arsimi

Podujeva përfaqësohet me tri zona zhvillimore, secila nga këto zona kanë dallime njëra me tjetrën qoftë në aspektin territorial apo edhe në shtrirjen e objekteve shkollore në hapësirë. Dallimet e tilla shprehen edhe në numrin e nxënësve, hapësirat e brendshme shkollore, gjendjen fizike të objekteve shkollore, në numrin e mësimdhënësve dhe kualifikimin e tyre.

3.4.1.1 Zona Qendrore Aktive

Zona qendrore aktive përfaqësohet me numër më të madh të institucioneve shkollore të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët (59%). Përqindja e nxënësve dhe mësimdhënësve për këtë nivel të shkollimit sillet rreth 72% dhe 63% respektivisht. Në këtë zonë gjendet institucioni i vetëm për shkollimin parashkollor, dhe institucionet e shkollimit të mesëm të lartë. Hapësira e brendshme shkollore në shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm të ulët sillet rreth 2,9 m² për një nxënës, kurse në ato të nivelit të mesëm të lartë sillet rreth 2.8 m² për një nxënës. Raporti nxënës/mësimdhënës sillet në mesatarisht rreth 18.6 nxënës/mësimdhënës në shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, kurse në ato të nivelit të mesëm të lartë sillet në 18.7 nxënës / mësimdhënës. Përqindja e kuadrit arsimor të kualifikuar në shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm të ulët është 97%, kurse në ato të nivelit të mesëm të lartë është 89%. Objektet shkollore në aspektin fizik në janë kryesisht në gjendje të mirë fizike. Megjithatë kërkohet përmirësim i objektit të paralales së ndarë të shkollës “Shefki Kuleta” në fshatin Halabak, që është në gjendje të keqe dhe objekteve të shkollave “Dituria” në Llapashticë dhe “Emin Duraku” në Bajcinë që nuk janë në gjendje fizike të kënaqshme. Shtrirja e mësimin para fillor do të organizohet edhe në ato vendbanime ku mungon ky nivel i arsimit për moshat 5-6 vjeç. Objektet që kërkojnë urgjentisht hapësirë shkollore janë: “Emin Duraku” në Bajcinë (0.9 m² për 1 nxënës), “Ilir Konushevc” në Llugë (1.2), “Musli Dumoshi” në Dumosh (1.5), “Naim Frashëri” në Podujevë (1.8) dhe “Shaban Shala” në Podujevë (1.9). Në të ardhmen do të ndërtohen ose t'i shtohen anekse të veçanta objekteve shkollore të lartë përmendura dhe po ashtu ti kushtohet rëndësi edhe gjendjes fizike të objekteve me qëllim që të përmirësohet gjendja e tyre edhe më tutje. Në zonën qendrore aktive janë

dhjetë vendbanime që nuk kanë objekte shkollore. Në disa nga këto duhet të ndërtohen objekte shkollore gjatë periudhës dhjetë vjeçare. Gjithashtu duhet të instalohet sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit në ato shkolla ku nuk ekziston. Për zhvillimin e arsimit në komunën e Podujevës kërkohet që të vazhdohet me ngritjen e kuadrit të kualifikuar, sidomos për nivelin arsimor të mesëm të lartë, në mënyrë që të arrihet qëllimi që kuadri arsimor në shkollat e Podujevës të jetë tërësisht i kualifikuar. Poashtu duhet të vazhdoj trajnimi i kuadrit arsimor me metoda bashkëkohore dhe të bëhet përmirësimi i pajisjes me mjete mësimore dhe modernizimi i tyre. Duhet të planifikohet edhe ndërtimi i institucioneve të tjera parashkollore, kur kihet parasysh se kontigjenti i popullsisë nga 0 – 4 vjet përbën një përqindje të konsiderushme.

3.4.1.2 Zona Veri-perëndimore – Malet dhe Peizazhet

Në këtë zonë janë të vendosura rreth 27% e institucioneve shkollore me rreth 19% të numrit të përgjithshëm të nxënësve dhe afro 24% të numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve. 95% e kuadrit arsimor është me kualifikim adekuat. Të gjitha shkollat në këtë zonë i takojnë nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët. Hapësira mesatare shkollore për një nxënës është 4.7 m² dhe mesatarja nxënës/mësimdhënës sillet rreth 13.1. Shtrirja e mësimit para fillor do të organizohet edhe në ato vendbanime ku mungon ky nivel i arsimit për moshat 5-6 vjeç. Institucioni shkollor i cili kërkon urgjentisht hapësirë shkollore është: “Esat Mekuli” në Dobratin (1.8 m² për nxënës). Objektet shkollore në këtë zonë në përgjithësi janë në gjendje të mirë dhe nuk kërkohet intervenim urgjent. Duhet të instalohet sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit në ato shkolla ku nuk ekziston. Do të organizohen trajnime dhe kurse të fushave të ndryshme për qëllim të efikasitetit dhe ngritjen së cilësisë së mësimdhënësve drejt zbatimit të teknikave të reja të përcaktuara nga ana e MASHT-it. Po ashtu nevojiten përpjekje të vazhdueshme për kompjuterizimin e shkollave dhe pajisjeve tjera përcjellëse. Do të organizohet transporti publik për bartjen e nxënësve shtëpi – shkollë dhe anasjelltas, për disa vendbanime të thella malore. Duhet të planifikohet edhe ndërtimi i institucioneve parashkollore, kur kihet parasysh se kontigjenti i popullsisë nga 0 – 4 vjet përbën një përqindje të konsiderushme.

3.4.1.3 Zona Lindore – Natyra dhe Turizmi

Zona Lindore “Natyra dhe turizmi” përfaqësohet me numrin më të vogël të institucioneve shkollore (afro 15%), me rreth 9% të numrit të përgjithshëm të nxënësve dhe afro 14% të numrit të mësimdhënësve. 95% e kuadrit arsimor është me kualifikim adekuat. Të gjitha shkollat në këtë zonë i takojnë nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët. Kjo zonë dallohet me hapësirë shkollore më të madhe për nxënës, krahasuar me dy zonat e tjera (mesatarisht 5.4 m²) dhe me raport më të ulët e nxënës/mësimdhënës prej 10.7 nxënës për një mësimdhënës. Nuk kërkohet intervenim për shtim të hapësirës shkollore në asnjë shkollë. Gjendja fizike e shkollave është e kënaqshme dhe nuk kërkohet intervenim i menjëhershëm. Këto shkolla do të pajisen edhe me infrastrukturën përcjellëse dhe mbajtjen e trajnimeve të ndryshme për mësimdhënësit për qëllim të efikasitetit dhe ngritjen së cilësisë së mësimdhënësve drejt zbatimit të teknikave dhe metodave bashkëkohore. Do të instalohet sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit në ato shkolla ku nuk ekziston. Duhet të planifikohet edhe ndërtimi i dy

institucioneve parashkollore në qytet, kur kihet parasysh se kontigjenti i popullsisë nga 0 – 4 vjet përbën një përqindje të konsiderushme.

3.4.2 Institucionet Shëndetësore

Shërbimi shëndetësor në komunën e Podujevës është i organizuar në nivel parësor, këto shërbime ofrohen në QKMF, QMF dhe AMF dhe gjithashtu në sektorin privat si mundësi plotësuese organizative në zhvillimin e sistemin shëndetësor. Institucionet shëndetësore janë të shpërndara dhe mbulojnë me shërbime gjithë territorin e komunës.

Në zonën Veri-perëndimore “Malet dhe pejzazhet”, vepron një 1 QMF dhe 5 AMF të cilat ofrojnë shërbime për 15500 banorë që jetojnë në vendbanimet që shtrihen në këtë zonë, ose 17.5% të popullatës së komunës. Objektet shëndetësore, me sipërfaqe mesatare 50m²-70m² janë në gjendje të mirë fizike dhe largësia maksimale nga vendbanimet është 3-5 km. QMF punon në dy ndërrime, kurse AMF-të punojnë në një ndërrim. Gjatë vitit 2014 janë realizuar gjithsejtë 18159 shërbime shëndetësore. Sipas kriterëve të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me raportin mjek-infermier/nr. banorë vërehet mungesë e stafit mjekësor (0.77 mjek/2000banorë, 0.39 infermierë / 6000 banorë dhe infermierëve 1.16 infermierë /2000 banorë).

Në zonën “Natyra dhe Turizmi” janë pesë institucione shëndetësore, një QMF dhe katër AMF, që ofrojnë shërbime për 7634 banorë që jetojnë në vendbanimet e kësaj zone ose 8.5% të popullatës së komunës. Në të ardhmen duhet të investohet në infrastrukturë rrugore dhe transportin publik meqenëse distanca maksimale nga vendbanimet deri te objekti shëndetësor është 7-8 km. QMF punon në dy ndërrime, kurse AMF-të punojnë në një ndërrim. Përveç QMF-së, ku punojnë 2 mjek, 1 stomatolog dhe 3 infermier, në AMF-të kryesish punojnë nga një mjek dhe një infermier. Gjatë vitit 2014 janë realizuar gjithsejtë 6721 shërbime shëndetësore. Ndryshe nga zona “Malet dhe Pejzazhet”, në zonën “Natyra dhe Turizmi” raporti mjek-infermier/2000 banor tregon se ka numër më të madh të personelit sesa janë kërkesat në bazë të kriterëve të Ministrisë së Shëndetësisë (1.54 mjek në 2000 banorë dhe 2.10 infermier për 2000 banorë). Mungesa e stomatologëve është e evidente edhe në këtë zonë (0.75 stomatolog / 6000 banorë).

Në zonën “Qendrore Aktive” funksionon QKMF-ja që është bartëse e kujdesit primarë e vendosur në qytetin e Podujevës dhe ofron shërbime për gjithë popullatën e komunës. Në këtë qendër ofrohen shërbime shëndetësore në lëmi mjekësorë që si bazë kanë shërbimin e mjekësisë familjare. Gjatë vitit 2014 në këtë institucion kanë punuar 174 punëtorë shëndetësor prej të cilëve 38 mjek, 7 stomatolog dhe 129 infermier. Janë realizuar gjithsejtë 286802 shërbime shëndetësore.

Në këtë zonë funksionojnë edhe 2 QMF dhe 8 AMF. Institucionet shëndetësore të kësaj zone ofronë shërbime për 65365 banorë që banojnë në 35 vendbanimet e kësaj zone apo afro 74% të popullatës së komunës. Gjatë vitit 2014 janë realizuar mbi 33000 shërbime shëndetësore. Edhe në këtë zonë, raporti mjek/banorë është i disfavorshem pasi që numri i personelit mjekësor është më i madh se sesa janë kërkesat në bazë të kriterëve të Ministrisë së Shëndetësisë (1.57 mjek në 2000 banorë dhe 4.53 infermierë në 2000 banorë). Sukrse edhe në dy zonat e tjera, edhe këtu vërehet mungesa e stomatologëve (0.83 stomatolog / 6000 banorë).

Me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimeve shëndetësore në Komunën e Podujevës duhet të vlerësohet mundësia e shpërndarjes më të mirë të stafit mjekësor në ato hapsira ku vërehet mungesë më e madhe. Është evidente se ekziston mbipopullim i stafit mjekësorë (mjek dhe infermier) që krijon shpenzime buxhetore shtesë për komunën. Poashtu duhet të shikohen mundësitë e angazhimit të katër stomatologëve me qëllim të mbulimit të kërkesave dhe plotësimit të standardit mbi numrin e stomatologëve. Komuna duhet të vazhdojë të investojë në ngritjen profesionale të stafit mjekësorë dhe paisjen e qendrave shëndetësore me mjete profesionale shëndetësore.

3.4.3 Zbutja e Papunësisë dhe Varfërisë

Hapja e vendeve të reja të punës do ta ketë efektin e vet duke tentuar në zbutjen e papunësisë, e cila do të arrihet përmes ngritjes së gjithmbarshme të zhvillimit ekonomik. Stimulimi i bujqësisë, përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, do të përmirësojnë situatën sociale. Tërheqja e investitorëve për të investuar në këtë territor gjithashtu do të zbus problemet sociale. Organizimi i trajnimeve profesionale, sipas kërkesave të tregut, do të ndikojë pozitivisht në shkallën e papunësisë dhe varfërisë.

Në zonën qendrore aktive zbutja e papunësisë dhe varfërisë do të arrihet duke krijuar kushte të favorshme për bizneset e vogla dhe të mesme pastaj në krijimin e kushteve për tregtarët që kryejnë veprimtaritë e tyre dhe stimulimin e bujqësisë dhe sigurimi i punës sezonale. Në zonën veriore “Malet dhe peizazhet natyrore” është shumë me rëndësi që të ofrohet një infrastrukturë më e mirë dhe shërbime adekuate me qëllim që këto pjesë të mos zbrazen apo shpopullohen. Gjithashtu nevojitet të stimulohen zhvillimi i disa sektorëve ekonomik bazuar në resurset natyrore që ka kjo zonë si: Zhvillimi i blegtorisë, posaçërisht asaj të imët, Pemëtarisë, veçanërisht asaj autoktone, Turizmi (turizmi rural, i gjuetisë dhe rekreacioni. Në zonën lindore “Natyra dhe turizmi” zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë do të arrihet përmes zhvillimit të turizmit natyror dhe kulturor, përkrahjes së sektorit të gastronomisë pasi që kjo zonë ka një pozitë të mirë gjeografike, duke ruajtur dhe mbrojtur potencialet natyrore dhe kulturore të kësaj zone. Me zhvillimin e këtyre veprimtarive do të krijohen kushte më të mira për jetë, duke e zvogëluar shkallën e papunësisë, varfërisë dhe duke i bërë këto vendbanime përditë e më shumë joshëse për qytetarët.

3.4.4 Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore


Masat mbrojtëse në bazë të Ligjit për mbrojtjen e natyrës janë në funksion të zhvillimit të turizmit si dhe në funksion të mbrojtjes së natyrës. Mbrojtja e monumenteve natyrore është përgjegjësi e komunës dhe MMPH nga se vlerat e veçanta të natyrës në këto pika janë vlera të trashëguara me gjenerata të tëra dhe janë në funksion të zhvillimit të më tejshëm si në aspektin mjedisor ashtu edhe atë ekonomik.

3.4.4.1 Trashëgimia Natyrore

Vlerat e trashëgimis natyrore në komunën e Podujevës që janë nën mbrojtje, në PZHK paraqiten si tërësi që duhet mbrojtë dhe shfrytëzuar racionalisht, si dhe duhet me vendim të komunës në këto

sipërfaqe të monumenteve natyrore të ndalohet çdo veprimtari e njeriut që nuk posedon leje institucionale (ndalohet ndërtimi i çdo lloj forme apo zhvillimi i çdo lloj biznesi ekonomik pa projekt të aprovuar dhe leje adekuate komunale apo edhe nga MMPH) në sipërfaqet e shënuara.

Harta 37. Trashëgimia natyrore



- Burimi i ujit në Revuq; 1ha 16 ari e 94m, viti i shpalljes 1988, Kategoria e III-të. IUCN është i shpallur Monument natyror me karakter hidrologjik

- Burimi i ujit mineral në Sallabaj; 31 ari e 47m, viti i shpalljes 1988, Kategoria e III-të. IUCN është i shpallur Monument natyror me karakter hidrologjik
- Burimi i ujit në Shakovicë; 1ha 40 ari e 54m, viti i shpalljes 1988, Kategoria e III-të., IUCN është i shpallur Monument natyror me karakter hidrologjik
- Trungu i qarrit në Dumnicë të poshtme, i shpallur me 1988 Monument natyror me karakter Botanik
- Trungu i qarrit në Pollatë të poshtme, i shpallur me 1988 Monument natyror me karakter Botanik
- Trungu i Plepit në Orllan, i shpallur me 1988 Monument natyror me karakter Botanik (Tani ne shkatërrim e sipër)
- Trungu i qarrit në Dobratin, i shpallur me 1988 Monument natyror me karakter Botanik
- Liqeni i Batllavës.

3.4.4.2 Trashëgimia Kulturore

Trashëgimia kulturore nuk është e hulumtuar sa duhet, edhe pse në shumë lokalitete janë zbuluar mbetje të ndryshme arkeologjike që jep të kuptohet se këto hapësira kanë qenë të banuara që nga kohët e lashta ilir-romake.

Në bazë të analizave të gjendjes ekzistuese në fazën e parë të projektit, sipas Institutit për mbrojtje të monumenteve të Kosovës, si dhe të dhënave komunale janë identifikuar 11 monumente. Të gjitha këto pika arkeologjike janë lënë nën mëshirën e kohës, ndërsa edhe dora e njeriut është prezentë në shkatërrimin e tyre.

Propozohet që këto objekte të trashëgimisë të vihen nën mbrojtje institucionale si dhe ruajtja dhe konservimi i tyre si dhe shfrytëzimi për nevoja turistike

Monumente arkeologjike

1	Lokaliteti arkeologjik "Vrlab" shek.XIII-XIV, nr.V.E.K.02-475/58	Bellastica (I - 20)	1958
2	Lokaliteti arkeologjik "Poljanicë" shek.III-VI, nr.V.E.K.0301-607/85	Gllavnik (III - 7)	1985
3	Lokaliteti arkeologjik "Qyteza" shek.IV p.e.sonë dhe shek.VI të Erës sonë, nr.V.E.K.0301-78/86	Lupçi i Poshtëm (I - 26)	
4	Lokaliteti arkeologjik "Gumurishtë" shek.IV-V, nr.V.E.K.0301-80/86	Surkish (III - 8)	
5	Lokaliteti arkeologjik "Kalaja" shek.V-XIV, nr.V.E.K.0301-81/86	Ballovc (I - 28)	


Varreza

6	Mbeturinat e varreve të vjetra, vendi i kishës dhe lisi shekullor shek.XIV, nr.V.E.K.02-596/65	Palatna (I - 21)	1965
---	---	---------------------	------

Monumete të besimit ortodoks dhe katolik

7	Kisha e vjetër e braktisur e Shën Arkangjel Mëhillit (të verës), shek.XV, nr.V.E.K.02-1008/67	Rakinicë (I - 24)	1967
8	Mbeturinat e kishës së zonjës së bekuar-Zonja e Brainës, shek.XIV, nr.V.E.K.524/66	Brainë (I - 22)	1966
9	Mbeturinat e kishës "Perandori Konstantin dhe Perandoresha Jelenë" me varr, shek.XIV, nr.V.E.K.978/66	Orllan (I - 23)	
10	Mbeturinat e kishës së Marisë së zjarrtë, shek.XVII, nr.V.E.K.0301-77/86	Batlava (I - 25)	1986
11	Mbeturinat e themeleve të kishës së Shën Arkangjelit, shek.XIV, nr.V.E.K.0301-79/86	Bradash (I - 27)	

Harta 38. Trashëgimia kulturore dhe natyrore



Propozim:

- Në bashkëpunim me MKRS komunal këto 11 vend-monumente duhet të vëhen nën mbrojtje fizike dhe ligjore .
- Për shkak të vlerave të larta natyrore të tërsisë së Liqenit të Batllavës, propozohet që edhe Kulla e Zahir Pajazitit në Turiçicë të hyj në kuadër të mbrojtjes së monumenteve.

3.5. Mobiliteti dhe Rrjeti i Trafikut

3.5.1 Infrastruktura Rrugore

Tabela në vijim paraqet një pasqyrë, në bazë të së cilës do të jepen rekomandimet dhe propozimet e ardhshme zhvillimore.

Tabela 65. Rrjeti i rrugëve sipas kategorisë

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia total në km	Rrugë në Zonen Qendrore aktive	Zona Natyra dhe Turizmi	Zona Malet dhe pejsazhet
1	Rrugë nacionale	18.8	18.8	0.00	0.00
2	Rrugë regjionale	80	37.29	23.12	19.59
3	Rrugë Lokale	370.1	181	59.1	130
4	Rrugë e pa kategorizuar	756.3	370	107.8	278.5
Total		1225	607	190	428.1
%		100	49.55	15.51	34.94


Rrugët Nacionale - E tërë rruga nacionale shtrihen në zonën aktive zhvillimore dhe paraqet arterie të rëndësishme të zhvillimit të komunës, përgjatë të cilës janë zhvilluar edhe vendbanimet kryesore të komunës, përfshirë këtu edhe zonën urbane.

Segmenti i rrugës nacionale Prishtinë – Merdare (M-25). Në këtë segment nevojitet të rritet cilësia i asfaltit, duke filluar nga kufiri me komunën e Prishtinës deri te vendbanimi Merdare (zona kufitare), mirëmbajtja e rrugës, rregullimi i anësoreve dhe trotuareve, sinjalizimi, kufizimi i aktiviteteve ekonomike përgjat segmenteve rrugore sipas standarteve etj.

Rrugët Regjionale – Nga gjithsejtë 80 km të rrugëve regjionale sa ka në komunën e Podujevës, 37.2 km ose 46.5 % të tyre shtrihen në zonën aktive, ndërsa 42.8 km shtrihet në dy zonat tjera (Malet dhe Pejzazhet natyrore, Natyra dhe turizmi). Në kuadër të këtyre rrugëve hynë rrugët regjionale: Rruga R-126 Batllavë Podujevë – Pollatë, Rruga R-125 Lluzhan - Batllavë – Orllan –deri në kufi me Serbi , Rruga R127 Llapashticë e Poshtme - Podujevë – Perpelac, Rruga R128 Podujevë – Llapashticë e Epërme, Rruga R129 Bajçinë – deri në kufirin e KK të Mitrovicës.

Në segmentet e rrugëve regjionale duhet të plotësohen këto aktivitete: mirëmbajtja e rrugëve regjionale, rregullimi i trotuareve, zgjerimi i rrjetit rrugor, rregullimi i anësoreve, sinjalizimi, kufizimi i aktiviteteve ekonomike etj.

Harta 39. Koncepti i zhvillimit të infrastrukturës rrugore



Rrugë lokale – Nga gjithsejtë 370.1 km të rrugëve të kategorisë lokale 181 km të rrugëve lokale shtrihen në zonën aktive zhvillimore dhe 189.1 km shtrihen në zonat Malet dhe Pejzazhet natyrore, dhe Natyra dhe turizmi, të cilat mundësojnë lidhje direkte të vendbanimeve me rrugët nacionale dhe regionale. Nga të gjitha rrugët lokale të cilat shtrihen në territorin e komunës 257.7 km ose 69.6% janë të asfaltuara. Është e rëndësishme të përmendet se rrugët lokale të cilat i lidhin vendbanimet që shtrihen në zonën aktive zhvillimore të komunës me qendrën komunale janë të asfaltuara, mirëpo statusi i tyre është i ndryshëm, duke u nisur nga fakti se një pjesë e madhe e tyre nuk janë në gjendje të

mirë, përkatësisht janë shumë të dëmtuara. Rrugët lokale duhet tu përmirësohet cilësia e asfaltit, si dhe disa nga to të asfaltohen.

Zgjerimi i rrugës nacionale – Sipas të dhënave të drejtorisë për urbanizëm të komunës së Podujevës është në plan zgjerimi i rrugës nacionale Prishtine – Merdar në 4 korsi, në segmentin nga rrethrotullimi (ku përfundon autostrada “Dr. Ibrahim Rugova”) deri tek Hotel Besiana në Podujevë, në gjatësi prej 20km.

3.5.2 Urat

Të gjitha urat e identifikuar në tërë territorin e komunës së Podujevës i takojnë dy kategorive të komunikacionit rrugor dhe komunikacionit hekurudhor. Komuna e Podujevës duhet të sigurojë mjete për rregullim, mirëmbajtje dhe zgjerim të disa urave, sepse gjatë rritjes së nivelit të ujit në liqenin e Batllavës dhe sharkimit të këtij uji në lumin Batllava po krijojnë vërshime në vendbanimet ku kalon lumi .

3.5.3 Rrjeti Hekurudhor

Rrjeti hekurudhor në komunën e Podujevës është i karakterit nacional dhe ka shtrirje në pjesën qendrore të komunës së Podujevës, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit nacional i cili i lidhë dy shtete fqinjë (Republikën e Kosovës dhe Serbinë). Kjo linjë hekurudhore kalon në pjesën qendrore të komunës së Podujevës është një binarësh me gjatësi prej 22 km. Sigurisht se shtrirja e rrjetit hekurudhor e nivelit nacional ka një rendësi shumë të madhe për komunën, si dhe ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin socio-ekonomik të saj. Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se rrjeti hekurudhorë i cili është mjaft i hershem në këtë komunë është edhe si indikator për zhvillimin e vendbanimeve më të rëndësishme të komunës. Rrjeti hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Podujevës por edhe tjerat sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe udhëtarëve. Linja hekurudhore me Serbinë nuk funksionon dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes sajë.

Në rrjetin hekurudhorë i cili kalon në territorin e komunës së Podujevës është e rëndësishme që të përmirësohet sinjalizimi i rrugëve ku mbikalohet hekurudha me sinjalizim dhe masa të sigurisë adekuate në vendbanime. Gjithashtu duhet të mirëmbahet linja e hekurudhës.

3.5.4 Infrastruktura Teknike

3.5.4.1 Rrjeti Energjetik

Rrjeti i Energjetikës në komunën e Podujevës është i mbuluar mirë shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, mirëpo gjendja e këtij rrjeti në drejtime te caktuara nuk është e mire dhe kërkon intervenime. Nga gjithsejtë 110.2 km, sa ka gjatësi rrjeti energjetik i tensionit të lartë, 62.1 km (56.3%) e rrjetës energjetik gjendet në zonën aktive zhvillimore. Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kv në 20 kv.

Tabela 66. Rrjeti i energjisë elektrike, sipas kapaciteteve

Nr.	Emri i Daljes	Kapaciteti i propozuar në kv	Numri i trafstacioneve të propozuar	Statusi fizik
1	Batlavë	20	2	Përmirësim solid
2	Batlavë - Orllan	20	0	Përmirësim solid
3	Podujevë 1	20	3	Përmirësim selektiv
4	Podujevë 2	20	0	Përmirësim solid
5	Podujevë 3	20	2	Përmirësim selektiv
6	Podujevë 4	20	1	Përmirësim solid
7	Podujevë 5	20	0	Përmirësim solid
8	Sillosi	20	0	Përmirësim solid
9	Ballovcit	20	3	Përmirësim selektiv
10	Fshatrat 1	20	6	Përmirësim selektiv
11	Fshatrat 2	20	4	Përmirësim selektiv
12	Livadica	20	2	Përmirësim selektiv
13	Letanci	20	4	Përmirësim selektiv
14	Llausha	20	1	Përmirësim solid


Përmirësimi i rrjetës së energjisë elektrike në përgjithësi në nivel komune duhet të bëhet edhe në segmentin e përmirësimit të infrastrukturës fizike me shtylla elektrike. Ky segment i infrastrukturës energjetike të komunës propozohet që në të gjitha drejtimet e shpërndarjes së energjisë elektrike të kapacitetit 20KV, të bëhen në shtylla të betonit me gjatësi standarde (sipas standardeve të BE-së). Është e rëndësishme të theksohet se rrjeti fizik i energjetikës në nivel të vendbanimeve në mënyrë selektive duhet të përmirësohet me shtylla plotësuese nga druri ose betoni. Nuk parashihet zhvillim i rrjetit energjitik që mund të bie ndesh me rrjetin ekzistues të nivelit nacional.

Kualiteti i furnizimit me energji elektrike - sipas statistikave të furnizimit me energji elektrike, si dhe gjendjes së rrjetës energjetike në nivel të komunës administrative të Podujevës mund të vërehet se ka një furnizim me energji elektrike jo në nivel të kënaqshëm, prandaj duhet të përmirësohet kualiteti i energjisë elektrike në disa vendbanime të komunës duke përmisuar edhe rrjetën e energjisë elektrike, i cili do të ndikojë në zvogëlimin e humbjeve të energjisë, me qëllim që të krijohen kushte të mira për banorët të cilët jetojnë në ato vise. Zgjerimi i rrjetit të energjisë elektrike duhet të bëhet në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës, paragrafi 4.1.4 (Strategjia e Zhvillimit dhe Integritet të Infrastrukturës dhe Komunikimit).

Ndriçimi Publik – është evident vetëm në zonën urbane të komunës dhe ka gjatësi prej 4150 metra³⁹. Rrjeti i sistemit të ndriçimit është i përbërë prej shtyllave metalike të drurit dhe shtylla të metalta me lartësi deri në 8.5 m.

Është e nevojshme që rrjeti i ndriçimit publik të bëhet në vendbanimet e mëdha dhe të dendura me numër të popullsisë si dhe në qendrat Sekondare (Lluzhan, Kërpimeh dhe në Orllan).

³⁹ Të dhënat nga Komuna e Podujevës - Zyra për shërbime publike



3.5.4.2 Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm në mënyrë të organizuar në komunën e Podujevës daton që nga vitet '50-ta. Nga ky sistem furnizohej vetëm qyteti i Podujevës. Sot komuna e Podujevës furnizohen me ujë nga dy drejtime:

- Nga fabrika e ujit në Shajkovc
- Nga sistemet e pompimit nga pusët e Peranit

Sistemi i ujësjellësit qendrorë të Podujevës menaxhohet nga KUR "Prishtina" njësi operative e ujësjellësit Podujevë. Ujësjellësi aktualisht disponon me 100 litra/sec dhe ate 80 l/sec nga akumulacioni në Batëllavë i cili ndodhet në zonën "turizmi dhe natyra" dhe 20 l/sec të uji nëntokësor nga pusët e Peranit të lokalizuara në pjesën "zona qendrore aktive". Nga ky sistem furnizohen 87370 banor ose 71.51% të popullatës së komunës të cilët jetojnë kryesisht në pjesën e identifikuar si "zona qendrore aktive". Në bazë të sasisë të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banor, vlerësohet të jetë përafërsisht 90-100 litra në ditë. Në proporcion me rritjen e numrit të banorëve për 10 vitet e ardhëshme, nevoja për sasi të ujit të pijshëm do të jetë 265 litra/sec.

Në zonën "turizmi dhe natyra" ndodhet liqeni i Batëllavës dhe fabrika e përpunimit të ujit në Shajkovc. Nga 10853 banorë sa ka kjo zonë, 42.76% e tyre nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemi qendror por nga sistemet e vogla lokale dhe puse individuale nga të cilësia 80% e ujit është jo i pijshëm për shkak të ndotjes bakterore me origjinë fekale. E tëra kjo është për arsye të mungesës së dezinfektimit dhe menaxhimit të këtyre resurseve. Kjo situatë e rëndon dukshëm standardin jetësor të banorëve të kësaj zone. Kyqja e vendbanimit Orllan në ujësjellës qendror do të ndikoj në zhvillimin ekonomik të kësaj zone turistike.

Në zonën e identifikuar si "malet dhe pejzazhet" popullatë furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemet e vogla lokale dhe puse individuale të cilat e marrin ujin nga burime natyrore dhe shpimet nëntokësore. Në këtë zonë jetojnë 22207 banor ose 18.18% e popullatës. Cilësia e ujit në këtë zonë është jo e sigurtë, rezultatet flasin për nivel të lartë të kontaminimit, 65% janë ujra jo të pijshëm. Meqenëse këto sisteme nuk menaxhohen nga ujësjellësi qendrorë dhe nuk dezinfektohen, nga aspekti shëndetësor paraqesin faktor rreziku permanent për banorët dhe e rëndojnë situatën epidemiologjike në këtë zonë.

Për përmirësimin e gjendjes të furnizimit me ujë në tërë komunën duhet të investohet në: rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit ekzistues, zgjerim i rrjetit, kaptimi i burimeve potenciale, "Vrella e Revuçit" në vendbanimin Revuç dhe "Vrella e Zhitisë" në vendbanimin Zhiti, menaxhimi i sistemeve lokale dhe përcjellja dhe kontrolli i cilësisë së ujit në vendbanime pa ujësjellës.

3.5.4.3 Rrjeti i kanalizimit

Në komunën e Podujevës, kanalizimi i ujërave të ndotura është shumë pak i zhvilluar përkundër investimeve të mëdha nga investimet e komunës të cilat janë kryer gjatë vitit 2008-2009. Ndërtimi i rrjetit është bërë pa ndonjë planifikim të mirëfilltë, varësisht prej nevojave të kohës dhe mjeteve në dispozicion dhe si i tillë përcillet me probleme dhe vështirësi të shumëta. Aktualisht sistemi i kanalizimit të ujërave fekale është në menaxhim të njësisë operative të ujësjellësi i cili ballafaqohet me vështirësi të shumëta në mirëmbajtja e rrjetit për shkak të vjetërsisë, dimensioneve joadekuate të

gypave, mosfunktionalitetit të tyre si dhe mospagesës së rregullt të shërbimeve. Praktikisht vetëm 45% të popullsisë së përgjithshme në komunë janë të mbuluar me këtë shërbim. Ky sistem është i shtrirë kryesisht në “zona qendrore aktive” përkatësisht në pjesën urbane të qytetit të Podujevës, vendbanimin Letanc dhe pjesërisht në vendbanimin Peran. Ujërat të zeza pa asnjë trajtim paraprak shkarkohen në shtratin e lumit Llap duke shkaktuar ndotje të tijë.

Për vendbanimet e zonës “malet dhe pejzazhet” në vendbanimin Zakut funksionon sistemet i kanalizimit me pastrues biologjik vertikal ku në mënyrë mjaftë efikase bëhet pastrimi i ujrave dhe si të tilla nuk ndotin rrjedhat lumore.

Në zonën “natyra dhe turizmi” asnjëri nga vendbanimet nuk kanë qasje në rrjetën e kanalizimit kolektiv dhe ujërat e zeza i derdhen në mënyrë të egër në lokacione të ndryshme në vendbanimet ku jetojnë. Kjo më së shumti ndikon në ndotjen e liqenit të Batllavës si rezervuar i ujit për pije për banorët e komunës Podujevës dhe Prishtinës.

Si hap i rëndësishëm në këtë drejtim do të ishte: zgjerimi i shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në tërë territorin e komunës, sidomos në vendbanimet e mëdha dhe ato qendrore, ndërësa në vendbanimet e vogla dhe ato kodrinoro-malore të organizohet sistemi i gropave septike.

Si zgjidhje afatgjate do të ishte ndërtimi i impiantit regional për ujrave të zeza, ku do të shkarkoheshin edhe ujrata e ndotura nga komuna e Podujevës.

3.5.4.4 Rrjeti i kanalizimit të ujërave atmosferik

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit me sisteme të ndara, nga aspekti teknik është lehtë i realizueshëm dhe nuk kërkon investime të mëdha andaj edhe nga aspekti ekonomik është i qëndrueshëm. Shtrirja e lumenjve në komunën e Podujevës është një përparësi e madhe për shtrirjen e kanalizimit të ujërave atmosferik meqenëse këto ujëra nuk kërkojnë trajtim paraprak dhe mund të derdhen kudo në rrjedhjet lumore.

3.5.4.5 Menaxhimi i mbeturinave

Në komunën e Podujevës shërbimin e menaxhimit të mbeturinave e kryen KUR „PASTRIMI” Shoqëria aksionare-Prishtinë, njësia operative në Podujevë, e cila kompani i kryen shërbimet në zonën urbane dhe para lagjet e qytetit. Në bazë të analizave të bëra ky shërbim është në shkallë të ultë, vetëm 35-40% të popullatës në komunë shfrytëzojnë këto shërbime.

Bazuar në raportin e prodhimit ditor të mbeturinave/banorë vlerësohet se mesatarisht në komunën grumbullohen 34 000 tonë mbeturina në vit. Në shumë vendbanime rurale të komunës ekzistojnë deponi të egra. Përkundër faktit se këto deponi nuk janë nën mbikqyrje të kompanisë për grumbullimin e mbeturinave, me iniciativë të Komunës shpesh organizohet grumbullimi nga këto deponi dhe bartja e tyre në deponin qendrore. Ky aktivitet i kushton Komunës 6 € për një tonë të mbeturinave, andaj për të përmirësuar këtë gjendje dhe për të penguar vazhdimin e këtij fenomeni negativ duhet të merren këto veprime të nevojshme: Shtrirja e shërbimit në vendbanimet ku mungon menaxhimi i organizuar, pastrimi i deponive të egra, sidomos në toka kualitative dhe të propozohet lokacioni për grumbullim në tokat me cilësi më të ultë. Shtrirja e shërbimit në lokalitetet e qendrave

sekondar: Orllan, Lluzhan dhe Kërpimeh dhe krahas grumbullimit të mbeturinave njëkohësisht Drejtorati Komunal për mjedis duhet aplikoj masat Ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

3.5.4.6 Telekomunikacioni


- Telefonia fikse: Kapaciteti momental është i mjaftueshëm edhe për periudhën e ardhme 5 vjeçare, mirëpo është e rëndësishme që të bëhet shtrirja e rrjetit në aspektin fizik në vendbanimet e tjera të cilat janë me të mëdha për nga numri i popullsisë. Shtrirja e rrjetës së telefonisë fikse ekzistuese mundëson qasje të mbi 46.8% të popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse.
- Foltore publike: Në funksion të ofrimit të shërbimeve të telefonisë fikse do të jetë edhe rritja e numrit të foltoreve publike në vendbanimet qendrore dhe vendosja e foltoreve publike në të gjitha vendbanimet ku ka rrjet të telefonisë fikse.
- Telefonia mobile: Në territorin e Podujevës është e mbuluar mjaftë mirë. Ppothuajse të gjitha vendbanimet e Podujevës kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil kanë të shpërndara antena individuale në lokacione të ndryshme të komunës, mirëpo duhet të bëhet koncentrimi i antenave në një ose dy lokacione të caktuara në bashkëpunim me operatorët e Telefonisë Mobile.
- Shërbimet Postare : Duhet të vazhdohet shpërndarja e shërbimeve postare në sistemin aktual të shpërndarjes.
- Shërbimet e internetit: Bashkëpunimi i ngushtë me operatorët e telefonisë mobile për stimulimin e qytetarëve të Podujevës në shfrytëzimin e mundësive për përdorim të internetit në nivel të vendbanimeve që shtrihen në zonën aktive zhvillimore, duke ofruar paketa stimuluese, si dhe duhet të ndërmerret një kampanjë për informimin e qytetarëve për mundësitë e shfrytëzimit të shërbimeve të tyre.
- Radiotelevizioni: Krijimi i mundësive për qasje në radiotelevizionet nacionale dhe lokale për të gjitha vendbanimet e komunës nëse paraqitet ndonjë problem e sidomos për vendbanimet të cilat janë në zonat e thella malore.

3.6 Mjedişi dhe Shfrytëzimi i Tokës

Mjedişi karakterizohet me diversitet të formave të shumta natyrore si dhe me ndikime të ndryshme të faktorit njeri. Në bazë të veçorive fiziko natyrore dhe atyre humane, komuna e Podujevës është e ndarë në tri terësi natyrore ku përfshihen edhe aktivitetet tjera shoqëro-ekonomike

- Malet dhe Pejshazhet 27700 ha
- Zona Aktive 19480 ha
- Natyra dhe Turizmi 15690 ha
- Gjithsej Sipërfaqe 62870 ha

Harta 40. Shfrytëzimi i tokës



3.6.1 Zona Qendrore Aktive

Zona qendrore aktive karakterizohet me: toka bujqësore, shtrirje të vendbanimeve, bizneseve, tregtisë, industrisë, etj.

Tabela 67. Kategoritë e tokës

Sipërfaqja	Madhesia (ha)
Sipërfaqe Pyjore	4509
Sipërfaqe të Banuara	1649
Sipërfaqe Bujqësore	11431
Kullosat	482.2

Livadhe	1253
Degradim	16.22
Djerrina	52.26
Mbeturina	39.12
Varreza	48.11

Tabela 68. Kategoritë e tokës dhe shfrytëzimi i saj në vendbanimet e zones qendrore aktive

Emri i vendbanimeve	Numri i objekteve	Sipërfaqe km ²	Sipërfaqet e ndërtuara/ha	Sipërfaqet e lejuara për ndërtim	Sipërfaqe e kategorisë I/ha	Sipërfaqe e kategorisë II/ha	Sipërfaqe e kategorisë III/ha	Sipërfaqe e kategorisë IV/ha
Kunushec	382	4.13	44.8	5.4		37.21		321.1
Halabak	220	6.56	22.23					
Terrnavë	389	9.03	38.83					
Bajcinë	554	9.1	79.05	3.63		347.6		439.3
Dumnicë e Poshtme	839	19.8	109.1	5.8			579	261.2
Letanc	634	3.15	59.18	11.47	283.4	27.16		
Peran	290	3.35	29.09	2.93	15.6			
Obrancë	1611	5.84	138.9	30.7	83.76			141.2
Llasphticë e Eperme	1018	21.7	89.54	11.71				817.9
Llasphticë e Poshtme	729	8.03	62.57	7.42	4.43			305.4
Gllamnik	1078	9.37	99.29	11.68		29.21		515.3
Surkish	253	2.18	19.6	1.8	207.5	10.51		
Ballofc	587	10.3	46.48	7.13	16.01	331.3	273	155.7
Shtedim	200	3.4	18.16	2.07	5.05	215.5	30.7	18.55
Mirofc	33	3.65	7.11	1.62		19.96	80.1	105.9
Podujevë	3395	8.9	279.1	63.7	663.4			117.9
Penuhë	184	4.34	21.55	1.7		108.9		149.4
Godishnjak	114	2.6	12.53	1.63				234.4
Sallabajë	180	2.5	20.53	2.25				249.1
Lluzhan	298	4.44	36.47	8.32		96.59		147.3
Llugë	334	3.16	41.25	7.01		299.8		
Bellopojë	447	5.8	42.36	3.8		231.2		
Gerdoc	315	5.9	31.47	3.34		176.4		22.72
Radujevc	38	1.92	6.24	1.2		191.3		
Kacibeg	105	1.36	11.36	3.5		136.3		
Siboc i Poshtem	76	1.42	7.52	1.78		142.8		
Siboc i Epërm	474	5.8	45.97	2.53	104.6	440		35.9
Sfeqël	571	5.54	55.06	5.45	284.1	270.7		
Dumosh	299	3.43	47.88	5.72		345.6		
Lladofc	206	4.7	20.52	4.8		146.2	21	190.1
Lupc i Poshtëm	612	8.23	60.65	5.67		303.3		12.5
Shakovicë	119	1.64	16.9	3.18		138		12.45
Merdar	38	3	9.53	1.01		87.51		
Livadhia	160	2.35	13.5	3.23		58.25		
Kalaticë	81	3.27	8.58					

Shtirja e tokave bujqësore të cilësisë më të lartë kryesisht është prezente në zonën e ulët, nën 700 metra, respektivisht në “Zonën Aktive”. Në këto toka zhvillohen aktivitete të rëndësishme bujqësore sic janë mbjellja e drithërave, perimeve, kopshte për lule, sera perimesh, bimëve foraxhere, pemëve si dhe mbajtja e kafshëve të trasha (miniferma), deleve dhe shpezëve (individuale dhe minifermeve). Problem mjaft i theksuar është zënia e tokës bujqësore të kategorisë I-IV nga ndërtimet dhe zgjerimi i vendbanimeve të tipit të shpërndarë, si dhe bizneseve, sidomos përgjatë akseve rrugore.

Tabela 69: Parandalimi i ndërtimeve në tokat bujqësore (të kategorisë I-IV);



Numri i Objekteve	Sipërfaqe km ²	Sipërfaqet ndërtuara ha	Sipërfaqet e lejuara për ndërtim	Kategoria I ha	Kategoria II ha	Kategoria III ha	Kategoria IV ha
16863	199.9	1652.9	233.2	1667.8	4191.3	984.1	4253.3





Zonimi i vendbanimeve dhe kontrolli i zhvillimeve tjera në tokat bujqësore janë veprime të domosdoshme për ta ruajtur tokën cilësore.


Kjo zonë ka rreth 11100 ha tokë buke të kategorisë I-IV ku me çdo kusht duhet të ruhen nga ndërtimet dhe ndërrimi i destinimit të sipërfaqeve bujqësore në ato komerciale apo ndërtimore për banim.

Shtirja e vendbanimeve dhe bizneseve është në konflikt me tokën bujqësore, sidomos me klasat I-IV. Për minimizimin e konfliktit në mes tokave bujqësore dhe zhvillimeve aktive duhet të bëhet zonimi i sipërfaqeve të ndërtuara dhe parandalimi i shtrirjes disperse të vendbanimeve, si dhe përcaktimi i zonave të biznesit.

Prezenca e vendbanimeve të tipit të shpërndarë është karakteristikë për këtë zonë.







Zgjerimi i vendbanimeve në kufijtë e zonimit të propozuar minimizon konfliktet në mes tokës bujqësore dhe vijës ndërtimore. Me këtë propozim janë plotësuar zbrazëtirat e sipërfaqeve tokësore brenda vendbanimit. Mbrojtja e tokave në këtë zonë, në aspektin fiziko-natyror, kërkon hulumtim të detajuar të terrenit: pjerrtësisë, mbulesës pedologjike, bonitetit, lartësisë mbidetare, gjeologjisë së terrenit etj. Shikuar nga aspekti i pjerrtësisë së terrenit në këtë zonë duhen të merren masat biologjike për ndërprerjen e erozionit ose shpërlarjes së tokës. Në tokat për lavërtari, ku pjerrtësia e terrenit është më e madhe se 15%, duhet të përshtaten kulturat bujqësore adekuate (të përhershme) ose pyllëzim të asaj zone.

Vendbanimet kanë mundësi të zgjerimit të zonës banuese në tokat që kanë pjerrtësi terreni më të madhe se 12%.

3.6.2 Zona Malet dhe Pejsazhet




Zona e dytë, Malet dhe Peizazhet Malore ka gjithsej 27700 ha. Tabela e mëposhtme tregon ndarjen në bazë të llojeve të sipërfaqeve:



Tabela 70. Kategoritë e tokës

Sipërfaqja	Madhesia (ha)
Sipërfaqe pyjore	15421
Sipërfaqe të banuara	597
Sipërfaqe bujqësore	4701
Kullosat	5651
Livadhe	1266
Degradim	12.21
Djerrina	17.71
Mbeturina	14.61
Varreza	19.6

Tabela 71. Kategoritë e tokës dhe shfrytëzimi i saj në vendbanimet e zones malet dhe pejsazhet

Emri	Numri i Objekteve	Sip_km ²	Sipërfaqet e ndërtura, në ha.	Sipërfaqet e lejuara per ndertim	Sip.Kat.-I-, në ha	Sip.Kat.-I-, në ha	Sip.Kat.-III-, në ha	Sip.Kat.-IV-, në ha
Perpellac	17	5.57	2.47					
Dumnicë e Eperme	144	7.44	23.1					
Murgull	80	37.53	9.3					
Termavicë	52	6.31	4.91					
Recicë	27	10.38	3.2					
Sllatinë	86	13.47	9.15					
Dvorishtë	66	5.9	8.2					
Brecë	83	9.55	6.9					
Pollatë	138	6.9	12.24					
Potok	10	3.05	1.4					
Repë	187	11.79	16.55					
Sylevicë	71	10.43	7.2					
Zhiti	65	12.34	5.74					
Pakashticë e Epërme	303	15.3	30.01					
Metehi	368	6.87	39.77	2.92		170.4		
Kërpimëh	249	6.03	22.23	4.2		157.23		
Revuq	384	7.92	33.99	4.25				251.2
Dobratin	456	15.68	55.39	4.32				357.8
Doberdol	323	6.5	46.51	2.34		339.7		158
Llaushë	356	9.99	32.1	4.01			108	117.6
Velikarekë	246	6.58	20.91	4.53			27.98	179.6
Popovë	119	17.59	14.03					
Bradash	810	15.3	71.77	8.91		11.55	301.9	30.62
Lupc i Eperm	612	7.45	13.11					
Majac	518	14.35	53					
Buricë	86	2.74	9.45	1.72				23.91
Pakashticë e Poshtme	58	0.9	6.18					
Zakut	161	2.23	19.87	3.01				10.53





3.6.2.1 Masat për parandalimin e shfrytëzimit ilegal të pyjeve

MBPZHR - Agjencioni i Pyjeve si administrues i pyjeve të Kosovës, në bashkëpunim me komunën duhet të gjej forma dhe metoda të reja që të sigurohet menaxhim sa më i mirë dhe efikas i pyjeve dhe aktiviteteve të gjuetisë si dhe formave tjera të shfrytëzimit të mjedisit.

Para se të fillojë planifikimi për ndryshime në sektorin pyjor duhet të bisedohet me të gjitha palët e interesuara dhe të bëhet vlerësim (fizibiliteti) paraprak i të gjitha resurseve dhe rëndësinë që ato paraqesin.

Me rëndësi të veçantë do të ishte analiza ekonomike paraprake e të gjitha ndryshimeve në strukturën pyjore. Kjo është mënyrë e veçantë e planifikimit ku do të dihen mundësitë financiare dhe burimet financiare për kryerjen e këtyre ndryshimeve. Duhet të parashikohet cili do të jetë qëllimi ekonomik i çdo aktiviteti si dhe arsyeshmëria e planeve dhe veprimeve të tilla duke marrë për bazë funksionet specifike të pyjeve. Disa nga këto funksione janë mbrojtja e biodiversitetit, ruajtja e ujit, masat

kundër erozionit, por edhe funksione sociale. Çfarëdo që të bëhet me pyje ato duhet të mbrohen edhe për shkak të traditave kulturore dhe historike. Me mënyrën e re për planifikim do të mund të përdoren më gjerë edhe produktet e tjera pyjore, si kërpudha, bimë kuruese, fruta pyjore, të cilat do të sjellin gjithashtu një pjesë të ardhurave.

Mbrojtja e pyjeve nga prerjet e pa kontrolluara, si dhe shfrytëzimi dhe ripyllëzimi i hapësirave pyjore është detyrë e institucioneve përgjegjëse. Këto zona kanë atraktivitetet peizazhor dhe turistik.

Aktivitetet turistike, siç janë; pushimi, vikendi dhe format tjera, janë prezentë sidomos në kufi me komunën e Mitrovicës, ku projektet e përbashkëta ndërkomunale japin rezultatet në zhvillimin ekonomik të kësaj zone që është mjaft atraktive me llojlojshmëri të botës bimore shtazore dhe reliev të përthyer si dhe pasuri të burimeve ujore.

Dallohen peizazhe mjaft atraktive që mund të shfrytëzohen për rekreacion dhe zhvillim të aktiviteteve të ndryshme turistike dhe shëndetësore si: shëtitje, kampingje, gjueti, sport etj. Bimët mjekuese kanë përhapje në tërë zonën dhe shfrytëzimi racional i tyre mundëson zhvillimin e kësaj zone. Kjo zonë është degraduar mjaft për shkak të prerjeve ilegale të pyjeve për nevoja të ngrohjes.

Ripyllëzimi i kontrolluar zëvendëson drunjtë e prerë duke ruajtur ekosistemin. Dëmtimet në një shkallë të gjerë ndaj ekosistemeve pyjore ndodhin si rezultat i prerjeve ilegale. Për ripyllëzim përdoren një sërë metodash të cilat synojnë jo vetëm të zëvendësojnë ato masa drusore të prera por edhe të ruajnë biodiversitetin. Në të gjitha programet e ripyllëzimit kujdes i veçantë i kushtohet konservimit pyjor.

Njeriu ndikon me veprimtarinë e tij në ekosistem. Efektet pozitive janë parandalimi i erozionit, si dhe rritja e sipërfaqeve gjelbëruese që kanë efekte mjedisore dhe ekonomike. Zonë degraduese më e theksuar është përgjatë lumit “Llap”si dhe në Murgull dhe Majac ku behet eksploatimi i inerteve. Drejtoria e mjedisit së bashku me operatorët duhet ti përmbahen rregullave për eksploatim

Në fshatin Ternavë, Repë, Bradash, Velikarekë është një vendgrumbullim i mbeturinave ilegale. Propozohet që në një afat të shkurtër kohore ky grumbull mbeturinash të largohet. Degradime të tokës në forma të ndryshme janë të përhapura në shumë pjesë të kësaj zone. Erozioni si dukuri natyrore është prezentë në këtë zonë. Erozion shumë i fortë është prezent në këtë zonë në fshatrat Murgull, Tërnavicë, Reçicë, Sllatinë, Pakashticë e epërme Revuq, Bradash, ku rreth 2700 ha rrezikohen nga erozioni shumë i fortë. Me erozion të fortë janë identifikuar këto zona katastrale: Popovë, Vellikarekë, Bradash, Repë, Pollatë, dhe Zhiti.

Në këto zona janë paraparë edhe masat anti erozive si mundësi për pengimin e kësaj dukurisë (shih hartën antierozive për 3 zonat hapësinore).

3.6.3 Zona e Vlerave Natyra dhe Turizmi

Shtirja e kësaj zone në jug-lindje paraqet një tërësi me veçori natyrore të shumëllojshme si dhe me veprimtari të faktorit njeri. Kjo zonë përfshihet nga malet e Gollakut dhe njihet si zona me atraktivitet të madh turistik dhe me pejsazhe natyrore të përshtatshme për veprimtari ekonomike. Sipërfaqja e përgjithshme e kësaj zone është 15690 ha.

Tabela 72. Kategoritë e tokës



Sipërfaqja	Madhesia (ha)
Sipërfaqe pyjore	9868
Sipërfaqe të banuara	344.5
Sipërfaqe bujqësore	2758
Kullosat	1284
Livadhe	1127
Degradim	18.21
Djerrina	9.75
Mbeturina	7.87
Varreza	15.09
Liqeni	257.52

Tabela 73. Kategoritë e tokës dhe shfrytëzimi i saj në vendbanimet e zones natyra dhe turizmi

Emri	Numri i Objekteve	Sip_km ²	Sipërfaqet e ndërtuara, në ha	Sip. e lejuara për ndërtim	Kat.I.ha	Kat.II.ha	Kat.III.ha	Kat.IV.ha
Surdull	0	2.6	0.77					
Dyz	254	9.12	24.92					
Shajkofc	457	9.45	64.41	5.66		338.7		179.3
Herticë	255	22.59	23.93					
Turucicë	118	15.33	10.8					
Rakinicë	6	4.16	0.32					
Muhazob	37	4.35	2.55					
Metergoc	65	16.37	13.5					
Bllatë	30	2.19	2.63					
Bervenik	55	4	13.25					
Orllan	480	17.47	51.84					
Krushevicë	127	5.26	16.02					
Brainë	206	16.65	30.78					
Barainë	32	5.91	4.08					
Batllavë	612	17.26	66.45	3.51		118.7		435.7

Sipërfaqet pyjore janë më të përhapura në këtë zonë, me rreth 9868 ha, ose 62% të sipërfaqes së Zonës “Natyra dhe Turizmi”. Kjo zonë ka karakteristika të mira edhe për bujqësi, kullosa, livadhe si dhe atraksion i kësaj zone është Liqeni i Batllavës.

Pyjet dhe kullosat janë bartës të zhvillimit ekonomik të zonës për blegtori, pylltari, bletari si dhe vlerat natyrore janë potencial i zhvillimit të turizmit.



Degradimet e shkaktuara nga faktori njeri janë prezente në zonën kadastrale: Shajkofc, Batllavë, si dhe hudhje të mbeturinave ilegale në Dumosh, Gërdoc, Dyç, Batllavë. (vrejtje të gjitha vendbanimet kanë mbetje të amvisërisë që hudhen në mjedise të pastra).

Prerjet ilegale janë prezentë edhe në këtë zonë. Ndikimet e faktorit njeri janë prezentë dhe manifestohen në forma të ndryshme: shfrytëzim ilegal të masës drurore, shfrytëzim ilegal të inerteve, hedhje e mbeturinave në mjedise të ndryshme natyrore etj. Erozioni i fortë është prezentë në: Dyz, Surdull, Herticë, Turiçic, Rakinicë, etj. Masat antierozive të parapara në këtë zonë, për parandalimin e dukurive negative janë: ndërprerja ilegale e shfrytëzimit të masës drunore, ripyllëzimi, ndërtimi i tearracave dhe mureve mbrojtëse.

3.6.3.1 Mbrojtja e lumenjve nga ndotja

Rrjeti hidrografik në Komunën e Podujevës, shtrihet në mjedise të ndryshme natyrore; zona malore, fushore, bregore, që karakterizohet si ujë i pastër, por edhe përmes shumë vendbanimeve që nuk po kursehet fare nga ndotja dhe aktivitetet humane. Të gjitha vendbanimet në komunën e Podujevës ujërat e zeza i shkarkojnë në lumej. Lumi Llap, nga burimi deri te vendbanimet ku ndikimet antropogjene janë prezentë, i ekspozohet ndotjes në aspekte të ndryshme; hudhja e mbeturinave dhe derdhjes së kanalizimeve. Nga këto fakte ky lum i ngjan deponisë dhe kanalizimit të hapur. Ndotja e ujit në lumin Llap, nga shkarkimi i kanalizimeve pa trajtim paraprak, që nga vendbanimet e para e deri në grykëderdhje në Sitnicë, si dhe hedhja e mbeturinave ka keqsuar gjendjen. Menaxhimi efikas i mbeturinave të ngurta në vendbanimet që nuk kanë qasje në sistem ndikon pozitivisht në uljen e ndotjes. Planifikimi i ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza.-Kostoja e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza është mjaft e lartë por komuna e ka për obligim që në bashkëpunim me komunën e Prishtinës, Obiliqit, F. Kosovës të zgjedhin modalitetet e realizimit të projektit për trajtim të ujërave të zeza. Në bazë të strategjisë për trajtimin e ujërave të zeza nga Ministria e punëve të jashtme të Finlandës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Departamenti i ujërave janë dhënë dy variante për trajtim të ujërave të zeza dhe ato variante janë të planifikuara në Planin Hapësinor të Kosovës.

- Varianti 1-Trajtim i decentralizuar i ujërave të zeza, sipas të cilës çdo komunë ka impiantin e vet për trajtimin e ujërave të zeza. Pika më e ultë për trajtim e ujërave të zeza në Komunën e Podujevës është në dalje të Fshatit Lupqi i Poshtum, ku komuna duhet të parashoh ndërtimin e impiantit dhe ndarjen e parcelës për ndërtimin e tij.
- Varianti 2 - Trajtim i centralizuar i ujërave të zeza me vetëm një impiant në secilën prej shtatë kompanive regjionale ujore, ku më vonë mund te kyçen edhe zonat rurale për rreth impiantit në përputhshmëri me Planin Hapësinor të Kosoves 2010 – 2020+. Në këtë variant, komuna e Podujevës parashihet të përfshihet në impiantin regjional të Prishtinës ku planifikohet ndërtimi i saj.

Konfiguracioni i terrenit e pamundëson lidhjen e përshtatshme të kolektorëve për bartjen e ujërave fekale për trajtim për impiantin e centralizuar, andaj propozohet që impianti i decentralizuar të ketë përparësi zi realizim i projektit.

Rekomandim i veçantë për Komunën është që çdo operator industrial duhet të ketë impiant për trajtim të ujërave të zeza .

3.6.3.2 Mbrojtja nga degradimet

Rehabilitimi i këtyre sipërfaqeve është projekt që kushton dhe komuna me fondet që ka nuk mund ti realizoj këtë projekt, andaj paraprakisht ajo duhet të filloj me parandalimin e eksploatimit si masa preventive. Shfrytëzimi i këtyre inerteve mund të bëhet vetëm me projekte për shfrytëzim në qoftë se dëmet mjedisore janë të vogla dhe zona mund të rigjenerohet. Sipërfaqe të degraduara të tokës janë rreth 47 ha.

Monitorimi i kompanive që merren me eksploatimin e zhavorit është masë preventive. Komuna duhet të ketë qasje në monitorim për shkak të degradimeve mjedisore që janë duke ndodhë në territorin e komunës.

Menaxhimi i dobët i mbeturinave në nivel komune është jo i plot dhe ka ardhë deri te krijimi i punkteve ilegale të deponive të plehërave të amvisnisë dhe atyre të ngurta në një sipërfaqe prej 61.6 ha. Degradimet janë prezentë përgjatë shtratit të lumit Llap, si pasoj e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në mënyrë të pa kontrolluar, ku edhe duhet të rehabilitohet gjendja sepse paraqet rrezik të vërshimeve në tokat bujqësore.

Rekomandim:

- Të ndalohet çdo eksploatim ilegal
- Të taksohen kompanitë eksploatuese që kanë licencë, me qëllim krijimit të fondit për rehabilitim të zonave të degraduara.
- Çdo kompani t'i përmbahet projektit dhe licencës për shfrytëzim dhe rehabilitim apo rikthim i gjendjes së më parëshme.

3.7 Fatkeqësitë elementare dhe masat mbrojtëse

3.7.1 Parandalimi i vërshimeve


Lumi Llap gjatë periudhës së lagështisë ka dispozita të rrezikimit të sipërfaqeve tokësore. Sipas vlerësimeve në Hidroekonominë e Kosovës sipërfaqe që janë të rrezikuara nga vërshimet janë rreth 50 ha, ndersa në rrezik të përhershëm janë rreth 2972ha.

Rregullimi i shtretërve të lumenjve do ti zvogëlonte dëmet. Në këto pjesë kërkohet që të bëhet zgjerimi i shtretërve të lumenjve aq sa do të përballonin vëllimin e ujit në këto raste. Masë tjetër është eliminimi i lakesave të forta të lumit dhe të përcaktohet vendi për menaxhimin e brigjeve të lumenjve. Pronarët e pronave duhet që të kujdesen për prerjen e shelgjeve dhe largimin e tyre pas prerjes që mos ti bartë lumi. Mbrojtja e lumenjve nga hedhja e mbeturinave, që në këtë rast paraqesin pengesa për lëvizjen e lirë të ujit. Me qëllim të mbrojtjes së shtretërve të lumenjve, komuna, gjegjësisht inspektorati për mjedis duhet të ndërmarr masa ndaj personave fizik dhe juridik që të gjitha aktivitetet e nxjerrjes ilegale të inerteve ti parandaloj.

Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesorë duhet të kufizohet me kullota të përhershme ose pyje përgjatë vijës ujore së paku 10 m nga vija ujore me qëllim të parandalimit të vërshimeve.

Pastrimi i shtretërve të lumenjve nga mbeturinat dhe nga bimët e vet rritura është e domosdoshme si projekt në vete që të iniciohet nga Komuna dhe MMPH- Departamenti i ujërave.

Harta 41. Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet



3.7.2 Mbrojtja nga erozioni

Erozioni është një prej komponentëve mjaft me rëndësi për ta trajtuar ngase rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është prezentë pothuajse në tërë territorin e komunës së Podujevës në forma dhe madhësi të ndryshme. Përshpejtimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka krijuar edhe faktori njeri si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër prezentë është mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrtësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj.

Rajonet në të cilat erozioni ka intensitet të madh e që sjellin pasoja të dëmshme në ujë rrjedha, tokë, pyje dhe objekte dhe paluajtshme, duhet të shpallen zona erozive ku sipas Ligjit të Ujërave të Kosovës i shpallë komuna.

Me qëllim të parandalimit të aktivitetit eroziv duhet të ndërmerren hapa konkret dhe të menjëhershëm:

- 1.Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve.
- 2.Ndalimi i mbi kullotjes
- 3.Ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë erozion

Veprimet antierozive: Për të penguar vazhdimin e këtij fenomeni negativ duhet të merren këto veprime hidroteknike, bujqësore dhe biologjike:

- Masat hidroteknike
 - Ndërtimi i teracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese.
 - Ndërtimi i argjinaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gërryerjes
 - Mbjellja e fidaneve pyjore në shtretërit e lumenjve
 - Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve
- Masat bujqësore
 - Të mirëmbahen tokat bujqësore
 - Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore
 - Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet bazyar në udhëzime të ekspertëve
 - Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve.
- Masat biologjike
 - Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri
 - Ndalimi i kullotjes në masivet e varfra me bimësi
 - Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara
 - Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone ku shkalla e erozionit është e lartë.
 - Erozioni duhet të kufizohet në brigjet e lumenjve kryesor me mbjelljen e drunjtëve që do të mbulonin brezin prej 10 m largësi nga lumi
 - Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesor duhet të kufizohet me kullota të përhershme ose pyje.

Në bazë të analizave propozohen masat antierozive si vijon:


- Melorimi i pyjeve 11850 ha
- Brezi mbrojtës i shpatieve 18170 ha
- Mbrojtja me ndertimin e terracave 3498 ha
- Zonat e zhvillimit të punëve të antierozionit 790.3 ha

Propozohet që këto sipërfaqe të pyllëzohen në bashkëpunim me MBPZHR-Agjencionin e pyjeve, ku ekspertët e pylltarisë përcaktojnë varietetet e pyjeve që duhet të mbillen me qëllim që të parandalojnë rritjen e shkallës së erozionit

Kombinimi i masave antierozive është i domosdoshëm. Hulumtimet detale të terrenit nga ekspertët e fushave të ndryshme: hidrologë, gjeologë, pylltarë, agronom, etj, janë të domosdoshme dhe në bazë të rekomandimeve të tyre duhet të merren masat antierozive.

Qeveria komunale duhet ti identifikoj zonat më të rrezikuara dhe të propozoj hapa konkret antieroziv në bashkëpunim me MMPH, MBPZHR, Agjencionin e pyjeve, MSHP, MEF etj.

Harta 42. Antierozioni



3.7.3 Mbrojtja nga termetet

Në tërësi, ose thënë ndryshe, 100% të teritorit të Podujevës shtrihet në zonat me rrezikshmëri nga tërmeti 9 shkallë të Rihterit.

Ndërtimet e infrastrukturës dhe objekteve të banimit duhet ti përmbahen shkallës së intensitetit të dridhjeve për minimizimin e fatkeqësisë në raste rreziku.

Kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+3, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, sidomos urave.

Në pjesën e profilit të PZHK është paraqitur harta e tërmeteve

Zjarret

Zjarret konsiderohen si kategori e fatkeqësive që shkaktojnë shkatërrim të të mirave materiale dhe konsiderohen si fatkeqësi elementare .

Janë prezentë zjarret në mjediset e pyllëzuara si pasojë e pakujdesisë së faktorit njeri. Masat mbrojtëse parashihen konform situatave, ku qeveria komunale me institucionet adekuate formon shtabet e krizave në përkrahje të shërbimit të zjarrfikësve .

Masat mbrojtëse duhet të kryhen në bashkëpunim me institucionet gjegjëse të qeverisë (MMPH, MBPZHR, MSHP, MEF, Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit, Agjencioni i Pyjeve etj, si dhe SHPK, FSK, KFOR, Qeveria komunale, Shtabet e krizave, Zjarrfikësit etj). Këto masa janë dhënë si udhëzime për komunat, institucionet e qeverisë dhe institucionet tjera publike. Ato duhet të jenë të organizuara mirë dhe të koordinuara nga institucionet publike si: Shërbimi Policor i Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, Zjarrfikësit. Këtu përfshihet edhe KFOR-i si një nga partnerët e komunës. Përgjegjësia e këtyre institucioneve është të ndërmarrin veprime të domosdoshme parapërgatitëse për sigurimin e mobilitetit të njerëzve të involvuar në veprimet që duhet të kryhen.

Komuna është përgjegjëse të formoj mekanizma paraprak për raste rreziku dhe duhet të formohet Shtabi i Krizave si dhe të hartohen planet e veprimit në rast rreziku nga zjarri, tërmetet, rrëshqitjet e dheu, epidemitë, ndotje alarmante etj.

“STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR KOMUNAL”

FAZA IV

4. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT KOMUNAL

Faza e katërt e Planit zhvillimor për komunën e Podujevës përmban strategjinë, përmes së cilës do të realizohet vizioni për të ardhmen e komunës si dhe do të arrihen synimet dhe objektivat e parapara gjatë procesit të planifikimit. Strategjia përfshin masat dhe veprimet që do të ndërmerren në të ardhmen për ta realizuar një zhvillim më kompakt dhe të qëndrueshëm të komunës së Podujevës. Propozimet që janë dhënë në këtë strategji, janë parashikime që do të realizohen në periudhën kohore deri në vitin 2020. Të gjitha propozimet që përmban kjo fazë janë të arritshme dhe shprehin nevojat e qytetarëve të komunës.

Përmes kësaj strategjie, arrihet një zhvillim efikas në fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik, social, mjedisor, të infrastrukturës etj. Strategjia parasheh avancim të administratës komunale, të arsimit dhe shëndetësisë. Gjithashtu kjo strategji do të mundësoj krijimin e hapësirave të mjaftueshme rekreative për periudhat e ardhme kohore. Kërkesat për ndërtime të reja do të plotësohen duke bërë ndërtime të planifikuara, por njëkohësisht duke e mbrojtur mjedisin, me një përkujdesje të veçantë ndaj trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Element mjaft i rëndësishëm është edhe arritja e një zhvillimi të harmonizuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, ku bujqësia dhe aktivitetet tjera ekonomik do të jenë më të avancuar se që janë sot. Për ta realizuar zhvillimin e dëshiruar ekonomik, do të krijohen kushte më të mira për investitor dhe infrastruktura të jetë e përshtatshme dhe bashkëkohore.

4.1. Strategjia e zhvillimit social dhe administrates

4.1.1 QËLLIMI 1: Administratë funksionale dhe efikase

Shërbimet administrative luajnë një rol të rëndësishëm në jetën shoqërore. Për të pasur shërbime administrative sa më cilësore duhet të krijohen këto kushte:

- Kuadër i profesionalizuar i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve .
- Avancimi i sistemit elektronik, ku çdo qytetar të ketë mundësi të informohet me gjithçka që i intereson dhe të mund të plotësoj formular dhe parashitjet kërkesa sipas nevojës së tij përmes sistemit elektronik si digjitalizimit të administratës.
- Decentralizimi i administratës – Funksionalizimi i shërbimeve administrative edhe në qendrat sekondare dhe ato të bashkësive lokale
- Digjitalizim i administrates – Ndërtimi i sistemit të adresave – krijimi i bazës së të dhënave mbi të gjitha ekonomin familjare dhe bizneseve përmes sistemit të GIS-it

Lista e plotë e projekteve të planifikuara për periudhën 2016 – 2026 është e paraqitur në Aneksin 1.

4.1.2 QËLLIMI 2: Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi

Në komunën e Podujevës ekzistojnë numër i konsiderueshëm i objekteve arsimore dhe shëndetësore. Shtrirja dhe shpërndarja hapësinore e objekteve shkollore nuk mundëson që me këto shërbime të mbulohet i tërë territori i komunës, ndërsa objektet shëndetësore kanë një përfshirje të mirë në këtë

drejtim. Gjendja fizike e këtyre objekteve nuk është e kënaqshme. Në disa vendbanime paraqitet si problem mungesa e hapësirës, ndërsa në disa të tjera edhe mungesa e mësimdhënësve dhe kuadrit të kualifikuar. Problem tjetër mjaft i theksuar është edhe mungesa e infrastrukturës së nevojshme në këto objekte siç janë: ujësjellësi, kanalizimi etj. Gjithashtu duhet siguruar edhe pajisjet adekuate për arsim dhe shëndetësi me qëllim të avancimit të këtyre shërbimeve.

Lista e plotë e projekteve të planifikuara për periudhën 2016 – 2025 është e paraqitur në Aneksin 2.

- **Synimi 1. Ndërtimi i objekteve shkollor në ato vendbanime ku janë identifikuar kërkesat**

Ndërtimi i objekteve arsimore, rregullimi i infrastrukturës fizike dhe teknike, si rrjedhim do të ketë avancimin e shërbimeve arsimore në komunë e Podujevës. Kjo arrihet me ndërmarrjen e masave konkrete dhe me investime-projekte adekuate në drejtime të ndryshme duke përfshi:

- ✓ Ndërtimi i shkollave fillore në vendbanimet: Surkish, Sallabajë, Kunushec, Kaqibeg, Shakovicë, Revuqë, Zakut, Repw SHFMU “ Naim Frashëri” në Podujevë, i objektit për SHFMU “ Enver Maloku” në Podujevë, i objektit për SHFMU Batllava II,
- ✓ Ndërtimi i dy çerdheve/kopshteve në Podujevë
- ✓ Organizimin e transportit për nxënësit e vendbanimeve më të thella malore.

Zbatimi i këtyre masave gjegjësisht projekteve konkrete, për shkak të rëndësisë që kanë, do të realizohen në periudhën afatmesme, dhe si rrjedhojë në komunë do ketë shërbime arsimore cilësore.

- **Synimi 2. Zgjerimi i hapësirave dhe ngritja e cilësisë fizike të objekteve arsimore dhe shëndetësore**

Problem tjetër mjaft i theksuar sa i përket shërbimeve arsimore dhe shëndetësore është mungesa e hapësirës dhe infrastrukturës teknike siç janë: ujësjellësi, kanalizimi etj. Kjo do të arrihet me ndërmarrjen e masave konkrete duke përfshirë:

- ✓ Ndërtimi i anekseve dhe renovimi i objekteve shkollore në vendbanimet: Renovimi komplet i shkollës së mesme teknike “Fan Noli” Podujevë, SHFMU në Dobratin, SHFMU në Llapashticë të Poshtme, SHFMU në Zhiti, SHFMU në Bellopojë, SHFMU në Brainë, në Bajqinë, Dumosh, Siboc i Epërm, Halabak, Llugë, Lluzhan, dhe Velikarekë; me qëllim të krijimit të hapësirave të nevojshme shkollore për mësim të rregullt dhe atë parashkollor.
- ✓ Renovimi dhe zgjerim i QMF-së, në vendbanimin Kërpimeh si qendër sekondare
- ✓ Kyçja në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjitha objektet shkollore të cilat nuk janë të kyçura.
- ✓ Kyçja në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit të AMF-ve të cilat nuk janë të kyçura

Zgjerimi i hapësirave shkollore, renovimi i objekteve shëndetësore dhe shkollore do ndikoj në përmirësimin e shërbimeve përkatëse. Përmirësimi i infrastrukturës teknike në këto objekte shkollore dhe shëndetësore (ujësjellësi dhe kanalizimi) janë të parapara në pjesën e infrastrukturës teknike. Në atë pjesë është shtjelluar në tërësi në nivel komunal kyçja në sistemin e ujësjellësit

dhe kanalizimit për të gjitha vendbanimet, në kuadër të cilës do të kyçen edhe këto objektet të lartshënuara.

- **Synimi 3- Rritja e numrit të kuadrit të kualifikuar profesional, në arsim dhe shëndetësi**

Faktorë tjetër me rëndësi për përmirësimin e shërbimeve në arsim dhe shëndetësi është edhe arritja e nivelit më të lartë kualifikues për kuadrin përkatës si dhe përmbushja e standardeve.

- ✓ Në shumicën e shkollave fillore të mesme të ulëta dhe në shkollat e mesme të larta duhet siguruar kuadër të kualifikuar konform ligjit në fuqi e veçanërisht për shkollat në viset rurale dhe shkollën e mesme teknike në Podujevë.
- ✓ Në të gjitha qendrat shëndetësore të arrihet raporti 1 mjek dhe 2 infermjer për 2000 banor
- ✓ Në QMF-të arrihet raporti 1 stomatolog dhe 2 infermjer për 6000 banor.

- **Synimi 4 - Programe dhe trajnime të vazhdueshme profesionale në arsim dhe shëndetësi**

Faktorë tjetër me rëndësi për përmirësimin e shërbimeve në arsim dhe shëndetësi është edhe arritja e nivelit më të lartë kualifikues për kuadrin përkatës

- ✓ Hartimi i programeve për trajnim të vazhdueshëm si dhe licencimi dhe akreditimi i tyre
- ✓ Organizmi i trajnimeve mitologjike dhe profesionale për kuadrin arsimor dhe shëndetësor.
- ✓ Edukimi i vazhduar profesional për kuadrin arsimor dhe shëndetësor

- **Synimi 5 - Sigurimi i pajisjeve teknike për shërbime arsimore dhe shëndetësore**


Sigurimi dhe pajisjet adekuate me mjete moderne për sigurimin e kushteve më të mira për arsim dhe shëndetësi që të ndikonte në përmirësimin e cilësisë të këtyre shërbimeve.

- ✓ Krijimi i kabineteve dhe laboratorëve të fushave përkatëse (Fizikë, Kimi, Biologji, Informatikë) dhe pajisja e tyre me mjete didaktike dhe profesionale
- ✓ Pajisja me mjete teknike moderne e kryesisht ato për diagnostifikim të hershëm të sëmundjeve në të gjitha institucioneve shëndetësore.

- **Synimi 6. Shtrirja e arsimit para fillor edhe në vendbanimet tjera**

Arsimi para fillor në komunën e Podujevës në të ardhmen do të organizohet në të gjitha vendbanimet. Duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e MASHT-it të gjitha komunat janë të obliguara që arsimin para fillor ta kenë të organizuar në të gjitha shkollat fillore. Në të ardhmen ky nivel i arsimimit do të shtrihet dhe do të organizohet edhe në ato shkolla fillore ku nuk e kanë të organizuar këtë nivel të arsimimit.

Harta 43. Harta Objektet shkollore dhe shëndetësore të propozuara



4.1.3 QËLLIMI 3: Zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë

Në komunën e Podujevës ekziston shkallë e lartë e papunësisë po ashtu krahas shkallës së lartë të papunësisë paraqitet edhe shkallë mjaft e lartë e varfërisë. Për ta përmirësuar këtë gjendje, kërkohet ndërmarrja e masave konkrete që kanë të bëjnë me rritjen e numrit të punësuarve dhe rritjen e të ardhurave për kokë banori, që do të ndikojnë në ngritjen e standardit jetësor. Në zbutjen e shkallës së papunësisë dhe varfërisë hapja e vendeve të reja të punës do ta ketë efektin e vet duke tentuar që këtë zbutje ta arrijmë përmes ngritjes së gjithmbarshëm të zhvillimit ekonomik. Stimulimi i bujqësisë, përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilët sektorë do të përmirësojnë situatën sociale. Tërheqja e investitorëve për të investuar në këtë territor gjithashtu do të zbus problemet sociale. Organizimi i trajnimeve profesionale, sipas kërkesave të tregut do të ndikojnë pozitivisht në shkallën e papunësisë dhe varfërisë. Sigurimi i punës sezonale brenda dhe jashtë vendit për mesë binjakëzimit me ndonjë komunë, ndërmarrje, etj. jashtë Kosove të cilës i duhet fuqi punëtore do të jetë e mirëseardhur.

Lista e plotë e projekteve të planifikuara për periudhën 2016 – 2025 është e paraqitur në Aneksin 3.

• **Synimi 1. Organizimi i programeve dhe trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut**

Në këtë komunë është e domosdoshme organizimi i disa kurseve dhe trajnimeve të fushave të ndryshme. Këto trajnime dhe kurse do të ndikojnë pozitivisht drejt përmirësimit të gjendjes ekonomike dhe ngritjes së standardit jetësor.

- ✓ Organizimi i kurseve të rrobaqepësisë dhe parukerisë
- ✓ Organizimi i trajnimeve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë
- ✓ Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e bizneseve të vogla
- ✓ Organizimin e trajnimeve apo seminareve për përdorimin e teknikave të reja

Zbatimi i këtyre masave gjegjësisht projekteve konkrete, për shkak të rëndësisë që kanë, do të realizohen në periudhën afatmesme, dhe si rrjedhojë në komunë do ketë zbutje të papunësisë dhe ulje të varfërisë dhe përfundimisht ngritje të standardit jetësor.

• **Synimi 2. Sigurimi i punës sezonale**

Sigurimi i punës sezonale ndikon drejtpërdrejt në përmirësim të gjendjes ekonomike të banoreve të Podujevës. Po ashtu do të ndikojë në uljen e papunësisë dhe varfërisë dhe në anën tjetër do të ndikonte në edukimin e rinisë drejtë një të ardhme më të mirë.

- ✓ Mbledhja e frutave, perimeve, qajrave etj.
- ✓ Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe parqeve.
- ✓ Lidhja e kontratës sezonale me ndonjë vend – shtet në rajon.

Sigurimi dhe implementimi i këtyre projekteve dhe bashkëpunimi me MPMS do të ndikonte në zbutjen e papunësisë dhe zvogëlimin e varfërisë.

- **Synimi 3. Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme**

Përkrahja e këtyre bizneseve është një faktorë shumë i rëndësishëm dhe luanë një rolë kyç në zbutjen e papunësisë dhe zvogëlimin e varfërisë.

- ✓ Stimulimi i bujkut përmes lirimit të kostos së derivateve, plehrave artificiale, farërave etj.
- ✓ Kredi me kamata të ulëta dhe afatgjata për bujqësi dhe blegtori.
- ✓ Zvogëlimi dhe lehtësimi i taksave për bizneset e vogla dhe të mesme.
- ✓ Ndërtimi i restauranteve, hoteleve, moteleve dhe ngritjen e kamp shtëpizave në zonën turizmi dhe natyra

4.1.4 QËLLIMI 4: Strategjia për krijimin e kushteve më të mira në viset rurale

- **Synimi 1. Lidhje funksionale me qendrën urbane**

Zhvillimet kryesisht janë të përqendruara në qendrën urbane dhe rreth saj, ndërsa viset rurale në përgjithësi, e në veçanti ato në viset kodrinoro malore ngecin në zhvillim ekonomik dhe social. Për të arritur një zhvillim të baraspeshuar hapësinor duhet investuar në dy aspekte kryesore. Së pari kërkohet që të zhvillohet infrastruktura rrugore në këto vise dhe të sigurohen lidhje më funksionale në transport, ndërsa zhvillimi i disa zonave atraktive turistike duhet të ketë prioritet. Këto premisa do të reflektoheshin drejtpërdrejtë në ngritjen e standardit jetësor dhe komoditetit për të jetuar në këto vise. Investimet në zhvillimin e infrastrukturës dhe të turizmit në këto vise janë të parapara në strategjinë e infrastrukturës dhe transportit dhe atë të zhvillimit ekonomik.

- **Synimi 2. Ofrim adekuat i shërbimeve publike**

Përmirësimi i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore është paraparë në strategjinë e zhvillimit social, ku vendbanimeve u ofrohen këto shërbime në bazë të standardeve dhe kërkesave. Shërbimet arsimore dhe shëndetësore janë paraparë si në aspektin e hapësirës së mjaftueshme, largësisë dhe kuadrit të mjaftueshëm e të kualifikuar. Shërbimet në infrastrukturën teknike gjithashtu kanë një rol të veçantë në përmirësimin e kushteve në këto vendbanime. Shërbimet e tilla gjithashtu janë paraparë sipas kërkesave të banorëve në këto vendbanime dhe sipas standardeve të avancuara. Realizimi i këtyre investimeve të parapara në strategjinë e zhvillimit social dhe të infrastrukturës teknike do ti përmirësonin kushtet e jetesës në vendbanimet rurale.

4.1.5 QËLLIMI 5: Strategjia e zhvillimit kompakt dhe funksionalizimit të vendbanimeve

Me qëllim të realizimit dhe zhvillimit kompakt të vendbanimeve, si dhe arritjen e funksionalitetit të plotë të tyre, është e nevojshme të themelohen tri qendrat sekondare në Lluzhan, Orllan dhe

Kërpimeh. Në këtë mënyrë do të bëhet edhe decentralizimi i shërbimeve dhe shkarkimi i administratës komunale.

Zgjerimi i vendbanimeve në mënyrë të pa kontrolluar do të ndalet dhe zhvillimi i tyre do të bëhet krahas dendësisë të ndërtimeve brenda zonës së ndërtuar. Kjo do të ndikoj edhe në ruajtjen e tokës bujqësore, sidomos në zonën aktive.

Urgjentisht duhet të hartohet plani zhvillimor urban për qytetin e Podujevës, ndërsa pas hartimit të planit zhvillimor urban vijë në radhë planet rregulluese për zonën urbane dhe për qendrat sekondare. Këto plane orientojnë zhvillimin e vendbanimeve në mënyrë të kontrolluar dhe do të ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve.

Trajtimi i vendbanimeve jo formale është gjithashtu pjesë e rëndësishme e strategjisë që do të ofroj zgjidhje për to duke i legalizuar përmes zgjidhjes së çështjes së pronësisë dhe ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës adekuate.

Lista e plotë e projekteve të planifikuara për periudhën 2016 – 2025 është e paraqitur në Aneksin 4.

• **Synimi 1. Formimi i qendrave sekondare**

Kjo strategji parasheh ofrimin e shërbimeve për qytetarët e komunës. Sipas sajë shërbimet duhet të decentralizohen me qëllim që qytetarët të jenë sa më afër tyre. Për këtë arsye në strategji janë paraparë tri qendra sekondare: Lluzhani, Orllani dhe Kërpimehi. Këto qendra do të ndikojnë në shkarkimin e administratës në vetë qytetin e Podujevës ku tani të gjitha shërbimet administrative janë të përqendruara vetëm në këtë qendër komunale.

• **Synimi 2. Përpilimi i Hartës Zonale të komunës**

Përmes Hartës Zonale do të përcaktohen kahet zhvillimore të qytetit të Podujevës dhe strategjitë për veprim.

Pastaj, për ta realizuar një funksionalitet më të mirë të vendbanimeve është me rëndësi të hartohen planet rregulluese të hollësishme për hapësirat e caktuara që janë me interes për komunën dhe të cilat do të përcaktohen në kuadër të Hartës Zonale. Planet rregulluese të hollësishme do të përpilohen së paku për hapësirat e mëposhtme:

- ✓ Të gjitha zonat urbane të qytetit të Podujevës dhe
- ✓ Qendrat sekondare: Lluzhan, Orllan dhe Kërpimeh.

Qëllimi i këtyre planeve është orientimi i zhvillimit të ardhshëm përbrenda dhe përreth zonave përkatëse duke iu përshtatur karakterit të veçantë të secilës qendër. Komuna do të bëjë investime në këto qendra sekondare dhe ato do të zhvillohen me qëllim të parandalimit të zgjerimit të pakontrolluar.

Zhvillimi i planifikuar i këtyre qendrave sjell deri te përmirësimi i cilësisë së jetës në këto vendbanime dhe vendbanimeve tjera përreth, nga se shërbimet do të jenë më afër popullsisë.

Nga këto arsye, komuna duhet të vazhdojë me planet rregulluese në zonat urbane dhe qendrat sekondare, si dhe zonat e parapara për zhvillim jashtë zonës urbane.

- **Synimi 3. Zgjidhje për ndëtimet ilegale dhe vendbanimet joformale**

Në komunën e Podujevës janë të regjistruara gjithsej 4788 objekte të ndertuara pa leje. Komuna është në proces të përpilimit të hartave për këto objekte. Të gjitha këto ndërtime kanë hyrë në proces të trajtimit për legalizim në përputhshmëri me ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje nr. 04/L-188.

Komuna ka përgatitur profilin e gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në territorin e saj dhe ka marrë vendim për përpilimin e programit 3 vjecar për banim 2015 – 2017 (nr. 01-006-16447 të datës 4 Shkurt 2015).

Çështjet e pazgjidhura pronësore duhen të zgjidhen në mënyrë që të sigurohet baza ligjore për inicimin e procesit të planifikimit. Kadastrin dhe departamentet pronësore duhet të ofrojnë të dhëna dhe dokumentacion hartografik në mënyrë që të shmangen problemet me të dhëna gjatë planifikimit dhe realizimit të projektit

Rregullimi i vendbanimeve joformale do të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës në mënyrë që pjesëmarrësve t'u mundësohet ti shprehin kërkesat e tyre për mundësimin e një vendimmarrje transparente.

Nevojitet bashkëpunimi me akterët vendimmarrës, me qëllim të shmangies së problemeve në raport me tokën publike. Diskutimet e ndërsjella janë të domosdoshme, në mënyrë që të gjenden zgjidhje për sigurimin e infrastrukturës teknike dhe sociale.

Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale duhet që në procesin e planifikimit ti përfshijë vendbanimet joformale dhe të merret me joformalitetin në përputhshmëri me udhëzimet e publikuara nga MMPH.

Veprimet e lartshënuara janë të nxjerra nga udhëzuesit për rregullimin e vendbanimeve joformale të hartuar nga DPH – MMPH, bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, Ligjit nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003-14 dhe Ligji për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174.

4.1.6 QËLLIMI 6: Mjedis të pastër me shfrytëzim racional dhe mbrojtje efikase

- **Synimi 1. Parandalimi dhe largimi i mbeturinave ne trupat uJOR dhe mjedisë tjera**

Hapësirat mjedisore të pa shfrytëzuara të cilat janë prona jo private shfrytëzohen pa kritere për deponimin e mbeturinave si në masat tokësore dhe ato të trupave uJOR.

Sfera mjedisore paraqet disa prej sfidave më të rëndësishme me të cilat duhet të përballlet komuna. Gjithashtu kemi detyrë edhe hartimin e Planeve Lokale për Mjedi.

Vlerësimet e bëra ne fazën e par të profilit rezultojnë me probleme te shumta mjedisore ku deponimi i mbeturinave ilegale ka ne mjedisë te shumta në hapësirë si rezultat i mos efikasitetit dhe mungesës se sistemit për grumbullimin e mbeturinave te amëvisris dhe atyre industriale .

Janë evidentuar një varg çështje të cilat kanë ndikuar në mjediset të cilat janë tani me deponime të mbeturinave e që komuna duhet nderuar hapa konkret në zgjedhjen e këtyre problemave:

- ✓ Kapacitetet për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve janë te pamjaftueshme
- ✓ Nuk ka traditë të trajtimit dhe hedhjes së përshtatshme të mbetjeve;
- ✓ Burimet financiare dhe teknike janë te pamjaftueshme;
- ✓ Mungon ndërgjegjësimi publik për dëmin e shkaktuar nga keqadministrimi i mbetjeve.

Sa më efikase të jetë shërbimi i largimit publik të mbeturinave për një komunë të pastër dhe të gjelbër, për një komunë me cilësi jetese më të mirë për qytetarët e saj, për një komunë më të shëndetshme dhe aktive, duhet të ndermirren një varg aktiviteteve dhe projekte të zbatueshme për Uljen e Shkallës së Ndotjes duke:

- ✓ Duhet rritur shpenzimet dhe teknologjitë për mbledhjen e mbeturinave
- ✓ Vënie në funksion të procesit të riciklimit të mbeturinave
- ✓ Vazhdimin e rehabilitimit të sipërfaqeve me mbetje ilegale
- ✓ Ndërtimi i një fushe të re të depozitimit, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave me komunat fqinje
- ✓ Marrja e masave për mbledhjen, grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve komunale
- ✓ Sigurimin e Partneritetit Privat-Publik për përpunimin e riciklimit të mbeturinave
- ✓ iniciativa fiskale për sjellje miqësore ndaj mjedisit
- ✓ Vazhdimi i mbjelljes së drunjtëve dhe shtimin e hapësirave të gjelbra
- ✓ Marrja e masave për ruajtjen e hapësirave të hapura, bukurive natyrore
- ✓ Marrja e masave për rehabilitimin e zonave të ndotura të mjedisit dhe hapjen e zonave të reja gjelbëruese

Organizimet në nivel komunal në bashkëpunim me OJQ-ët dhe partneritetin privato - publik

Një ndër iniciativat që janë shumë të preferuara për një mjedis të pastër e që komuna ka mundësi ta organizoj në bashkëpunim me ndonjë OJQ-ë mjedisore si dhe në bashkëpunim me MMPH-në është edhe :Fushata për reduktimin e mbetjeve 2009-2020 me moton *“Së bashku, për një mjedis të Shëndetshëm”*

Fushata Mjedisore, përmban një paketë projektesh drejtuar grupeve të ndryshëm interesi në referencë të çështjeve mjedisore kryesore që ata përfaqësojnë.

Është orientuar në çështjen e Reduktimit të Mbetjeve, si një metodë e re alternative, por edhe si një nga çështjet që përbën problem në cilësinë e mjedisit dhe jetës.

- ✓ Programi “Edukimi mjedisor” nga subjektet e kontraktuara për shërbimin e pastrimit” synon të ndërgjegjësojë dhe sensibilizojë opinionin publik për sa i përket çështjes së depozitimit të mbeturinave në kontejner, për të lehtësuar mbledhjen e tyre, si dhe menaxhimin e depozitimit, duke krijuar premisat për të prezantuar elemente të tjera të trajtimit të mbetjeve, nëpërmjet riciklimit. Po ashtu edhe çështje që kanë të bëjnë me pastrimin e rrugëve (fshirjes dhe larjes së rrugëve).

Hapat që duhen ndërmarr për riparimin e dëmeve mjedisore janë:

- ✓ Analiza e shtrirjes dhe natyrës së problemit – llogaritja e rrezikut
- ✓ Shqyrtimi i alternativave që qojnë në një metodë të pëlqyer – vlerësimi i alternativave
- ✓ Hartimi i detajuar i projektit që qon në një specifikim tenderi – përgatitja për programin e pastrimit.

- ✓ Lidhja e kontratës dhe zbatimi i saj për pastrimin e mbetjeve

Disa prej këtyre hapave tashmë janë ndërmarrë për sa i përket mbledhjes së mbeturinave por ka ende për tu bërë. Parimi bazë që duhet të respektohet është që toka dhe trupat ujqor te ndotur duhet te rikthehet në gjendjen e mëparshme sipas përdorimit të planifikuar. Hapat që duhet ndërmarrë:

- ✓ Vetëdijesimi i qytetarëve për aktivitetet jo legale dhe pasojat
- ✓ Shtirja e aktivitetit të Kompanisë për në vendbanimet e mëdha si dhe ndarja në faza deri sa të mbulohet i ter territori i komunës
- ✓ Mënjanimi dhe grumbullimi i të gjitha mbetjeve ilegale

Hartimi i rregullores komunale në bazë të Ligjit për Mbrojtje të mjedisit dhe funksionalizimi i Inspektoratit të Mjedisit në gjobitjen e veprimeve ilegale mjedisore.

Pjesë e synimit të parë është edhe e masave që duhet ndërmarr me projekte konkrete për Lumenj të pastër - Parandalimi i hedhjes së mbeturinave në lumenj

Sfidë e madhe në tërë Republikën e Kosovës por edhe në Komunën e Podujevës është hedhja e mbeturinave të amvisërisë dhe ato të tjera në shtretërit e lumenjve ku pasojat janë shumë të mëdha për ujërat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësore, si dhe për botën bimore dhe shtazore.

Mbeturinat e ngurta (materiale ndërtimore), mbetjet e plehrave shtëpiake, mbetjet e amvisërisë etj. janë ndotësit shumë të mëdhenj. Nëpër çdo vendbanim ku lumenjtë kalojnë janë vërejtur dukuri të tilla negative.

Hapat që duhet të ndermirën janë:

- ✓ Pastrimi i shtratit të lumit Llap dhe Liqenit të Batllava
- ✓ Kontroll rigoroze nga inspektorati Komunal dhe pajisja e tyre me mjete të nevojshme .
- ✓ Angazhimi i aksionit vullnetar për pastrim të mbeturinave nga lumi Llap, me degët e saj si dhe hapësirës ujore të Liqenit të Batllavës organizuar nga OJQ-të mjedisore dhe Komuna, Drejtoria e Arsimit si dhe nga vet Komuniteti për vetëdijesim për ujëra .

Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe ligjeve në fuqi nga inspektorati si dhe zbatimi i dënimeve për ndotësit.

- **Synimi 2. Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale ne lumenj si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim te ujërave të zeza**

Problem ne vete ne ter territorin e Kosovës përveç ndotjes nga trupat e ngurtë që hidhen ne shtretërit e lumenjve është edhe shkarkimi i ujërave të zza pa trajtim paraprak e sidomos edhe e objekteve komerciale.

Podujeva ka një rrjet hidrografik të pasur edhe pse sasi të janë të mjaftueshme për nevojat aktuale. Cilësia e tyre shpesh është problem për shkak të ndotjes, sidomos në zonat ku jetojnë pjesa me e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen aktivitetet kryesore.

Ndotja e ujerave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore është pasojë e të gjitha veprimtarive aktuale urbane, industriale dhe bujqësore. Ujërat e zeza urbane paraqesin problem të veçantë si pasojë e mungesës së trajtimit të tyre.

Pjesa më e madhe e qytetit, kombinon sistemet e kanalizimit të ujërave të zeza dhe mbledhjes së ujit të bardha që shkarkohen drejtpërdrejtë në ujin sipërfaqësor.

Ndotja e ujit nga aktivitetet si p.sh. pastrimi i automjeteve dhe servisi, mbetjet bujqësorë, pesticidet e ruajtura keq apo të braktisura dhe kimikate të tjera, shkarkimi i ujërave të zeza në trupat ujqor pa trajtim paraprak ndikojnë në cilësinë e dobët të ujit.

Presione të tjera përfshijnë ndërtimet e pakontrolluara, ndotja dhe eutrofikimi që vjen nga ujërat e zeza të pa trajtuara që shkarkohen në lumenj dhe nga rrjedhja e plehrave kimike dhe pesticideve nga toka bujqësore në drejtim të lumenjve, rrëshqitje dhe gërryerje të tokës, praktikrat e gjuetisë në dëm të mjedisit etj.

Masat e parapara në këtë strategji:

- ✓ Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në ter zonën urbane .
- ✓ Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanimet rurale, dhe ndërtimi i sistemeve të gropave septike
- ✓ Përcaktimi i lokacionit varësisht se cili option është i përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza
- ✓ Ndarja e kanalizimit fekal nga ai i shirave
- ✓ Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza në përputhshmëri me standardet
- ✓ Identifikimi i lokacionit më të përshtatshëm për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza në jug të qytetit
- ✓ Prioritet është mënjanimi i ujërave te zeza qe shkarkohen ne Liqenin e Batllaves

Te gjitha implikimet buxhetore janë paraparë në Infrastrukturë. Këto rekomandime janë konformë rregullave mjedisore .

• Synimi 3. Ndërmarrja e masave anti-erozive

Dy janë problemet gjeneralë më kryesore dhe më shqetësuese: Erozioni dhe prishja e cilësisë së tokës. Erozioni është procesi natyror i veprimit të ujit dhe erës mbi tokën. Megjithatë, shkalla e erozionit mund të rritet shumë nga aktivitetet e papërgjegjshme të njeriut. Niveli i lartë i erozionit paraqet një sërë problemesh që janë të pranishme sot në territorin e komunës . Rreth 22000ha janë të ekspozuar direkt erozionit

Në bazë të analizave propozohen masat antierozive:

- ✓ Meliorimi i pyjeve 11850 ha
- ✓ Brezi mbrojtës i shpateve 18170 ha
- ✓ Mbrojtja ndërtimi i tarracave 3498 ha
- ✓ Zonat e zhvillimit të punëve te antierozionit 790.3 ha

Masat parandaluese me molerim të pyjeve kanë kosto më të lirë se aktivitetet tjera antierozive dhe në bashkëpunim me MBPZHR mund të arrihen efekte pozitive në përmasimin dhe stabilizimin e masave tokësore.

Një ndër prioritetet e ngadalësimit eroziv është edhe kontrolli rigoroz i shfrytëzimit të masës drusore

Pasojat:

- ✓ Prishja e cilësisë së tokës dhe humbja e pjellorisë
- ✓ Dalja e ujit nga shtretërit e lumenjve
- ✓ Është shtuar rreziku i rrëshqitjeve të tokës dhe humbjes së saj;

- ✓ Depozitimi i sedimenteve në lumenj, që ndryshon rrjedhën e tyre natyrore dhe problemet ekologjike;
- ✓ Degradimi i pyjeve, mbi kullotja, zhdukja e sipërfaqeve me drunj dhe atyre frutore dhe ndërtimet, e sidomos i rrugëve, kanë zvogëluar sipërfaqet me bimësi dhe si pasojë rrisin erozionin.

Kontrolli i erozionit është kërkesa kryesore, e shoqëruar nga praktikrat e administrimit të baseneve të lumenjve dhe të cilat ulin efektet negative të transportimit dhe depozitimit të sedimenteve.

Në rastin e erozionit është bërë një dallim mes erozionit në zonat e larta malore dhe erozionit në zonat e ulëta fushore. Edhe pse kjo “ndarje” nuk është aspak e përsosur ajo duhet kuptuar si e tille, që përfshin një dallim mes zonave me pjerrtësi të madhe dhe zonave me pjerrtësi më të vogël. Të parat, në përgjithësi përfshijnë zona pyjore kurse të fundit janë kryesisht bujqësore.

Masat që kërkohet të ndërmerren përfshijnë:

- ✓ Masat hidroteknike
- ✓ Masat bujqësore
- ✓ Masat biologjike

Ruajtja e cilësisë së tokës – Ndërtimet e pa kontrolluara, mbetjet e amvisërisë, mbetjet ndërtimore, mbetjet industriale, përdorimi jo i drejtë i plehrave kimike dhe pesticideve, mënyra e përdorimit të tokave, shkarkimi i ujërave të zeza, fatkeqësitë natyrore siç janë vërshimet etj. ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e tokës.

Duke marr parasysh një varg problemesh që shkaktohen nga faktori njeri duhet marr masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes nëpërmjet eksperteve të fushave bujqësore.

Masat parandaluese:

- ✓ Organizimi i seminareve nga fusha e bujqësisë
- ✓ Kontrolli i mbetjeve të natyrave të ndryshme
- ✓ Kontrolli përdorimit të plehrave dhe pesticideve
- ✓ Kontrolli dhe mënyra e përdorimit të tokave

• Synimi 4 Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve

Komuna me kapacitetet e veta dhe në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Departamentin e ujërave, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës) duhet të ndërmarrë masat vijuese hidrologjike, në mënyrë që të parandalojë apo të zvogëlojë ndikimet nga rreziku i vërshimeve:

- ✓ Largimi i barrierave nga shtrati i lumenjve, qofshin ato natyrale apo të krijuara nga njeriu
- ✓ Të bëhet meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve si masa parandaluese
- ✓ Ndërtimi i kanaleve dhe / ose mureve mbrojtëse
- ✓ Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos për ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet.
- ✓ Komuna do të ndërmarrë masat përkatëse për mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve. Prerja e domosdoshme do të lejohet në zonat ku ato do të mund të shkaktonin ndikime

negative. Komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e vlerave peizazhore të brigjeve të lumenjve përmes mbjelljeve dhe veprimeve për rregullim peizazhor për rekreim, si modeli i terrenit dhe mbjellja e barit.

- ✓ Kontrollimi i eksploatimit të zhavorrit nga shtrati i lumenjve aty ku ka licencë për eksploatim, si dhe ndëshkimi i operatorëve ilegal të bëhet nga Inspektorati komunal me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujit, shkatërrimit të botës shtazore të lumenjve dhe dëmtimeve të shtratit që mund të shkaktojnë vërshime.
- ✓ Çdo ndryshim i rrjedhës së lumit do të ndalohet nga komuna dhe veprimet që mund të çojnë deri në rritjen e rreziqeve nga vërshimet do të kontrollohen në mënyrë strikte.

• **Synimi 5 Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore**

Vlerat e natyrës në favor të zhvillimit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit janë prezentë në komunën e Podujevës.

Synim kryesor për mbrojtjen e vlerave natyrore është edhe mbrojtja nga ndërtimet në zonën e Liqenit të Batllaves

Masat Mbrojtese:

- ✓ Parandalimi i ndërtimeve
- ✓ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me komunën do të hartoj dokumentet e planifikimit hapësinor për piken më turistike për komunën „Liqenin e Batllavës” në përputhshmëri me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 17/127 të vitit 2013 për mbrojtjen e burimit ujor të akumulacionit të Batllavës.
- ✓ Komuna së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të ketë efekte negative ndaj këtyre vlerave.
- ✓ Komuna në bashkëpunim me MKRS, të inicioj me akt të veçantë vënien nën mbrojtje lokalitetet arkeologjike.
- ✓ Të përpilohet katalogu i hartave për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore për nevojat e turizmit.

• **Synimi 6. Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve**

Problemet e natyrës ilegale të prerjeve të pyjeve janë prezentë në territorin e Kosovës njashtu edhe në komunën e Podujevës si pasojë e shfrytëzimit të pa kontrolluar të pyjeve. Shifra ekzakte nuk ka edhe pse vlerësimet janë të larta nga se shumë ekonomi familjare që shfrytëzojnë lëndën djegëse për amvisni me aktivitetin ilegal të prerjes së pyjeve shkaktojnë pasojë të mëdha mjedisore që janë edhe të riparueshme.

Hapësira mjedisore është e llojllojshme në komunë. Përzjerja e ekosistemeve dhe habitateve përfshin ato malore, fushore, lumenjve, shkurret, pyjet gjetherënëse, halore dhe të përziera, kullotat, livadhet dhe zonat e larta malore. Kjo shumëllojshmëri bimore dhe shtazore nuk është mbrojtur në nivelin e

duhur nga njeriu dhe moskujdesi ndaj tyre ekziston edhe sot e kësaj dite. Problemet thelbësore janë praktikatat e papërshtatshme të ndjekura në zonat malore, sidomos shpyllëzimi si dhe degradimet mjedisore

Problemet lidhur me administrimin e pyjeve janë identifikuar qysh në fillim të viteve 1990. Këto probleme janë duke u trajtuar kohet e fundit nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës si dhe me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale ku nevojat e decentralizimit dhe nevoja për administrim më të mirë ja ka kaluar pronësinë e pyjeve pushtetit vendor, me kusht që të hartojnë e të marrin masa për zbatimin e Planeve për Administrimin efikas.

Masat që duhet ndërmarr komuna:

- ✓ Në bashkëpunim me MBPZHR/Agjencionin e pyjeve të ndërmarr masa strikte për parandalimin e prerjeve ilegale.
- ✓ Në bashkëpunim me njësinë Zjarrfikëse, SSPK, FSK, Njësinë e Ujësjiellit, Agjencionin e pyjeve dhe të gjithë faktorët relevant të krijohet shtabi i emergjencës në rast të paraqitjes së zjarreve në pyje.
- ✓ Të bëhen vlerësime nga ekspertet e pylltarisë për nevojat e rralimit dhe prerjes sanitare të pyjeve në mënyrë që shfrytëzimi i pyjeve do të plotësojë nevojat e qytetarëve
- ✓ Hartimi i planeve menaxhuese të pyjeve për periudha afatgjate.

Ripyllëzimi i hapësirave të zhveshura dhe krijimi i brezave të gjelbëruar: Sipërfaqet e zhveshura në territorin e komunës së Podujevës janë prezentë sidomos në lartësitë mbidetare mbi 700m ku edhe aktiviteti eroziv është më i theksuar. Masat që duhet ndërmerren për ruajtjen e këtyre zonave dhe peizazheve të mbetura e të cilat mbrohen me ligj, për qëllime argëtimi, çlodhjeje e turizmi por edhe për ruajtjen e biodiversitetit janë:

- ✓ Ripyllëzimi ose ripërtëritja e kullosave të sipërfaqeve që kanë pjerrtësi më shumë se 15%
- ✓ Sipërfaqet e identifikuar me erozion të mesëm, të lartë dhe shumë të lartë të pyllëzohen.
- ✓ Krijimi i brezave të gjelbër për gjatë shtretërve të lumenjve është masë parandaluese erozive.
- ✓ Hulumtimet e tokës dhe përshtatja e fidanëve për pyllëzim dhe ripyllëzim.

Lista e plotë e projekteve të planifikuara për periudhën 2016 – 2025 është e paraqitur në Aneksin5.

4.1.7 QËLLIMI 7: Zhvillim i harmonizuar dhe i qëndrueshëm ekonomik

Në komunën e Podujevës ekzistojnë mundësi të shumta për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Këtu mund të planifikohet një ekonomi e larmishme varësisht nga hapësira dhe kushtet ekzistuese.

Strategjia e zhvillimit ekonomik në komunën e Podujevës ka për qëllim të arrijë një zhvillim të kontrolluar, duke mbrojtur resurset ekzistuese, si tokën bujqësore, rezervat minerare dhe vlerat kulturore dhe natyrore turistike që ka komuna e Podujevës. Ky zhvillim bazohet në shfrytëzimin e resurseve humane, organizative, kapitale dhe natyrore me qëllim të arritjes së mirëqenies së qëndrueshme ekonomike të qytetarëve të komunës së Podujevës.

Strategjia e zhvillimit ekonomik parasheh arritjen e një zhvillimi ekonomik të harmonizuar dhe të qëndrueshëm. Kjo nënkupton që të arrihet një zhvillim i harmonizuar ekonomik si në aspektin

hapësinor ashtu edhe në atë të sektorëve të ndryshëm ekonomik. Disa hapësira në komunën e Podujevës kanë arritur zhvillim më të lartë ekonomik e disa të tjera kanë mbetur të pa zhvilluara. Strategjia parasheh zhvillim më të harmonizuar hapësinor, si dhe zhvillim më të harmonizuar mes sektorëve të ndryshëm ekonomik. Gjithashtu, kjo strategji bazohet në konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm ku resurset natyrore do të shfrytëzohen në mënyrë racionale. E gjithë strategjia e zhvillimit ekonomik do të bazohet në standardet e parapara me Planin Hapësinor të Kosovës, paragrafët 5.3 (Kushtet e vendosjes së veprimtarive ekonomike në hapësirë), 5.5 (Kushtet funksionale, hapësinore, ekologjike të përcaktimit të sistemeve të komunikimit dhe infrastrukturës tjetër në hapësirë), 5.7 (Masat e mbrojtjes së vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike), 5.9 (Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis).

- **Synimi 1. Zhvillim dhe rritje e prodhimtarisë në bujqësi (drithërave, pemëtarisë dhe perimtarisë)**

Prodhimet bujqësore janë një potencial i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe në përgjithësi të ekonomisë së komunës së Podujevës. Përmes kësaj strategjie parashihet një zhvillim më intensiv i bujqësisë, duke mbrojtur tokën bujqësore dhe duke stimuluar vazhdimisht bujqit që të merren me këtë veprimtari. Politikat mbi mbrojtjen e tokës bujqësore do të bazohen në strategjinë e përcaktuar në Planin Hapësinor të Kosovës 2010 – 2020+, paragrafi 4.1.2.9.1.

Ndër projektet të cilat do të realizohen në këtë sektor ekonomik janë:

- ✓ Ndalimi i zhvillimeve në tokat kualitative bujqësore
- ✓ Stimulimi i mbjelljes dhe përpunimit të drithërave
- ✓ Stimulim për kultivimin pemëve dhe perimeve
- ✓ Përkrahje tregtare për prodhimet vendore

- **Synimi 2. Përkrahja e zhvillimit të blegtorisë dhe bletarisë**

Blegtoria dhe bletari janë dy veprimtari ekonomike me rëndësi të veçanët për komunën e Podujevës. Potencialet ekzistuese që ka kjo komunë sidomos në hapësira të caktuara rurale, ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin e këtyre veprimtarive. Që të arrihet një zhvillim i duhur i blegtorisë dhe bletarisë kërkohet një përkrahje e vazhdueshme e blegtorëve dhe bletarëve si nga aspekti financiar, ashtu edhe në aspekte të tjera stimuluese. Krijimi i kushteve të favorshme për blegtor dhe bletar, mbrojtja dhe favorizimi i prodhimeve të tyre janë masa konkrete që do të ndikonte drejtpërdrejtë në zhvillimin e këtyre dy aktiviteteve ekonomike.

Ndër projektet të cilat do të realizohen në këtë sektor ekonomik janë:

- ✓ Zhvillimi i blegtorisë dhe përkrahje e blegtorëve
- ✓ Zhvillimi i bletarisë dhe përkrahje e bletarëve
- ✓ Favorizimi dhe mbrojtja e prodhimeve vendore

- **Synimi 3. Funksionalizimi i zonave industriale**

Bizneset hasen me probleme të shumta duke përfshirë hapësirën, pozitën, mungesën e infrastrukturës së nevojshme fizike, energji jo të mjaftueshme, mungesë të kapitalit për investime etj. Bizneset përveç që duhet të përkrahen nga komuna duhet krijuar edhe mundësi për përkrahje financiare përmes kredive më të volitshme dhe përmes konsultave për profilizim ose funksionalizim të tyre. Sigurisht rëndësi të veçanët do ti kushtohet edhe organizimit dhe përqendrimit të bizneseve në një zonë të veçanët të veprimit të tyre. Gjithashtu janë definuar edhe zonat e zhvillimit të turizmit dhe zonat e zhvillimit të bujqësisë me sipërfaqe të dedikuara vetëm për aktivitetet bujqësore.

Për të arritur këtë objektiv duhet të realizohen disa projekte, si në vijim:

- ✓ Hartimi i planeve për zonat me karakter ekonomik në komunën e Podujevës (industriale, bujqësore dhe turistike),
- ✓ Instalimi i infrastrukturës elementare në zonat e interesit ekonomik
- ✓ Promovimi i interesit të komunës për investime konkrete në zonat me interes ekonomik dhe vende tjera

- **Synimi 4. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore (drurit, inerteve etj)**

Resurset ekzistuese në komunën e Podujevës duhet të mbrohen sa më parë nga veprime ilegale dhe të pa ligjshme. Pyjet janë resurse me rëndësi ekonomike dhe gjithashtu ofrojnë një peizazh të bukur dhe ekologjik. Dëmtimi i tyre pa plan dhe në formë ilegale duhet të ndërpritet dhe të filloj shfrytëzimi i tyre në mënyrë racionale dhe me plan. Gjithashtu edhe shfrytëzimi i inerteve pa kritere përkatëse dhe në mënyrë të pa kontrolluar dëmton mjedisin, andaj është e domosdoshme që në të ardhmen të bëhet një shfrytëzim racional dhe me plan i këtyre resurseve natyrore dhe të tjera.

Ndër projektet të cilat do të realizohen në këtë sektorë ekonomik janë:

- ✓ Hartimi i planeve menaxhuse për pyjet dhe
- ✓ Respektimi i kritereve dhe ligjeve për shfrytëzimin e inerteve

- **Synimi 5. Krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit**

Hapësirat e veçanta, me peizazhe të bukura dhe mjaft karakteristike, ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit në komunën e Podujevës. Të gjitha këto hapësira duhet të mbrohen nga degradimi dhe të rregullohen me plane përkatëse. Pos mbrojtjes, këto hapësira duhet edhe të zhvillohen dhe të avancohen si potenciale të rëndësishme për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit.

Lista e plotë e projekteve të planifikuara për periudhën 2016 – 2025 është e paraqitur në Aneksin 6.

4.1.8 QËLLIMI 8: Strategjia e zhvillimit të infrastruktures

- **Synimi 1. Asfaltimi i rrugëve për zonat me prioritet**

Me qëllim të krijimit të mundësive për qasje të gjithë qytetarëve të Podujevës në rrugë të asfaltuara të kualitetit të mirë është e nevojshme që të ndërmerren veprime konkrete në ngritjen e kualitetit të rrugëve në nivel të komunës. Për të realizuar këtë synim duhet që të ndërmerren këto masa:

- ✓ Përmisimi i kualitetit të asfaltit në rrugët nacionale, përkatësisht rrua nacionale M25 Prishtinë – Podujevë është e nevojshme që të ketë kualitet të lartë të asfaltit duke filluar nga kufiri me komunën e Prishtinës e deri tek Merdare te pika kufitare me Serbinë , me gjatësi prej 18.8 km.
- ✓ Përmisimi i kualitetit të asfaltit në Rrugën regjionale nga gjithsejtë 80 km të rrugëve regjionale sa ka në komunën e Podujevës, 37.2 km ose 46.5 % të tyre shtrihen në zonën aktive, ndërsa 42.8 km shtrihet në dy zonat tjera (Malet dhe Peizazhet natyrore, Natyra dhe turizmi). Përmisimi i kualitetit të rrugës regjionale Në kuadër të këtyre rrugëve hynë rrugët regjionale: Rruga R-126 Batllavë Podujevë – Pollatë, Rruga R-125 Lluzhan - Batllavë – Orllan -deri në kufi me Serbi , Rruga **R127** Llapashticë e Poshtme - Podujevë – Perpelac, Rruga **R128** Podujevë – Llapashticë e Epërme, Rruga **R129** Bajçinë – deri në kufirin e KK të Mitrovicës.

Rrugët lokale – Pozita gjeografike e komunës i ka mundësuar një lidhje shumë të mirë të disa vendbanimeve nëpërmjet të rrugëve nacionale dhe regjionale, si dhe prioritet i qeverisë lokale deri më tani ka qenë asfaltimi i rrugëve që lidhin vendbanimet, prandaj në këtë kategori të rrugëve është e nevojshme që të bëhet asfaltimi i disa rrugëve lokale brenda vendbanimeve, me qëllim që të iu mundësoj një numri të konsiderueshëm të qytetarëve qasje direkt në rrugë të asfaltuara. Vendbanimet të cilat kanë nevojë që të kenë rrugë të asfaltuara janë:

- ✓ Rregullimi i rrugës transit e cila do të ketë gjatësi 2.45 km dhe do të lidhë rrugët regjionale (R127 dhe R126).
- ✓ Mirëmbajtja e rrugëve lokale - Rrugët e pa asfaltuara të cilat, duhet të kenë mirëmbajtje permanente me mbulesë të rërës dhe zhavorrit janë rrugët të cilat shumica e tyre shtrihen në pjesën e strukturës Malet dhe pejsazhet natyrore dhe në zonën Natyra dhe Turizmi .

Tabela 74. Asfaltimi i rrugëve në të ardhmen

Vendbanimi	Statusi ne te ardhmen	Gjatësia_km
Surdull	Asfalt i ri	3.7
Murgull	Asfalt i ri	2.8
Sllatinë	Asfalt i ri	2.1
Dvorishte	Asfalt i ri	2.3
Brece	Asfalt i ri	3.4

Revuq	Asfalt i ri	1.8
Popove	Asfalt i ri	2.7
Ballofc	Asfalt i ri (është në asfaltim e sipër)	1.6
Gerdoc	Asfalt i ri (është në asfaltim e sipër)	1.8
Herticë	Asfalt i ri (është në asfaltim e sipër)	1.7
Total		23.9

Tabela 75. Mirëmbajtja e rrugëve në të ardhmen

Vendbanimet të cilat nuk kanë qasje në rrugë të asfaltuara (Këto rrugë duhet të mirëmbahen)	
1	Terrnavice
2	Recice
3	Potok
4	Sylevice
5	Llapashtice e Posh.
6	Mirofc
7	Rakinice
8	Muhazob
9	Metergoc
10	Bllate
11	Krushevice
12	Braine
13	Baraine
14	Burice
15	Kalatice

Rregullimi i trotuareve, sinjalizimit, anësorëve dhe kufizimi i aktiviteteve socio-ekonomike – Me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe lehtësimit të qarkullimit të qytetarëve të vendbanimeve të

cilat shtrihen përgjatë rrugëve nacionale dhe regjionale, që të bëhet rregullimi i trotuareve për këmbësor, anësorëve, sinjalizimit, si dhe ndërprerja e aktiviteteve socio-ekonomike. Për realizimin e këtij synimi duhet të ndërmerren këto aktivitete:

- ✓ Rregullimi i trotuareve në vendbanimin e Batllavës me një gjatësi prej 4.5 km, Llugë 2.5 km, Shajkoc me 3.5 km, Surkish 1.3 km, Podujevë 2.47 km, Llapashticë e Poshtme (1.77 km), Llapashticë e Epërme (2.68 km), Obranë rreth 6 km në kuadër të komunës kadastrave në rrugët regjionale, Peran me 3 km, Bajçinë me 2.3 km, Dobratin me 0.86 km, Dobërdol 1.8 km, Zakut 1.88 km Pakashticë e Poshtme 1.1 km, Kërpimeh me 1.2 km, dhe Dumnicë e Poshtme me 1.8 km.
- ✓ Rregullimi i anësorëve mbrojtëse përgjatë segmentit të rrugëve regjionale në vendbanimin e Batllavës me një gjatësi prej 4.1 km, Llugë 2.5 km, Shajkoc 3.5 km, Surkish 1.3 km, Podujevë 2.4 km, Llapashticë e Epërm 1 km, Dumnicë e Poshtme 2.8 km, Bajçinë 2.4 km, Dobratin 0.9 km, Dobërdol 1.5 km, Zakut 3.8 km, Pakashticë e Poshtme 0.9 km, Kërpimeh 1.2 km . në të dy anët e rrugëve.
- ✓ Rregullimi i sinjalizimit për vendkalim këmbësor (zebra), në dy lokacione në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat sekondare (Kerpimeh, Orllan, dhe Lluzhan)
- ✓ Kufizimi i aktiviteteve socio-ekonomike përgjatë segmentit të rrugëve regjionale në një gjatësi prej 60m.
- ✓ Vendosija e mbishkrimeve për hyrje në Komunën e Podujevës në kufi me komunën e Prishtinës.

• Synimi 2 Përmirësim i rrjetit energjetik

Pozita gjeografike e komunës i mundëson edhe një rrjet të rëndësishëm, të furnizimit me energji elektrike. Për përmirësimin e rrjetës energjetik në komunën e Podujevës në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10kv në 20kv:

Tabela 76. Përmirësim i rrjetit energjetikë

Nr.	Emri i Daljes	Kapaciteti i propozuar në kv	
1	Batlavë	20	Përmirësim solid
2	Batlavë - Orllan	20	Përmirësim solid
3	Podujevë 1	20	Përmirësim selektiv
4	Podujevë 2	20	Përmirësim solid

5	Podujevë 3	20	Përmirësim selektiv
6	Podujevë 4	20	Përmirësim solid
7	Podujevë 5	20	Përmirësim solid
8	Sillosi	20	Përmirësim solid
9	Ballovcit	20	Përmirësim selektiv
10	Fshatrat 1	20	Përmirësim selektiv
11	Fshatrat 2	20	Përmirësim selektiv
12	Livadica	20	Përmirësim selektiv
13	Letanci	20	Përmirësim selektiv
14	Llausha	20	Përmirësim solid

Kualiteti i furnizimit me energji elektrike – sipas statistikave të furnizimit me energji elektrike, si dhe gjendjes së rrjetës energjetike në nivel të komunës administrative të Podujevës mund të vërejmë se ka një furnizim me energji elektrike jo në nivelin e kënaqshëm, prandaj duhet të përmirësohet kualiteti i energjisë elektrike në komunën e Podujevës duke përmirësuar edhe rrjetin e energjisë elektrike, i cili do të ndikoj në zvogëlimin e humbjeve të energjisë. Zgjerimi i rrjetit të energjisë elektrike do të bëhet në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës, paragrafi 4.1.4 (Strategjia e Zhvillimit dhe Integritet të Infrastrukturës dhe Komunikimit).

• **Synimi 3. Ndryçimi i rrugëve në zona të frekuentuara**

Është e nevojshme që rrjeti i ndryçimit publik të bëhet në vendbanimet e mëdha dhe të dendura me numër të popullsisë si dhe në qendrat Sekondare (Lluzhan, Kërpimeh dhe në Orllan).

• **Synimi 4. Shtrirja e telefonisë fikse dhe internetit në zonat me prioritet**

Për përmisimin e rrjetës së telekomunikimit në komunën e Podujevës duhet të ndërmerren disa veprimeve, Kapaciteti momental është i mjaftueshëm edhe për periudhën e ardhme 10 vjeçare, mirëpo është e rëndësishme që të bëhet shtrirja e rrjetit në aspektin fizik në vendbanimet e tjera të cilat janë me të mëdha për nga numri i popullsisë .

- ✓ Telefonia fikse Rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Podujevës është i lidhur nëpërmjet fibrit optik, i cili i përket linjës së trasesë Prishtinë – Podujevë. Ky rrjet menaxhohet nga njësia e PTK-së. Shtrirja e rrjetës së telefonisë fikse ekzistuese mundëson qasje të mbi 46.8% të popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse.

- ✓ Foltore publike - Në funksion të ofrimit të shërbimeve të telefonisë fikse do të jetë edhe rritja e numrit të foltoreve publike në zonën urbane dhe në vendbanimet e propozuara si vendbanime sekondare dhe qendrat e bashkësive lokale (Kerpimeh dhe Orllan) duhet të jetë minimum dy për qendër sekondare.
- ✓ Telefonia mobile –Të dy operatorët mobil kanë të vendosura antena individuale në lokacione të ndryshme të komunës, mirëpo duhet të bëhet koncentrimi i antenave në një ose dy lokacione të caktuara në bashkëpunim me operatorët e Telefonisë Mobile.
- ✓ Shërbimet Postare – duhet të vazhdohet shpërndarja e shërbimeve postare në sistemin aktual të shpërndarjes
- ✓ Shërbimet e internetit – bashkëpunimi i ngushtë me operatorët e telefonisë mobile për stimulimin e qytetareve të Podujevës në shfrytëzimin e mundësive për përdorim të internetit në nivel të vendbanimeve që shtrihen në zonën aktive zhvillimore, duke ofruar paketa stimuluese, si dhe duhet të ndërmerret një kampanjë për informimin e qytetarëve për mundësitë e shfrytëzimit të shërbimeve të tyre.
- ✓ Radiotelevizioni – Krijimi i mundësive për qasje në radiotelevizionet nacionale dhe lokale për të gjitha vendbanimet e komunës nëse paraqitet ndonjë problem e sidomos për vendbanimet të cilat janë në zonat e thella malor

• Synimi 5. Zgjerim dhe kontroll i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

Sistemi i ujësjellësit qendrorë të Podujevë furnizon rreth 72 % të popullatës së komunës. Aktualisht 90-100 litra ujë në ditë për kokë banori që janë në dispozicion, vlerësohet të jetë i pamjaftueshëm. Në të ardhmen, në proporcion me rritjen e numrit të banorëve në komunë, nevojat për sasi të ujit të pijshëm janë më të mëdha, rreth 270 litra/sec.

Për përmirësimin e qasjes të banorëve në ujësjellës dhe kanalizim, me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor të popullatës në komunë, është e nevojshme që të ndërmerren këto veprime:

- ✓ Rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit qendror në zonën urbane me qëllim të zvogëlimit të humbjeve
- ✓ Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit qendror në vendbanimet Orllan në zonën “turizmi dhe natyra”- do të ndikoj në zhvillimin ekonomik të kësaj zone turistike.
- ✓ Kaptimi i burimeve potenciale, “Vrella e Revuçit” në vendbanimin Revuç, dhe ndërtimi i ujësjellësit për vendbanimet e zonës
- ✓ Kaptimi i burimeve potenciale, “Vrella e Zhitisë” në vendbanimin Zhiti dhe ndërtimi i ujësjellësit për vendbanimet e zonës.

Në zonën e identifikuar si “malet dhe pejzazhet” popullatë furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemet e vogla lokale dhe puse individuale të cilat e marrin ujin nga burime natyrore dhe shpimet nëntokësore. Veprimet konkrete dhe të menjëhershme për sigurimin e ujit higjienik për popullatë do të jenë:

- ✓ Menaxhimi i sistemeve lokale nga ujësjellësi qendror
- ✓ Përcjellja dhe kontrolli i cilësisë së ujit në vendbanime pa ujësjellës


Gjatë punës së hartimit të gjendjes ekzistuese (profilin) komunale është identifikuar edhe problemi i theksuar i shtrirjes së rrjetit dhe kyçja në sistem të kanalizimit, me të cilin aktualisht përballet pjesa dërmuese e komunës së Podujevës. Për përmirësimin e kësaj gjendjeje do të ndermirën hapa konkrete:

- ✓ Zgjerimi i shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në tërë territorin e komunës, e sidomos në qendrat sekondare në Orllan dhe Kërprimëh.
- ✓ Zgjerim i rrjetit në zonën urbane të Podujevës si dhe ndërtimi i gropave septike adekuate.
- ✓ Ndërtimi i rrjetit të veçantë të ujërave të zonës industriale dhe trajtim adekuat i tyre.
- ✓ Në vendbanimet më të thella me numër më të vogël të banorëve dhe varësisht nga shpërndarja hapësinore e tyre dhe karakteristikat e terrenit, do të organizohen sisteme me gropa septike individuale dhe kolektive me sistem të vetëpastrimit të ujërave të ndotura.


Sistemi i kanalizimit të ujërave të ndotura, gjendja e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të ndotura në Komunë, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor. Si zgjidhje afat gjate do të ishte ndërtimi i impiantit regjional për ujërave të zeza.

Sigurimi i ujit higjienik për pije dhe sistemi i organizuar i kanalizimeve për banorët e komunës do të ndikojnë në mbrojtjen e shëndetit të tyre si dhe në përmirësimin kualitetit të jetës të qytetarëve në komunë.

Harta 44. Rrjeti i ujësjellësit i propozuar



Harta 45. Rrjeti i kanalizimit i propozuar



Synimi 6. Organizim i grumbullimit të mbeturinave dhe riciklimi i tyre

Në komunën e Podujevë shërbimin e menaxhimit të mbeturinave e kryen KUR „PASTRIMI” Shoqëria aksionare-Prishtinë, njësia operative në Podujevë, e cila kompani i kryen shërbimet në

zonën urbane dhe paralagjet e qytetit. Në shumë vendbanime rurale të komunës ekzistojnë deponi të egra.

Përmirësimi i shërbimit dhe të shtrirja e tij në tërë territorin e komunës është përgjegjësi e kuvendit komunal dhe atij regjional. Kjo do të realizohet me veprime konkrete:

- ✓ Shtrirja e shërbimit në vendbanimet ku mungon menaxhimi i organizuar, pastrimi i deponive të egra, sidomos në toka kualitative dhe të propozohet lokacioni për grumbullim në tokat me cilësi më të ultë.
- ✓ Shtrirja e shërbimit në lokalitetet e qendrave sekondar: Orllan, Luzhan dhe Kërpimeh dhe krahas grumbullimit të mbeturinave njëkohësisht Drejtorati Komunal për mjedis duhet të aplikoj masat Ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit

Lista e plotë e projekteve të planifikuara për periudhën 2016 – 2025 është e paraqitur në Aneksin 7.

“DISPOZITAT PËR ZBATIM”

FAZA V

5. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Plani Zhvillimor Komunal i Podujevës është dokument bazë që parasheh zhvillimin e dëshiruar hapësinor për të ardhmen. Bazuar në gjendjen ekzistuese dhe sfidat kryesor që janë identifikuar, është përcaktuar vizioni për të ardhmen si dhe qëllimet që duhet të arrihen. Gjithashtu është propozuar korniza e zhvillimit komunal sipas të cilës do të realizohet një zhvillim policentrik dhe i qëndrueshëm. Strategjia e zhvillimit komunal parasheh fushat konkrete dhe mënyrën se si do të arrihet zhvillimi dhe mbrojtja në tërë territorin e komunës. Plani është shumë real dhe i zbatueshëm. Zbatimi konkret i këtij plani është prezantuar në këtë pjesë, ku përshkruhen dispozitat për zbatim, përmes të cilave përshkruhet mënyra më konkrete e zbatimit praktik të këtij plani. Pra, jepen udhëzimet dhe sugjerimet për realizimin e strategjisë së propozuar, me tërë përmbajtjen e sajë, duke përfshirë afatet kohore, implikimet financiare dhe hapësirën përkatëse.

5.1. Dispozitat e Përgjithshme

Në këtë pjesë jepen informata për parimet e përgjithshme të implementimit të planit, ku përfshihen afatet kohore dhe periudhat e revidimit të planit, përgjegjësit dhe kompetencat për revidimin e tij si dhe rëndësinë e këtij dokumenti në nivelin komunal.

- ✓ Plani Zhvillimor Komunal është hartuar për periudhën kohore 2016 – 2025.
- ✓ Përpilimi i planit bëhet së paku cdo 8 vite, në përputhshmëri me nenin 11, pikën 1.4 të ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174.
- ✓ Përgjegjës për përpilimin e Planit është Qeveria komunale e Podujevës, konkretisht Drejtoria për Urbanizëm.
- ✓ Plani është hartuar në pajtim me të gjitha konventat dhe parimet ndërkombëtare të fushës së Planifikimit Hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- ✓ Plani gjithashtu është në përputhje të plotë me Ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003-14, Udhëzimin Administrativ nr. 33 për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planit Zhvillimor të Komunës dhe ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174.
- ✓ Plani merr parasysh të gjitha projektet e përcaktuara për tu realizuar si nga niveli qendror ashtu edhe nga niveli komunal.
- ✓ Dispozitat për zbatim përcaktojnë mënyrën e rregullimit, zhvillimit dhe mbrojtjes së hapësirave sipas destinimit të përcaktuar.
- ✓ Plani përfshinë projekt-elaboratin me titull “Plani Zhvillimor Komunal i Podujevës 2016 – 2025” që është hartuar në vitin 2015 nga Komuna e Podujevës përmes kompanisë DataGIS Consulting, dhe përbëhet nga: pjesa tekstuale dhe ajo grafike (Harta, grafikone, tabela dhe foto të ndryshme).
- ✓ Ky plan është dokumenti kryesor për zhvillimin e ardhshëm hapësinor dhe të gjitha planet tjera i nënshtrohen këtij plani.

- ✓ Në përputhshmëri me ligjin mbi Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174, neni 26, komuna duhet të përpiloj Hartën Zonale të komunës në afat kohor prej 9 muaj pas miratimit përfundimtar të PZHK-së.

5.2 Detyrat dhe masat për zbatimin e planit

- ✓ Qeveria komunale e Podujevës është përgjegjëse për ta udhëhequr tërë procesin për realizimin e këtij plani brenda periudhës kohore 2016 -2025.
- ✓ Drejtoria për urbanizëm në komunën e Podujevës është koordinator i realizimit të këtij plani, por gjithashtu edhe Drejtoritë tjera komunale do të jenë të involvuara drejtpërdrejtë, duke marrë për sipër zhvillimin e fushave përkatëse në harmoni të plotë me këtë dokument.
- ✓ Të gjitha zhvillimet e parapara në këtë plan parashihet të financohen, jo vetëm nga buxheti komunal, por edhe nga ai qendror, ndërkombëtar dhe nga biznesi privat, andaj kërkohet nga qeveria komunale dhe konkretisht nga sektorët gjegjës që të kenë një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha këto institucione dhe akterët kyç për realizimin e planit.
- ✓ Drejtoria për urbanizëm vazhdimisht përcjell zbatimin e planit dhe rrjedhën e zbatimit të tij, duke nxitur dhe stimuluar të gjithë akterët kyç, gjithashtu realizon edhe hulumtime që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin urban.

5.3 Kushtet për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e komunës

Vizioni për Komunën e Podujevës përcakton shtyllat kryesore në të cilat zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i bazuar. Zhvillimi i çdonjërës nga këto shtylla ka dimensionin e vet hapësinor dhe ndikim në zonat e përcaktuara për zhvillim.

Në çdo vendbanim ekzistues, duke përfshirë edhe vendbanimet joformale, nevoja dhe mundësia e përcaktimit të hapësirave publike, si; fushat për lojë, zonat e gjelbëruara, tregjet, hapësirat sportive dhe hapësira për parkim do të përkrahen me plane rregulluese, aty ku përpilimi i Hartës Zonale është prioritet. Ky vlerësim do të jetë pjesë e procesit të hartimit të këtyre planeve.

Parimet për zhvillim dhe mbrojtje formulojnë bazën për përcaktimin e kushteve për çështjet e shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit.

Zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i bazuar në vendime adekuate. Në PZHK, toka për zhvillim dhe rregullim është e destinuar për këto lloje të shfrytëzimit:

- ✓ Vendbanime
- ✓ Rekreacion
- ✓ Toka bujqësore
- ✓ Korridore të gjelbërimit
- ✓ Kullosa dhe livadhe
- ✓ Pyje
- ✓ Pyllëzim
- ✓ Gurëthyes
- ✓ Rrjedha të ujit

5.4 Kushtet për rregullimin e hapësirës

Ndërtimi do të jetë i lejuar vetëm në zonat e destinuar për ndërtim të përcaktuara me PZHK. Zhvillimi në qytetin e Podujevës dhe në qendrat sekondare duhet të rregullohen me Plane Rregulluese Urbane. Infrastruktura publike do të ofrohet vetëm në zonat e destinuar për ndërtim. Në zonat ku Hartat Zonale nuk janë të miratuara, duhet zbatuar hulumtimin për kërkesat, mundësitë dhe ofrimin e infrastrukturës.

Ndërtimi në tokën bujqësore do të jetë i lejuar vetëm në tokën e cilësisë së ulët, mbi klasën e IV, djerrina dhe vetëm në raste të veçanta për zhvillimin që përkrahin veprimtaritë bujqësore. Zhvillimet në hapësirën e lirë, peizazhi natyror, duhet bazuar në rregullat mjedisore për mbrojtjen e natyrës dhe peizazhit. Në mungesë të hartës zonale, komuna duhet të nxjerrë udhëzimet përkatëse të karakterit obligativ.

Në zonat ku zhvillimi është i lejuar, kushtet ndërtimore duhet të përcaktojnë:

- ✓ Formën dhe madhësinë e zonës së zhvillimit,
- ✓ Mënyrën e shfrytëzimit apo përdorimit e autorizuar për ngastrën tokësore,
- ✓ Rregullat e ndërtimit dhe distancën në mes të ndërtesave në ngastër,
- ✓ Rregullat për kyçje e ndërtesës në rrjetin e infrastrukturës;
- ✓ Masat për mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.
- ✓ Përgatitja e lokacionit si: largimi i ndërtesave dhe rehabilitimi i dheut (tokës), hulumtimet gjeo-mekanike dhe dheut.

5.5 Ndertesat me rendesi per Kosoven ne Komunen e Podujeves

- ✓ Komuna do të vendosë nën kontroll strikt të gjitha zhvillimet përreth (përgjatë) korridorit të autostradës Morinë – Merdarë.
- ✓ Për të kufizuar ndikimin mjedisor – emisionin e gazrave dhe zhurmën, komuna duhet të zhvilloj një zonë mbrojtëse – brez të gjelbër përgjatë pjesëve të korridorit të autostradës në pjesët ku ky korridor kalon në afërsi të vendbanimeve në përputhshmëri me ligjet në fuqi (ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për rrugë nr. 2003/11).
- ✓ Komuna do të bashkëpunoj dhe koordinoj aktivitetet me MMPH-në për mbrojtjen e akumulacionit të Batllavës në përputhshmëri të plotë me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 17/127 të vitit 2013 për mrojtjen e burimit ujor te akumulacionit të Batllavës .

5.6 Zonat Ndertimore per Vendbanime

- ✓ Zonat e ndërtimit janë të përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal për Podujevën. Ndërtimi është i lejuar vetëm në zonat e përcaktuara për zhvillimin e vendbanimeve (tokën ndërtimore).
- ✓ Kufijtë e tokës ndërtimore, banimi dhe rritja e vendbanimeve) të PZHK paraqesin kufijtë absolut për zhvillimin e vendbanimeve (sipas grifakoneve në tekst).

- ✓ Pasi që zhvillimi në masë të madhe duhet të zë vend në vendbanimet ekzistuese, vetëm zhvillimi dhe ndërtimi plotësues duhet lejuar.
- ✓ Dendësimi i ndërtimit dhe metodat e ndërtimit për shfrytëzim më racional të tokës do të aplikohen në mënyrë rigoroze.
- ✓ Definicioni përkatës i veçorive dhe karakterit të ndërtesave në zonat kufizuese me peizazh të ndjeshëm ndaj ndikimit duhet përcaktuar me Hartën Zonale dhe Plan Rregullues të Hollësishëm. Planet rregulluese si instrument i planifikimit duhet përdorë po ashtu për të arritur përshtatshmërinë ndërtimore me rrethinën.
- ✓ Infrastruktura dhe shërbimet duhet të ofrohen në zonat e reja për ndërtim (rryma, sistemi i kanalizimit, ai i ujit). – Zhvillimi i infrastrukturës duhet ofruar gradualisht bazuar në kërkesat dhe në përputhje me mundësitë financiare të komunës.
- ✓ Alternativat tjera sikur partneriteti publik-privat ose skemat private të financimit duhet dakorduar me komunën.

5.7 Strukturat e ndertuara jashte Vendbanimeve

- ✓ Për zonat e përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal si të lira nga cilido lloj i zhvillimit dhe të mbrojtura nga ndërtimi duhet garantuar:
 - Mbrojtjen e zonave për zhvillimin e vazhdueshëm të bujqësisë dhe pylltarisë
 - Zonat me vlera të veçanta ekologjike
 - Mbrojtjen e peizazhit natyror dhe lokacioneve të trashëgimisë, dhe po ashtu zonat e lidhura natyrore për rekreacion. (duke mos kundërshtuar zhvillimin e vendbanimit)
- ✓ Jashtë zonës ndërtimore do të lejohen vetëm ndërtesat që janë në harmoni me Ligjin për Planifikim Hapësinor 2003/14, Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Ligji L-03/L-106 dhe Ligjit për Planifikimin Hapësinor 04/L-174:
 - Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile;
 - Ndërtesa për mbrojtje nga zjarri dhe materialet të dëmshme – eksploziv etj;
 - Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore;
 - Infrastruktura;
 - Ndërtesa për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksploatuar;
 - Rekreacion dhe turizëm rural dhe malor (shtigje për ecje, objekte sportive)
- ✓ Komuna nuk do të jetë përgjegjëse për ofrimin e infrastrukturës jashtë vendbanimeve. Bazuar në shfrytëzimin e përcaktuar të tokës, ofrimi i infrastrukturës për zhvillimin e ri do të jetë përgjegjësi e pronarëve ose ndërmarrësve.

5.8. Kushtet per vendosjen e veprimtarive publike

- ✓ Për të mbrojtur zonën e infrastrukturës me interes për komunën, një politikë e avansuar do të udhëhiqet nga ana e komunës.
- ✓ Plani Zhvillimor Komunal duhet të alokoj tokë rezervë për kërkesa të veçanta (banimi për të moshuarit, institucionet për persona me kërkesa specifike, jetimore), dhe zgjerimin e zonave

të aktivitetit publik në përputhej me funksionin e vendbanimit – qendra kryesore, nën qendra, qendër lokale dhe fshatrat.

- ✓ Komuna duhet të alokoj hapësirë për shkolla të reja dhe institucione parashkollore. Ato duhet rregulluar me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme nga transporti publik. Ngastrat e alokuara për këtë ndërtim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - Institucionet parashkollore 20 - 40 m²/fëmijë
 - Shkollat fillore 20 - 50 m²/fëmijë
- ✓ Komuna mund të alokoj një ngastër të përbashkët për ndërtimin e përmbajtjeve sikur janë: edukimi, kultura, shëndetësia dhe shërbimet sociale, qendra të komunitetit. Kjo posaçërisht është e rëndësishme për nën qendrat dhe qendrat lokale.
- ✓ Zonat e destinuar për sporte dhe rekreacion duhet të jenë të pajisura me shtigje, infrastrukturë dhe gjelbërim. Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane që shërbejnë pajisje sportive rekreative. Maksimumi i indeksit të zënies së ngastrës lejohet të kaloj 10% të sipërfaqës së ngastrës.

5.9 Masat për mbrojtjen e peisazheve, vlerave natyrore dhe tersive kulturore-historike

- ✓ Komuna, së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të atakoj vlerat e monumenteve, përveç atyre që shërbejnë ti mbroj ato.
- ✓ Komuna nuk do të lejoj asnjë zhvillim në tokën kualitative bujqësore, përveç atyre zhvillimeve që shërbejnë për mirëmbajtje të veprimtarisë bujqësore
- ✓ Komuna do të nënshkruaj marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për veprime të përbashkëta për mbrojtje të pyjeve.
- ✓ Komuna në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të hartoj planet rregulluese për bregun e lumit Llap si hapësirë publike që të mbroj vlerën e peizazhit.
- ✓ Komuna në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të ndërmarrë masa për konsolidimin e tokës në zonat e deponive ilegale.
- ✓ Komuna, së bashku me Kompaninë Publike Rajonale për menaxhim të mbeturinave, bazuar në ligjin dhe kompetencat e deleguara, duhet të përmirësoj shërbimet për menaxhim të mbeturinave në Komunën e Podujevës dhe vendbanimet tjera.
- ✓ Komuna duhet të hartoj Rregulloren për hapësirat e gjelbra dhe politikën për gjelbërim.

5.10 Menyra e trajtimit të hedhurinave

- ✓ Koncepti detaj i Menaxhimit të Mbeturinave për zonën Urbane të Podujevës dhe nën qendrave duhet të elaborohet.
- ✓ Deponia regjionale gjendet në fshatin Dumnicë e Epërme, në mënyrë që të mblidhen të hyra për shërbimin e hedhjes së mbeturinave dhe ujërave të zeza.
- ✓ Komuna duhet të paraqes një politikë për mbledhjen e materialeve të rendit të dytë si dhe për riciklimin e mbeturinave. Komuna e Podujevës së bashku me kompaninë publike regjionale për menaxhimin e mbeturinave duhet të organizojnë ndarjen, mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave.
- ✓ Sistemi i ujërave të zeza duhet të bazohet në Strategjinë për Trajtimin e Ujërave të Përdorura për Kosovë.
- ✓ Hedhja e mbeturinave dhe ujërave të zeza duhet të bazohet në metoda të qëndrueshme, duke u përqendruar në prodhimin e energjisë ripërtëritëse dhe biomasës në të gjitha zonat e definuara si zona për prodhimin e energjisë ripërtëritëse.

5.11 Masat për pengimin e ndikimeve të demshme në mjedis

- ✓ Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.
- ✓ Projektet Zhvillimore në shkallë prej 5 hektarëve duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë ndikime (konflikt) në mjedis.
- ✓ Gjatë dhënies së kushteve ndërtimore dhe lejeve ndërtimore për objekte zhvillimore ekonomike, nëse është e nevojshme, në pajtim me rregullat mjedisore, të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis si ndotja e ajrit dhe zhurma, vibrimet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i evojshëm për përmbajtjet prodhuese.
- ✓ Burimet e ujit duhet të mbrohen gjatë dhënies së kushteve ndërtimore dhe lejeve ndërtimore, është e nevojshme që të rregullohen masat për mbrojtje në mënyrë që uji nëntokësor të mbrohet:
 - Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza me elemente të papërshkueshme nga uji
 - Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhimit
 - Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza
 - Për mbrojtjen e rrjedhave të lumenjve, është e nevojshme të kontrollohet të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.
- ✓ Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga ndotja e zhurmës është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve për motoçikleta dhe vendbanimeve.
- ✓ Në mënyrë që të mbrohet ajri nga ndotja është e nevojshme që të kontrollohet lokacioni për prodhimin e pajisjeve dhe llojin e teknologjisë, llojin e energjisë dhe të stimulohet energjia e pastër dhe energjia ripërtëritëse.

- ✓ Meqenëse Podujeva është e pasur me pyje dhe peizazhe kodrinore, është e nevojshme të kontrollohet gjuetia në mënyrë që të mbrohet zhdukja e specieve shtazore.

5.12 Masat për parandalimin e ndikimeve negative sociale

- ✓ Komuna duhet të ofrojë infrastrukturë të nevojshme sociale (edukim, shërbim mjekësor, kulturë, sport) që të shmanget ndikimi negativ social i zhvillimit. Një seri e masave për infrastrukturë duhet të jenë sipas funksionit të vendbanimit (qendra kryesore, nën qendra, qendra lokale).
- ✓ Dendësia e vendbanimit duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me zhvillimet sociale të vendbanimit.
- ✓ Komuna do të vlerësojë problemet specifike në lidhje me vendbanimet joformale dhe do të propozojë zgjedhje në ato vende ku përpilimi i Hartës Zonale është prioritet.
- ✓ Komuna duhet të ballafaqohet me ndërtimet ilegale konform ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale. Për këtë arsye do të krijohet një bazë e të dhënave e cila për çdo ngastër do të përmbajë informata e nevojshme në lidhje me lejen e lëshuar.
- ✓ Për ndërtesat e konsideruara si ilegale, sipas ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale, komuna do të fillojë procedurën e legalizimit. Për procesin e legalizimit dhe lëshimin e lejeve valide për ndërtesë komuna do të kërkojë takes në përputhshmëri me ligjet në fuqi.

5.13 Mjedis i pastër dhe atraktiv

- ✓ Eliminimin e të gjitha vendgrumbullimeve ilegale të mbeturinave në të ardhmen.
- ✓ Organizimin e një sistemi funksional dhe mjaft efikas për menaxhimin e mbeturinave.
- ✓ Angazhimi i kompanive profesionale për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.
- ✓ Funksionalizimi i inspektoratit të mjedisit dhe ndërmarrja e masave të rrepta ndaj veprimeve ilegale mjedisore.
- ✓ Kontroll më të shpeshta dhe të veçanta përgjatë rrjedhave lumore me qëllim të mbrojtjes së tyre nga hedhja e mbeturinave.
- ✓ Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe me donatorët privat për të gjetur mundësinë e ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza sipas standardeve dhe gropave septike.
- ✓ Parandalimin e operatoreve ilegal të gurthyesve, grumbullimin e taksave mjedisore dhe ndalimin e furrave për pjekje të gjelqeres me materiale plastike.
- ✓ Mbrojtja e trashëgimisë përfshinë disa masa konkrete për të ardhmen, ku paraprakisht duhet kushtuar vëmendje të veçanët mbrojtjes së trashëgimisë ekzistuese nga degradimet eventuale deri realizimin e projekteve të parapara në këtë strategji për fushën e trashëgimisë.
- ✓ Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe donatorët tjerë për hartimin e planeve menaxhuese të pyjeve, si dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura.

- ✓ Për ta mbrojtur tokën kualitative bujqësore, organet komunale duhet ta respektojnë vijën e ndërtimit që është përcaktuar në fazën e koncepteve, ku të gjitha vendbanimet e komunës kanë drejtimet e zgjerimit dhe drejtimet kah nuk mund të zhvillohen për shkak të tokës kualitative.

5.14 Kushtet per vendosjen e veprimtarive ekonomike

- ✓ Komuna do të alokoj tokë të mjaftueshme që të përkrahë zhvillimin e biznesit i cili është i bazuar në shfrytëzimin e fuqisë punëtore vendore.
- ✓ Në zonat e përcaktuara për biznes dhe industri do të lejohet vetëm ndërtimi i përmbajtjeve të pastra për prodhimtari bujqësore dhe industriale, depot, shërbimet dhe përmbajtje tregtare të cilat nuk kanë ndikim negative në mjedis.
- ✓ Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimtarisë dhe shfrytëzim përkatës komercial mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin që i rrethon (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit, zhurma, trafiku.).
- ✓ Bizneset industriale dhe komerciale me ndotje të shprehur nuk do të lejohen kurrsesi.
- ✓ Zgjerimi i zonave ekzistuese të industrisë dhe biznesit vetëm nëse qëndrueshmëria e zonës është paraprakisht e dëshmuar, në rast të urgjencës dhe mungesës së hapësirës së përshtatshme për tu alokuar.
- ✓ Parqet e reja të biznesit duhet të dëshmojnë furnizim energjetik të vet-qëndrueshëm me prodhim të energjisë nga burimet e ripërtërishme nëse ato gjinden në afërsi të potencialit të lartë për energji të ripërtërishme
- ✓ Komuna do të lejojë ndërtimin e infrastrukturës që përkrahë atraksionet turistike dhe aktivitetet e rekreacionit të cilat nuk kanë asnjë ndikim negative në mjedis – shtigjet për bjeshkatar dhe çiklistë, pikat e vizitës etj.
- ✓ Bashkëpunimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe donatorët tjerë me qëllim të realizimit të projekteve të parapara në këtë planë e që ndërlidhen me zhvillimin e bujqësisë së komunës

5.15 Kushtet per vendosjen e korridoreve apo traseve, siperfaqeve komunikuese dhe sistemeve tjera te infrastruktures

- ✓ Korridoret rrugore duhet të garantohen në shkallë të përshtatshme në harmoni me funksion të qendrave dhe kërkesave kombëtare e regjionale.
- ✓ Gjatë procesit të definimit të zonave të ndërtimit, duhet të dëshmohet se është shmangur kostoja e lartë në masat zhvillimore dhe mirëmbajtje. Ndërtimi duhet ti respektojë rregullativat për një ndërtim të qëndrueshëm – orientimi, kushtet klimatike etj.
- ✓ Koncepti detaj i mobilitetit (përfshirë edhe transportin publik, këmbësor dhe trafikun për çiklist) për komunën e Podujevës duhet te elaborohet. Ky koncept duhet të përcillet me plan detaj për zhvillim turistik.
- ✓ Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve (gjerësia e rrugëve, kalimet e rrezikshme, pjerrtësia) duhet të shmangen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.

- ✓ Qasje direkte për zhvillim në rrugët kryesore (p.sh. Kategoria I) me kufizim të shpejtësisë me më shumë se 60 Km/h nuk do të lejohet.
- ✓ Ministria e transportit dhe Post Telekomunikacionit është përgjegjëse për rrugët kryesore dhe ato regjionale. Kështu që rregulloret dhe standardet teknike janë të dhëna nga Ministria.
- ✓ Në komunën e Podujevës, rrugët kryesore, rrugët lokale dhe rrugët e tjera duhet të dimensionohen në mënyrë që të mund të lejojnë zhvillim të komunikacionit të sigurt për të gjitha automjetet në çfarëdo kushte atmosferike. Shtigjet e Komunikacionit duhet të respektojnë rregulloret ekzistuese. Shtigjet duhet të jenë të gjera më së paku 3.0m'. Aty ku ka barriera fizike shtigjet mund të ngushtohen.
- ✓ Nëse pozita financiare e komunës nuk mund të siguroj zbatimin e rrugëve me hapësira te veçanta për këmbësorë - në zonat e banimit, është e rekomanduar që rruga duhet të përfshij shtigjet për këmbësor .
- ✓ Rruga për qasje në parcelat për ndërtim duhet të jetë minimum 3.0m' e gjerë dhe max. 60.0 m' e gjatë.
- ✓ Te gjitha udhëkryqet në nivelin e terrenit duhet të sigurojnë pamje prej të gjitha drejtimeve.
- ✓ Shtigjet për çiklizëm të një drejtimi, nëse janë të ndara duhet të jenë 0,8m' të gjëra.
- ✓ Nëse hapësirat për çiklizëm janë të ndara atëherë shtegu i gjelbër duhet te jetë 0,35m'.
- ✓ Në zonat për parkim që shërbejnë për transportin publik, shtegu i ndaljeve të autobusëve duhet të jetë së paku 2.0m i gjerë.
- ✓ Standardet për parkim janë si në vijim:
 - Shtëpi banimi për një familje(1VP/shtëpi) në ngastër;
 - Banimi shumë familjar (1VP/1 kat në ngastër apo të ngjashëm)
 - Zyret; 1 VP në 75 m² btto zonë; (12 VP/1000 m² btto)
 - Dyqane 1 VP në 50 m² btto zonë; (20 VP/1000 m² btto)
 - Qendër tregtare: 1 VP në 40 m² btto zonë; (25 VP/1000 m² btto)
 - Industri dhe depo: 1 VP / 5 të punësuar;
 - Shërbime 1 VP / 3 të punësuar;
 - Restorante 1 VP /1 tavolinë;
 - Ndërtesa sportive: 1 VP / 20 ulëse;
 - Shkolla dhe jetimore: 1 VP/ klasa dhe grupe të fëmijëve
 - Shërbimet e shëndetësisë : 1 VP /40 m² btto . (25 VP/1000 m² btto)
- ✓ Në korridorin rrugor të rrugëve kryesore regjionale, është i lejuar ndërtimi i ndërtesave në vijim:
 - Pompa të benzinës me dyqane, restorant dhe përmbajtje shërbyese
 - Larje dhe shërbime të automjeteve
- ✓ Këto ndërtesa duhet pas hapësirën e dedikuar për parkim brenda ngastrës.
- ✓ Gjatë kërkimit për leje ndërtimore, miratimi i kushteve të vecanta për qasje në rrugën magjistrale duhet të lëshohet nga Drejtoria për Rrugë në Ministrinë e Infrastrukturës.
- ✓ Prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës teknike do t'i jepen Podujevës dhe nënqendrave, si dhe zonave rurale më të pazhvilluara.

- ✓ Korridoret duhet të garantohen në një shkallë të caktuar sipas funksioneve të qendrave dhe nevojave nacionale dhe rajonale.

5.16 Dispozitat përfundimtare

- ✓ Hyrja e planit në fuqi: Ky plan do të jetë i plotëfuqishëm pas aprovimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe miratimit nga Kuvendi i Komunës 7 ditë nga publikimi në faqen zyrtare të komunës.
- ✓ Ky plan do të jetë valid për periudhën kohore 2016 – 2025.
- ✓ Pas miratimit dhe publikimit të PZHK-së kopja në formë digjitale e vërtetuar do t'i dorëzohet MMPH-së.

5.17 Vlerësimi

PZHK do të vlerësohet rregullisht, një herë në çdo 2 vite.

Gjithashtu, do të shqyrtohen zhvillimet aktuale dhe të dhënat demografike të tanishme, nevojat për banim dhe zhvillimet ekonomike. Vlerësimet do të përcaktojnë serinë e zbatimit të planeve të veprimit dhe strategjive.

Procedura e rregullt e rishikimit është në periudhën prej së paku 8 viteve.

Elementet dhe udhëzimet për hulumtim

Plani Zhvillimor Komunal ofron kornizë punuese për studime të mëtutjeshme në zhvillimin e komunës që lehtëson zbatimin e Planit.

Planet dhe politikat që duhet hartuar:

- ✓ Plani i politikave mjedisore, në veçanti mbrojtja e ujërave, pyjeve dhe tokës bujqësore,
- ✓ Kadastër të avancuar komunal,
- ✓ Plan të zhvillimit ekonomik,
- ✓ Plan për zhvillimin të turizmit,
- ✓ Politikat e mobilitetit,
- ✓ Hulumtim i burimeve energjetike, duke përfshirë studimin e burimeve të energjisë rigjenerues
- ✓ Harta Zonale e Komunës

ANEKSET
PROJEKTET E PLANIFIKUARA 2016 – 2025

REFERENCAT

1. Ligji për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14,
2. Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 03/L-106
3. Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174
4. Ligji për kufijtë administrativ të komunave Nr. 03/L-041
5. Ligji për shëndetësi Nr. 04/L-125
6. Ligji për arsimin parauniversitar Nr. 04/L-032
7. Ligji për vetqeverisjen locale Nr 03/L-040
8. Strategjia e Zhvillimit Hapësinor të Kosovës 2010 – 2020+, Prishtine 2010
9. Strategjia e Zhvillimi Ekonomik Lokal, 2011 – 2014, Komuna Podujevë, 2010
10. Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Komuna Podujevë, 2011
11. Vendimi i Qeverisë së Kosovës, nr. 17/127 për përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe masave mbrojtëse të burimit ujor sipërfaqësor të Akumulimit të Batllavës
12. Të dhënat zyrtare nga sektorët e Qeverisë Komunale – plotësimi i veglave të punës.
13. Të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011
14. Të dhënat nga sektorët e ndryshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
15. Të dhënat nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Podujevës.
16. Të dhënat nga kompanitë publike komunale.
17. Hartat topografike: 1:50000, 1:25000
18. Orto-fotot (prodhim: viti 2009 dhe 2012).
19. Puna në terren (ekipet e kompanisë kanë vizituar të gjitha vendbanimet e komunës).
20. Aplikimi i GIS dhe GPS
21. Literatura shkencore.



PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SE PODUJEVËS
Aneksi 1: Projektet e Planifikuara 2016 - 2025
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SOCIAL DHE ADMINISTRATES

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT SOCIAL DHE ADMINISTRATES							
Strategjia e zhvillimit social dhe administrates	S1.Administratë funksionale dhe efikase	Kuadër i profesionalizuar i cili do të jetë në shërbim të qytetarëve	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2025	K. Komunal	
		Avancimi i sistemit elektronik, ku çdo qytetar të ketë mundësi të informohet me gjithçka që i intereson dhe të mund të plotësoj formular dhe parashtroj kërkesa sipas nevojës së tij përmes sistemit elektronik si digitalizimit të administratës	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2025	K. Komunal, Donatorët	
		Decentralizimi i administratës - Funksionalizimi i shërbimeve administrative edhe në qendrat sekondare dhe ato të bashkësive lokale	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2025	K. Komunal, Donatorët	
		Ndërtimi i sistemit të adresave - krijimi i bazës së të dhënave mbi të gjitha ekonomit familjare dhe bizneseve përmes sistemit të GIS-it	MSH,K. Komunal	K.Komunal	2016 - 2025	K. Komunal, donatorët	
		Inventarizimi i objektit të ri të Administratës	K.Komunal	K.Komunal	2016 - 2017	K.Komunal	80,000.00
		Blerja e automjeteve	K.Komunal	K.Komunal	2017 - 2018	K.Komunal	50,000.00
		Instalimi i rrethojave per zyrat e vendit	K.Komunal	K.Komunal	2016 - 2018	K.Komunal	40,000.00
		Ndërtimi i zyrave të vendit si ne fsh. Lluzhan, etj.	K.Komunal	K.Komunal	2016 - 2018	K.Komunal	190,000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR DHE ARSIMOR							
Sistem i avancuar në arsim dhe shëndetësi	S1. Ndërtimi i objekteve shkollore dhe shëndetsore në ato vendbanime ku janë identifikuar kërkesat	Ndërtimi i shkollave të reja: SHFMU " Naim Frashëri" në Podujevë, SHFMU " Enver Maloku" në Podujevë, SHFMU në fshatin Batllava (II)	K.Komunal	K.Komunal	2016 - 2018	K. Komunal, Granti Qeveritar	400,000.00
		Ndërtimi i një çerdheje/kopshti në Podujevë	K. Komunal, MASHT	K.Komunal	2016 - 2018	K. Komunal ,Granti Qeveritar	50,000.00
		Organizimin e transportit për nxënësit të cilet udhetojne ne nje drejtim mbi 4km nga shtepia ne shkolle	K.Komunal	K.Komunal	2016- 2020	K.Komunal	/
		Ndertimi i ambulancave ne fshatin Majac dhe Obrace, Bradash	K.Komunal	K.Komunal	2016 - 2018	Granti Qeveritar	165,000.00
	S2. Zgjerimi i hapësirave dhe ngritja e cilësisë fizike të objekteve arsimore dhe shëndetësore	Ndërtimi i anekseve dhe renovimi i objekteve shkollore me qëllim të krijimit të hapësirave të nevojshme shkollore për mësim të rregullt dhe atë parashkollor. Renovimi i plote i SHMTL "Fan Noli" ne Podujeve SHFMU në Dobratin, Llapashticë të Poshtme, Zhiti, Bellopojë, Brainë, në Bajqinë, Dumosh, Halabak	K. Komunal, MASHT,	K.Komunal	2016 - 2018	Granti Qeveritar	400,000.00
		Renovimi i objekteve shëndetsore, ndertimi I objekteve ndihmese per QMF dhe AMF dhe rregullimi i oborrit te QMF-se dhe AMF-ve	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2018	Grant Qeveritar	143,527.00
		Kyçja në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit të AMF-ve të cilat nuk janë të kyçura	K. Komunal, MSH	Përfshihet në pjesën e infrastrukturës teknike (ujësjellësi dhe kanalizimi) në nivel të komunës			
	S3. Rritja e numrit të kuadrit të kualifikuar profesional, në arsim dhe shëndetësi	Në shumicën e shkollave fillore të mesme të ulëta dhe në shkollat e mesme të larta duhet siguruar kuadër të kualifikuar konform ligjit në fuqi e veçanërisht për shkollat në viset rurale dhe shkollën e mesme teknike në Podujevë.	K. Komunal, MASHT	K. Komunal,	2016 - 2019	K. Komunal,	/
		Në QMF-të arrihet raporti 1 stomatolog për 6000 banor	MSH,K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2018	K. Komunal,	/

PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SE PODUJEVËS
Aneksi 2: Projektet e Planifikuara 2016 - 2025
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR DHE ARSIMOR

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
	S4 Programe dhe trajnime të vazhdueshme profesionale në arsim dhe shëndetësi	Hartimi i programeve për trajnim të vazhdueshëm si dhe licencimi dhe akreditimi i tyre	MASHT, MSH, K. Komunal	K. Komunal	2010 - 2018	K. Komunal	/
		Organizmi i trajnimeve metodologjike dhe profesionale për kuadrin arsimor dhe shëndetësor.	MASHT, MSH, K. Komunal	K. Komunal	2015 - 2018	K. Komunal	/
		Edukimi i vazhduar profesional për kuadrin arsimor dhe shëndetësor.	MASHT, MSH, K. Komunal	MASHT, MSH, K. Komunal	2016 - 2018	MASHT, MSH	/
	S5. Sigurimi i pajisjeve teknike për shërbime arsimore dhe shëndetësore	Krijimi i kabinetëve dhe laboratorëve të fushave përkatëse (Fizikë, Kimi, Biologji, Informatikë) dhe pajisja e tyre me mjete didaktike dhe profesionale	MASHT, K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2018	K. Komunal,	/
		Pajisja me mjete teknike moderne e kryesisht ato për diagnostifikim të hershëm të sëmundjeve në të gjitha institucioneve shëndetësore: Furnizim me pajisje mjeksore Blerja e karrigeve stomatologjike	MSH, K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2018	K. Komunal,	458,000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
STRATEGJIA E ZBUTJES SË PAPUNËSISË DHE VARFËRISË							
Zbutja e shkallës së papunësisë dhe varfërisë	S1. Organizimi i programeve dhe trajnimeve profesionale sipas kërkesave të tregut	1 Organizimi i kurseve të rrobaqepësisë dhe parukerisë	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2020	K.Komunal, Donatorët	5,000.00
		2 Organizimi i trajnimeve për menaxhimin e bizneseve të vogla	K. Komunal, MTI	K.Komunal	2016 - 2020	K.Komunal, Donatorët	9,000.00
		3 Organizimin e trajnimeve apo seminareve për përdorimin e teknikave të reja	MSH, K. Komunal	K.Komunal	2016 - 2020	K.Komunal, Donatorët	9,500.00
	S2. Sigurimi i punës sezonale	1 Mbledhja e frutave, perimeve, qajrave etj	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2020	K. Komunal	Nuk ka implikime financiare
		2. Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe parqeve	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2020	K. Komunal, donatorët	Nuk ka implikime financiare
		3. Lidhja e kontratës sezonale me ndonjë vend - shtet	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2020	K. Komunal, donatorët	Nuk ka implikime financiare
	S3 Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme	1 Stimulimi i bujkut përmes lirimit të kostos së derivateve, plehrave artificiale, farërave etj	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2020	K. Komunal	Nuk ka implikime financiare
		2. Kredi me kamata të ulëta dhe afatgjata për bujqësi dhe blegtori	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2020	K. Komunal	Nuk ka implikime financiare
		3. Zvogëlimi dhe lehtësimi i taksave për bizneset e vogla dhe të mesme.	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2020	K. Komunal	Nuk ka implikime financiare



PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SE PODUJEVËS
Aneksi 4: Projektet e Planifikuara 2016 - 2025
ZHVILLIMI KOMPAKT DHE I QËNDRUESHËM I VENDBANIMEVE

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
ZHVILLIMI KOMPAKT DHE I QËNDRUESHËM I VENDBANIMEVE							
Strategjia e zhvillimit kompakt dhe funksionalizimit të vendbanimeve	S1. Formimi i qendrave sekondare	Sigurimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në qendrat sekondare dhe vendbanimeve tjera me qëllim të përmirësimit të kushteve jetësore	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2020	Kuvendi Komunal dhe ndërmarrjet publike	E lartë
	S2. Hartimi i planeve rregulluese urbane	Përpilimi i Hartës Zonale të Komunës	K. Komunal,	K.Komunal	2016 - 2018	Komuna dhe Grantet Qeveritare	60,000.00
	S3. Rregullimi i vendbanimeve jo formale	Ndërtimi i një lagjeje për banim në qytetin e Podujevës për vendosjen e popullatës që jetojnë në Lagjen e Kuvajtit	K. Komunal,	K.Komunal	2016 -2018	Komuna dhe MPMS	600,000

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TE MJEDISIT							
Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor	S1. Parandalimi dhe largimi i mbeturinave ne trupat uhor dhe mjedise tjera	Rritja e shpenzimeve dhe teknologjisë për mbledhjen e mbeturinave	K. Komunal	Komuna, Kompania Regjionale per grumbullimin e mbeturinave	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Kompania Regjionale, Donatoret	150,000.00
		Vënja në funksionim e procesit te riciklimit të mbeturinave	K. Komunal	Komuna, Kompania Regjionale per grumbullimin e mbeturinave	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Kompania Regjionale, Donatoret	
		Vazhdimi i rehabilitimit te sipërfaqeve me mbetje ilegale dhe mënjanimin e tyre ne tere komunën në masat tokësore dhe ne mjediset ku trupat uhor kanë shtrirje	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	300,000.00
		Inicimi i iniciatives fiskale për sjellje miqësore ndaj mjedisit	Kuvendi Komunal	K. Komunal	2016 - 2020	Taksa ekofond	
		Mirembajtja e ambientit, parqeve, zgjerimi i hapësirave të gjelbruara, rregulimi, renovimi e pastrimi i shtreterve te lumenjeve dhe hapësirave pergjate brigjeve te tyre.	Komuna	K. Komunal	2016 - 2018	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare,	306,894.00
		Marrja e masave për rehabilitimin e zonave të ndotura të mjedisit	Komuna	K. Komunal	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	55,000.00
		Edukim mjedisor nga subjektet e kontraktuara dhe nga OJQ-të mjedisore	Komuna	Komuna - Drejtoria për arsim	2016 - 2025	K. Komunal	15,000.00
		Shtrirja e aktivitetit te kompanisë për pastrim ne tere territorin e komunës	Komuna	ZRRM	2016 - 2020	K. Komunal	50,000.00
		Hartimi i rregullores komunale në bazë të Ligjit për Mbrojtje të mjedisit dhe funksionalizimi i Inspektoratit të Mjedisit në gjobitjen e veprimeve ilegale mjedisore	Komuna	K. Komunal	2016 - 2020	K. Komunal	1,500.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
		Kontroll rigoroz nga inspektorati Komunal dhe pajisja e tyre me mjete të nevojshme .	Komuna	K. Komunal	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare	20,000.00
		Organizimi i aksioneve vullnetare për pastrim të mbeturinave nga lumi Llap organizuar nga OJQ-ët mjedisore dhe Komuna, Drejtoria Arsimit si dhe nga vet Komuniteti, si dhe organizimi i fushatave për vetëdijesim për ujëra	Komuna	K. Komunal	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	10,000.00
		Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve dhe ligjeve ne fuqi nga inspektorati si dhe zbatimi i dënimeve për ndotësit.	Komuna	K. Komunal	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	5,000.00
	Synimi 3. Ndërmarrja e masave anti-erozive dhe ruajtja e tokës	Meliorimi i pyjeve të rreth 11000ha ne tri faza 2010-2015, 2016-2020 dhe 2021-2025, Masat të përpilohen në bazë të prioriteteve.	Komuna	MMPH dhe Komuna	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	E larte
		Kontrolli i mbetjeve të natyrave të ndryshme	Komuna	MMPH dhe Komuna	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	10,000.00
		Kontrolli përdorimit të plehrave dhe pesticideve si dhe Kontrolli dhe mënyra e përdorimit të tokave	Komuna	Komuna - Drejtoria për bujqësi	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	5,000.00
	S4. Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve	Pastrimi dhe rregullimi i shtratit te lumenjve	Komuna	K. Komunal	2016- 2017	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare	370,000.00
		Të bëhet meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve si masa parandaluese te vërshimeve dhe të parandalimit të erozionit. Marrja e masave përkatëse për mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve.	Komuna	K. Komunal	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare	3,500,000.00
		Marrja e masave te nevojshme për kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos për ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet	Komuna	K. Komunal	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare	90,000.00
		Kontrollimi i eksploatimit të zhavorrit nga shtrati i lumenjve aty ku ka licencë për eksploatim si dhe ndëshkimi i operatorëve ilegal të behët nga Inspektorati komunal me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujit, shkatërrimit të botës shtazore lumore dhe dëmtimeve të shtratit që mund të shkaktojnë vërshime.	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2020	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare	10,000.00

PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SE PODUJEVËS
Aneksi 5: Projektet e Planifikuara 2016 - 2025
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TE MJEDISIT

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
	S5. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore	Pergatitja e planit menaxhues për mbrojtjen e integruar te natyrës dhe monumenteve kulturore.	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2025	K. Komunal	
		Perpilimi i planit të hollësishëm rregullues për liqenin e Batllaves	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2025	K. Komunal dhe MMPH	15,000.00
		Hartimi i planit të hollësishëm rregullues për bregun e lumit si hapësire publike që të mbroj vlerën e peizazhit të Lumit Llap si dhe për ujin termal në Lluzhan	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare	72,000.00
		Verja nën mbrojtje e lokaliteteve arkeologjike dhe monumenteve historike e ushtarake të luftës së UÇK-se	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare	5,000.00
		Perpilimi i katalogut turistik për shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare	15,000.00

PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SE PODUJEVËS
Aneksi 6: Projektet e Planifikuara 2016 - 2025
ZHVILLIM I HARMONIZUAR DHE I QËNDRUESHËM EKONOMIK

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
ZHVILLIM I HARMONIZUAR DHE I QËNDRUESHËM EKONOMIK							
Zhvillim i harmonizuar dhe i qëndrueshëm ekonomik	S1. Zhvillim dhe rritje e prodhimit në bujqësi drithëra, pemëtarisë dhe perimtarisë)	Ndalimi i zhvillimeve në tokat kualitative bujqësore	K. Komunal,	Inspektorati komunal dhe i Ministrisë së BPZHR	2016 - 2025	Pa implikime buxhetore	
		Stimulimi i mbjelljes dhe përpunimit të drithërave	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	1,000,000.00
		Stimulim për kultivimin pemëve dhe perimeve	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	1,000,000.00
		Përkrahje tregtare për prodhimet vendore	K. Komunal,	K. Komunal	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	500,000.00
	S2. Përkrahja e zhvillimit të blegtorisë dhe bletarisë	Zhvillimi i blegtorisë dhe përkrahje e blegtorëve	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	1,000,000.00
		Zhvillimi i bletarisë dhe përkrahje e bletarëve	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	500,000.00
		Favorizimi dhe mbrojtja e prodhimeve vendore	K. Komunal,	K. Komunal	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	500,000.00
	S3. Funksionalizimi i zonave industriale	Hartimi i planeve përkatëse për tri zonat me karakter ekonomik në komunën e Podujevës (industriale, bujqësore dhe turistike)	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2018	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	50,000.00
		Instalimi i infrastrukturës elementare në zonat e interesit ekonomik	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	1,000,000.00
		Promovimi i interesit të komunës për investime konkrete në zonat me interes ekonomik dhe vende tjera	K. Komunal,	K. Komunal	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	20,000.00

PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SE PODUJEVËS
Aneksi 6: Projektet e Planifikuara 2016 - 2025
ZHVILLIM I HARMONIZUAR DHE I QËNDRUESHËM EKONOMIK

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Zhvillimi	S4. Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore (drurit, inerteve etj)	Respektimi i kriterëve dhe ligjeve për shfrytëzimin e inerteve	K. Komunal,	Inspektorati i Komunës dhe MMPH-së	2016 - 2017	Pa implikime buxhetore	
	S5. Krijimi i kushteve për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit	Hartimi i planeve për zonat turistike	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	300,000.00
		Promovimi i pikave turistike	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2018	Buxheti Komunal,	20,000.00
		Rregullimi i infrastrukturës në zona turistike sipas planit	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret	/
	S6. Krijimi i kushteve për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme	Përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	Buxheti Komunal, Grantet Qeveritare, Donatoret dhe INDEP	1,000,000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS							
	S1. Asfaltimi dhe mirembajtja e rrugëve	Riparimi dhe mirembajtja e rrugëve të asfaltuara	K. Komunal	MI, K.Komunal	2016 - 2025	K. Komunal, Granti Qeveritar	370,000.00
		Asfaltimi i disa rrugëve në qytet me shtresën e dytë me trashësi d=4.0cm	K. Komunal	MI, K.Komunal	2016 - 2018	K. Komunal, Granti Qeveritar	250,000.00
		Ndërtimi i rrugës transite e cila do të ketë gjatësi 2.45 km dhe do të lidhë rrugët regjionale (R127 dhe R126).	MI, K. Komunal	MI, K.Komunal	2016 - 2018	Granti Qeveritar	245,000.00
		Asfaltimi i rrugëve lokale në vendbanimet e Komunës së Podujevës përfshirë edhe ekspozimin e nevojshëm të tokave	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2018	Komuna, Granti Qeveritar	4,365,315.00
		Mirëmbajtja e rrugëve lokale - Rrugët e pa asfaltuara duhet të mirëmbahen me mbulesë të rërës dhe zhavorrit	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2025	Komuna, Granti Qeveritar	270,000.00
		Rregullimi i trotuareve përgjatë rrugëve	MI	K. Komunal	2016 - 2020	Komuna, Granti Qeveritar	800,000.00
		Rregullimi i anësorëve mbrojtëse përgjatë segmentit të rrugëve nacionale dhe regjionale (në të dy anët e rrugës): Llugë (2.5 km), Shajkovc (3.5 km), Podujevë (2.4 km), Lapshticë e Epërme (1 km), Dobratin (0.9 km), Zakut (3.8 km)	MI	K. Komunal	2016 - 2020	MI	100,000.00
		Rregullimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal	MI	K. Komunal	2016 - 2020	Granti Qeveritar	150,000.00
		Rregullim, mirëmbajtje dhe zgjerim të urave	MI	K.Komunal	2016 - 2018	Granti Qeveritar	280,000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
Infrastrukturë të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët	S2. Funkcionalizim i vijës hekurudhore	Rregullimi i sinjalizimit për vijën hekurudhore, në vendbanime të mëdha dhe të frekuentuara me dendësi të popullsisë e sidomos në qendrat (Podujevë, Surkish, Siboc i Epërm, Lluzhan)	MI	K. Komunal,	2016 - 2025	Granti Qeveritar	5,000.00
	S3. Përmirësim i rrjetit energjetik	Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Batlavë, përmirësim solid	K. Komunal, KEDS	K. Komunal,	2016 - 2025	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	5,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Batlavë - Orllan - përmirësim solid	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2017	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	170,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Podujevë 1 përmirësim selektiv	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2020	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	280,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Podujevë 2, përmirësim selektiv	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	220,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Podujevë 3, përmirësim selektiv	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	220,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Podujevë 4, përmirësim solid	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	120,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Podujevë 5, përmirësim solid	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	120,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Sillosi përmirësim solid	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	120,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Ballovcit përmirësim selektiv	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	220,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Fshatrat 1 përmirësim selektiv	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	200,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Fshatrat 2 përmirësim selektiv	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	250,000.00

Qëllimi	Synimi	Projektet:	Aktorët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi financiar	Çmimi (€)
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Livadica përmirësim selektiv	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	220,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Letanc përmirësim selektiv	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	200,000.00
		Rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet nga 10kv në 20kv si vijon: Drejtimi Llausha përmirësim solid	K. Komunal, KEDS	K. Komunal	2016-2018	K. Komunal, KEDS, Granti Qeveritar	120,000.00
	S4. Përmirësim i telefonisë	Telefonia fikse - Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse në disa vendbanime të mëdha ku mungon telefonia fikse.	K. Komunal / PTK	K. Komunal	2016-2018	PTK	Vlere e madhe
		Foltore publike të propozuara në qendrat sekondare (Kerpimeh dhe Orllan) duhet të jetë minimum dy për qendër sekondare	K. Komunal / PTK	K. Komunal	2016-2018	PTK	30,000.00
	S5. Zgjerim dhe kontroll i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit	Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit qendror në fshatin Orllan.	K. Komunal,	K. Komunal	2016 - 2020	K. Komunal, donatorët, komuniteti	300,000.00
		Zgjerimi dhe mirembajtja e rrjetit të ujësjellësit	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	K. Komunal, Granti Qeveritar	100,000.00
		Zgjerimi i shtrirjes së rrjetit të kanalizimit në tërë territorin e komunës	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	K. Komunal, Granti Qeveritar	400,000.00
		Rindertimi dhe mirembajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	K. Komunal, Granti Qeveritar	10,000.00
		Ndertimi i kolektoreve të ujërave të zeza	K. Komunal,	K. Komunal,	2016 - 2025	K. Komunal, Granti Qeveritar	2,500,000.00
		Kaptimi i burimeve "Vrella e Revuçit" dhe ndërtimi i ujësjellësit për vendbanimet e zonës	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2025	K. Komunal, donatorët, komuniteti	150,000.00
		Kaptimi i burimeve "Vrella e Zhitisë" dhe ndërtimi i ujësjellësit për vendbanimet e zonës	K. Komunal	K. Komunal	2016 - 2025	K. Komunal, donatorët, komuniteti	150 000
		Përcjellja dhe kontrolli i cilësisë së ujit në vendbanime pa ujësjellës	K. Komunal	K. Komunal,	2016 - 2025	K. Komunal	50,000.00
		Ndërtimi i rrjetit të veçantë të ujërave të zonës industriale dhe trajtim adekuat i tyre.	K. Komunal, Sektori privat industrial	K. Komunal,	2016 - 2025	K. Komunal, Sektori privat industrial	200,000.00